



**Botim i përtremuajshëm i QSHRT**  
(Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës)



**QSHRT Botimet 2011**  
Rr. "Kont Urani" Nr.10



Me mbështetjen e Bashkimit Evropian

Në kuadër të zbatimit të programit "Mbështetje për të drejtat e njeriut dhe aksesin në drejtësi për grupet e marginalizuara në vendet e privimit të lirisë"



**SHËNDETI MENDOR**  
dhe TË DREJTAT E NJERIUT

**SHËNDETI MENDOR**  
dhe TË DREJTAT E NJERIUT

Vol 13 (2012)  
Nr. 1

SHËNDETI MENDOR  
dhe TË DREJTAT E NJERIUT

---

**Parandalimi i torturës**

*Përmbledhje aktesh*

Ne kuader te zbatimit te programit “Mbeshtetje per te drejtat e njeriut dhe aksesit ne drejtesi per grupet e marginalizuara ne vendet e privimit te lirise”



Publikuar me mbështetjen e Komisionit Evropian  
**Volumi 13, Numri I (2012)**

## TE DREJTAT E NJERIUT DHE SHENDETI MENDOR



©Copyright: Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës (QSHRT). Te gjitha te drejtat jane te rezervuara. Permbajtja e ketij botimi nuk mund te riprodhohet, kopjohet pa citimin ne dokument.

Permbajtja reflekton opinionet e botuesit dhe ne asnje rrethane te Komisionit Evropian

Botimet QSHRT 2012

Drejtor Ekzekutiv:

Adrian KATI

**ARCT/QSHRT**

Rr.Kont Urani 10

Tirana, ALBANIA

Tel: +355 422 56522

Fax:+355 422 39121

Email: arct@albmail.com

Grafika

Elvira Çiraku (Osmani)

---

## PËRMBAJTJA E LËNDËS

---

NDALIMI, DËNIMI DHE PARANDALIMI I TORTURËS DHE  
DËNIMEVE A TRAJTIMEVE TË TJERA MIZORE,  
ÇNJERËZORE OSE DEGRADUESE (CAT) ..... 5

Hyrje: Ndalimi i torturës si dimension i së  
drejtës ndërkombëtare në të drejtën kushtetuese ..... 5

2. Problemet kushtetuese ..... 6

3. Jurisprudenca e zhvilluar nga organet e Strasburgut ..... 8

4. Ndalimi i Torturës në Të Drejtën Humanitare ..... 9

5. Perfundime dhe shenime ..... 12

6. Konventat e OKB-se Karta e Kombeve të Bashkuara ..... 15

7 Tekste të miratuara nga Këshilli i Europës..... 107


8 Tekste të miratuara nga Bashkimi Europian ..... 139

KONVENTA KUNDER TORTURËS DHE  
DËNIMEVE A TRAJTIMEVE TË TJERA MIZORE,  
ÇNJERËZORE OSE DEGRADUESE (CAT)  
dhe legjislacioni shqiptar ..... 147

Hyrje ..... 147

Kuadri i përgjithshëm ligjor ..... 147

Angazhime të tjera që rrjedhin nga Konventat e ratifikuara ....	151
Përfshirja në legjislacionin e brendshëm .....	154
Mjetet ligjore të mbrojtjes .....	154
Informacion në lidhje me nenet e pjesës i të konventës .....	155



## NDALIMI, DËNIMI DHE PARANDALIMI I TORTURËS DHE DËNIMEVE A TRAJTIMEVE TË TJERA MIZORE, ÇNJERËZORE OSE DEGRADUESE (CAT)

### 1. Hyrje

Ndalimi i torturës konsiderohet gjerësisht si një ndër të drejtat themelore të njeriut. Në optikën e së drejtës ndërkombëtare, ndalimi i torturës u sanksionua që me hartimin e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut<sup>1</sup>, për të vazhduar më pas me instrumentët e tjerë global dhe rajonal në fushën e të drejtave të njeriut. Paralelisht me këto zhvillime, ndalimi i torturës ka gjetur pasqyrim në të drejtën e brendshme dhe vecanërisht në të drejtën kushtetuese. I tillë është rasti i Shqipërisë, ku ligjvënësi ka sanksionuar ndalimin e torturës në Kushtetutë dhe në legjislacionin penal.

Megjithatë, në praktikën e gjyqësore gjithnjë lindin pikëpyetje mbi përkufizimin e nocionit të 'torturës' sikundër shtrirjes së rrethit të subjekteve që mund të implikohen në rast të kryerjes së kësaj vepre penale.

Nëpërmjet vendimit të datës 15.10.2003, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në çështjen në ngarkim të të gjykuarit Y. H. i akuzuar për vepren penale të torturës parashikuar nga Nenet 86 dhe 87 të Kodit Penal, ka çmuar se dispozitat e Kodit Penal që parashikojnë torturën vijnë në kundërshtim me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga ana e Republikës së Shqipërisë. Ndodhur në këto rrethana, Kolegji Penal, bazuar në nenin 145/2 të Kushtetutës, vendosi pezullimin e gjykimit të çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës Kushtetuese për t'u shprehur për kushtetutshmërinë e dispozitave.

Sipas Gjykatës së Lartë, kuptimi i tortures, i dhënë në dispozitat e sipërpërmendura të Kodit Penal është i ndryshëm nga formulimi kushtetues dhe ai i instrumentëve ligjore ndërkombëtare. Kjo pasi tortura konsiderohet si një vepër penale e kryer nga persona zyrtarë ose me nxitjen e tyre kryesisht ndaj personave të privuar nga liria, ose personave që përballen me organet e policisë. Në vështrimin e Gjykatës së Lartë, vendosja e dispozitave ligjore në Kodin Penal, nuk është në përputhje me atë çfarë parashikohet në aktet ndërkombëtare, sepse rrethi i marrëdhënieve që mbrohen merr kuptim më të ngushtë se ai i dhënë në aktet ndërkombëtare dhe në Nenin 314 të Kodit Penal.

## 2. Problemet kushtetuese

Në vendimin e Gjykatës së Lartë, megjithëse pretendohet për antikushtetutshmëri të dispozitave të Kodit Penal që kanë të bëjnë me torturën, nuk arsyetohet se cila pjesë e Nenit 25 të Kushtetutës apo dispozita të tjera të saj çënohen nga formulimi i Neneve 86 dhe 87 të Kodit Penal. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për aktet ndërkombëtare në të cilat ka aderuar Republika e Shqipërisë.

Në kontekstin kushtetues, mosnënshtrimi ndaj torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues është përfshirë si garanci kushtetuese në kreun e lirive dhe të drejtave vetjake<sup>2</sup>. Ndërkohë, Nenet 863 dhe 874 të Kodit Penal nuk bëjnë gjë tjetër veçse sigurojnë zbatimin e këtij detyrimi kushtetues përmes sanksioneve në rast të konsumimit të veprës penale të torturës. E thënë ndryshe, Nenet 86 dhe 87 të Kodit Penal janë pasojë e drejtpërdrejt e Nenit 25 të Kushtetutës.

Përcaktimi i dispozitave të mësipërme në njërën apo tjetrën pjesë të Kodit Penal nuk ka asnjë relevancë kushtetuese, por mund të përbëjë objekt diskutimi në sfondin e teknikës legjislative<sup>5</sup>. Po kështu, ngushtimi a zgjerimi i subjektit që mund të përgjigjet penalisht për veprat e parashikuara në nenet 86 dhe 87 të Kodit Penal nuk sjell implikime të karakterit kushtetues, sa kohë që parashikohet kryerja e këtyre veprave me dashje. Madje, në literaturën e së drejtës penale shqiptare është pranuar se subjekti i krimit është personi që ka mbushur moshën e caktuar për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm, subjekt i përgjithshëm apo i posaçëm, civil a ushtarak<sup>6</sup>.

Zgjerimi i subjekteve përgjegjëse është në përputhje me frymën e përcuar nga formulimi i traktateve ndërkombëtare mbi detyrimet pozitive që rrjedhin për shtetet pale, si dhe në jurisprudencën

ndërkombëtare në fushën e të drejtave njeriut, *ius in bello* (e drejta ndërkombëtare humanitare), dhe në të drejtën ndërkombëtare penale.

Komiteti për të Drejtat e Njeriut e ka lidhur të drejtën për të mos qenë subjekt i torturës dhe keqtrajtimit – sipas nenit 7 të Paktit mbi të Drejtat Civile dhe Politike - me detyrimin e shtetit për të siguruar mbrojtje nëpërmjet ‘masave legjislative ose masave të tjera’ kundër torturës apo keqtrajtimit nga individët privatë. Qëllimi i Neni 7 të Paktit është mbrojtja e dinjitetit dhe integritetit fizik e mendor të individit. Ndaj, është detyrë e çdo shteti palë të ofrojë për këdo mbrojtje nëpërmjet legjislacionit dhe masave të tjera që mund të konsiderohen të nevojshme kundër veprimeve të ndaluara nga Neni 7, pavarësisht nëse shkaktohen nga njerëz që veprojnë në kapacitet zyrtar, jashtë kapacitetit të tillë zyrtar ose në kapacitet privat<sup>7</sup>.

Gjithashtu, Gjykata Europiane e të Drejtave të njeriut – e mirënjohur në praktikën e saj për dimensionin horizontal që i ka dhënë mbrojtjes së të drejtave substanciale të parashikuara nga Konventa<sup>8</sup> - në çështjen A. kundër Mbretërisë së Bashkuar arriti në përfundimin se “detyrimi i shteteve anëtare nga Neni 1 i Konventës për t’i siguruar kujtdo që ndodhet nën juridiksionin e tij të drejtat dhe liritë e shprehura në Konventë, e kombinuar së bashku me Nenin 3 të saj, i kërkon shteteve anëtare të marrin masa të përcaktuara për të siguruar se individët nën juridiksionin e tyre nuk janë subjekt i torturës apo keqtrajtimit çnjerëzor degradues, duke përfshirë edhe keqtrajtimet e kryera nga individët privatë”<sup>9</sup>.

Ndërsa në çështjen Velasquez Domingues kundër Hondurasit, Gjykata Ndër-Amerikane e të Drejtave të Njeriut, ndër të tjera theksoi se, “detyrimi i shteteve anëtare në Konventën Amerikane për të siguruar ushtrimin e të drejtave të parashikuara në Konventë, përfshin detyrimin e shteteve anëtare të organizojnë aparatin e tyre qeverisës, dhe në përgjithësi strukturat përmes të cilave ushtrohet pushteti publik, në mënyrë që ato të jenë në gjendje që juridikisht të sigurojnë gëzim të lirë dhe të plotë të të drejtave të njeriut, pasi edhe një akt i kundraligjshëm që shkel të drejtat e njeriut dhe që nuk është kryer nga shteti mund të çojë në përgjegjësi ndërkombëtare të shtetit, jo për faj të aktit në vetvete, por, për shkak të mungesës së vigjilencës së duhur për të parandaluar shkeljen, apo për t’iu përgjigjur asaj çfarë kërkohet nga Konventa”<sup>10</sup>.

Në të njëjtën frymë interpretuese, duke u mbështetur në doktrinën e së drejtës ndërkombëtare, Gjykata Kushtetuese shqiptare arriti në



përfundimin se: “për sa kohë që ndalimi i torturës dhe keqtrajtimi është përcaktuar si një e drejtë njerëzore dhe përderisa të drejtat e njeriut janë konsideruar si të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme, çdonjeri ka të drejtë për të mos iu nënshtruar torturës apo keqtrajtmeve, pavarësisht se ai është në duart e një zyrtari publik apo të një individi”<sup>11</sup>.

Në vendimin e saj, Gjykata Kushtetuese shkon edhe më tej, duke sanksionuar detyrimin e shtetit për të mbrojtur shtetasit e tij nga kryerja e torturës apo keqtrajtit nga zyrtarët publik, por edhe në detyrimin për të marrë masa për t’i mbrojtur njerëzit ndaj akteve të torturës apo keqtrajtit të kryer edhe nga individë<sup>12</sup>. Me pak fjalë, Gjykata Kushtetuese, përmes arsytimit të mësipërm, i dha ndalimit të torturës një dimension horizontal mbrojtje në praktikën e përditshme.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është i rëndësishëm edhe për shkak të njohjes së rolit të së drejtës ndërkombëtare. Sipas Gjykatës Kushtetuese, “e drejta ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut sanksionon si rregull vetëm një minimum bazë të lirive dhe të drejtave, ndërkohë që shtetet palë në konventat ndërkombëtare mund të ngrihen mbi këto minimume dhe të implementojnë ligje kombëtare që përmbajnë ose mund të përmbajnë dispozita të një karakteri më të gjerë”<sup>13</sup>. Në të vërtetë, ky qëndrim konsolidon jurisprudencën kushtetuese në këtë fushë bazat e së cilës i gjejmë të ngulitura që në çështjen Rakipi.

### **3. Jurisprudenca e zhvilluar nga organet e Strasburgut**

Aksoy<sup>14</sup> ishte çështja e parë në të cilën Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut përdori cilësimin ‘torturë’, si mënyrë përshkruese për sjelljen e zyrtarëve shtetërorë<sup>15</sup>. Më pas, Gjykata konstatoi disa raste torture në çështjet Aydin kundër Turqisë<sup>16</sup>, Çakici kundër Turqisë<sup>17</sup>, si dhe në çështjen Selmouni kundër Francës<sup>18</sup>.

Në jurisprudencën e hershme të Komisionit Europian të të Drejtave të Njeriut tortura u evidentua në dy raste: në çështjen Greke<sup>19</sup> dhe në çështjen Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar<sup>20</sup>. Gjithsesi, çështja e parë nuk erdhi kurrë në Gjykatë, ndërsa në të dytën Gjykata përqafoi një qëndrim më fleksibël, duke konstatuar ‘trajtme çnjerëzore dhe degraduese’ në vend të ‘torturës’.

Sipas jurisprudencës së Strasburgut, ‘tortura’ përfshin mundime shumë serioze dhe vuajtje mizore. Ndërsa, nocionet e trajtimve ‘çnjerëzore’ dhe ‘degraduese’ përfshijnë situata më pak serioze, megjithëse këto situata sërish bien në rrezën e veprimit të Nenit 3 të

Konventës. Në çështjen Tyer kundër Mbretërisë së Bashkuar<sup>21</sup>, Gjykata vlerësoi se ndëshkimi trupor, të cilit i ishte nënshtruar një djalë 15 vjeçar kualifikohej si ndëshkim 'degradues'. Nga ana tjetër, i njëjti pretendim i ngritur në çështjen Costello-Roberts kundër Mbretërisë së Bashkuar<sup>22</sup> nuk arriti 'niveлин minimal të ashpërsisë' si kërkesë e Nenit 3 të Konventës.

Në çështjen Ribitsch kundër Austrisë<sup>23</sup>, e cila kishte të bënte me dhunën fizike ushtruar ndaj disa të burgosurve, Gjykata konkludoi se të burgosurit ishin ekspozuar ndaj 'një trajtimi çnjerëzor dhe degradues'. Ndërkohë, në çështjen Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar<sup>24</sup>, Gjykata e Strasburgut argumentoi se ekstradimi i aplikantit për në SHBA e ekspozonte atë ndaj një risku real për keqtrajtim, që shkon përtej kufijve të përcaktuar në Nenin 3.

#### **4. Ndalimi i torturës në të drejtën ndërkombëtare**

Tortura dhe çdo trajtim çnjerëzor e degradues janë të ndaluara sipas të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ius in bello (e drejta ndërkombëtare humanitare), dhe të drejtës ndërkombëtare penale. Dëshmi e pohimit të mësipërm janë dispozitat e Paktit mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa Kundër Torturës e OKB-së, Protokolli Opsional i Konventës së OKB-së kundër Torturës, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, Konventa kundër Torturës e Këshillit të Europës, Statuti i Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare, Statuti i Tribunalit Penal Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë, Statuti i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ruandën, Konventa Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut dhe Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve. Mund të thuhet pa mëdyshje se 'ndalimi i torturës dhe trajtimeve poshtëruese e degraduese' gjen pasqyrim në shumicën e traktateve që përfshihen brenda disiplinave të ndryshme të së drejtës ndërkombëtare.

Krahas aspektit konvencional, ndalimi i torturës është kthyer në pjesë përbërëse të së drejtës zakonore ndërkombëtare. E drejta zakonore ndërkombëtare është burim i së drejtës ndërkombëtare dhe siç u konfirmua nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në çështjen Nikaragua kundër SHBA-së<sup>25</sup>, ajo përbëhet nga ana objektive, ose e njohur ndryshe si rregulla ndërkombëtare që rrjedhin nga praktika e shteteve për një kohë të gjatë (usus), të cilat mbështeten në anën subjektive, pra, në një opinion ligjor që konsiderohet si ligj (opinion

juris sive necessitatis)<sup>26</sup>. Praktika e shteteve në vetvete nuk mjafton, ajo duhet shoqëruar me bindjen e shteteve (elementin psikologjik) që një formë e caktuar sjelljeje kërkohet nga e drejta ndërkombëtare.

Komiteti për të Drejtat e Njeriut ka theksuar se detyrimi për mos t'iu nënshtruar torturës apo keqtrajtimit është një rregull i së drejtës zakonore ndërkombëtare, dhe se ndalimi i torturës përbën një normë të pakundërshtueshme<sup>27</sup>.

Drejtësia ndërkombëtare në disa çështje radhazi (për shembull, Prokurori i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë kundër Furundzija<sup>28</sup>, Prokurori i Tribunalit Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë kundër Delacic dhe të tjerët<sup>29</sup>, Prokurori i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë kundër Kunarac<sup>30</sup>, Regina v. Bow Street Metropolitan Stipendiary Magistrate & others, ex parte Pinochet Ugarte<sup>31</sup>) ka konfirmuar 'ndalimin e torturës' si një normë të pakundërshtueshme të së drejtës ndërkombëtare (jus cogens)<sup>32</sup>.

Duke iu referuar çështjeve Furundzija dhe Pinochet, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut me të njëjtën vendosmëri konkludoi se "ndalimi i torturës ka arritur statusin e një norme të pakundërshtueshme në të drejtën ndërkombëtare"<sup>33</sup>.

Ndërkohë, Gjykata Kushtetuese shqiptare e konsideron detyrimin për të mos iu nënshtruar torturës apo keqtrajtimit si një 'rregull të së drejtës zakonore ndërkombëtare' dhe se ndalimi i torturës përbën një 'normë të pakundërshtueshme'<sup>34</sup>. Megjithëse indirekt Gjykata Kushtetuese njohu rëndësinë e zakonit ndërkombëtar, ajo nuk bëri një vlerësim të fuqisë juridike të zakonit ndërkombëtar në kontekstin kushtetues.

Ndalimi i torturës, si një norme e pakundërshtueshme mund të shquhet qartë edhe në sfondin e mosderogimit. Neni 15/2 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut e liston 'ndalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor e degradues' së bashku me Nenin 2 (të drejtën e jetës), Nenin 4/1 (ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar), Nenin 7 (nuk ka dënim pa ligj), si ndër të drejtat e paderogueshme edhe në rast se një shtet përballet me një situatë emergjence apo gjendje të jashtëzakonshme.

Mirëpo, Neni 2 lejon marrjen e jetës kur vjen si rezultat i përdorimit të forcës kur ajo (forca) konsiderohet absolutisht e domosdoshme. Të njëjtën gjë parashikon edhe Neni 2 i Protokollit 6 të Konventës. Ndërkohë, rastet përjashtimore të Nenit 7 të Konventës mund të aplikohen në situatat e një konflikti ndërkombëtar të armatosur<sup>35</sup>. Pra, 'ndalimi i

torturës dhe trajtimit çnjerëzor e degradues' dhe 'ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar' janë të drejta absolutisht të paderogueshme në çfarëdo lloj rrethane<sup>36</sup>.

Në çështjen Aksoy kundër Turqisë, ku aplikanti pretendonte se ishte keqtrajtuar në formën më ekstreme të mundshme, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut theksoi se: "Neni 3 përbën një nga vlerat themelore të shoqërisë demokratike. Edhe në rrethanat më të vështira, siç është lufta kundër terrorizmit dhe krimit, Konventa ndalon në mënyrë absolute torturën, dënimin apo trajtimin çnjerëzor ose degradues. Ndryshe nga shumë dispozita të Konventës dhe të Protokollit Nr 1 dhe 4, Neni 3 nuk ka asnjë parashikim për përjashtim apo shmangie prej tij të lejuar në bazë të Nenit 15 edhe në rastet e emergjencës publike të kërcënimit të jetës së një kombi"<sup>37</sup>.

Normat e ashtuquajtura jus cogens apo detyrimet me karakter erga omnes, janë detyrime që rrjedhin nga normat e gjithpranuara të së drejtës zakonore ndërkombëtare, të cilat i adresohen gjithë bashkësisë ndërkombëtare si një e tërë dhe gëzojnë një status superior në të drejtën ndërkombëtare në raport me normat e zakonshme<sup>38</sup>. Këto norma janë të detyrueshme për t'u zbatuar edhe në rast të mos aderimit të Republikës së Shqipërisë në një apo disa instrumente ndërkombëtare që ndalojnë expressis verbis përdorimin e torturës. Ndaj, detyrimet me karakter erga omnes rredhin që prej momentit që norma ka fituar statusin e jus cogens. Për pasojë, shteti duhet të marrë masa efektive për të ndaluar torturën dhe të dënojë veprimet që kualifikohen si akte torture. Pra, gjykatat e zakonshme dhe aq më tepër Gjykata e Lartë, e cila është instanca kompetente për të unifikuar praktikën ligjore, duhet të analizojnë elementët e veprës penale në përputhje me Kushtetutën dhe përkufizimin e ofruar nga e drejta ndërkombëtare e detyrueshme për Republikën e Shqipërisë.

Kushtetuta shqiptare në Nenin 5 të saj përcakton se "Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të". E drejtë ndërkombëtare e detyrueshme për Republikën e Shqipërisë nuk është thjesht tërësia e detyrimeve që rrjedhin prej instrumentave ndërkombëtare (konventa, pakte, marrëveshje, traktate) ku aderon Republika e Shqipërisë, por edhe normat e gjithpranuara të së drejtës zakonore ndërkombëtare dhe parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, të cilat përbëjnë burim të së drejtës ndërkombëtare, sipas Nenit 38 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë<sup>39</sup>.

Duke marrë shkas nga çështja në shqyrtim, për Gjykatën Kushtetuese do të ishte një rast i mirë për të bërë një interpretim të zgjeruar, përfundimtar e funksional<sup>40</sup> të Nenit 5 të Kushtetutës, duke shmangur njëkohësisht qëndrimin kazuistik në lidhje me fuqinë juridike të tij<sup>41</sup>. Norma të tilla jo vetëm që nuk mund të injorohen, por ato duhen konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës së brendshme të shteteve<sup>42</sup>.

## 5. Përfundime

Ky artikull kishte për qëllim të argumentonte ndër të tjera se:

- Ndalimi i torturës ka fituar një tjetër dimension në të drejtën ndërkombëtare si pasojë e zhvillimeve të vrullshme jurisprudenciale, ç'ka pasqyrohet edhe në të drejtën kushtetuese. Madje, jurisprudenca kushtetuese (dëshmi e vlefshme është vendimi i Gjykatës Kushtetuese V-3/2004) pranon diskrecionalitetin e shteteve për të vendosur në legjislationin e brendshëm rregulla mbrojtës të një spektri më të gjerë se ato të ofruara nga e drejta ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut.
- Jurisprudenca ndërkombëtare e cila shfaqet e shumëllojshme në lidhje me 'torturën', 'trajtimin çnjerëzor dhe poshtëruës' duhet të kihet në vëmendje nga gjykatat e zakonshme në rastet e cilësimit të veprave penale. Në këtë drejtim, roli i Gjykatës së Lartë, si instanca e vetme për unifikimin e praktikës ligjore mbetet i pazëvendësueshëm.
- Me gjithë risitë e evidentuara në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, si dhe me njohjen e rolit të veçantë të së drejtës ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, ajo (Gjykata Kushtetuese) kishte mundësi që të bënte një interpretim të zgjeruar e përfundimtar të Nenit 5 të Kushtetutës, duke shmangur njëkohësisht qëndrimin kazuistik në lidhje me fuqinë juridike të tij.

## Shenime

- 1 Shih për këtë argument, P. V. Kessing, *New Optional Protocol to the UN Torture Convention*, *Nordic Journal of International Law*, (2003).
- 2 Neni 25 i Kushtetutës thotë: "Askush nuk mund t'i nënshtrohet

- torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës”.
- 3 Neni 86 i Kodit Penal thotë: “Tortura si dhe çdo akt tjetër çnjerëzor apo poshtëruës dënohen me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet”.
  - 4 Neni 87 i Kodit Penal thotë: “Tortura si dhe çdo akt tjetër çnjerëzor, kur ka sjellë gjyktimin, shëmtimin ose çdo dëmtim të përhershëm të shëndetit të personit apo vdekjen, dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet”.
  - 5 Shembuj të ngjashëm adoptimi – sikundër Kodi Penal shqiptar - mund të gjejmë në Itali.  
Shih për këtë argument edhe Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr. 3 të datës 11.02.2004.
  - 6 Shih, I. Elezi, E Drejta Penale 70-71 (2002).
  - 7 Shih për më gjerë, Komentin e Përgjithshëm 20, para., 2 të Komitetit për të Drejtat e Njeriut.
  - 8 Shih për shembull, X dhe Y kundër Holandës, Vendim i 26 marsit 1985, A-91.
  - 9 Vendimi A. kundër Mbretërisë së Bashkuar, i datës 23.09.1998, para. 21-22.
  - 10 Velasques Rodriguez kundër Hondurasit, Vendim i Gjykatës Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut, i 10 shtatorit 1996, para., 166 dhe 172.
  - 11 V-3/2004.
  - 12 Shih po aty.
  - 13 Po aty.
  - 14 Aksoy kundër Turqisë, Vendim i 18 Dhjetorit 1996.
  - 15 Shih, R.A. Lawson & H.G. Schermers, Leading Cases of the European Court of Human Rights 665 (1999).
  - 16 Vendim i 25 Shtatorit 1997.
  - 17 Vendim i 8 Korrikut 1999.
  - 18 Vendim i 28 Korrikut 1999.
  - 19 Çështja Greke, Appl. No. 3321/67 Yearbook vol. 12 (1969), p. 501.
  - 20 Appl. No. 5310/71, B-23, p. 411.
  - 21 Vendim i 25 Prillit 1978, A-26.
  - 22 Vendim i 25 Marsit 1993, A-247-C.

- 23 Vendim i 4 Dhjetorit 1995, A-336.
- 24 Vendim i 7 Korrikut 1989, A-161.
- 25 Nikaragua kundër SHBA-së (Merits), ICJ. Rep 1986, 14 at 97.
- 26 Sipas nenit 38 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, "Gjykata, misioni i së cilës është të zgjidhë sipas të drejtës ndërkombëtare mosmarrëveshjet që i paraqiten, zbaton: .b) zakonin ndërkombëtar si provë të një praktike të përgjithshme të pranuar si normë e së drejtës...."
- 27 Shih, Komentin e Përgjithshëm 24 të Komitetit për të Drejtat e Njeriut të Paktit mbi të Drejtat Civile dhe Politike.
- 28 Vendim i 10 Dhjetorit 1998, Case no. IT-95-17/I.
- 29 Vendim i 16 Nëntorit 1998, Case no. IT-96-21-T, 454.
- 30 Vendim i 22 Shkurtit 2001, Case no. IT-96-23-T dhe IT-96-21/1, 466.
- 31 Vendim i 24 Marsit 1999 (2000) Appeal Cases 147.
- 32 Sipas nenit 53 të Konventës së Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve të vitit 1969 jus cogens është "një normë e pranuar dhe e njohur nga komuniteti ndërkombëtar i shteteve si një e tërë, si një normë nga e cila asnjë derogim nuk është i lejueshëm dhe e cila mund të modifikohet vetëm nga një normë e mëvonshme e së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare që ka të njëjtin karakter". Konventa e Vjenës është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 8696 të datës 23.11.2000.
- 33 Shih, Al-Adsani kundër Mbretërisë së Bashkuar, Vendim i 21 Nëntorit 2001, para., 61.
- 34 V-3/2004.
- 35 Shih, D.J. Harris, M.O. 'Boyle & C. Warbrick, Law of the European Convention on Human Rights 504 (1995).
- 36 Shih, D. Bushati, Human Rights in States of Emergency, Leiden University (2001).
- 37 Aksoy kundër Turqisë, Vendim i 18 Dhjetorit 1996, para., 62. Në paragrafët 76-78 të vendimit Gjykata riafirmoi sërish qëndrimin e vet ndaj joderogueshmërisë absolute të nenit 3 të Konventës. Për këtë argument Gjykata është shprehur edhe në çështjet Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar, Vendim i 18 Janarit 1978, A-25 para., 163 dhe Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar, Vendim i 7 Korrikut 1989, A-161 para., 88.

- 38 Në doktrinën e të drejtës ndërkombëtare pranohen gjerësisht si shëmbuj të normave jus cogens (peremptory norms) ndalimi i agresionit, genocidit, torturës, mbrojtja nga skllavëria, mbrojtja nga diskriminimi racial, ndalimi i përdorimit të armëve bërthamore etj.
- 39 Shih për këtë argument, M. Mendelson, *The International Court of Justice and the sources of international law*, in V. Loëe and M. Fitzmaurice (Ed.), *Fifty years of the International Court of Justice*, 63-89 (1996), i cili shpreh mendimin se Neni 38 i Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare pranohet në teorinë e së drejtës ndërkombëtare si dispozitë që përfaqëson listën e burimeve të së drejtës ndërkombëtare.
- 40 Një interpretim funksional do të përfshinte përveç burimeve eksplicite të së drejtës ndërkombëtare edhe Rezolutat e Këshillit të Sigurimit që adoptohen në bazë të Kreut VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe që janë të detyrueshme jo vetëm për palët në konflikt, por për të gjitha shtetet anëtare të OKB-së.
- 41 Gjykata Kushtetuese në të paktën dy vendime (Vendimi Nr. 65 i 10 dhjetorit 1999 me objekt "Pajtueshmëria me Kushtetutën e dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, që parashikojnë dënimin me vdekje", dhe Vendimi Nr. 186 i 23.09.2002 me objekt "Pajtueshmëria me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i Statutit të Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare") i është referuar Neni 5 të Kushtetutës.
- 42 Një qasje e tillë është adoptuar nga shumë shtete të tilla si Holanda, Gjermania, Spanja, Belgjika etj.

### **Konventat e OKB-se Karta e Kombeve të Bashkuara**

Nenshkruar në San Francisco, SHBA, më 26 Qershor 1945

Hyri në fuqi në 24 Tetor, 1945, në përputhje me nenin 110

Hyrje

Ne Popujt e Kombeve të Bashkuara të vendosur

Të shpëtojmë brezat që vijnë nga kamxhiku i luftës, i cili dy herë gjatë jetës sonë i ka sjellë njerëzimit hidhërim të paparë, dhe

Të riafirmojmë besimin në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe vlerën e qenies njerëzore, në të drejtat e barabarta midis burrave dhe grave dhe kombeve të mëdhenj e të vegjël, dhe



Të krijojmë kushtet në të cilat të mbrohen drejtësia dhe respektimi i detyrimeve që rrjedhin nga traktatet dhe burimet e tjera të ligjit ndërkombëtar, dhe

Të nxitim progres shoqëror dhe statndarde më të mira jetese në një shkallë më të gjerë lirie,

Dhe për këto qëllime

Të jemi tolerantë dhe të jetojmë sëbashku në paqe me njeri tjetrin si fqinj të mirë, dhe

Të bashkojmë forcat tona për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare,

Të përcaktojmë parime dhe të vendosim metoda që të garantojnë se nuk do të përdoret forca e armëve, përveç se kur këtë e kërkon interesi i përbashkët, dhe

Të shfrytëzojmë institucionet ndërkombëtare për nxitjen e përparimit ekonomik dhe shoqëror të të gjithë popujve,

Kemi vendosur të bashkërendojmë përpjekjet tona për përmbushjen e ketyre qëllimeve

Si rrjedhim, Qeveritë tona përkatëse, përmes përfaqësuesve të tyre të mbledhur në qytetin San Francisco, dhe të pajisur me fuqi të plota, që u gjetën në rregull dhe në formën e duhur, miratuan këtë Kartë të Kombeve të Bashkuara dhe nëpërmjet kësaj krijojnë një organizatë ndërkombëtare që do të marrë emrin e Kombeve të Bashkuara.

## KAPITULLI I

### Qëllimet dhe Parimet

#### *Neni 1*

Qëllimet e Kombeve të Bashkuara janë:

1. Të ruajnë paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, dhe për këtë qëllim: të marrë masa kolektive të efektshme për parandalimin dhe mënjanimin e kërcënimeve ndaj paqes, dhe për shtypjen e akteve të agresionit apo prishje të tjera të paqes, dhe, përmes mjeteve paqësore dhe në përputhje me parimet e drejtësisë dhe ligjit ndërkombëtar, të mundësojë ndrqjen ose zgjidhjen e mosmarrveshjeve ndërkombëtare apo të situatave të cilat mund të çojnë në prishje të paqes;

2. Të zhvillojë marrëdhënie miqësore ndërmjet kombeve duke u

bazuar në respektimin e parimit të të drejtave të barabarta dhe të së drejtës së tyre për vetëvendosje, dhe të marrë çdo masë tjetër që mund të forcojë paqen në botë;

3. Të realizojnë bashkëpunim ndërkombëtar për zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare me karakter ekonomik, shoqëror, kulturor dhe humanitar, dhe për nxitjen dhe mbështetjen e respektit për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore për të gjithë pa dallim për shkak të racës, seksit, gjuhës, ose fesë; dhe

4. Të jenë një qendër e harmonizimit të veprimeve të kombeve për arritjen e ketyre qëllimeve të përbashkëta.

#### *Neni 2*

Për realizimin e Qëllimeve të parashtruara në Nenin 1 Organizata dhe Anëtarët e saj do të veprojnë në përputhje me Parimet e mëposhtëme:

1. Organizata bazohet në parimin e barazisë sovrane të të gjithë Anëtarëve të saj.

2. Të gjithë Anëtarët, me qëllim që secilit prej tyre t'i sigurohen të drejtat dhe përfitimet që rezultojnë nga anëtarësimi, do të përmbushin në mirëbesim detyrimet e marra prej tyre në përputhje me Kartën aktuale.

3. Të gjithë Anëtarët do t'i zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre ndërkombëtare me mjete paqësore dhe në mënyrë të tillë që të mos rrezikojnë paqen, sigurinë dhe drejtësinë ndërkombëtare.

4. Në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare të gjithë Anëtarët do të shmangin kërcënimin për përdorimin ose përdorimin e forcës kundër integritetit territorial apo pavarësisë politike të çfarëdo shteti, ose në çfarëdo mënyre tjetër të papajtueshme me Qëllimet e Kombeve të Bashkuara.

5. Të gjithë Anëtarët do t'i japin Kombeve të Bashkuara çdo ndihmë në çdo veprim që ajo ndërmerr në përputhje me Kartën aktuale, dhe do të shmangin dhënien e ndihmës ndaj çdo shteti kundër të cilit Kombet e Bashkuara ndërmarrin veprime parandaluse ose detyruese.

6. Organizata do të sigurojë që shtetet që nuk janë Anëtarë të Kombeve të Bashkuara të veprojnë në përputhje me këto parime për aq sa do të jetë e nevojshme për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

7. Asnjë dispozitë e kësaj Karte nuk i autorizon Kombet e Bashkuara të ndërhyjnë në çështje që i përkasin kryesisht juridiksionit kombëtar të një shteti, as nuk i detyron Anëtarët të shtrojnë çështje të kësaj natyre,

për t'i zgjidhur sipas një proçedure të parashikuar në këtë Kartë. Megjithatë, ky parim nuk cënon aspak zbatimin e masave shtrënguese të parashikuara në Kreun VII.

## KAPITULLI IX

Bashkëpunimi ekonomik dhe shoqëror ndërkombëtar.

*Neni 55*

Me synimin për të krijuar kushtet e stabilitetit dhe mirëqenies që janë të domosdoshme për marrëdhëniepaqësore dhe miqësore ndërmjet kombeve mbi bazën e respektimit të parimit të të drejtave të barabarta dhe të vetëvendosjes së popujve, Kombet e Bashkuara do të nxisin:

a. Standarde më të larta jetese, punësim të plotë dhe kushte të progresit dhe zhvillimit social dhe ekonomik.

b. Zgjidhje të problemeve ekonomike, sociale dhe shëndetësore nderkombëtare; dhe

bashkëpunim kulturor dhe arsimor ndërkombëtar; dhe

c. Respektimin universal dhe efektiv të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjithë, pa dallim race, seksi, gjuhe ose feje.

## [...] KAPITULLI X

Këshilli Ekonomik dhe Shoqëror [...]

*Neni 62*

1. Këshilli Ekonomik dhe Shoqëror mund të kryejë ose të iniciojë studime dhe raporte për çështje nderkombëtare me karakter ekonomik, social, kulturor, arsimor, shëndetësor dhe mund t'i japë rekomandime për çështje të tilla Asamblesë së Përgjithshme, Anëtarëve të Kombeve të Bashkuara, dhe agjencive të specializuara të interesuara.

2. Ai mund të bëjë rekomandime me synimin për të nxitur respektimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjithë.

[...]

*Neni 68*

Këshilli Ekonomik dhe Shoqëror ngre komisione për fushat ekonomike dhe sociale dhe për nxitjen e të drejtave të njeriut, dhe të tjerë komisione të ngjashëm që mund të nevojiten për kryerjen e funksioneve të tij.

[...]

Pakti Ndërkombëtar për Të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR)<sup>1</sup>

Miraturar dhe e hapur për nënshkrim, ratifikim dhe aderim me Rezolutën 2200A (XXI) të Asamblesë së Përgjithshme të 16 Dhjetor 1966 Hyri në fuqi më 23 Mars 1976, në përputhje me nenin 49.

### *Hyrje*

Shtetet Palë në Paktin aktual,

Duke marrë parasysh se, në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, njohja e dinjitetit të qenësishëm dhe e të drejtave të barabarta e të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë,

Duke pranuar se këto të drejta rrejdhin nga dinjiteti i qenësishëm i qeniës njerëzore,

Duke pranuar se, në përputhje me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, ideali i qenieve të lira njerëzore, që gëzojnë liri civile dhe politike dhe liri nga frika e nevoja, mund të arrihet vetëm nëse krijohen kushtet në të cilat cilido mund të gëzojë të drejtat e veta civile dhe politike, si edhe të drejtat e veta ekonomike, sociale dhe kulturore,

Duke marrë parasysh detyrimin e Shtetve sipas Kartës së Kombeve të Bashkuara për të nxitur respektimin dhe zbatimin universal të të drejtave dhe lirive të njeriut,

Duke kuptuar se individi, duke pasur detyrime ndaj individëve të tjerë dhe ndaj komunitetit të cilit ai i përket, ka përgjegjësinë të përpiqet për nxitjen dhe zbatimin e të drejtave të njohura në Kartën aktuale,

Janë dakord me nenet e mëposhtëme: [...]

### *Neni 2*

1. Secili Shtet Palë në Paktin aktual angazhohet të respektojë dhe t'u sigurojë të gjithë individëve brenda territorit të tij dhe nën juridiksionin e tij të drejtat e njohura nga Pakti aktual, pa dallim të çdo lloji, si rraca, ngjyra, seksi, gjuha, feja, opinionin politik apo çdo opinionin tjetër, origjina kombëtare ose sociale, prona, statusi i lindjes ose çdo status tjetër.

2. Aty ku masat ekzistuese legjislative ose të tjera nuk i mundësojnë, çdo Shtet Palë në Pakt, në përputhje me të drejtën e tij kushtetuese dhe me dispozitat e Paktit aktual, angazhohet të ndër marrë hapat e nevojshëm për miratimin e ligjeve ose masave të tilla, të nevojshme për

të zbatuar të drejtat e njohura në Paktin aktual.

3. Secili Shtet Palë në Paktin aktual angazhohet:

(a) Të sigurojë që çdo person, të drejtat ose liritë e të cilit të njohura prej këtej dhunohen, do të ketë një zgjidhje të efektshme, pavarësisht se dhunimi është kryer nga persona që veprojnë në cilësi zyrtare.

(b) Të sigurojë që e drejta e çdo personi që kërkon një zgjidhje të tillë të përcaktohet nga autoritetet kompetente gjyqësore, administrative ose legislative, ose nga çdo autoritet tjetër kompetent i parashikuar nga sistemi ligjor i Shtetit, dhe të zhvillojë mundësitë e zgjidhjes gjyqësore;

(c) Të sigurojë që autoritetet kompetente të zbatojnë të tilla zgjidhje kur ato jepen.

*[...] Neni 4*

1. Në situata emergjencash publike që kërcënojnë jetën e kombit, egzistenca e të cilave shpallet zyrtarisht, Shtetet Palë në Paktin aktual mund të marrin masa që shmangen nga detyrimet e tyre ndaj Paktit aktual deri në atë shkallë që kërkohet rreptësisht nga situata, me kusht që masa të tilla të mos jenë të papajtueshme me detyrimet e tjera të tyre sipas të drejtës ndërkombëtare dhe të mos shkaktojnë diskriminim vetëm për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë ose origjinës shoqërore.

2. Asnjë shmangie nga nenet 6, 7, 8 (paragrafet 1 dhe 2), 11, 15, 16 dhe 18 nuk mund të bëhet sipas kësaj dispozite.

*[...]*

*Neni 41*

*[...] Neni 7*

Askush nuk do t'i nënshtrohet torturës ose trajtimit apo ndëshkimit të egër, çnjerëzor dhe degradues. Në mënyrë të veçantë, askush nuk do t'i nënshtrohet eksperimentimit shkencor ose mjekësor pa pëlqimin e tij të lirë.

*[...]*

*Neni 10*

1. Të gjithë personat e privuar nga liria do të trajtohen me humanizëm dhe respekt për dinjitetin e qenësishëm të njeriut.

*[...]*

*Neni 28*

1. Të ngrihet një Komitet i Të Drejtave të Njeriut (të cilit më poshtë do t'i referohemi në Konventën aktuale si Komiteti). Ai do të përbëhet nga 18 anëtarë dhe do të kryejë funksionet e parashikuara paskëtaj.

2. Ky Komitet do të përbëhet nga bashkëkombës të Shteteve Palë në Paktin aktual që do të jenë persona me karakter të lartë moral dhe autoritet të njohur në fushën e të drejtave të njeriut, konsideratë që bëhet për shkak të dobisë së pjesëmarrjes së disa personave që kanë eksperiencë ligjore.

3. Anëtarët e Komitetit do të zgjidhen dhe do të shërbejnë në cilësinë e tyre personale.

[...]

1. Një Shtet Palë në Paktin aktual mund të deklarojë në çdo kohë sipas këtij neni se ai njih autoritetin e Komitetit për të marrë dhe shqyrtuar komunikata në rast se një Shtet Palë pretendon se një tjetër Shtet Palë nuk përmbush detyrimet e tij sipas Konventës aktuale. Komunikatat sipas këtij neni mund të merren dhe shqyrtohen vetëm nëse paraqiten nga një Shtet Palë i cili ka bërë një deklaratë me të cilën ai vetë njih autoritetin e Komitetit. Komiteti nuk do të marrë asnjë komunikatë nëse ajo ka të bëjë me një Shtet Palë i cili nuk e ka bërë një deklaratë të tillë. Komunikimet e marra sipas këtij neni do të trajtohen në përputhje me procedurën që vijon:

(a) Nëse një Shtet Palë në këtë Pakt mendon se një tjetër Shtet Palë nuk zbaton dispozitat e Paktit aktual, ai mund, nëpërmjet një komunikate të shkruar, ta sjellë çështjen në vëmendjen e Shtetit Palë. Brenda tre muajve nga marrja e komunikatës shteti marrës duhet ti japë shtetit dërgues të komunikatës një shpjegim, ose çfarëdo deklarimi tjetër me shkrim për të sqaruar çështjen dhe që duhet të përmbajë, me aq sa është e mundur dhe me vend, referenca për procedurat dhe zgjidhjet e brendshme që janë dhënë, janë pezull, apo që janë të disponueshme për çështjen në fjalë;

(b) Nëse çështja nuk ndreqet në mënyrë të kënaqshme për të dy Shtetet Palë të interesuara brenda gjashtë muajve nga marrja e komunikatës së parë prej Shtetit marrës, secili Shtet do të ketë të drejtën ta parashtojë çështjen në Komitet, përmes një njoftimi që i bëhet Komitetit dhe Shtetit tjetër;

(c) Komiteti trajton një çështje drejtuar atij vetëm pasi ai të jetë siguruar se janë kërkuar dhe konsumuar të gjitha zgjidhjet e brendshme

të mundshme për këtë çështje, në pajtim me parimet përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare. Ky nuk do të jetë rregulli që do të ndiqet në rastet kur aplikimi i zgjidhjeve tejzgjatet pa arsye;

(d) Komiteti bën mbledhje të mbyllura kur shqyrton komunikata sipas këtij neni;

(e) Duke iu nënshtruar dispozitave të nënparagrafit (c), Komiteti vë zyrat e tij në dispozicion të Shteteve Palë të interesuara me synimin për një zgjidhje miqësore të çështjes mbi bazën e respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore siç njihen në Paktin aktual;

(f) Në çdo çështje drejtuar atij, Komiteti mund t'u kërkojë Shteteve Palë të interesuara, të përmendura në nënparagrafin (b), që të vënë në dispozicion çdo informacion të vlefshëm;

(g) Shtetet Palë të interesuara, të përmendura në nënparagrafin (b), kanë të drejtën të përfaqësohen kur çështja të shqyrtohet në Komitet dhe të bëjnë deklaramë me shkrim ose me gojë;

(h) Komiteti paraqet një raport brenda dymbëdhjetë muajve nga data e marrjes së njoftimit sipas nënparagrafit (b):

#### *Neni 42*

1. (a) Nëse një çështje e dërguar në Komitet në përputhje me nenin 41 nuk zgjidhet në mënyrë të kënaqëshme për të dy Shtetet Palë të interesuara, Komiteti, me pëlqimin paraprak të Shteteve Palë, mund të caktojë një Komision ad hoc Pajtimi (më poshtë i quajtur Komisioni). Zyrat e Komisionit do t'u vihen në dispozicion Shteteve Palë të interesuara me synimin për një zgjidhje miqësore të çështjes mbi bazën e respektimit të Paktit aktual; (b) Komisioni do të përbëhet nga pesë persona të pranueshëm për Shtetet Palë të interesuara. Nëse brenda tre muajve Shtetet Palë të interesuara nuk arrijnë një marrëveshje për përbërjen e të gjithë Komisionit ose një pjese të tij, anëtarët e Komisionit për cilët nuk është arritur marrëveshja do të zgjidhen me votim të fshehtë nga një votë shumice prej dy të tretat e Komitetit.

2. Anëtarët e Komisionit do të shërbejnë me cilësinë e tyre individuale. Ata nuk do të jenë bashkëkombës të Shteteve Palë të interesuara, ose të një Shteti që nuk është Palë në Paktin aktual, ose të një Shteti Palë i cili nuk ka bërë një deklaratë sipas nenit 41.

3. Komisioni zgjedh Kryetarin e vet dhe vendos rregullat e veta proceduriale.

4. Mbledhjet e Komisionit normalisht do të mbahen në Selinë e Kombeve të Bashkuara ose në Zyrën e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë. Sidoqoftë, ato mund të mbahen edhe në vende të tjerë të përshtatshëm që Komisioni mund t'i caktojë në konsultim me Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe Shtetet Palë të interesuara.

5. Sekretariati i ngritur në përputhje me nenin 36 do t'u shërbejë komisioneve të caktuara sipas këtij neni.

6. Informacioni i marrë dhe i përpunuar nga Komiteti do të vihet në dispozicion të Komisionit dhe Komisioni mund t'u kërkojë Shteteve Palë të interesuara të paraqesin çdo informacion tjetër të vlefshëm.

7. Pasi Komisioni ka shqyrtuar plotësisht çështjen, por gjithmonë jo më vonë se dymbëdhjetë muaj pasi ka marrë në dorë çështjen, ai duhet t'i dorëzojë Kryetarit të Komitetit një raport për t'ua komunikuar Shteteve Palë të interesuara:

(a) Nëse Komisioni nuk është në gjendje të përfundojë shqyrtimin e çështjes brenda dymbëdhjetë muajve nga marrja në dorë e saj, ai e kufizon raportin e tij në një parashtrim të shkurtër të statusit të shqyrtimit të çështjes nga ana e tij;

(b) Nëse arrihet një zgjidhje miqësore e çështjes mbi bazën e respektimit të të drejtave të njeriut të njohura në Paktin aktual, Komisioni e kufizon raportin e tij në një parashtrim të shkurtër të fakteve dhe të zgjidhjes së arritur;

(c) Nëse nuk arrihet një zgjidhje sipas kushteve të nënparagrafit (b), raporti i Komisionit do të përmbajë konkluzionet e tij për faktet që lidhen me çështjet ndërmjet Shteteve Palë të interesuara, dhe pikëpamjet e tij mbi mundësitë për një zgjidhje miqësore të çështjes. Raporti do të përmbajë edhe deklaratimet me shkrim dhe regjistrimet e deklarimeve me gojë të bëra nga Shtetet Palë të interesuara;

(d) Nëse raporti i Komisionit paraqitet sipas nënparagrafit (c), Shtetet Palë të interesuara duhet që brenda tre muajve nga data e marrjes së raportit të njoftojnë Kryetarin e Komitetit nëse ato e pranojnë ose jo përmbajtjen e raportit të Komisionit

8. Dispozitat e këtij neni nuk paragjykojnë përgjegjësitë e Komitetit sipas nenit 41.

9. Shtetet Palë të interesuara ndajnë në mënyrë të barabartë shpenzimet për anëtarët e Komisionit në përputhje me vlerësimet e paraqitura nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.



10. Sekretari Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara është i autorizuar të paguajë shpenzimet për anëtarët e Komisionit, nëse është e nevojshme, para rimbursimit nga Shtetet Palë të interesuara, në përputhje me paragrafin 9 të këtij neni.

Protokolli Opsional i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

Miraturar dhe e hapur për nënshkrim, ratifikim dhe aderim me Rezolutën 2200A (XXI) të Asamblesë së Përgjithshme, 19 Dhjetor, 1966 Hyri në fuqi më 23 Mars 1976, në përputhje me nenin 9 Shtetet Palë në Protokollin Aktual,

Duke marrë parasysh se, për arritjen me tej të qëllimeve të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (më poshtë i quajtur Pakti) dhe për zbatimin e dispozitave të saj, do të ishte me vend t'i krijohej mundësia Komitetit të të Drejtave të Njeriut të ngritur në Pjesën IV të Konventës (më poshtë i quajtur Komiteti) për të marrë dhe shqyrtuar, siç parashikohet në Protokollin aktual, komunikata nga individë që pretendojnë se janë viktima të dhunimeve të cilësdo nga të drejtat e parashtrura në Pakt.

Janë dakord si më poshtë:

#### *Neni 1*

Çdo Shtet Palë në Pakt, që bëhet Palë në Protokollin aktual, njeh autoritetin e Komitetit për të marrë dhe shqyrtuar komunikata nga individë që janë nën juridiksionin e tij dhe që pretendojnë se janë viktima të dhunimit nga ai Shtet Palë i cilësdo nga të drejtat e parashtrura në Pakt. Komiteti nuk do të marrë asnjë komunikatë nëse ajo ka të bëjë me një Shtet Palë në Pakt i cili nuk është palë në Protokollin aktual.

#### *Neni 2*

Sipas dispozitave të nenit 1, individët që pretendojnë se u është dhunuar ndonjëra prej të drejtave të numëruara në këtë Pakt, dhe të cilët kanë shterruar të gjitha zgjidhjet e mundëshme brenda vendit, mund t'i paraqesin Komitetit për shqyrtim një komunikatë me shkrim.

#### *Neni 3*

Komiteti do të konsiderojë të papranueshme në kuadrin e Protokollit

aktual çdo komunikatë anonime, ose që ai e konsideron se është një abuzim me të drejtën për paraqitjen e një komunikate të tillë, ose që nuk është në përputhje më dispozitat e Paktit.

#### Neni 4

1. Sipas dispozitave të nenit 3, Komiteti sjell çdo komunikatë të paraqitur atij sipas Protokollit aktual, në vëmendjen e Shtetit Palë në këtë Protokoll i cili akuzohet se ka shkelur ndonjë nga dispozitat e Paktit.

2. Brenda gjashtë muajve, Shteti marrës duhet t'i dorëzojë Komitetit shpjegime me shkrim ose deklarime që sqarojnë çështjen dhe zgjidhjet, nëse ka, që janë dhënë nga ai Shtet.

#### Neni 5

1. Komiteti i shqyrton komunikatat e marra sipas Protokollit aktual në dritën e gjithë informacionit me shkrim të vënë në dispozicion atij nga individit dhe Shteti Palë i interesuar.

2. Komiteti nuk merr në shqyrtim asnjë komunikatë nga një individ nëse ai nuk sigurohet se:

(a) E njëjta çështje nuk është duke u shqyrtuar sipas ndonjë procedure tjetër të hetimit ose zgjidhjes ndërkombëtare;

(b) Individit i ka shterruar të gjitha zgjidhjet e mundshme brenda vendit. Nuk do të veprohet kështu në rastet kur aplikimi i zgjidhjeve tejzgjatet pa arsye.

3. Komiteti bën mbledhje të mbyllura kur shqyrton komunikatat sipas këtij Protokollit.

4. Komiteti ia përcjell pikëpamjet e veta Shtetit Palë të interesuar dhe individit.

### **JURISPRUDENCË E PËRZGJEDHUR NGA PAKTI NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE (ICCPR)**

Komiteti për Të Drejtat e Njeriut, organi i traktatit i cili monitoron implemetimin e ICCPR nga Shtetet Palë, ka miratuar një numër komentesh të përgjithshme që interpretojnë dhe sqarojnë nene të veçanta të Paktit. Në vijim janë Komentet e Përgjithshme 20 dhe 21, që kanë të bëjnë respektivisht me nenet 7 dhe 10 të ICCPR. Komenti

20 i Komitetit për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara lidhur me Nenin 7 të ICCPR

Miraturar nga Komiteti gjatë sesionit të tij të 44t, 1992

1. Ky koment i përgjithshëm zëvendëson komentin e përgjithshëm 7 (sesioni i gjashtëmbëdhjetë, 1982) duke reflektuar mbi të dhe duke e zhvilluar atë më tej.

2. Qëllimi i dispozitave të nenit 7 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike është të mbrojë dinjitetin dhe integritetin mendor dhe fizik të individit. Është detyrë e Shtetit palë t'i garantojë gjithsecilit mbrojtje, përmes masave ligjore e të tjera që mund të nevojiten, kundër veprimeve që ndalohen sipas nenit 7, pavarësisht nëse shkaktohen nga njerëz që veprojnë në cilësi zyrtare ose private. Ndalimi në nenin 7 plotësohet me kërkesat pozitive të nenit 10, pragrafi 1, të Paktit, i cili përcakton se "Të gjithë personat e privuar nga liria e tyre do të trajtohen me humanizëm dhe respekt për dinjitetin e qenësishëm të genies njerëzore".

3. Teksti i nenit 7 nuk lejon asnjë kufizim. Komiteti riafirmon gjithashtu se, edhe në situata emergjencash publike si ato të parashikura në nenin 4 të Konventës, nuk lejohet asnjë shmangie nga dispozitat e nenit 7 dhe dispozitat e tij duhet të mbeten në fuqi. Në të njëjtën mënyrë, Komiteti nënvizon se asnjë justifikim ose rrethanë lehtësuese nuk mund të shërbejnë për të justifikuar një dhunim të nenit 7 për çfarëdo arsyeje, duke përfshirë ato që bazohen në një urdhër nga një zyrtar epror ose autoritet publik.

4. Pakti nuk përmban asnjë përkufizim të koncepteve që trajtohen në nenin 7, dhe as Komiteti nuk e konsideron të rëndësishme të hartojë një listë veprimesh të ndaluara apo të përcaktojë dallime të qarta ndërmjet llojeve të dënimit apo trajtimit; dallimet varen nga natyra, qëllimi dhe rreptësia e trajtimit të zbatuar.

5. Ndalimi në nenin 7 lidhet jo vetëm me veprime që shkaktojnë dhimbje fizike por edhe veprime që i shkaktojnë viktimës vuajtje mendore. Sipas këndvështrimit të Komitetit, për më tepër, ndalimi duhet të zgjerohet tek ndëshkimi trupor, duke përfshirë ndëshkimin e tepruar të urdhëruar si dënim për një krim ose si një masë edukative apo disiplinore. Është me vend të theksohet në këtë rast se neni 7 mbron veçanërisht fëmijët, nxënësit dhe pacientët në institucionet mësimore dhe mjekësore.

6. Komiteti vëren se izolimi i tejzgjatur në vetmi i personave të

ndaluar ose të burgosur mund të klasifikohet si veprim i ndaluar nga neni 7. Siç ka deklaruar Komiteti në komentin e tij të përgjithshëm Nr. 6 (16), neni 6 i Paktit e trajtojnë në përgjithësi heqjen e dënimit me vdekje me terma që sugjerojnë me forcë se heqja e tij është e dëshirueshme. Për më tepër, kur dënimi me vdekje zbatohet nga një Shtet palë për krimet më të rënda, ai jo vetëm duhet të kufizohet rreptësisht në përputhje me nenin 6, por duhet të zbatohet në mënyrë të tillë që të shkaktojë vuajtjen më të vogël fizike dhe mendore të mundshme.

7. Neni 7 shprehimisht ndalon eksperimentimin mjekësor ose shkencor pa pëlqimin e lirë të personit të përfshirë. Komiteti vëren se raportet e Shteteve palë në përgjithësi përmbajnë pak informacion për këtë pikë. Më shumë vëmendje i duhet kushtuar nevojës dhe mjeteve për të siguruar zbatimin e kësaj dispozite. Komiteti gjithashtu vëren se nevojitet mbrojtje e veçantë ndaj këtyre eksperimenteve në rastet e personave të paaftë për të dhënë një pëlqim të vlefshëm, dhe veçanërisht ndaj çfarëdo forme burgosjeje ose ndalimi. Persona të tillë nuk duhet t'i nënshtrohen asnjë eksperimentimi mjekësor ose shkencor që mund të jetë i dëmshëm për shëndetin e tyre.

8. Komiteti nënvizon se për zbatimin e nenit 7 nuk mjafton që një trajtim apo ndëshkim i tillë të ndalohet ose të konsiderohet krim. Shtetet palë duhet të informojnë Komitetin për masat ligjore, gjyqësore, administrative dhe të tjera që ato ndërmarrin për të parandaluar dhe ndëshkuar torturën dhe trajtimin e egër, çnjerëzor dhe degradues në çdo territor nën juridiksionin e tyre.

9. Në pikëpamjen e Komitetit, Shtetet palë nuk duhet t'i ekspozojnë individët ndaj rrezikut të torturës ose trajtimit a ndëshkimit të egër, çnjerëzor dhe degradues kur ata kthehen në një vend tjetër për shkak të ekstradimit, dëbimit ose përsëritjes së fajit. Shtetet palë duhet të tregojnë në raportet e tyre se çfarë masash kanë marrë për këtë qëllim.

10. Komiteti duhet të informohet për mënyrën si Shtetet palë përhapin në publikun e gjerë informacionin e duhur që ka të bëjë me eliminimin e torturës dhe trajtimit të ndaluar nga neni 7. Personeli zbatues, personeli mjekësor, oficerët e policisë dhe çdo person tjetër i angazhuar në mbikqyrjen ose trajtimin e çdo individi që i nënshtrohet çdo forme arresti, ndalimi apo burgosjeje, duhet të marrë udhëzimet dhe trainimin e duhur. Shtetet palë duhet ta informojnë Komitetin për udhëzimet e trainimin e dhënë dhe për mënyrën se si ndalimi nga neni 7 është bërë pjesë përbërëse e rregulloreve të veprimit dhe standardeve etike që duhet të ndiqen nga këta persona.

11. Krahas përshkrimit të hapave për të garantuar mbrojtje të përgjithshme, të cilën e gëzojnë të gjithë, ndaj veprimeve të ndaluara sipas nenit 7, Shteti palë duhet të japë informacion të detajuar mbi garancitë për mbrojtjen e posaçme të personave veçanërisht të prekshëm. Duhet nënvizuar se mbajtja nën mbikqyrje sistematike e rregulloreve, udhëzimeve, metodave dhe praktikave të hetimit, si edhe masat për ruajtjen dhe trajtimin e personave që i nënshtrohen çfarëdo forme arresti, ndalimi, apo burgosjeje, janë mjete të efektshme për parandalimin e rasteve të torturës dhe keqtrajtimit. Për të garantuar mbrojtjen e efektshme të personave të ndaluar duhen krijuar dispozita që të ndaluarit të mbahen në vende të njohura zyrtarisht si vende ndalimi, dhe emrat e vend-ndalimeve e tyre, si edhe emrat e personave përgjegjës për ndalimin e tyre, të mbahen në regjistra që mund të vihen menjëherë në dispozicion dhe të jenë të aksesueshëm nga të interesuarit, duke përfshirë të afërmit dhe miqtë e tyre. Për të njejtin qëllim, duhet të regjistrohen koha dhe vendi i gjithë intervistimit, sëbashku me emrat e të gjithë atyre që kanë qenë të pranishëm, dhe ky informacion duhet të vihet në dispozicion për procedime gjyqësore dhe administrative.

Duhet krijuar dispozita edhe kundër ndalimit incommunicado. Lidhur me këtë, Shtetet palë duhet të sigurohen që çdo vend-ndalim të mos ketë asnjë pajisje që mund të përdoret për të shkaktuar torturë ose keqtrajtim. Mbrojtja e të ndaluarit kërkon gjithashtu akses të menjëhershëm dhe periodik për mjekët e avokatët, si dhe për familjarët, nën mbikqyrjen e duhur kur kjo kërkohet nga hetimi,

12. Për të mos nxitur dhunimet e parashikuara në nenin 7 është e rëndësishme që ligji të ndalojë përdorimin e administrimit në procedime gjyqësore të deklarimeve ose rrëfimeve të marra përmes torturës ose formave të tjera të trajtimit të ndaluar.

13. Kur paraqesin raportet e tyre, Shtetet palë duhet të tregojnë dispozitat e ligjit të tyre penal të cilat penalizojnë torturën dhe trajtimin apo ndëshkimin e egër, çnjerëzor dhe degradues, duke specifikuar dënimet që zbatohen për raste të tilla, pavarësisht nëse janë kryer nga nëpunës publikë apo persona të tjerë që veprojnë në emër të Shtetit ose si persona privatë. Ata që dhunojnë nenin 7 duke nxitur, urdhëruar, toleruar ose kryer veprime të ndaluara, duhet të mbajnë përgjegjësi. Rrjedhimisht, ato që kanë refuzuar t'i binden urdhërave nuk duhet të ndëshkohen ose t'i nënshtrohen asnjë trajtimi armiqësor.

14. Neni 7 duhet lexuar sëbashku me nenin 2, paragrafi 3, të Paktit. Në raportet e tyre, Shtetet palë duhet të dëshmojnë se si sistemi i tyre

ligjor garnaton në mënyrë të efektshme përfundimin e menjëhershëm të të gjithë veprimeve të ndaluara me nenin 7, si edhe korrigjimet e duhura. E drejta për të paraqitur ankesë ndaj keqtrajtimit të ndaluar sipas nenit 7 duhet të njihet nga legjislacioni i brendshëm. Ankesat duhet të hetohen më përpikmëri dhe në mënyrë të paanshme nga autoritetet kompetente me qëllim që zgjidhja të jetë e efektshme. Raportet e Shtetve palë duhet të japin informacion të veçantë mbi zgjidhjet e mundshme për viktimat e keqtrajtimit dhe procedurën që ndjekin ankesat, si edhe statistika për numrin e ankesave dhe mënyrën si janë trajtuar ato.

15. Komiteti ka vërejtur se disa Shtete kanë bërë amnisti në lidhje me aktet e torturës. Amnistitë janë përgjithësisht të papajtueshme me detyrimin e shteteve për të hetuar veprime të tilla; për të garantuar lirinë për veprime të tilla brenda juridiksionit të tyre; dhe për të siguruar se ato nuk do të ndodhin në të ardhmen. Shtetet nuk mund t'i privojnë individët nga e drejta për një zgjidhje të efektshme; duke përfshirë kompensimin dhe rehabilitimin sa më të plotë të mundshëm.

### **Komenti 21 i Komitetit për Të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara lidhur me Nenin 10 të PNDCP Miratuar nga Komiteti gjatë sesionit të 44, 1992**

1. Ky koment i përgjithshëm zëvendëson komentin e përgjithshëm 9 (sesioni 16, 1982) duke reflektuar për të dhe duke e zhvilluar atë më tej.

2. Neni 10, paragrafi 1, i Paktit Ndërkombëtar për Të Drejtat Civile dhe Politike zbatohet për këdo që është privuar nga liria sipas ligjeve dhe autoritetit të Shtetit dhe që mbahet në burgje, spitale – veçanërisht spitale psikiatrike – kampe përqëndrimi ose institucione korigjuese, apo në vende të tjera. Shtetet palë duhet të sigurojnë që parimi i përcaktur atje, zbatohet në të gjithë institucionet brenda juridiksionit të tyre në të cilat mbahen personat.

3. Neni 10, paragrafi 1, u imponon Shteteve palë një detyrim pozitiv ndaj personave që janë veçanërisht të prekshëm për shkak të statusit të tyre si persona të privuar nga liria, dhe plotëson për to ndalimin e torturës ose trajtimit a ndëshkimit të egër, çnjerëzor ose degradues që përfshihen në nenin 7 të Paktit. Kështu, personat e privuar nga liria e tyre jo vetëm nuk do t'i nënshtrohen trajtimit që bie në kundërshtim me nenin 7, duke përfshirë eksperimentimin mjekësor apo shkencor, por nuk do t'i nënshtrohen asnjë vështirësie apo kufizimi përveç asaj që rezulton nga privimi i lirisë së tyre; respekti për dinjitetin e personave të

tillë duhet të garantohet në të njejtat kushte si për personat e lirë. Personat e privuar nga liria e tyre gëzojnë të gjitha të drejtat e parashtruara në këtë Pakt, duke iu nënshtruar kufizimeve që janë të pashmangshme për një ambient të mbyllur.

4. Trajtimi me humanizëm dhe respektimi i dinjitetit njerëzor të personave të privuar nga liria e tyre është një rregull themelor që zbatohet në mënyrë universale. Rrjedhimisht, zbatimi i këtij rregulli, mininmalisht, nuk mund të jetë në varësi të burimeve materiale që disponojnë Shtetet palë. Ky rregull duhet zbatuar pa asnjë dallim për shkak rrace, ngjyre, seksi, gjuhe, feje, bindjeje politike a të tjera, origjine shqërore a kombëtare, prone, statusi lindjeje a ndonjë statusi tjetër.

5. Shtetet palë ftohen të dëshmojnë në raportet e tyre se në ç'masë ato zbatojnë standardet përkatëse të Kombeve të Bashkuara të zbatueshme për trajtimin e të burgosurve: Rregullat Standarde Minimale për Trajtimin e të Burgosurve (1957), Paketën e Parimeve për Mbrojtjen e të gjithë Personave në çdo formë Ndalimi ose Burgimi (1988), Kodin e Sjelljes për Nëpunësit e Zbatimit të Ligjit (1978), dhe Parimet e Etikës Mjekësore që lidhen me Rolin e Personelit Mjekësor, veçanërisht të Psikiatërve, në Mbrojtjen e të Burgosurve dhe të Ndaluarve ndaj torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit të egër, çnjerëzor ose degradues (1982).

6. Komiteti kujton se raportet duhet të japin informacion të detajuar për dispozitat ligjore dhe administrative kombëtare që kanë lidhje me të drejtën e përcaktuar në nenin 10, paragrafi 1. Komiteti gjithashtu e konsideron të domosdoshme që raportet të specifikojnë se ç'masa konkrete janë marrë nga autoritetet kompetente për monitorimin e zbatimit të efektshëm të rregullave që kanë të bëjnë me trajtimin e personave të privuar nga liria e tyre. Në raportet e tyre Shtetet palë duhet të përfshijnë informacion lidhur me sistemin e mbikqyrjes së ambienteve ndëshkimore, masat e veçanta për parandalimin e torturës dhe trajtimit të egër, çnjerëzor ose degradues, dhe mënyrat si sigurohet një mbikqyrje e paanshme.

7. Për më tepër, Komiteti kujton se raportet duhet të dëshmojnë nëse tërësia e dispozitavë të zbatueshme është pjesë e pandarë e udhëzimeve dhe trainimit të personelit që ka autoritet mbi personat e privuar nga liria e tyre, dhe nëse ato dispozita respektohen nga ky personel gjatë kryerjes së detyrës. Gjithashtu, do të ishte me vend të specifikohet nëse personat e arrestuar ose të ndaluar kanë akses tek një informacion i tillë dhe kanë mjetet ligjore të efektshme që i sigurojnë ata se këto rregulla

respektohen, se mund të ankohen nëse rregullat nuk zbatohen, dhe se përfitojnë kompensimin e duhur në rast dhunimi.

8. Komiteti kujton se parimi i përcaktuar në nenin 10, paragrafi 1, përbën bazën e detyrimeve më të veçanta të Shteteve palë për drejtësinë penale të cilat përcaktohen në nenin 10, paragrafet 2 dhe 3.

9. Neni 10, paragrafi 2 (a), lejon veçimin, përveçse në rrethana të jashtëzakonshme, të personave të akuzuar nga ato të burgosur. Ky veçim kërkohet me qëllim që të theksohet statusi i tyre si persona të padënuar (paraburgosur), që në të njëjtën kohë gëzojnë të drejtën për t'u konsideruar të pafajshëm, siç parashtrohet në nenin 14, paragrafi 2. Raportet e Shteteve palë duhet të tregojnë si kryhet në praktike ndarja e personave të akuzuar nga personat e burgosur dhe të shpjegojnë ku ndryshon trajtimi i personave të akuzuar nga ai i personave të dënuar.

10. Përsa i përket nenit 10, paragrafi 3, që ka të bëjë me personat e burgosur, Komiteti dëshiron të ketë informacion të detajuar mbi funksionimin e sistemit të burgjeve të Shtetit palë. Asnjë sistem penitenciar nuk duhet të jetë vetëm ndëshkues; në thelb ai duhet të synojë reformimin dhe rehabilitimin social të të burgosurit. Shtetet palë ftohen të specifikojnë nëse ato kanë një sistem që ofron asistencë pas lirimimit dhe të japin informacion mbi suksesin e tij.

11. Në një numër rastesh, informacioni i dhënë nga Shteti palë nuk përmban asnjë referencë të veçantë mbi dispozitat ligjore ose administrative ose mbi masat praktike për të siguruar riedukimin e personave të burgosur. Komiteti kërkon informacion specifik lidhur me masat e marra për të siguruar mësimdhënie, edukim dhe riedukim, udhëzim dhe trainim profesional, dhe informacion lidhur me programe pune për të burgosurit si brenda ambienteve të burgut ashtu edhe jashtë tij.

12. Me qëllim që të përcaktohet nëse po zbatohet plotësisht parimi i parashtruar në nenin 10, paragrafi 3, Komiteti gjithashtu kërkon informacion specifik mbi masat që zbatohen gjatë ndalimit, p.sh., trajtimi individual i personave të dënuar dhe si kategorizohen ata, sistemi disiplinor, izolimi i vetmuar e arresti i sigurisë së lartë, dhe kushtet në të cilat sigurohen kontaktet me botën e jashtme (familje, avokat, shërbime sociale e mjekësore, organizata joqeveritare).

13. Për më tepër, Komiteti vëren se në raportet e disa Shteteve palë nuk jepet asnjë informacion lidhur me trajtimin e dhënë për adoleshentët të akuzuar dhe për adoleshentët qëshkelin ligjin. Neni 10, paragrafi 2 (b) parashikon që një adoleshent i akuzuar duhet të ndahet nga të rriturit.



Informacioni i dhënë në raporte tregon se disa Shtete palë nuk i kushtojnë vëmendjen e duhur faktit se kjo është një dispozitë e detyrueshme e Paktit. Teksti parashikon gjithashtu se çështjet që kanë të bëjnë me adoleshentët duhet të shqyrtohen sa më shpejt të jetë e mundur. Raportet duhet të specifikojnë masat e marra nga Shtetet palë për vënien në zbatim të kësaj dispozite. Së fundi, sipas nenit 10, paragrafi 3, adoleshentët që shkelin ligjin duhet të veçohen nga të rriturit dhe t'u jepet trajtim i përshtatshëm për moshën dhe statusin ligjor të tyre për sa i përket kushteve të ndalimit, si orë më të pakta pune dhe kontakt me të afërmit, me synimin që të nxitet riformimi dhe rehabilitimi i tyre. Neni 10 nuk vendos kufinj për moshën e adoleshentëve. Ndërsa kjo vendoset nga secili Shtet palë nën dritën e kushteve të duhura sociale, kulturore dhe të tjera, Komiteti ka mendimin se neni 6, paragrafi 5, sugjeron se të gjithë personat nën 18 vjeç duhet të trajtohen si adoleshentë, të paktën në çështje që lidhen me drejtësinë penale. Shtetet duhet të japin informacionin e nevojshëm për grupmoshat e personave që trajtohen si adoleshentë. Për këtë, Shtetet palë ftohen të tregojnë nëse ata zbatojnë Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për Adolleshentët, të njohura si Rregullat e Pekinit (1977).

### **Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore**

Miratuar dhe e hapur për nënshkrim, ratifikim dhe aderim me Rezolutën 2200A (XXI) të Asamblesë së Përgjithshme të 16 Dhjetor, 1966

Hyri në fuqi më 3 Janar 1976 në përputhje me nenin 37

Hyrje

Shtetet palë në Paktin aktual,

Duke marrë parasysh, se në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, njohja e dinjitetit të qenësishëm dhe e të drejtave të barabarta e të patjetërsueshme të anëtarëve të familjes njerëzore është themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë,

Duke pranuar se këto të drejta rrjedhin nga dinjiteti i qenësishëm i qenies njerëzore,

Duke pranuar se, në përputhje me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, ideali i qenieve të lira njerëzore që gëzojnë lirinë nga frika dhe nevoja mund të arrihet vetëm nëse krijohen kushtet në të cilat cilido mund të gëzojë të drejtat e veta ekonomike, sociale dhe kulturore, si edhe të drejtat e veta civile dhe politike,

Duke marrë parasysh detyrimin e Shteteve sipas Kartës së Kombeve të Bashkuara për të nxitur respektimin dhe zbatimin universal të të drejtave dhe lirive të njeriut,

Duke kuptuar se individi, duke pasur detyrime ndaj individëve të tjerë dhe komunitetit që i përket, ka përgjegjësinë të përpiket për nxitjen dhe zbatimin e të drejtave të njohura në Paktin aktual,

Janë dakord për nenet që vijojnë: [...]

1. Shtetet Palë në këtë Pakt njohin të drejtën e gjithsecilit për të gëzuar standardin më të lartë të mundshëm të shëndetit fizik dhe mendor.

2. Hapat që duhen ndërmarrë nga Shtetet Palë në këtë Pakt për të përmbushur realizimin e plotë të kësaj të drejte duhet të përfshijnë ato për:

[...]

a) Krijimin e kushteve që mund të sigurojnë shërbim mjekësor dhe kujdes mjekësor për të gjithë në rast sëmundjeje.

Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të

Tjera të Egra, Çnjerëzore dhe Degraduese

Miraturar dhe e hapur për nënshkrim, ratifikim dhe aderim me Rezolutën 39/ 46A (XXI) të Asamblesë së Përgjithshme të 10 Dhjetor, 1984

Hyri në fuqi më 26 Qershor 1987, në përputhje me nenin 27 (1)

Shtetet Palë në këtë Konventë,

Duke marrë parasysh, se në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, njohja e dinjitetit të qenësishëm dhe e të drejtave të barabarta e të patjetërsueshme të anëtarëve të familjes njerëzore është themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë,

Duke pranuar se këto të drejta rrjedhin nga dinjiteti i qenësishëm i qenies njerëzore,

Duke marrë parasysh detyrimin e Shteteve sipas Kartës së Kombeve të Bashkuara, veçanërisht nenin 55, për të nxitur respektimin dhe zbatimin universal të të drejtave dhe lirive të njeriut,

Duke marrë në konsideratë nenin 5 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 7 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat që të dyja përcaktojnë se askush nuk do t'i

nënshtrahet torturës ose trajtimit apo ndëshkimit të egër, çnjerëzor ose degradues,

Duke marrë në konsideratë edhe Deklaratën për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Nënshtrimi ndaj Torturës ose Trajtimeve apo Ndëshkimeve të Tjerë të Egër, Çnjerëzorë ose Degradues, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 9 Dhjetor 1975,

Me dëshirën për ta bërë më të efektshme luftën kundër torturës dhe trajtimeve apo ndëshkimeve të tjerë të egër, çnjerëzorë ose degradues në mbarë botën,

Janë dakord për sa vijon:

## PJESA I

### *Neni 1*

1. Për qëllimet e kësaj Konvente, termi "torturë" do të nënkuptojë çfarëdoveprimi me anë të të cilit një personii shakaktohet me dashje dhimbje ose vuajtje e madhe fizike ose mendore për qëllime të tilla simarrja prej tij ose një personi të tretë e informacioneve oserrëfimeve, ndëshkimi i tij për një veprim që ai ose një person i tretë ka kryer ose dyshohet ta ketë kryer, kërcënimi ose detyrimi i tij ose i një personi të tretë, ose për çfarëdo arsyeje të bazuar në çfarëdo lloj diskriminimi, kur një dhimbje ose vuajtje e tillë shkaktohet, ose nxitet, ose bëhet me lejen me pranimin në heshtje të një nëpunësi publik që vepron në cilësi zyrtare. Ai nuk përfshin dhimbje apo vuajtje që vijnë vetëm nga sanksione të ligjshme, janë pjesë e qenësishme ose rastësore e këtyre sanksioneve.

2. Ky nen nuk paragjykon asnjë instrument ndërkombëtar ose legjislacion kombëtar i cili përmban ose mund të përmbajë dispozita me një zbatueshmëri më të gjerë.

### *Neni 2*

1. Çdo Shtet Palë merr masa të efektshme ligjore, administrative, gjyqësore ose të tjera për të parandaluar torturën në çdo territor nën juridiksionin e tij.

2. Asnjë rrethanë sado e jashtëzakonshme, si gjendje lufte ose kërcënim për luftë, destabilitet i brendshëm politik apo çfarëdo emergjence tjetër publike, nuk mund të përdoret për të justifikuar torturën.

3. Një urdhër nga një nëpunës epror apo autoritet publik nuk mund të përdoret për të justifikuar torturën.

*Neni 3*

1. Asnjë Shtet Palë nuk do të dëbojë, rikthejë apo ekstradojë një person të një Shteti tjetër në rastet kur ka arësye thelbësore për të besuar se ai do të rrezikonte t'i nënshtrohej torturës.

2. Me qëllim që të përcaktohet nëse të tilla arësye egzistojnë, autoritetet kompetente do të marin parasysh të gjitha konsideratat e vlefshme duke përfshirë, ku është e rastit, edhe egzistencën në Shtetin në fjalë të një praktike të vazhdueshme të dhunimit masiv e flagrant të të drejtave të njeriut.

*Neni 4*

1. Çdo Shtet Palë do të sigurojë që çdo formë torure të konsiderohet shkelje nga legjislacioni penal i brendshëm. E njejta gjë do të zbatohet edhe për përpjekjet për të kryer torturë dhe për veprime të kryera nga çdo person të cilat përbëjnë bashkëpunim ose pjesëmarrje në torturë.

2. Çdo Shtet Palë do t'i bëjë këto shkelje të ndëshkueshme duke parashikuar dënime përkatëse, të cilat duhet të mbajnë parasysh natyrën e rëndë të shkeljeve.

*Neni 5*

1. Çdo Shtet Palë do të marrë masat e nevojshme për të vendosur juridiksionin e vet mbi shkeljet e parashikauara në nenin 4 në rastet e mëposhtëme:

- a) Kur shkeljet bëhen në çfarëdo territori brenda juridiksionit të tij ose në bordin e një anijeje apo avioni të regjistruar tek ky Shtet;
- b) Kur shkelësi i akuzuar është bashkëkombës i këtij Shteti;
- c) Kur viktimat është bashkëkombës i atij Shteti, nëse ai Shtet e konsideron me vend.

2. Në të njejten mënyrë çdo Shtet Palë do të marrë masat e nevojshme për të vendosur juridiksionin e vet mbi shkeljet në rastet kur shkelësi i akuzuar është prezent në çfarëdo territori nën juridiksionin e tij dhe ai nuk e ekstradon atë në zbatim të nenit 8 në asnjërin nga Shtetet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Kjo Konventë nuk përjashton asnjë juridiksion penal që zbatohet në përputhje me ligjin e brendshëm.

*Neni 6*

1. Pas shqyrtimit të informacionit të disponueshëm dhe kur është i kënaqur se rrethanat e përlegjin një gjë të tillë, çdo Shtet Palë, në territorin e të cilit është prezent një person i akuzuar që ka kryer çfarëdo shkejeje të parashikuar në nenin 4, e merr atë në ruajtje ose ndërmerr masa të tjera ligjore për të siguruar praninë e tij. Ruajtja dhe masat e tjera ligjore do të jenë ato që parashikon legjislacioni i brendshëm i atij Shteti por mund të vazhdojnë për aq kohë sa është e nevojshme për të bërë të mundur fillimin e çfarëdo procedimi penal a ekstradues.

2. Mejëherë ky Shtet bën një hetim paraprak të fakteve.

3. Çdo person në ruajtje në zbatim të paragrafit 1 të këtij neni do të ndihmohet për të komunikuar menjëherë me përfaqësuesin e duhur e më të afërt të Shtetit bashkëkombës i të cilit ai është,

ose, nëse është një person pa shtetesi, me përfaqësuesin e Shtetit ku ai zakonisht banon.

4. Kur një Shtet, në zbatim të këtij neni, merr në ruajtje një person, ai duhet të njoftojë menjëherë Shtetet e përcaktuara në nenin 5, paragrafi 1, për faktin se një person i tillë është marrë në ruajtje dhe për rrethanat që sollën në këtë ndalim. Shteti që bën hetimin paraprak të parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni duhet menjëherë t'ia raportojë rezultatet e tij Shteteve në fjalë dhe duhet të tregojë nëse ai synon të ushtrojë juridiksionin e tij.

*Neni 7*

1. Shteti Palë, në territorin nën juridiksionin e të cilit gjendet një person i akuzuar për kryerjen e një shkeljeje të përcaktuar në nenin 4, duhet, në rastet e parashikuara në nenin 5, nëse nuk e ekstradon atë, t'ia përcjellë çështjen për ndjekje penale autoriteteve të tij kompetente.

2. Këto autoritete marrin vendimin e tyre në të njëjtën mënyrë si në rastin e një shkeljeje të zakonshme të një natyre të rëndë sipas ligjit të atij Shteti. Për rastet e përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, standardet e provave që kërkohen për ndjekje penale dhe dënim, në asnjë mënyrë nuk duhet të jenë më pak të rrepta se ato që zbatohen për rastet e përcaktuara në nenin 5, paragrafi 1.

3. Çdo personi, për të cilin procedurat janë bërë në lidhje me cilëndo nga shkeljet e përcaktuara në nenin 4, i garantohet trajtim i drejtë në të gjitha etapat e procedimit.

*Neni 8*

1. Shkeljet e përcaktuara në nenin 4 klasifikohen si shkelje të ekstradueshme në çdo marrëveshje ekstradimi që egziston ndërmjet Shteteve Palë. Shtetet Palë angazhohen t'i përfshijnë shkelje të tilla si shkelje të ekstradueshme në çdo marrëveshje ekstradimi që mund të arrihet ndërmjet tyre.

2. Nëse një Shtet Palë, i cili bën ekstradimin i kushtëzuar nga egzistenca e një marrëveshjeje, merr një kërkesë për ekstradim nga një tjetër Shtet Palë me të cilin ai nuk ka marrëveshje ekstradimi, ai mund ta konsiderojë këtë Konventë si një bazë ligjore për shkelje të tilla. Ekstradimi do t'i nënshtrohet kushteve të tjera të parashikuara nga ligji i Shtetit të cilit i bëhet kërkesa.

3. Shtetet Palë, të cilët nuk e bëjnë ekstradimin të kushtëzuar nga egzistenca e një marrëveshjeje, do t'i njohin shkelje të tilla si shkelje të ekstradueshme ndërmjet tyre, duke iu nënshtuar kushteve të parashikuara nga ligji i Shtetit të cilit i bëhet kërkesa.

4. Për qëllime ekstradimi ndërmjet Shteteve Palë, të tilla shkelje do të trajtohen sikur të jenë kryer jo vetëm në vendin ku ato ndodhën, por edhe në territoret e Shteteve të cilave u kërkohet të vendosin juridiksionin e tyre në përputhje me nenin 5, paragrafi 1.

*Neni 9*

1. Shtetet Palë do t'i sigurojnë njeri-tjetrit asistencë maksimale lidhur me procedimin penal të ngritur për secilën nga shkeljet e parashikuara në nenin 4, duke përfshirë dhënien e të gjitha provave që ato disponojnë dhe që mund të nevojiten për procedim.

2. Shtetet Palë do të përmbushin detyrimet e tyre nga paragrafi 1 i këtij neni në përputhje me çdo marrëveshje për asistencë gjyqësore reciproke që mund të egzistojë ndërmjet tyre.

*Neni 10*

1. Çdo Shtet Palë do të sigurojë që edukimi dhe informacioni për ndalimin e torturës të përfshihen plotësisht në trainimin e personelit që merret me zbatimin e ligjit, personelit mjekësor, nëpunësve publikë dhe personave të tjerë të angazhuar në ruajtjen, hetimin ose trajtimin e çdo individi që i nënshtrohet çfarëdo forme arresti, ndalimi ose burgosjeje.

2. Çdo Shtet Palë do ta përfshijë këtë ndalim në rregulloret ose

udhëzimet e nxjerra lidhur me detyrat dhe funksionet e çdo personi të tillë.

*Neni 11*

Çdo Shtet Palë do të mbajë nën mbikqyrje sistematike rregulloret, udhëzimet, metodat dhe praktikat e hetimit, si edhe masat për ruajtjen dhe trajtimin e personave që i nënshtrohen çfarëdo forme arresti, ndalimi ose burgosjeje në çdo territor nën juridiksionin e tij, me synimin për të parandaluar çdo rast torture.

*Neni 12*

Çdo Shtet Palë do të sigurojë që autoritetet e tij kompetente të proçedojnë me një hetim të shpejtë dhe të paanshëm, sa herë ka arsye tëbesueshme se është ushtruar torturë në çdo territor nën juridiksionin e tij.

*Neni 13*

Çdo Shtet Palë do të sigurojë që çdo individ i cili pretendon se i është nënshtuar torturës në çdo territor nën juridiksionin e tij, ka të drejtë të ankohet dhe çështja e tij të shqyrtohet me përpikmëri dhe paanësi nga autoritetet kompetente të tij. Do të ndërmerren hapa për të siguruar që ankuesi dhe dëshmitarët e tij të mbrohen nga keqtrajtimi ose kërcënim i pasojë e ankesës apo të dëshmive të dhëna.

*Neni 14*

1. Çdo Shtet Palë do të sigurojë që në sistemin e tij ligjor viktimat e çdo veprimi torture të përfitojë rehabilitim dhe të gëzojnë të drejtën e detyrueshme për një kompensim të drejtë dhe në masën e duhur, duke përfshirë mjetet për një rehabilitim sa më të plotë të mundshëm. Në rastin e vdekjes së viktimës si rezultat i torturës, personat në ngarkim të tij kanë të drejtën e kompensimit

2. Asgjë në këtë nen nuk do të prekë asnjë të drejtë të viktimës ose çdo personi tjetër për kompensim që mund të egzistojë sipas ligjit kombëtar.

*Neni 15*

Çdo Shtet Palë do të sigurojë që çdo deklaratë që rezulton të jetë bërë si pasojë e torturës nuk do të përdoret si provë në asnjë procedim,

mepërjashtim të personave të akuzuar për torturë si provë që deklarata është bërë.

#### *Neni 16*

1. Çdo Shtet Palë angazhohet për të parandaluar në çdo territor nën juridiksionin e tij veprime të tjera të trajtimit apo ndëshkimit të egër, çnjerëzor ose degradues të cilat nuk klasifikohen si torturë sipas përkufizimit në nenin 1, kur të tilla veprime kryhen, nxiten, lejohen ose kalohen në heshtje nga njënëpunës publik që vepron në cilësi zyrtare, veçanërisht, detyrimet e përfshira në nenet 10, 11, 12 dhe 13 do të zbatohen me zëvendësimin për përcaktimet e torturës ose përcaktimet e formave të tjera të trajtimit apo ndëshkimit të egër, çnjerëzor ose degradues.

2. Dispozitat e kësaj Konvente nuk paragjykojnë dispozitat e asnjë instrumenti ndërkombëtar ose ligji kombëtar i cili ndalon trajtimin apo ndëshkimin e egër, çnjerëzor ose degradues ose ka të bëjë me ekstradimin ose dëbimin.

## **PJESA II**

#### *Neni 17*

1. Do të krijohet një Komitet kundër Torturës (më poshtë i quajtur Komiteti) i cili do të kryejë funksionet e dhëna paskëtaj. Komiteti do të përbëhet nga dhjetë ekspertë me qëndrim të lartë moral dhe autoritet të njohur në fushën e të drejtave të njeriut, të cilët do të shërbejnë në cilësinë e tyre personale. Ekspertët zgjidhen nga Shtetet Palë duke marrë parasysh një shpërndarje gjeografike të barabartë dhe dobinë e pjesëmarrjes së disa personave që kanë përvojë ligjore.

2. Anëtarët e Komitetit zgjidhen me votim të fshehtë nga një listë personash të kandiduar nga Shtetet Palë. Çdo Shtet Palë mund të kandidojë një person nga bashkëkombësit e vet. Shtetet Palë do të kenë parasysh dobinë e kandidimit të personave që janë edhe anëtarë të Komitetit për të Drejtat e Njeriut të krijuar nga Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe që janë të gatshëm të shërbejnë në Komitetin kundër Torturës.

3. Zgjedhjet e anëtarëve të Komitetit bëhen në takimet e përdyvitshme të Shteteve Palë që thirren nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Në këto takime, kuorumi për të cilët përbëhet



nga dy të tretat e Shteteve Palë, personat që do të zgjidhen në Komitet duhet të marrin numrin më të madh të votave dhe një shumicë absolute të votës së përfaqësuesve të Shteteve Palë që janë të pranishëm dhe që votojnë.

4. Zgjedhjet e para mbahen jo më vonë se gjashtë muaj nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Të paktën katër muaj para datës së çdo zgjedhjeje, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara i dërgon një letër Shteteve Palë, duke i ftuar ato të dorëzojnë kandidaturat e tyre brenda katër muajve. Sekretari i Përgjithshëm përgatit një listë alfabetike të të gjithë personave të kandiduar në këtë mënyrë, duke përfshirë edhe Shtetet Palë që i kanë kandiduar ata, dhe ia dorëzon atë Shteteve Palë.

5. Anëtarët e Komitetit zgjidhen për një mandat katërvjeçar. Ata kanë të drejtë të rizgjidhen nëse rikandidojnë. Sidoqoftë, mandati ipesë prej anëtarëve të zgjedhur në zgjedhjet e para përfundon në fund të dy viteve të para; menjëherë pas zgjedhjeve të para emrat e këtyresës anëtarëve zgjidhen me short nga kryetari i mbledhjes i përmendur në paragrafin 3 të këtij neni.

6. Nëse një anëtar i Komitetit vdes apo jep dorëheqjen ose për çfarëdo arsyeje tjetër nuk mund të kryejë më detyrat e tij në Komitet, Shteti Palë që e kandidoi atë cakton një ekspert tjetër nga bashkëkombësit e vet për të shërbyer për pjesën e mbetur të periudhës, duke iu nënshtruar miratimit nga shumica e Shteteve Palë. Miratimi konsiderohet i dhënë, përveç rasteve kur gjysma ose më shumë se gjysma e Shteteve Palë përgjigjen negativisht brenda gjashtë javëve pasi janë informuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara për kandidaturën e propozuar.

7. Shtetet Palë do të jenë përgjegjës për shpenzimet e anëtarëve të Komitetit për aq kohë sa ata kryejnë detyrat e Komitetit.

#### *Neni 18*

1. Komiteti zgjedh nëpunësit e vet për një periudhe dyvjeçare me të drejtë rizgjedhjeje.

2. Komiteti vendos rregullat e veta procedurale, por ato duhet të mundësojnë, ndër të tjera, që:

a) Gjashtë anëtarë përbëjnë kuorumin;

b) Vendimet e Komitetit merren me shumicë vote të anëtarëve të pranishëm.

3. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara siguron stafin e nevojshëm dhe lehtësirat për kryerjen me efektshmëri të funksioneve të Komitetit sipas kësaj Konvente.

4. Sekretari i Përgjithshëm i Kombevetë Bashkuara thërret mbledhjen e parë të Komitetit. Pas mbledhjes së parë, Komiteti mblidhet atëhere kur përcaktohet në rregulloret e tij procedurale.

5. Shtetet Palë janë përgjegjës për shpenzimet e bëra për mbajtjen e mbledhjeve të Shteteve Palë dhe të Komitetit, duke përfshirë edhe rimbursimin e Kombeve të Bashkuara për çdo shpenzim, si kostoja e stafit dhe e lehtësirave, të përballuara nga Kombet e Bashkuara në zbatim të paragrafit 3 të këtij neni.

#### *Neni 19*

1. Shtetet Palë i dorëzojnë Komitetit, përmes Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, raporte për masat që ato kanë marrë për të vënë në jetë angazhimet në kuadrin e kësaj Konventë, brenda një viti nga hyrja në fuqi e Konventës për Shtetet Palë të interesuara. Paskësaj, Shtetet Palë dorëzojnë raporte shtesë në çdo katër vjet për çdo masë të marrë dhe raporte të tjerë të ngjashëm sipas kërkesës së Komitetit.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara ia përcjell raportet të gjithë Shteteve Palë.

3. Çdo raport shqyrtohet nga Komiteti i cili mund të bëjë komente të përgjithshme mbi raportin ashtu si ai e konsideron me vend dhe ia përcjell këto komente Shteteve Palë të interesuara. Shteti Palë mund t'i përgjigjet Komitetit duke bërë vëzhgimet që ai vetë zgjedh.

4. Komiteti mund të vendosë, në çdo kohë, të përfshijë në raportin vjetor që bëhet në përputhje me nenin 24, çfarëdo komenti të bërë prej tij në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, sëbashku me vëshgimet e marra nga Shteti Palë i interesuar. Nëqoftëse i kërkohet nga Shteti Palë, Komiteti mund të përfshijë edhe një kopje të raportit të dorëzuar sipas paragrafit 1 të këtij neni.

#### *Neni 20*

1. Nëse Komiteti merr informacion të besueshëm që atij i duket se përmban tregues të argumentuar se në territorin e një Shteti Palë praktikohet sistematikisht tortura, Komiteti e fton këtë Shtet Palë të

bashkëpunojë për shqyrtimin e informacionit dhe për këtë qëllim të dorëzojë vëzhgime përsa i përket informacionit në fjalë.

2. Duke marrë parasysh çdo vëzhgim që mund të dorëzohet nga Shteti Palë në fjalë, si edhe çdo informacion tjetër të vlefshëm që ai disponon, Komiteti mund të caktojë, nëse ai vendos se kjo gjë është përligjur, një ose më shumë anëtarë të tij për të bërë një hetim konfidencial dhe për të raportuar me urgjencë në Komitet.

3. Nëse bëhet një hetim në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, Komiteti kërkon bashkëpunimin e Shtetit Palë në fjalë. Në mirëkuptim me Shtetin Palë, një hetim i tillë mund të përfshijë një vizitë në territorin e këtij vendi.

4. Pasi shqyrton përfundimet e nxjerra nga anëtari ose anëtarët e tij dhe të dorëzuara në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, Komisioni ia përcjell këto konkluzione Shtetit

Palë në fjalë, sëbashku me komentet apo sugjerimet e duhura në varësi të situatës.

5. Të gjithë procedurat e Komitetit të përmendura në paragrafet 1 deri 4 të këtij neni janë konfindenciale, dhe në të gjitha etapat e procedimit do të kërkohet bashkëpunimi i Shtetit Palë. Pasi të jenë përfunduar këto procedime lidhur me një hetim të kryer në përputhje me paragrafin 2, Komiteti mund të vendosë, pas konsultimeve me Shtetin Palë në fjalë, të përfshijë në raportin e tij vjetor të hartuar në përputhje me nenin 24 një relacion përmbledhës për rezultatet e procedimeve.

#### *Neni 21*

1. Një Shtet Palë në këtë Konventë mund të deklarojë në çdo kohë sipas këtij neni se ai njeh autoritetin e Komitetit për të marrë dhe shqyrtuar komunikata në rastet kur një Shtet Palë pretendon se një tjetër Shtet Palë nuk përmbush detyrimet e tij nga kjo Konventë. Të tilla komunikata mund të merren dhe të shqyrtohen sipas procedurave të parashtruara në këtë nen vetëm në rastet kur ato paraqiten nga një Shtet Palë i cili ka bërë një deklaratë se ai vetë e njeh autoritetin e Komitetit. Nuk trajtohet nga Komiteti asnjë komunikatë sipas këtij neni, nëse ajo ka të bëjë me një Shtet Palë që nuk e ka bërë një deklaratë tillë. Komunikatat e marra sipas këtij neni trajtohen në përputhje me procedurën e mëposhtme:

a) Nëse një Shtet Palë gjykon se një tjetër Shtet Palë nuk po vë në zbatim dispozitat e kësaj Konvente, ai mund ta sjellëçështjen, nëpërmjet

një komunikate me shkrim, në vëmendjen e atij Shteti Palë. Brenda tre muajve nga marrja e komunikatës, Shteti marrës duhet t'i japë Shtetit që dërgoi komunikatën një shpjegim ose deklaram tjetër me shkrim ku të sqarohet çështjen, dhe të përfshijë, me aq sa është e mundur dhe me vend, përshkrimin e procedurave të brendshme dhe të masave të marra, të lëna pezull ose që janë të mundshme për atë çështje;

b) Nëse çështja nuk zgjidhet duke kënaqur të dy Shtetet Palë në fjalë brenda gjashtë muajve nga marrja e komunikatës së parë nga Shteti marrës, secili Shtet ka të drejtë ta paraqesë çështjen në Komitet, përmes një njoftimi që i bëhet Komitetit dhe Shtetit tjetër;

c) Komiteti e trajton çështjen e paraqitur atij sipas këtij neni vetëm pasi ai të ketë vërtetuar se janë provuar dhe konsumuar të gjitha zgjidhjet e mundshme të çështjes brenda vendit, në pajtim me parimet e gjithpranuara të së drejtës ndërkombëtare. Ky rregull nuk do të zbatohet në rastet kur aplikimi i zgjidhjeve është tejzgjatur pa arsye ose kur nuk ka gjasa t'i sjellë lehtësim të efektshëm personit që është viktimë e dhunimit të kësaj Konvente;

d) Komiteti zhvillon mbledhje të mbyllura kur shqyrton komunikatat sipas këtij neni;

e) Duke iu nënshtruar dispozitave të nënparagrafit (c), Komiteti vë zyrat e tij në dispozicion të Shteteve Palë të interesuaramë synimin për një zgjidhje miqësore të çështjes mbi bazën e respektimit të detyrimeve të parashikuara në këtë Konventë. Për këtë qëllim, Komiteti, kur e sheh me vend, mund të krijojë një komision ad hoc pajtimi;

f) Për çdo çështje që i paraqitet atij sipas këtij neni, Komiteti mund t'u kërkojë Shteteve Palë në fjalë, dhe të përmendura në nënparagrafin (b), të sjellin çdo informacion të vlefshëm;

g) Shtetet Palë në fjalë, të përmendura në nënparagrafin (b), kanë të drejtë të përfaqesohen gjatë shqyrtimit të çështjes nga Komiteti dhe të bëjnë deklarime me shkrim ose/ dhe me gojë;

h) Brenda dymbëdhjetë muajve nga data e marrjes së njoftimit sipas nënparagrafit (b), Komiteti paraqet një raport:

(i) Nëse arrihet një zgjidhje brenda kushteve të nënparagrafit (e), Komiteti e kufizon raportin e tij në një parashtrim të shkurtër të fakteve dhe zgjidhjeve të arritura;

(ii) Nëse nuk arrihet një zgjidhje brenda kushteve të nënparagrafit (e), Komiteti e kufizon raportin e tij në një parashtrim të shkurtër të

fakteve; deklaratimet me shkrim dhe regjistrimet e deklaratimeve me gojë të bëra nga Shtetet Palë në fjalë do t'i bashkëngjiten raportit.

Për çdo çështje, raporti u komunikohet Shteteve Palë në fjalë.

2. Dispozitat e këtij neni hyjnë në fuqi kur pesë Shtete Palë në këtë Konventë bëjnë deklaratat sipas paragrafit 1 të këtij neni. Këto deklarata depozitohen nga Shtetet Palë tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili u përcjell kopje të tyre Shteteve të tjera Palë. Deklarata mund të tërhiqet në çdo kohë pasi njoftohet Sekretari i Përgjithshëm. Kjo tërheqje nuk paragjykon shqyrtimin e asnjë çështjeje që i nënshtrohet një komunikate të përcjellur tashmë sipas këtij neni; asnjë komunikatë tjetër nga çdo shtet nuk do të pranohet sipas këtij neni pas marrjes nga Sekretari i Përgjithshëm të njoftomit për tërheqjen e deklaratës, vetëm nëse Shteti Palë në fjalë bën një deklaratë të re.

#### *Neni 22*

1. Një Shtet Palë në këtë Konventë mund në çdo kohë të deklarojë sipas këtij neni se ai e njeh autoritetin e Komitetit për të marrë dhe shqyrtuar komunikata nga ose në emër të individëve nën juridiksionin e tij të cilët pretendojnë se janë viktime të një dhunimi të dispozitave të Konventës nga një Shtet Palë. Komiteti nuk do të marrë asnjë komunikatë nëse kjo çështje ka të bëjë me një Shtet Palë që nuk e ka bërë një deklaratë të tillë.

2. Komisioni do të konsiderojë të paparanueshme çdo komunikatë sipas këtij neni e cila është anonime ose të cilën ai e gjykon të jetë një abuzim me të drejtën e paraqitjes së komunikatave të tilla ose që nuk përputhet me dispozitat e kësaj Konvente.

3. Duke iu nënshtuar dispozitave të paragrafit 2, Komiteti sjell çdo komunikatë paraqitur atij sipas këtij neni, në vëmendjen e Shtetit Palë në këtë Konventë i cili ka bërë një deklaratë sipas paragrafit 1 dhe akuzohet se po shkel cilëndo dispozitë të Konventës. Brenda gjashtë muajve, Shteti marrës i paraqet Komitetit shpjegime ose deklaratime me shkrim ku sqaron çështjen dhe zgjidhjet, nëse ka, që mund të jenë dhënë nga ai Shtet.

4. Komiteti i shqyrton komunikata të marra sipas këtij neni nën dritën e të gjithë informacioneve të vëna në dispozicion të tij nga ose në emër të individëve dhe nga Shteti Palë në fjalë.

5. Komiteti nuk do të shqyrtojë asnjë komunikatë nga një individ sipas këtij neni pa vërtetuar se:

a) E njejta çështje nuk ka qenë, nuk është duke u shqyrtuar sipas një procedure tjetër të hetimit ose zgjidhjes ndërkombëtare;

b) Individit i ka konsumuar të gjitha zgjidhjet e mundshme brenda vendit; nuk do të vepohet kështu në rastet kur aplikimi i zgjidhjeve tejzgjatet pa arsye ose nuk ka gjasa t'i sjellë lehtësim të efektshëm personit i cili është viktimë e dhunimit të kësaj Konvente.

6. Komiteti zhvillon mbledhje të mbyllura kur shqyrton një komunikatatë sipas këtij neni.

7. Komiteti ia përcjell pikëpamjet e veta Shteteve Palë dhe individëve në fjalë.

8. Dispozitat e këtij neni hyjnë në fuqi kur pesë Shtete Palë në këtë Konventë të kenë bërë deklarata sipas paragrafit 1 të këtij neni. Këto deklarata depozitohen nga Shtetet Palë tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili i përcjell kopje të tyre Shteteve të tjerë Palë. Deklarata mund të tërhiqet në çdo kohë pasi njoftohet Sekretari i Përgjithshëm. Kjo tërheqje nuk paragjykon shqyrtimin e asnjë çështjeje që i nënshtrohet një komunikate të përcjellur tashmë sipas këtij neni; asnjë komunikatë tjetër nga ose në emër të çdo individit nuk do të pranohet sipas këtij neni pas marrjes nga Sekretari i Përgjithshëm të njoftimit për tërheqjen e deklaratës, vetëm nëse Shteti Palë në fjalë bën një deklaratë të re.

#### *Neni 23*

Anëtarët e Komitetit dhe të komisionit ad hoc të pajtimit të cilët mund të emërohen sipas nenit 21, paragrafi 1 (e), kanë të drejtën e lehtësirave, privilegjeve dhe imuniteteve të ekspertëve në mision për Kombet e Bashkuara siç përcaktohet në seksionet përkatës të Konventës për Privilegjet dhe Imunitetet e Kombeve të Bashkuara.

#### *Neni 24*

Komiteti i paraqet Shteteve Palë dhe Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara një raport vjetor mbi veprimtarinë e tij sipas kësaj Konvente.

#### *Neni 25*

1. Kjo Konventë është e hapur për firmosje nga të gjithë Shtetet.
2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit. Instrumentet e ratifikimit depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

*Neni 26*

Kjo Konventë është e hapur për aderim nga të gjithë Shtetet. Aderimi do të kryhet nëpërmjet depozitimit të një instrumenti aderues tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

*Neni 27*

1. Kjo Konventë hyn në fuqi tridhjetë ditë pas datës së depozitimit tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara të instrumentit të njëzetë të ratifikimit dhe aderimit.

2. Për çdo Shtet që e ratifikon këtë Konventë ose pranohet pas depozitimit të instrumentit të njëzetë të ratifikimit dhe aderimit Konventa hyn në fuqi tridhjetë ditë pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit dhe aderimit.

*Neni 28*

1. Çdo Shtet mund të deklarojë, në momentin e firmosjes ose ratifikimit të kësaj Konvente ose të aderimit në të, se ai nuk e njeh autoritetin e Komitetit të parashikuar në nenin 20.

2. Çdo Shtet Palë që ka bërë një rezervim në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni mund, në çdo kohë, ta tërheqë këtë rezervim

*Neni 29*

1. Çdo Shtet Palë në këtë Konventë mund të propozojë një amendament dhe ta skedojë atë tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm paskësaj ia komunikon amendamentin e propozuar Shteteve Palë me një kërkesë që ata ta njoftojnë nëse janë në favor të një konference të Shteteve Palë me qëllim që të shqyrtohet dhe votohet për atë propozim. Në rast se brenda katër muajve nga data e kësaj komunikate të paktën një e treta e Shteteve Palë është në favor të kësaj konference, Sekretari i Përgjithshëm e thërret konferencën sipas rrethanave të Kombeve të Bashkuara. Çdo amendament i miratuar nga shumica e Shteteve Palë të pranishëm dhe votues në konferencë i paraqitet për miratim të gjithë Shteteve Palë nga Sekretari i Përgjithshëm.

2. Një amendament i miratuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni hyn në fuqi kur dy të tretat e Shteteve Palë në këtë Konventë njoftojnë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara se e

pranojnë atë në përputhje me të drejtën e tyre kushtetuese.

3. Kur amendamentet hyjnë në fuqi, ato bëhen të detyrueshme për ato Shtete Palë që i pranojnë ato, Shtetet e tjera Palë mbeten akoma të detyruara nga dispozitat e kësaj Konvente dhe çdo amendament i mëparshëm që ata kanë pranuar.

#### *Neni 30*

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy a më shumë Shteteve Palë, që ka të bëjë me interpretimin apo zbatimin e kësaj Konvente e cila nuk mund të zgjidhet përmes bisedimeve, paraqitet për arbitrazh me kërkesën e njërit prej tyre. Nëse brenda gjashtë muajve nga data kërkesës për arbitrazh Palët nuk janë në gjendje të bien dakord për organizimin e arbitrazhit, secila nga këto Palë mund ta paraqesë mosmarrëveshjen në Gjykatë përmes një kërkesë në përputhje me Statutin e Gjykatës.

2. Çdo Shtet mund të deklarojë në momentin e firmosjes ose ratifikimit të kësaj Konvente ose aksesit në të, se ai nuk e konsideron veten të detyruar nga paragrafi 1 këtij neni. Shtetet e tjera Palë nuk do të kenë detyrime sipas paragrafit 1 të këtij neni ndaj çdo Shteti Palë që ka bërë një rezervim të tillë.

3. Çdo Shtet Palë që ka bërë një rezervim në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni mund ta tërheqë në çdo kohë këtë rezervim duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

#### *Neni 31*

1. Një Shtet Palë mund të denoncojë këtë Konventë me një njoftim me shkrim tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Denoncimi bëhet i efektshëm një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

2. Një denoncim i tillë nuk e çliron Shtetin Palë nga detyrimet e tij sipas kësaj Konvente për sa i përket çdo veprimi ose përjashtimi që ndodh para datës në të cilën bëhet i efektshëm denoncimi, dhe as nuk paragjykon në asnjë mënyrë shqyrtimin e vazhdueshëm të çdo çështjeje që është tashmë nën shqyrtim nga Komiteti para datës në të cilën bëhet i efektshëm denoncimi.

3. Pas datës në të cilën denoncimi i një Shteti Palë bëhet i efektshëm, Komiteti nuk do të fillojë shqyrtimin e asnjë çështjeje të re që ka të bëjë me atë Shtet.



*Neni 32*

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara informon Shtetet Anëtarë të Kombeve të Bashkuara dhe Shtetet që kanë firmosur këtë Konventë ose janë pranuar në të për sa më poshtë:

- a) Firmosjet, ratifikimet, aderimin sipas neneve 25 dhe 26;
- b) Datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente sipas nenit 27 dhe datën e hyrjes në fuqi të çdo amendamenti sipas nenit 29;
- c) Denoncimet sipas nenit 31.

*Neni 33*

1. Kjo Konventë, për të cilën ka tekste njëloj autentike në gjuhët Arabe, Kineze, Angleze, Franceze, Ruse dhe Spanjolle, depozitohet tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara i përcjell kopje të certifikuara të kësaj Konvente të gjithë Shteteve.

## **JURISPRUDENCË E PËRZGJEDHUR MBI KONVENTAT E KOMBEVE TË BASHKUARA KUNDËR TORTURËS**

Komiteti i Kombeve të Bashkuara kundër torturës, organi i traktatit që monitoron implementimin e Konventës kundër Torturës, përmes një Komenti të Përgjithshëm, i vetmi deri më sot, ka interpretuar dispozitat e Konventës. Komenti i Përgjithshëm Nr. 1 analizon marrëdhëniet ndërmjet nenit 3 të Konventës, i cili ndalon Shtetet Palë të rikthejnë një person në një vend ku ka arsye të forta për të besuar se ai ose ajo do të rrezikonin t'i nënshtroheshin torturës, dhe nenit 22, që bën fjalë për procedurën e komunikatave individuale:

Koment i Përgjithshëm Nr.1 i Komitetit të Kombeve të Bashkuara kundër Torturës mbi zbatimin e nenit 3 të Konventës në kontekstin e nenit 22 Miratuar nga Komiteti në Sesionin e tij të 19, 1997

Duke patur parasysh kërkesat e nenit 22, paragrafi 4, të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të Tjerë të Egër, Çnjerëzorë ose Degradues që Komiteti kundër Torturës “i konsideron komunikata të marra sipas nenit 22 nën dritën e gjithëinformacionit të vënë në dispozicion të tij nga ose në emër të individit dhe nga Shteti palë i interesuar”,

Duke marrë parasysh nevojën që do të lindë si pasojë e zbatimit të

rregullit 111, paragrafi 3, të rregullores procedurale të Komitetit (CAT/C/3Rev.2), dhe Duke patur parasysh nevojën për direktiva për zbatimin e nenit 3 sipas procedurës së parashikuar në nenin 22 të Konventës,

Komiteti kundër Torturës, në sesionin e tij të 317, mbajtur në 21 Nëntor 1997, miratoi komentin e përgjithshëm në vijim si udhërrëfyes për Shtetet Palë dhe autorët e komunikatave:

1. Neni 3 kufizohet në zbatimin e tij për çështje në të cilat ka arësye të konsiderueshme për të besuar se autori do të rrezikonte t'i nënshtrohej torturës siç është përcaktuar në nenin 1 të Konventës.

2. Komiteti është i mendimit se shprehja “një tjetër Shtet” në nenin 3 i referohet Shtetit për tek i cili është duke u dëbuar, rikthyer ose ekstraduar individi në fjalë, si edhe çdo Shteti tek i cili autori mund të dëbohet, rikthehet ose ekstradohet më pas.

3. Në zbatim të nenit 1, kriteri i përmendur në nenin 3, paragrafi 2, i “dhunimit të vazhdueshëm masiv e flagrant të të drejtave të njeriut” i referohet vetëm dhunimeve nga ose me nxitjen e ose me lejen ose dijeninë e një nëpunësi publik ose një personi tjetër që vepron në cilësi zyrtare.

#### *Pranueshmëria*

4. Komiteti është i mendimit se është përgjegjësia e autorit të provojë një çështje prima facie me synimin e pranueshmërisë së komunikatës së vet sipas nenit 22 të Konventës duke plotësuar secilën prej kërkesave të rregullit 107 të rregullores procedurale të Komitetit.

#### *Meritat*

5. Përsa i përket zbatimit të nenit 3 të Konventës për meritat e një çështjeje, barra për të paraqitur një çështje të argumentuar i mbetet autorit. Kjo nënkupton se për pozicionin e autorit duhet të ketë një bazë faktesh të mjaftueshëm për të kërkuar një përgjigje nga Shteti Palë.

6. Duke mbajtur parasysh se Shteti Palë dhe Komiteti janë të detyruar të vlerësojnë nëse ka arësye të konsiderueshme për të besuar se autori do të rrezikonte t'i nënshtrohej torturës atje ku ai/ajo duhej të dëbohej, rikthehej ose ekstradohej, rreziku i torturës duhet të vlerësohet me argumente që shkojnë përtej një teorie ose dyshimi të thjeshtë. Sidoqoftë, nuk është e domosdoshme që rreziku të kalojë provën e të qenit tepër i mundshëm.

7. Autori duhet të vërtetojë se ai/ajo do të rrezikonte të torturohej

dhe se arësyet për ta besuar këtë janë të konsiderueshme në mënyrën se si përshkruhen, dhe se një rrezik i tillë është personal dhe i pranishëm. I gjithë informacioni që gjykohet se ka lidhje me çështjen mund të paraqitet nga secila palë për t'u marrë në konsideratë për këtë çështje.

8. Informacioni i mëposhtëm, kur nuk mungon, do të ishte i lidhur me çështjen:

a) A është Shteti në fjalë një Shtet në të cilin ka prova të një dhunimi të

vazhdueshëm masiv e flagrant të të drejtave të njeriut (shiko Nenin 3. paragrafi. 2)?

b) A është torturuar ose keqtrajtuar autori nga ose me nxitjen, lejen ose dijeninë e një nëpunësi publik ose të një personi tjetër që ka vepruar në cilësi zyrtare në të kaluarën? Nëqoftëse po, a ka ndodhur kjo në të kaluarën e afërt?

c) A ka prova mjekësore ose prova të tjera të pavarura që mbështesin pretendimin e autorit se ai/ajo është torturuar ose keqtrajtuar në të kaluarën? A ka patur tortura efekte të mëvonshme?

d) A ka ndryshuar situata e përmendur në (a) më sipër? A ka ndryshuar situata për sa i përket respektimit të të drejtave të njeriut?

e) A është angazhuar autori në veprimtari politike ose të tjera brenda ose jashtë Shtetit në fjalë të cilat mund ta bëjnë atë veçanërisht të prekshëm nga rreziku i mundshëm i torturës nëse ai/ajo dëbohet, rikthehet ose ekstradohet në Shtetin në fjalë?

f) A ka ndonjë provë për besueshmërinë e autorit?

g) A ka mospërputhje në pretendimet e autorit? Nëse po, a janë të vlefshme ato?

9. Duke mbajtur parasysh se Komiteti kundër Torturës nuk është organ apeli, quasi gjyqësor ose administrativ, por më shumë një organ monitorues i krijuar nga vetë Shtetet palë vetëm me fuqi deklarative, është e kuptueshme se:

a) Në ushtrimin e juridiksionit të Komitetit në zbatim të nenit 3 të Konventës, peshë e konsiderueshme do t'i jepet rezultateve të fakteve që nxirren nga organet e Shtetit palë në fjalë; por

b) Komiteti nuk kufizohet nga fakte të tilla dhe ka fuqinë e dhënë nga neni 22, paragrafi 4, i Konventës, për një vlerësim të lirë të fakteve bazuar në tërë morinë e rrethanave për çdo çështje.

**Konventa për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Genocidit**

Miraturar dhe e hapur për nënshkrim, ratifikim dhe aderim me rezolutën 210 A (III) të Asamblesë së Përgjithshme më 9 Dhjetor 1948

Hyri në fuqi më 12 Janar 1951, në përputhje me nenin XIII

[...]

*Neni I*

Palët Kontraktuese konfirmojnë se genocidi, i kryer në kohë paqeje ose në kohë lufte, është krim sipas të drejtës ndërkombëtare, të cilin ato (Shtetet) angazhohen ta parandalojnë e ndëshkojnë.

*Neni II*

Në këtë Konventë, genocidi nënkupton çdonjërin nga veprimet e mëposhtëme të kryeya me qëllim për të shkatërruar, tërësisht ose pjesërisht, një grupimkombëtar, etnik, rracor ose fetar, si:

[...]

b) Shkaktimi i dëmtimeve të rënda trupore ose mendore ndaj pjesëtarëve të një grupimi;

*[...] Neni III*

Veprimet e mëposhtëme janë të ndëshkueshme:

- (a) Genocidi;
- (b) Konspiracioni për të kryer genocid;
- (c) Nxitja e drejtpërdrejtë dhe publike për të kryer genocid;
- (d) Përpjekja për të kryer genocid;
- (e) Bashkëpunimi në genocid

*Neni IV*

Personat që kryejnë genocid osendonjë nga veprimet e tjerë të listuar në nenin III ndëshkohen, pavarësisht nëse ata janë zyrtare te larte që përgjigjen sipas kushtetutës, nëpunës publikë ose individë privatë.

*Neni V*

Palët kontraktuese angazhohen të dekretojnë, në përputhje me

kushtetutat e tyre përkatëse, legjislacionin e nevojshëm për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente, dhe, veçanërisht, të parashikojnë ndëshkime të efektshme për personat fajtorë për genocid ose çdonjerin nga veprimet e listuar në nenin III.

*Neni VI*

Personat e akuzuar për genocid ose çdonjerin nga veprimet e listuar në nenin III gjykohen nga një gjykatë kompetente e Shtetit në territorin e të cilit është kryer veprimi, ose nga një gjykatë ndërkombëtare që ka juridiksion mbi ato Palë Kontraktuese të cilat e pranojnë juridiksionin e saj.

*Neni VII*

Genocidi dhe veprime të tjera të listuar në nenin III nuk konsiderohen krime politike për qëllim ekstradimi. Palët Kontraktuese angazhohen që në raste të tilla të bëjnë ekstradimin në përputhje me ligjet e tyre dhe marrëveshjet në fuqi.

*Neni VIII*

Çdo Palë Kontraktuese mund t'i kërkojë organeve kompetente të Kombeve të Bashkuara të ndërmarrin çdo veprim që e konsiderojnë të përshtatshëm për parandalimin dhe zhdukjen e veprimeve të genocidit ose çdonjerit nga veprimet e listuar në nenin III.

[...]

Konventa Ndërkombëtare për Zhdukjen dhe Ndëshkimin e Krimit të Aparteidit

Miraturar dhe e hapur për nënshkrim, ratifikim dhe aderim me rezolutën 3068 (XXVIII) të Asamblesë së Përgjithshme më 30 Nëntor 1973

Hyri në fuqi më 18 Korrik 1976, në përputhje me nenin XV

[...] *Neni I*

1 Shtetet Palë në këtë Konventë deklarojnë se aparteidi është krim kundër njerëzimit dhe se veprimet çnjerëzore që rezultojnë nga politikat dhe praktikrat e aparteidit dhe politika e praktika të ngjashme të veçimit dhe diskriminimit rracor, siç janë përcaktuar në nenin II të Konventës, janë krime që dhunojnë parimet e të drejtës ndërkombëtare, në veçanti

qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, dhe që përbëjnë një kërcënim serioz për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

2 Shtetet Palë në këtë Konventë i deklarojnë kriminale ato organizata, institucione dhe individë që kryejnë krimin e aparteidit.

#### *Neni II*

Për qëllimet e kësaj Konvente, termi “krimi i aparteidit”, i cili përfshin politika dhe praktika të ngjashme të veçimit dhe diskriminimit rracor si ato të praktikuar në Afrikën e Jugut, zbatohet edhe për veprimet e mëposhtëme çnjerëzore të kryera me qëllimin për të vendosur dhe ruajtur dominimin e një grupi rracor personash mbi çdo grup tjetër rracor personash dhe shtypjen sistematike të tyre:

[...]

ii. Shkaktimi i dëmtimeve të rënda trupore dhe mendore mbi anëtarët e një grupi ose grupeve rracorë, duke shkelur lirinë ose dinjitetin e tyre, ose duke i nënshtruar ato ndaj torturave ose trajtimit të egër, çnjerëzor ose degradues;

#### *Neni III*

Përgjegësia penale ndërkombëtare zbatohet, pavarësisht nga motivi përkatës, për individët, anëtarët e organizatave dhe institucioneve dhe përfaqësuesit e Shtetit, nëse banojnë në territorin e Shtetit në të cilin janë kryer veprimet ose në ndonjë Shtet tjetër, sa herë që ato:

a) Kryejnë, marrin pjesë, nxisin ose komplotojnë drejtpërdrejt në kryerjen e veprimeve të përmendura në nenin II të kësaj Konvente; b) Mbështesin, nxisin ose bashkëpunojnë drejtpërdrejt në kryerjen e krimit të aparteidit.

#### *Neni IV*

Shtetet Palë në këtë Konventë angazhohen:

a) Të miratojnë çdo masë ligjore ose tjetër të nevojshme për të shtypur edhe për të parandaluar çdo nxitje të krimit të aparteidit dhe politikave të ngjashme veçuese apo shfaqje të tyre, dhe të ndëshkojnë personat fajtorë për atë krim;

b) Të miratojnë masa ligjore, gjyqësore dhe administrative për të ndjekur penalisht, gjykuar dhe ndëshkuar në përputhje me juridiksionin e tyre personat përgjegjës, ose të akuzuar për krimet e përcaktuara

në nenin II të kësaj Konvente, pavarësisht nëse ata banojnë ose jo në territorin e Shtetit në të cilin kryhen këto veprime, ose janë shtetas të atij Shteti ose të një Shteti tjetër, ose janë persona pa shtetësi.

#### *Neni V*

Personat e akuzuar për veprimet e listuara në nenin II të kësaj Konvente mund të gjykoen nga një gjykatë kompetente e çdo Shteti Palë në Konventë i cili mund të marrë juridiksionin mbi personin e akuzuar ose nga një gjykatë penale ndërkombëtare që ka juridiksionin për ato Shtete Palë të cilat e kanë pranuar juridiksionin e saj.

Tekste Jo-detyrues të miratuara nga Kombet e Bashkuara

#### **Deklarata Universale e Të Drejtave të Njeriut**

Miratuar dhe shpallur me rezolutën 217 (III) të Asamblesë së Përgjithshme më 10 Dhjetor 1948

#### *Hyrje*

Duke patur parasysh se njohja e dinjitetit të qenësishëm dhe e të drejtave të barabarta e të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë,

Duke patur parasysh se mospërfillja dhe përbuzja për të drejtat e njeriut kanë çuar në veprime barbare që kanë cënuar ndërgjegjen e njerëzimit, dhe se krijimi i një bote në të cilën qeniet njerëzore gëzojnë lirinë e shprehjes e të besimit dhe lirinë nga frika e nevoja, është shpallur si aspirata më e lartë e njerëzve të thjeshtë,

Duke patur parasysh se është thelbësore, që të drejtat e njeriut të mbrohen nga sundimi i ligjit me qëllim që njeriu të mos detyrohet të përdorë, si mundësinë e fundit, rebelimin ndaj tiranisë dhe shtypjes,

Duke patur parasysh se është thelbësore të nxitet zhvillimi i marrëdhënieve miqësore ndërmjet kombeve. Duke patur parasysh se popujt e Kombeve të Bashkuara kanë riafirmuar në Kartë besimin në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe vlerën e qenies njerëzore dhe në të drejtat e barabarta ndërmjet burrave dhe grave dhe kanë vendosur të nxisin progresin social dhe standarde më të mira jetese në një liri më të madhe,

Duke patur parasysh se Shtetet Anëtarë janë angazhuar të realizojnë, në bashkëpunim me Kombet e Bashkuara, nxitjen e respektimit dhe zbatimit universal të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut,

Duke patur parasysh se një kuptim i përbashkët i këyre të drejtave dhe lirive ka rëndësi shumë të madhe për realizimin e plotë të këtij angazhimi,

Tani, prandaj,

Asambleja e Përgjithshme,

Shpall Deklaratën Universale të Të Drejtave të Njeriut si një standard të përbashkët për t'u përmbushur nga të gjithë popujt dhe kombet, me qëllim që çdo individ dhe çdo organ i shoqërisë, duke mbajtur vazhdimisht parasysh këtë Deklaratë, të përpiqet të nxisë, përmes mesimdhënies dhe edukimit, respektin për këto të drejta e liri dhe përmes masave progresive, kombëtare e ndërkombëtare, të garantojnë njohjen dhe zbatimin e tyre universal e të efektshëm si nga vetë popujt e Shteteve Anëtarë, ashtu edhe nga popujt e territoreve nën juridiksionin e tyre.

#### *Neni 1*

Të gjitha qeniet njerëzore lindin të lira e të barabarta në dinjitet dhe të drejta. Ata janë të pajisur me arësye dhe ndërgjegje dhe duhet të veprojnë ndaj tjetrit me frymën e vëllazërimit.

[...]

#### *Neni 5*

Askush nuk i nënshtrohet torturës ose trajtimit apo ndëshkimit të egër, çnjerëzor ose degradues.

#### *[...] Neni 8*

Cilido ka të drejtën e një zgjidhjeje të efektshme nga gjykatat kompetente kombëtare për veprime që shkelin të drejtat themelore të cilat i jepen atij nga kushtetuta ose ligji.

[...]

**Deklarata mbi Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Nënshtrimi ndaj Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të Tjerë të Egër, Çnjerëzorë ose Degradues**

Miratuar me rezolutën 3452 (XXX) të Asamblesë së Përgjithshme më 9 Dhjetor 1975



*Neni 1*

1 Për qëllimet e kësaj Deklarate, tortura nënkupton çdo veprim përmes të cilit me dashje i shkaktohet një personi dhimbje ose vuajtje e rëndë fizike ose mendore nga apo me nxitjen e një nëpunësi publik për qëllime të tilla si marrja prej tij ose një personi të tretë e informacioneve ose rrëfimeve, ndëshkimi i tij për një veprim që ai ka kryer ose dyshohet ta ketë kryer, ose kërcënimi i tij apo personave të tjerë. Ajo nuk përfshin dhimbje ose vuajtje që shkaktohet vetëm, ose është e qenësishme apo rastësore, nga sanksionet e ligjshme në atë masë që lejohet nga Rregullat Standarde Minimale për Trajtimin e të Burgosurve.

2 Tortura përbën një formë të rëndë dhe të qëllimshme të trajtimit ose ndëshkimit të egër, çnjerëzor ose degradues.

*Neni 2*

Çdo torturë ose trajtim apo ndëshkim tjetër i egër, çnjerëzor ose degradues është një shkelje e të dinjitetit të njeriut dhe dënohet si mohim i qëllimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe si dhunim i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të shpallura në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut.

*Neni 3*

Asnjë Shtet nuk mund të lejojë ose tolerojë torturën ose trajtime apo ndëshkime të tjera të egra, çnjerëzore ose degradues. Rrethana të jashtëzakonshme si gjendja e luftës ose kërcënimi për luftë, mos-stabiliteti i brendshëm politik ose çdo emergjencë tjetër publike nuk mund të përdoren për të justifikuar torturën ose trajtimin apo ndëshkimin e egër, çnjerëzor ose degradues.

*Neni 4*

Çdo Shtet, në përputhje me dispozitat e kësaj Deklarate, merr masa të efektshme për parandalimin e praktikimit brenda juridiksionit të tij të torturës dhe trajtimeve apo ndëshkimeve të tjerë të egër, çnjerëzore ose degradues.

*Neni 5*

Trainimi i personelit ligjzbatues dhe nëpunësve të tjerë publikë që mund të jenë përgjegjës për persona të privuar nga liria e tyre siguron që të merren masa të plota për ndalimin e torturës dhe trajtimeve apo

ndëshkimeve të tjerë të egër, çnjerëzorë ose degradues. Ky ndalim përfshihet, kur është e përshtatshme, në rregulloret ose udhëzimet e përgjithshme që nxirren në lidhje me detyrat dhe funksionet e cilitdo që mund të përfshihet në mbikqyrjen ose trajtimin e këtyre personave.

#### *Neni 6*

Çdo Shtet mban nën vëmendje të vazhdueshme metodat dhe praktikat hetimore si edhe masat për mbikqyrjen dhe trajtimin e personave të privuar nga liria e tyre në territorin e tij, me synimin për parandalimin e çdo rasti të torturës dhe trajtimeve apo ndëshkimeve të tjerë të egër, çnjerëzorë ose degradues.

#### *Neni 7*

Çdo Shtet siguron që të gjithë rastet e torturës të përcaktuara në nenin 1 të konsiderohen shkelje sipas sistemit të tij ligjor penal. E njëjta gjë zbatohet edhe për veprime të cilat përbëjnë pjesëmarrje, bashkëpunim, nxitje ose përpjekje për të kryer torturë.

#### *Neni 8*

Çdo person që pretendon se i është nënshtruar torturës ose trajtimeve apo ndëshkimeve të tjerë të egër, çnjerëzorë ose degradues nga ose me nxitjen e një nëpunësi publik, ka të drejtë të ankohet dhe të kërkojë shqyrtimin asnjanes të çështjes së tij nga autoritetet kompetente të Shtetit në fjalë.

#### *Neni 9*

Sa herë ka arësye për të besuar se është ushtruar torturë, siç përcaktohet në nenin 1, autoritetet kompetente të Shtetit në fjalë procedojnë menjëherë për një hetim asnjanes, edhe sikur të mos jetë bërë asnjë ankesë formale.

#### *Neni 10*

Nëse një hetim sipas nenit 8 ose nenit 9 konkludon se duket të jetë ushtruar torturë sipas përcaktimit në nenin 1, nisin procedimet penale kundër shkelësit apo shkelësve të akuzuar, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Nëse një pretendim për forma të tjera të trajtimit ose

ndëshkimit të egër, çnjerëzor ose degradues konsiderohet i argumentuar mirë, shkelësi ose shkelësit e akuzuar i nënshtrohen procedimeve të duhura penale, disiplinore ose të tjera.

*Neni 11*

Atje ku provohet se nga ose me nxitjen e një nëpunësi publik është kryer torturë ose trajtim apo ndëshkim tjetër i egër, çnjerëzor ose degradues, viktimës i akordohet kompensim në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

*Neni 12*

Asnjë deklaratë, e cila gjykohet se është bërë si rezultat i torturës ose i trajtimeve apo ndëshkimeve të tjera të egra, çnjerëzore ose degraduese, nuk mund të përdoret si provë kundër personit në fjalë ose kundër çdo personi tjetër në asnjë procedim.

Deklarata mbi Eleminimin e Dhunës ndaj Grave

Miraturar me rezolutën 48/04 të Asamblesë së Përgjithshme më 20 Dhjetor 1993

[...] *Neni 2*

Dhuna ndaj grave përfshin, por nuk kufizohet vetëm në, sa vijon:

[...]

(c) Dhunë fizike, psikologjoke e seksuale e ushtruar ose e lejuar nga Shteti, kudo që të ndodhë.

*Neni 3*

Gratë kanë të drejtën e gëzimit e mbrojtjes së barabartë të të gjitha të drejtave e lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, sociale, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër. Këto të drejta përfshijnë, ndër të tjera:

[...]

a. Të drejtën për të mos iu nënshtuar torturës ose trajtimeve apo ndëshkimeve të tjerë të egër, çnjerëzore ose degradues.

*Neni 4*

Shtetet duhet të dënojnë dhunën ndaj grave dhe nuk duhet të përdorin asnjë zakon, traditë ose konsideratë fetare për të shmangur detyrimet e tyre për sa i përket eliminimit të saj. Shtetet duhet të ndjekin me të gjitha mjetet e nevojshme dhe pa vonesë një politikë të eliminimit të dhunës ndaj grave dhe, për këtë qëllim, duhet:

[...]

- a. Të shmangin përfshirjen në dhunë ndaj grave;
- b. Të ushtrojnë kujdesin e duhur për parandalimin, hetimin, dhe në përpunje me legjislacionin kombëtar, ndëshkimin e veprimeve të dhunës ndaj grave, pavarësisht nëse ato veprime janë shkaktuar nga Shteti ose nga persona privatë;
- c. Të zhvillojnë sanksione penale, civile, administrative e pune në legjislacionin e brendshëm, për të ndëshkuar dhe korigjuar të këqiat që i janë shkaktuar grave të cilat i janë nënshtruar dhunës; grave që i janë nënshtruar dhunës duhet t'u garantohet akses në mekanizmat e drejtësisë dhe, siç parashikohet nga legjislacioni kombëtar, në zgjidhje të drejta e të efektshme për dëmtimin që ato kanë vuajtur; Shtetet duhet gjithashtu të informojnë gratë mbi të drejtat për të kërkuar korigjim përmes mekanizmave të tillë;

[...]

(g) Të punojnë për të siguruar, në masën më të madhe të mundëshme nën dritën e burimeve të disponueshme dhe, ku është e nevojshme, brenda kuadrit të bashkëpunimit ndërkombëtar, që gratë të cilat i janë nënshtruar dhunës dhe, ku është e nevojshme, fëmijët e tyre, të kenë asistencë të specializuar, si rehabilitim, asistencë për kujdesin e mbajtjen e fëmijëve, trajtim, keshillim dhe shërbime, lehtësi e programe shëndetësore e sociale, si edhe struktura mbështetëse, dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për të nxitur sigurinë dhe rehabilitimin e tyre fizik e psikologjik;

2 Konsiderohen kriminale të gjitha format e shtypjes dhe trajtimit të egër dhe çnjerëzor të grave dhe fëmijëve, duke përfshirë burgosjen, torturën, të qëlluarit me armë, arrestimet masive, ndëshkimin kolektiv, shkatërrimin e banesave dhe dëbimin me forcë, të kryera nga palët ndërluftuese gjatë operacioneve ushtarake ose në territore të pushtuara.

[...]

Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për

Administrimin e Drejtësisë për adoleshentët

[...](“Rregullat e Pekinit”)

### **Deklarata për Mbrojtjen e Grave e Fëmijëve gjatë Emergjencave dhe Konfliktëve të Armatosura**

Shpallur me rezolutën 3318 (XXIX) të Asamblesë së Përgjithshme më 14 Dhjetor 1974

[...]

1 Të bëhen të gjitha përpjekjet, nga Shtetet e përfshirë në konflikt të armatosur, operacione ushtarake në territore të huaja ose operacione ushtarake në territore akoma nën sundim kolonial, për të ruajtur gratë dhe fëmijët nga rrënimi i luftës. Të ndërmerren të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar ndalimin e masave të tilla si persekutimi, tortura, masat ndëshkimore, trajtimi dhe dhuna degraduese, veçanërisht ndaj pjesës së popullsisë civile që përbëhet nga gratë dhe fëmijët. Miratuar me rezolutën 40/33 të Asamblesë së Përgjithshme më 29 Nëntor 1985

[...]

17.3 Adoleshentët nuk i nënshtrohen ndëshkimit trupor;

[...]

Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e Adoleshentëve të Privuar nga Liria e tyre

Miratuar me rezolutën 45/113 të Asamblesë së Përgjithshme më 14 Dhjetor 1990

#### **I. KËNDVËSHTRIME THEMELORE**

1 Sistemi i drejtësisë që mbulon adoleshentët duhet të mbrojë të drejtat dhe sigurinë dhe të nxisë mirëqenien fizike dhe mendore të tyre. Burgosja duhet të përdoret vetëm si masë e fundit.

2 Adoleshentët duhet të privohen nga liria e tyre vetëm në përputhje me parimet dhe procedurat e parashtruara në këto Rregulla dhe në Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për Adoleshentët (Rregullat e Pekinit).

Privimi i lirisë së një adoleshenti duhet të jetë një dispozitë si masë e fundit dhe për periudhën minimale të domosdoshme, dhe duhet të kufizohet vetëm për raste të jashtëzakonshme. Kohëzgjatja e ndëshkimit duhet të përcaktohet nga autoriteti gjyqësor, pa paragjykuar mundësinë e lirimit të parakohshëm të tij/saj.

3 Rregullat synojnë të vendosin standardet minimale të pranuar nga Kombet e Bashkuara për mbrojtjen e adoleshentëve të privuar nga liria e tyre në të gjitha format, në përputhje me të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe me synimin për të kundërvepruar ndaj pasojave shkatërruese të të gjitha llojeve të burgosjes dhe për të favorizuar integrimin në shoqëri.

4 Rregullat duhet të zbatohen në mënyrë asnjënjë, pa asnjë dallim të çdo lloji, si për shkak të racës, ngjyrës, seksit, moshës, gjuhës, fesë, kombësisë, bindjeve politike ose çdo bindjeje tjetër, besimeve ose praktikave kulturore, pronës, statusit të lindjes ose atij familjar, origjinës etnike ose sociale, dhe paaftësisë. Besimet dhe praktikat fetare e kulturore, dhe konceptet morale të adoleshentëve duhet të respektohen.

5 Rregullat janë hartuar për të shërbyer si standarde të përshtatshme për t'iu referuar dhe për të siguruar inkurajimin dhe udhëheqjen e profesionistëve të përfshirë në menaxhimin e sistemit të drejtësisë adoleshente.

[...]

a. Këto Rregulla nuk duhet të interpretohen si pengesë për zbatimin e instrumenteve dhe standardeve përkatës të Kombeve të Bashkuara dhe të të drejtave të njeriut, të njohura nga komuniteti ndërkombëtar, që janë më të favorshëm për sigurimin e të drejtave, kujdesit dhe mbrojtjes së adoleshentëve, fëmijëve dhe gjithë personave të rinj.

[...]

11. Për qëllimet e Rregullave, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtëme:

a) Adoleshent është çdo person nën moshën 18 vjeç. Kufiri moshor nën të cilin nuk duhet të lejohet që një fëmijë të privohet nga liria e tij/saj duhet të përcaktohet me ligj;

b) Privimi i lirisë nënkupton çdo formë paraburgosjeje ose burgosjeje apo vendosjen e një personi në një ambient mbikqyrës publik ose privat, nga i cili ky person nuk lejohet të largohet me dëshirë, me urdhër të asnjë autoriteti gjyqësor, administrativ ose autoriteti tjetër publik.

12. Privimi i lirisë duhet të kryhet në kushte dhe rrethana të cilat sigurojnë respektimin e të drejtave të adoleshentëve. Adoleshentëve në ambiente paraburgimi duhet t'u garantohet përfitimi prej veprimtarive dhe programeve të kuptimita të cilat shërbejnë për të nxitur dhe

mbështetur shëndetin dhe respektin e tyre për veten, për të ushqyer ndjenjën e tyre të përgjegjësisë dhe për të inkurajuar ato qëndrime e shprehje që i ndihmojnë ato të zhvillojnë potencialet e tyre si anëtarë të shoqërisë.

13. Adoleshentëve të privuar nga liria e tyre, për asnjë arsye të lidhur me statusin e tyre, nuk u mohohen të drejtat civile, ekonomike, politike, sociale, kulturore të cilat ata i gëzojnë sipas të drejtës kombëtare ose ndërkombëtare, dhe që përputhen me privimin e lirisë.

14. Mbrojtja e të drejtave individuale të adoleshentëve, në veçanti ligjshmëria e ekzekutimit të masave të ndalimit, sigurohen nga autoriteti kompetent, ndërsa objektivat e integritetit social duhet të sigurohen nga inspektimet e rregullta dhe mjete të tjera të kontrollit që kryhen, sipas standardeve ndërkombëtare, ligjeve dhe rregulloreve kombëtare, nga një organ me përbërjen e duhur e i autorizuar për të vizituar adoleshentët dhe që nuk i përket ambientit të paraburgimit.

[...]

16. Rregullat zbatohen në kontekstin e kushteve ekonomike, sociale dhe kulturore që sundojnë në çdo Shtet Anëtar.

### III. ADOLESHENTËT NËN ARREST OSE NË PRITJE TË GJYKIMIT

17. Adoleshentët që mbahen nën arrest ose në pritje të gjyqimit ("të pagjykuar") konsiderohen të pafajshëm dhe trajtohen si të tillë. Ndalimi para gjyqimit shmanget në masën e mundëshme dhe kufizohet në rrethana të veçanta. Prandaj, të bëhen të gjitha përpjekjet për të zbatuar masa alternative. Gjithsesi, kur përdoret ndalimi preventiv, gjykatat adoleshente dhe organet hetimore i japin përparësi më të madhe procesimit sa më të shpejtë të rasteve të tilla për të siguruar kohëzgjatjen më të shkurtër të mundëshme të ndalimit. Të ndaluarit e pagjykuar duhet të veçohen nga adoleshentët e dënuar.

18. Kushtet në të cilat ndalohet një adoleshent duhet të përputhen me rregullat e parashtruara më poshtë, me dispozita të veçanta shtesë që mund të jenë të nevojshme e të përshtatshme, duke pasur parasysh kërkesat e supozimit të pafajsisë, kohëzgjatjen e ndalimit dhe statusin ligjor e rrethanat e adoleshentit. Këto dispozita përfshijnë, por jo dosdoshmërisht kufizohen në, sa më poshtë:

a) Adoleshentët duhet të kenë të drejtën për avokat dhe për të pasur mundësi të aplikojnë për ndihmë ligjore falas, kur kjo ndihmë është e

disponueshme, dhe të komunikojnë rregullisht me avokatët e tyre. Për të tilla komunikime sigurohen intimiteti dhe konfidencialiteti;

[...]

#### IV. ADMINISTRIMI I AMBIENTEVE

K. Kufizimet e detyrimit fizik dhe përdorimit të forcës

63. Përdorimi i instrumenteve të detyrimit dhe të forcës për çdo qëllim duhet të ndalohet, përveçse siç parashikohet në rregullin 64 më poshtë.

64. Instrumentet e detyrimit dhe forcës mund të përdoren vetëm në raste të veçanta, kur janë shterruar dhe kanë dështuar të gjitha metodat e tjera të kontrollit, dhe vetëm siç përcaktohet e autorizohet qartë nga ligji dhe rregulloret. Ato nuk duhet të shkaktojnë fyerje ose degradim, dhe duhet të përdoren me kufizim dhe vetëm për periudhën e kohës më të shkurtër të mundëshme. Me urdhër të drejtorit të administratës, instrumente të tillë mund të përdoren me qëllim që të mos e lejojnë një adoleshent t'i shkaktojë dëm vetes, të tjerëve ose të shkatërrojë rëndë pronën. Në raste të tilla drejtori duhet të këshillohet menjëherë me personelin mjekësor e çdo personel tjetër të nevojshëm dhe të raportojë tek autoriteti më i lartë administrativ.

[...]

#### L. Procedurat disiplinore

66. Çdo masë dhe procedurë disiplinore duhet të ruajë interesin e sigurisë së një jete komunitare të rregullt dhe duhet të jetë në përputhje me mbështetjen e dinjitetit të qenësishëm të adoleshentit dhe objektivën themelore të kujdesit institucional, përkatësisht, kultivimin e ndjenjës së drejtësisë, respektit për veten dhe respektit për të drejtat elementare të çdo personi.

67. Ndalohen rreptësisht të gjitha masat disiplinore që përbëjnë trajtim të egër, çnjerëzor ose degradues, duke përfshirë ndëshkimin trupor, futjen në qeli të errët, izolimin e mbyllur ose të vetmuar ose çdo ndëshkim tjetër që mund të rrezikojë shëndetin fizik ose mendor të adoleshentit në fjalë. Pakësimi i dietës dhe kufizimi ose mohimi i kontaktit me pjesëtarët e familjes duhet të ndalohet për çfarëdo qëllimi. Puna duhet konsideruar gjithmonë si mjet edukimi dhe nxitjeje për vetërespektin e adoleshentit në përgatitjen e tij ose të saj për t'u rikthyer



në komunitet dhe nuk duhet imponuar si ndëshkim disiplinor. Asnjë adoleshent nuk duhet të ndëshkohet më shumë se një herë për të njëjtën shkelje disiplinore. Ndëshkimet kolektive duhet të ndalohen.

[...]

70. Asnjë adoleshent nuk duhet të ndëshkohet disiplinarisht përveçse në përputhje të rreptë me kushtet e ligjit dhe rregulloreve në fuqi. Asnjë adoleshent nuk duhet ndëshkuar për shkeljen e pretenduar pa u informuar në mënyrë të përshtatshme e plotësisht të kuptueshme për adoleshentin, dhe pa i dhënë mundësinë e paraqitjes së mbrojtjes së tij/saj, duke përfshirë të drejtën për të apeluar në një autoritet kompetent asnjanes. Duhet të mbahet dokumentacion i plotë për të gjithë procedimin disiplinor.

[...]

#### **M. Inspektimi dhe ankesat.**

72. Inspektorë të kualifikuar ose nje autoritet me përbërjen e duhur që nuk i përket administratës së ambientit të burgimit duhet të autorizohen të kryejnë inspektime të rregullta e të ndërmarrin inspektime të papritura me iniciativën e tyre, dhe duhet të kenë garanci të plota pavarësie në ushtrimin e këtij funksioni. Inspektorët duhet të kenë akses të pakufizuar në të gjithë personat e punësuar ose që punojnë në çdo ambient burgimi ku adoleshentët janë privuar ose mund të privohen nga liria e tyre, në të gjithë adoleshentët dhe gjithë dokumentacioni i këtyre ambienteve.

[...]

78. Çdo adoleshent duhet të ketë të drejtë të kërkojë asistencë nga pjesëtarët e familjes, avokatët, grupet humanitare ose të tjerë, atje ku është e mundur, me qëllim që të bëjë ankesë. Adoleshentëve analfabetë duhet t'u jepet asistencë nëqoftëse ato kanë nevojë të përdorin shërbimet publike ose agjencitë e organizatat private të cilat ofrojnë këshillim ligjor ose janë kompetente për të marrë ankesa.

[...]

#### **V. PERSONELI [...]**

85. Personeli duhet të marrë trainim të tillë që t'i mundësojë atij përmbushjen e përgjegjësive në mënyrë të efektshme, veçanërisht trainim për psikologjinë e fëmijës, mirëqenien e fëmijës dhe standardet e normat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut e të drejtave të

fëmijës, duke përfshirë Rregullat në fjalë. Personeli duhet të zotërojë e përmirësojë njohuritë dhe aftësitë e veta profesionale duke ndjekur kurse trainimi që duhet të organizohen në intervale të përshtatshme gjate gjithë karrierës së tyre.

[...]

87. Në kryerjen e detyrave të tij, personeli i ambienteve të burgimit duhet të respektojë dhe të mbrojë dinjitetin njerëzor dhe të drejtat themelore të të gjithë adoleshentëve, sidomos, si më poshtë:

a) Asnjë pjesëtar i ambientit ose institucionit të burgimit nuk mund të shkaktojë, nxisë ose tolerojë asnjë torturë ose formë trajtimi, ndëshkimi, korrigjimi ose disiplinimi të egër, çnjerëzor ose degradues, për asnjë pretekst ose rrethanë ciladoqoftë;

[...]

c) I gjithë personeli duhet të respektojë Rregullat në fjalë. Personeli që ka arësye të besojë se ka ndodhur ose mund të ndodhë një shkelje e rëndë e Rregullave në fjalë, duhet ta raportojë çështjen tek autoritetet ose organet e prokurorisë që kanë fuqi shqyrtuese ose zgjidhëse;

d) I gjithë personeli duhet të sigurojë mbrojtjen e shëndetit fizik e mendor të adoleshentëve, duke përfshirë mbrojtjen nga abuzimi ose shfrytëzimi fizik, seksual e emocional, dhe duhet të marrë masa të menjëhershme për të siguruar kujdes mjekësor kur ky është i nevojshëm;

[...]

Paketa e Parimeve për Mbrojtjen e Të Gjithë Personave nën Çdo Formë Ndalimi ose Burgimi

Miratuar me rezolutën 43/173 të Asamblesë së Përgjithshme më 9 Dhjetor 1988

## SFERA E PAKETËS SË PARIMEVE

Këto parime zbatohen për mbrojtjen e të gjithë personave nën çdo formë ndalimi ose burgimi.

## PËRDORIMI I TERMAVE

Për qëllimet e Paketës së Parimeve:

a) "Arrestim" nënkupton veprimin e kapjes së një personi që pretendohet se ka kryer një krim ose përmes veprimit të një autoriteti;

b) "Person i ndaluar" nënkupton çdo person të privuar nga liria

personale por akoma i padënuar për një shkelje;

c) “Person i burgosur” nënkupton çdo person të privuar nga liria personale si rezultat i dënimit për një shkelje;

d) “Ndalim” nënkupton gjendjen e pesonave të ndaluar siç u përshkrua më lart;

e) “Burgim” nënkupton gjendjen e personave të burgosur siç u përcaktua më lart;

f) Fjalët “një autoritet gjyqësor ose tjetër” nënkuptojnë autoritet gjyqësor ose tjetër sipas ligjit, statusi dhe mandati i të cilëve duhet të sigurojë garancitë më të mëdha të mundëshme të kompetencës, asnjësisë dhe pavarësisë.

#### *Parimi 1*

Të gjithë personat nën çdo formë ndalimi ose burgimi trajtohen në mënyrë njerëzore dhe me respekt për dinjitetin e qenësishëm të qenies njerëzore.

#### *Parimi 2*

Arrestimi, ndalimi ose burgimi bëhen vetëm në përputhje të rreptë me dispozitat e ligjit dhe nga nëpunës ose persona kompetentë të autorizuar për këtë qëllim.

#### *Parimi 3*

Nuk ka asnjë kufizim ose shmangie nga asnjëra prej të drejtave të njeriut të personave nën çdo formë ndalimi ose burgimi, të njohura ose egzistuese në një Shtet, në zbatim të ligjit,

konventave, rregulloreve ose zakoneve, me preteksin se kjo Paketë e Parimeve nuk i njeh këto të drejta ose se ajo i njeh ato në një masë më të vogël.

#### *Parimi 4*

Çdo formë ndalimi ose burgimi dhe të gjitha masat që prekin të drejtat e njeriut të personave nën çdo formë ndalimi ose burgimi urdhërohet nga ose nënshtrohet kontrollit të efektshëm të një autoriteti gjyqësor ose tjetër.

#### *Parimi 5*

1 Këto parime zbatohen për të gjithë personat brenda territorit të çdo Shteti të dhënë, pa asnjë dallim të çfarëdo lloji, si rraca, ngjyra, seksi, gjuha, feja ose besimi fetar, bindjet politike ose të tjera, origjina etnike ose sociale, prona, statusi i lindjes ose tjetër.

2 Masat e zbatuara sipas ligjit e të destinuara vetëm për mbrojtjen e të drejtave dhe statusit të veçantë të grave dhe nënave me fëmijë në gji, fëmijëve dhe adoleshentëve, të moshuarve, të sëmurëve ose handikapatëve nuk konsiderohen diskriminuese. Nevoja dhe zbatimi i masave të tilla i nënshtrohet gjithmonë shqyrtimit nga autoriteti gjyqësor ose tjetër.

*Parimi 6*

Asnjë person nën çdo formë ndalimi ose burgimi nuk i nënshtrohet torturës ose trajtimit apo ndëshkimit të egër, çnjerëzor ose degradues. Asnjë rrethanë ciladoqoftë nuk mund të përdoret si justifikim për torturë ose trajtim apo ndëshkim tjetër të egër, çnjerëzor ose degradues.

*Parimi 7*

1 Shtetet duhet të ndalojnë me ligj çdo veprim në kundërshtim me të drejtat dhe detyrat që përfshihen në këto parime, dhe t'ua nënshtrojnë këto veprime ndëshkimeve përkatëse e të kryejnë hetime asnjane për ankesat.

2 Nëpunësit që kanë arësye të besojnë se ka ndodhur ose mund të ndodhë një shkelje e kësaj Pakete Parimesh, e raportojnë çështjen tek autoritetet e tyre eprore dhe, kur është e nevojshme, tek autoritetet ose organet përkatëse që kanë fuqi shqyrtuese ose zgjidhëse.

3 Çdo person tjetër që ka arësye të besojë se ka ndodhur ose mund të ndodhë një shkelje e kësaj Pakete Parimesh ka të drejtën ta raportojë këtë çështje tek eprorët ose nëpunësit e përfshirë si edhe tek autoritetet ose organet përkatëse që kanë fuqi shqyrtuese ose zgjidhëse.

*Parimi 8*

Personat nën ndalim i nënshtrohen trajtimit të përshtatshëm me statusin e tyre prej të padënuari. Sipas tij ata mbahen, kur është e mundshme, të veçuar nga personat e burgosur.

*Parimi 9*

Autoritetet që arrestojnë një person, mbajnë atë nën ndalim ose hetojnë çështjen, ushtrojnë vetëm fuqitë e dhëna sipas ligjit dhe ushtrimi i këtyre fuqive i nënshtrohet adresimit të një autoriteti gjyqësor ose tjetër.

*Parimi 10*

Cilido që arrestohet, informohet në momentin e arrestimit për arësyen e arrestimit të tij dhe informohet menjëherë për çdo akuzë kundër tij.

*Parimi 11*

1 Asnjë person nuk mbahet nën ndalim pa iu dhënë mundësia të dëgjohet menjëherë nga një autoritet gjyqësor ose tjetër. Një person i ndaluar ka të drejtë të vetëmbrohet ose të ndihmohet nga një avokat siç e parashikon ligji.

2 Një person i ndaluar dhe avokati i tij, nëse ka, merr komunikim të plotë e të menjëhershëm për çdo urdhër për ndalim, sëbashku me arësytet për këtë.

3 Një autoritet gjyqësor ose tjetër ka autoritetin për të shqyrtuar siç është e përshtatshme, vazhdimin e ndalimit.

*Parimi 12*

1 Duhet të dokumentohen me saktësi:

- a) Arësytet e arrestimit;
- b) Koha e arrestimit dhe sjellja e personit të arrestuar në vendin e ruajtjes si edhe koha e paraqitjes së tij të parë para një autoriteti gjyqësor ose tjetër;
- c) Identiteti i nëpunësve ligjzbatues të përfshirë;
- d) Informacioni i saktë lidhur me vendin e ruajtjes.

2 Ky dokumentacion i komunikohet të ndaluarit ose avokatit të tij, nëse ka, në atë formë që parashikon ligji.

*Parimi 13*

Çdo personi, në momentin e arrestimit dhe në fillim të ndalimit ose burgimit, ose menjëherë paskëtaç, i vihet në dispozicion nga autoriteti përgjegjës përkatësisht për arrestimin, ndalimin ose burgimin e tij, informacion dhe shpjegim për të drejtat e tij dhe mënyra si ai mund t'i përdorë ato.

*Parimi 14*

Një person që nuk kupton ose flet mjaftueshëm gjuhën e përdorur nga autoritetet përgjegjës për arrestimin, ndalimin ose burgimin e tij, ka të drejtë të marrë në një gjuhë të cilën ai e kupton, informacionin e përmendur në parimin 10, parimin 11, paragrafi 2, paramin 12, paragrafi 1, dhe parimin 13, dhe të ketë asistencën falas të një përkthyesi, nëse është e nevojshme, në lidhje me procedimet ligjore që pasojnë arrestimin e tij.

*Parimi 15*

Pavarësisht nga përjashtimet e përfshira në parimin 16, paragrafi 4, dhe parimin 18, paragrafi 3, komunikimi i personit të ndaluar ose të burgosur me botën e jashtme, dhe veçanërisht me familjen ose avokatin

e tij, nuk mohohet për më shumë se disa ditë.

#### *Parimi 16*

1 Menjëherë pas arrestimit dhe pas çdo transferimi nga një vend ndalimi në një tjetër, një person i ndaluar ose i burgosur ka të drejtën të njoftojë pjesëtarët e familjes ose persona të tjerë përkatës, për arrestimin, ndalimin apo burgimin e tij ose për transferimin dhe vendin ku ai mbahet nën mbikqyrje.

2 Nëse personi i ndaluar ose i burgosur është i huaj, ai gjithashtu informohet menjëherë për të drejtën e tij për të komunikuar me mjetet e përshtatshme me një zyrë konsullore ose mision diplomatik në Shtetin, shtetas i të cilit ai është, ose përndryshe që ka të drejtën të marrë një komunikim të tillë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare ose me përfaqësuesin e organizatës ndërkombëtare kompetente, nëse ai është refugjat, ose përndryshe është nën mbrojtjen e një organizate ndërqeveritare.

3 Nëse personi i ndaluar ose i burgosur është adoleshent ose është i paaftë të kuptojë të drejtat e tij, autoriteti kompetent, me iniciativën e vet, ndërmerret komunikimin e përmendur në këtë parim. Vëmendje e veçantë i kushtohet njoftimit të prindërve ose kujdestarëve.

4 Çdo njoftim i përmendur në këtë parim bëhet ose lejohet pa vonesë.

Autoriteti kompetent, sidoqoftë, mund të vonojë njoftimin për një periudhë të arësyeshme kur një gjë e tillë kërkohet nga nevojat e veçanta të hetimit.

#### *Parimi 17*

1. Një person i ndaluar ka të drejtë të ketë asistencën e një avokati. Ai informohet për të drejtën e tij nga autoriteti kompetent menjëherë pas arrestimit dhe atij i sigurohen lehtësira të arësyeshme për ta ushtruar atë.

2. Nëse një person nuk ka një avokat të zgjedhur nga ai vetë, ai ka të drejtë të ketë një avokat që caktohet nga një autoritet gjyqësor ose tjetër në të gjitha rastet kur kur kjo kërkohet nga drejtësia dhe, pa pagesë, nëse ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar.

#### *Parimi 18*

1. Një person i ndaluar ose i burgosur ka të drejtë të komunikojë dhe të konsultohet me avokatin e vet.

2. Një personi të ndaluar ose të burgosur i lejohet koha dhe lehtësitë e nevojshme për konsultim me avokatin e vet.

3. E drejta e një personi të ndaluar ose të burgosur për t'u vizituar dhe konsultuar e komunikuar, pa vonesë ose çensurë dhe në konfidencialitet të plotë me avokatin e vet nuk mund të pezullohet ose kufizohet përveçse në rrethana të veçanta, që përcaktohen me ligj ose rregullore të ligjshme, kur kjo konsiderohet e domosdoshme nga një autoritet gjyqësor ose tjetër me qëllim që të ruhet siguria dhe rregulli.

4. Intervistat ndërmjet një personi të ndaluar ose të burgosur dhe avokatit të tij duhet të bëhen brenda fushëpamjes, por jo brenda hapësirës së dëgjimit të autoritetit ligjzbatues.

5. Komunikimi ndërmjet një personi të ndaluar ose të burgosur dhe avokatit të tij, i përmendur në parimin në fjalë, nuk pranohet si provë kundër personit të ndaluar ose të burgosur, përveçse kur ata lidhen me një krim të vazhdueshëm ose të paramenduar.

*Parimi 19*

Një person i ndaluar ose i burgosur ka të drejtë të vizitohet dhe të ketë korrespondencë, në mënyrë të veçantë me pjesëtarët e familjes së tij, dhe atij i krijohen mundësitë e duhura për të komunikuar me botën e jashtme, duke iu nënshtruar kushteve e kufizimeve të arësyeshme siç përcaktohen nga ligji ose rregulloret e ligjshme.

*Parimi 20*

Kur kërkohet nga një person i ndaluar ose i burgosur, ai mbahet, nëse është e mundur, në një vend ndalimi ose burgimi që është, në masë të arësyeshme, pranë vendbanimit të tij.

*Parimi 21*

1. Është e palejueshme të përfitohet nga gjendja e personit të ndaluar ose të burgosur me qëllim që ai të detyrohet të rrëfejë, të inkriminojë veten, ose përndryshe të dëshmojë kundër çdo personii tjetër.

2. Gjatë hetimit asnjë person i ndaluar ose i burgosur nuk i nënshtrohet dhunës, kërcënimeve ose metodave hetimore që pengojnë aftësinë e tij për të vendosur ose gjykuar.

*Parimi 22*

Asnjë person i ndaluar ose i burgosur nuk i nënshtrohet, madje as me pëlqimin e tij, asnjë eksperimentimi mjekësor ose shkencor i cili mund të jetë i dëmshëm për shëndetin e tij.

*Parimi 23*

1. Kohëzgjatja e çdo hetimi të një personi të ndaluar ose të burgosur dhe e intervaleve ndërmjet seancave hetimore si edhe identiteti i

nëpunësve që kryejnë hetimin i personave të tjerë të pranishëm dokumentohet dhe vërtetohet në ato forma që përcaktohen me ligj.

2. Një person i ndaluar apo i burgosur ose avokati i tij, kur e mundëson ligji, kanë akses në informacionin e përshkruar në paragrafin 1 të këtij neni.

*Parimi 24*

Një personi të ndaluar ose të burgosur i ofrohet kontrolli i duhur mjekësor sa më shpejt që të jetë mundur pas pranimit të tij në vendin e ndalimit ose burgimit, dhe paskëtaj kujdesi dhe trajtimi mjekësor jepen sa herë që është e nevojshme. Ky kujdes e trajtim jepen falas.

*Parimi 25*

Një person i ndaluar ose i burgosur dhe avokati i tij, duke iu nënshtruar vetëm kushteve të arësyeshme për garantimin e sigurisë e rregullit në vendin e ndalimit ose burgimit, kanë të drejtë kërkojnë ose të bëjnë peticion tek një autoritet gjyqësor ose tjetër për një kontroll ose opinion të dytë mjekësor.

*Parimi 26*

Fakti që një person i ndaluar ose i burgosur i është nënshtruar një kontrolli mjekësor, emri i mjekut dhe rezultatet e këtij kontrolli, dokumnetohen si duhet. Aksesin në këtë dokumentacion bëhet në përputhje me rregullat përkatëse të së drejtës së brendshme.

*Parimi 27*

Mosrespektimi i këtyre parimeve gjatë marrjes së provave merret në konsideratë në përcaktimin e pranueshmërisë së këtyre provave kundër një personi të ndaluar ose të burgosur.

*Parimi 28*

Një person i ndaluar ose i burgosur ka të drejtë të marrë, brenda kufinjve të burimeve të disponueshëm, nëse janë nga burimet publike, sasi të arësyeshme matarialesh arsimore, kulturore dhe informative, duke iu nënshtruar kushteve të arësyeshme për garantimin e sigurisë dhe rregullit në vendin e burgimit ose ndalimit.

*Parimi 29*

1. Me qëllim që të mbikqyret zbatimi i rreptë i ligjeve dhe rregulloreve përkatëse, vendet e ndalimit vizitohen rregullisht nga persona të kualifikuar e me përvojë, që emërohen dhe japin llogari para një autoriteti të ndryshëm nga autoriteti i drejtpërdrejtë përgjegjës për administrimin e vendit të ndalimit ose burgimit.



2. Një person i ndaluar ose i burgosur ka të drejtë të komunikojë lirshëm dhe në konfidencialitet të plotë me personat që vizitojnë vendet e ndalimit ose burgimit në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, duke iu nënshtruar kushteve të arësyeshme për garantimin e sigurisë e rregullit në këto vende.

*Parimi 30*

1. Llojet e sjelljes së një personi të ndaluar ose të burgosur, që përbëjnë shkelje disiplinore gjatë ndalimit ose burgimit, përshkrimi dhe kohëzgjatja e ndëshkimit disiplinor që mund të jepet, dhe autoritetet kompetente që japin këtë ndëshkim, përcaktohen me ligj dhe rregullore të ligjëshme e të publikuara si duhet.

2. Një person i ndaluar ose i burgosur ka të drejtë të dëgjohet para zbatimit të një veprimi disiplinor. Ai ka të drejtë ta dërgojë këtë veprim për shqyrtim nga autoritete më të larta.

*Parimi 31*

Autoritetet përkatëse përpiqen të sigurojnë asistencë, sipas të drejtës së brendshme, kur kjo është e nevojshme, për personat në varësi ose të miturit e personave të ndaluar ose të burgosur, dhe i kushtojnë vëmendje të veçantë kujdesit të nevojshëm për fëmijët e lënë pa mbikqyrje.

*Parimi 32*

1. Një person i ndaluar ose avokati i tij kanë të drejtë të nisin, në çdo kohë, sipas të drejtës së brendshme, procedime para një autoriteti gjyqësor ose tjetër për të sfiduar ligjshmërinë e paraburgimit të tij me qëllim që të sigurojë lirinë e tij pa vonesë, nëse ai është i paligjshëm.

2. Procedimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij parimi janë të thjeshtë dhe të shpejtë dhe pa asnjë kosto për personin e ndaluar që nuk ka mjetet e nevojshme për të paguar. Autoriteti ndalues e dërgon personin e burgosur pa vonesë të arësyeshme, para autoritetit shqyrtues.

*Parimi 33*

1. Një person i ndaluar apo i burgosur ose avokati i tij kanë të drejtë të bëjnë një kërkesë ose ankesë për këtë trajtim, sidomos në rastet e torturës ose trajtimeve të tjerë të egër, çnjerëzorë ose degradues, pranë autoriteteve përgjegjëse për administrimin e vendit të ndalimit e autoriteteve më të lartë dhe, kur është e nevojshme, pranë autoriteteve përkatëse që kanë fuqi shqyrtuese dhe zgjidhëse.

2. Në ato raste kur, as personi i ndaluar ose i burgosur, as avokati i tij nuk kanë mundësi të ushtrojnë të drejtën e vet sipas paragrafit 1 të këtij parimi, këto të drejta mund t'i ushtrojnë një pjesëtar i familjes së

personit të ndaluar ose të burgosur, ose çdo person tjetër që ka dijeni për çështjen.

3. Konfidencialiteti lidhur me kërkesën ose ankesën ruhet nëse kjo gjë kërkohet nga ankuesi.

4. Çdo kërkesë ose ankesë trajtohet menjëherë dhe merr përgjigje pa vonesë të paarësyeshme. Nëse kërkesa ose ankesa refuzohet ose, në rast vonese të tepruar, ankuesi ka të drejtën ta dërgojë atë para një autoriteti gjyqësor ose tjetër. As personi i ndaluar ose i burgosur, as çdo ankues tjetër sipas paragrafit 1 të këtij parimi nuk paragjykohet për shkak se ka bërë një kërkesë ose ankesë.

#### *Parimi 34*

Kur gjatë burgimit ose ndalimit ndodh vdekja ose zhdukja e personit të ndaluar ose të burgosur, një autoritet gjyqësor ose tjetër ndërmerret, me iniciativën e vet ose me kërkesë të një pjesëtari të familjes së këtij personi ose të çdo personi tjetër që ka dijeni për çështjen, një hetim për shkaqet e vdekjes ose zhdukjes. Kur e kërkojnë rrethanat, ky hetim ndërmerret mbi të njejtën bazë proçduriale sa herë që vdekja ose zhdukja ndodh menjëherë pas përfundimit të ndalimit ose burgimit. Rezultatet e këtij hetimi ose një raport rreth tij vihen në dispozicion me kërkesë, përveçse kur kjo mund të rrezikojë ndjekjen e mëtejshme penale.

#### *Parimi 35*

1. Dëmi i pësuar për shkak të veprimeve ose mosveprimeve nga një nëpunës publik në kundërshtim me të drejtat e përfshira në këto parime kompensohet sipas rregullave ose detyrimeve në fuqi që parashikon e drejta e brendshme.

2. Informacioni që kërkohet të dokumentohet sipas këtyre parimeve vihet në dispozicion në përputhje me proçedurat e parashikuara nga e drejta e brendshme që përdoren kur pretendohet një kompensim sipas këtij parimi.

#### *Parimi 36*

1. Një person i burgosur që dyshohet ose akuzohet për një shkelje penale konsiderohet i pafajshëm dhe

trajtohet si i tillë deri sa të provohet fajtor sipas ligjit në një gjyq publik në të cilin ai ka pasur të gjitha garancitë e nevojshme për mbrojtjen e tij.

2. Arrestimi ose ndalimi i këtij personi në pritje të hetimit dhe gjykimit bëhet vetëm për qëllimet e dhënies së drejtësisë mbi bazën,

kushtet dhe procedurat e përcaktuara me ligj. Ndalohet vendosja e kufizimeve mbi këtë person kur ato nuk janë rreptësisht të nevojshme për ndalimin ose kur parandalojnë pengimin e procesit të hetimit ose dhënies së drejtësisë, ose për ruajtjen e sigurisë dhe rregullit në vendin e ndalimit.

*Parimi 37*

Një person i ndaluar për një akuzë penale dërgohet para një autoriteti gjyqësor ose tjetër të parashikuar me ligj menjëherë pas arrestimit. Ky autoritet vendos pa vonesë për ligjshmërinë dhe nevojën e ndalimit. Asnjë person nuk mund të mbahet nën ndalim në pritje të hetimit ose gjykimit, përveçse me një urdhër me shkrim nga ky autoritet. Një person i ndaluar ka të drejtë, kur dërgohet para një autoriteti të tillë, të bëjë një deklaram mbi trajtimin që i është bërë atij gjatë kohës së qëndrimit nën mbikqyrje.

*Parimi 38*

Një person i ndaluar për një akuzë penale ka të drejtën të gjykohet brenda një kohe të arësyeshme ose të lirohet në pritje të gjykimit.

*Parimi 39*

Përveç rasteve të veçanta të parashikuara me ligj, një person i ndaluar për një akuzë penale ka të drejtë, përveçse kur një autoritet gjyqësor ose tjetër vendos ndryshe në interes të dhënies së drejtësisë, të lirohet në pritje të gjykimit duke iu nënshtruar kushteve që mund t'i vihen në përputhje me ligjin. Ky autoritet mban nën shqyrtim nevojën për ndalim.

*Nen i përgjithshëm*

Asgjë në këtë Paketë Parimesh nuk interpretohet si kufizim ose shmangie nga asnjë e drejtë e përcaktuar në Konventën Ndërkombëtare për Të Drejtat Civile dhe Politike.

### **Parimet Bazë për Trajtimin e Të Burgosurve**

Miraturar dhe shpallur me rezolutën 45/ 111 të Asamblesë së Përgjithshme më 14 Dhjetor 1990

1. Të gjithë të burgosurit trajtohen me respektin e duhur për dinjitetin e tyre të qenësishëm dhe vlerën e qenieve njerëzore.

2. Nuk ka asnjë diskriminim mbi bazën e racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, bindjeve politike ose të tjera, originës kombëtare ose sociale, pronës, statusit të lindjes ose tjetër.

3. Megjithatë, është e dëshirueshme të respektohen besimet fetare dhe normat kulturore të grupit të cilit i përkasin të burgosurit, sa herë që kjo kërkohet nga kushtet lokale.

4. Përgjegjësia e burgjeve për ruajtjen e të burgosurve dhe për mbrojtjen e shoqërisë nga krimi ushtrohet duke iu përmbajtur objektivave të tjerë socialë të një Shteti dhepërgjegjësive të tij themelore për nxitjen e mirëqenies dhe zhvillimit të të gjithë anëtarëve të shoqërisë. Me përjashtim të kufizimeve që provohet se bëhen të nevojshëm nga fakti i burgimit, të gjithë të burgosurit i ruajnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të përcaktuara në Deklaratën Universale të Të Drejtave të Njeriut, dhe kur Shteti në fjalë është pale në Konventën Ndërkombëtare për Të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollin Opsional të saj, si edhe të drejta të tjera që përcaktohen në konventat e Kombeve të Bashkuara.

5. Të gjithë të burgosurit kanë të drejtë të marrin pjesë në veprimtari kulturore dhe në edukimin që synon zhvillimin e plotë të personalitetit të njeriut.

6. Duhet të bëhen përpjekje dhe të inkurajohet ndalimi i izolimit të vetmuar si një formë ndëshkimi, ose kufizimi i përdorimit të tij.

7. Të krijohen të gjitha kushtet që t'u mundësojnë të burgosurve angazhimin në punë të shpërblyeshme e cila lehtëson ri-integrimin e tyre në tregun e punës së atij vendi dhe i lejon ato të kontribuojnë për mbështetje financiare për vete dhe për familjete tyre.

8. Të burgosurit kanë akses në shërbimet shëndetësore të disponueshme në vend, pa diskrimin për shkak të gjendjes së tyre ligjore.

9. Me pjesëmarrjen dhe ndihmën e komunitetit dhe institucioneve sociale, dhe me konsideratën e duhur për interesin e viktimave, krijohen kushte të favorshme për ri-integrimin e ish të burgosurve në shoqëri në kushtet më të mira të mundshme.

10. Parimet e sipërpërmendura zbatohen në mënyrë asnjëse.

### **Rregullat Standarde Minimale për Trajtimin e Të Burgosurve**

Miraturar nga Kongresi i Parë i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Shkelësve, mbajtur në Gjenevë në 1955, dhe aprovuar nga Këshilli Ekonomik e Shoqëror me rezolutën e tij 603C (XXIV) më 31 Korrik 1957 dhe 2076 (LXII) më 13 Maj 1977

#### *Vërejtje Paraprake*

1. Rregullat e mëposhtëme nuk synojnë të përshkruajnë me

hollësi një sistem model të institucioneve penale. Ato synojnë vetëm të përcaktojnë, mbi bazën e konsensusit të përgjithshëm të mendimit bashkëkohor dhe elementëve kryesorë të sistemeve më të përshtatshme bashkëkohorë, atë që përgjithësisht pranohet si parim dhe praktikë e mirë për trajtimin e të burgosurve dhe menaxhimin e institucioneve.

2. Duke pasur parasysh larminë e madhe të kushteve ligjore, sociale, ekonomike dhe gjeografike

botërore, është e qartë se jo të gjithë rregullat janë të mundshme për t'u zbatuar në të gjithë vendet dhe të gjitha kohët. Sidoqoftë, ato duhet të shërbejnë për të nxitur një përpjekje të vazhdueshme për kapërcimin e vështirësive praktike në zbatimin e tyre, në njohuritë që ato përfaqësojnë, në tërësi, në kushtet minimale që pranohen si të përshtatshme nga Kombet e Bashkuara.

[...]

31. Ndëshkimi trupor, ndëshkimi përmes vendosjes në një qeli të errët, dhe të gjitha ndëshkimet e egra, çnjerëzore ose degraduese ndalohen tërësisht si ndëshkime për shkelje disiplinore.

32. (1) Ndëshkimi përmes izolimit të mbyllur ose pakësimi i dietës nuk zbatohet asnjëherë, përveçse kur i burgosuri kontrollohet nga nëpunësi mjekësor i cili vërteton me shkrim se ai është në gjendje ta përballojë atë.

(2) E njëjta gjë zbatohet edhe për çdo ndëshkim tjetër i cili paragjykon shëndetin fizik ose mendor të të burgosurit. Në asnjë rast një ndëshkim i tillë nuk mund të jetë nëkundërshtim ose të shmangëparimin e parashtruar në rregullin 31.

(3) Nëpunësi mjekësor viziton çdo ditë të burgosurit që i nënshtrohen ndëshkimeve të tilla dhe këshillon drejtorin nëse ai e konsideron të nevojshëm përfundimin ose ndryshimin e ndëshkimit për shkak të shëndetit fizik ose mendor.

#### *Instrumentet e detyrimit*

33. Instrumentet e detyrimit, si prangat, zinxhirët, hekurat dhe xhaketat shtërnguese, nuk përdoren kurrë si ndëshkim. Për më tepër, zinxhirët ose hekurat nuk përdoren si detyrues. Mund të përdoren instrumente të tjerë detyrimi vetëm në rrethanat e mëposhtme:

a) Si masë parandaluese e arratisjes gjatë shpërnguljes, me kusht që ato të hiqen kur i burgosuri paraqitet para një autoriteti gjyqësor ose administrativ;

b) Për arsye mjekësore me udhëzim të nëpunësit mjekësor;

c) Me urdhër të drejtorit, nëse dështojnë metodat e tjera të kontrollit, me qëllim që të parandalohet mundësia që një i burgosur të dëmtojë veten, të tjerët ose pronën; në këto raste drejtori këshillohet menjëherë me nëpunësin mjekësor dhe raporton tek autoriteti më i lartë administrativ.

34. Mënyrat e përdorimit të instrumenteve të detyrimit përcaktohen nga administrata qendrore e burgjeve. Këto instrumente nuk duhet të zbatohen për kohë më të gjatë nga sa është rrëptësisht e nevojshme.

Informacioni për të burgosurit dhe ankesat prej tyre

35. (1) Në momentin e pranimit çdo i burgosur pajiset me informacion me shkrim mbi rregulloret që drejtojnë trajtimin e të burgosurve të kategorisë së tij, kërkesat disiplinore të institucionit, metodat e autorizuara për të kërkuar informacion dhe për të bërë ankesa, dhe çështje të tjera të nevojshme për të bërë të mundur që ai të kuptojë të drejtat dhe detyrimet e tij dhe të përshtatet me jetën në institucion.

(2) Nëse një i burgosur është analfabet, informacioni i sipërpërmendur i transmetohet atij me gojë.

36. (1) Çdo ditë jave (jo në fundjavë) çdo i burgosur ka mundësi të bëjë kërkesa ose ankesa tek drejtori i institucionit ose nëpunësi i autorizuar që e përfaqëson atë.

(2) Është e mundur që kërkesat ose ankesat t'i bëhen inspektorit të burgjeve gjatë inspektimit të tij. I burgosuri ka mundësi të flasë me inspektorin ose çdo nëpunës tjetër inspektimi pa praninë e drejtorit ose pjesëtarëve të tjerë të stafit.

(3) Çdo i burgosur lejohet të bëjë një kërkesë ose ankesë, pa u censuruar për përmbajtjen por në formën e duhur, pranë administratës qendrore të burgjeve, autoritetit gjyqësor ose autoriteteve të tjerë përkatës, përmes kanaleve të miratuara.

(4) Përveçse kur është e paargumentuar ose pa vlerë, çdo kërkesë ose ankesë trajtohet menjëherë dhe merr përgjigje pa asnjë vonesë të arësyeshme.

Kontakti me botën e jashtme

37. Të burgosurit lejohen, nën mbikqyrjen e nevojshme, të komunikojnë në intervale të rregullta kohe me familjen e tyre dhe shokët e respektuar, si përmes korrespondencës ashtu edhe përmes pritjes së vizitave.

38. (1) Të burgosurve që janë shtetas të huaj u lejohen lehtësira të arësyeshme për të komunikuar me përfaqësuesit diplomatikë dhe konsullorë të Shtetit të cilit ata i përkasin.

(2) Të burgosurve që janë shtetastë Shtetve pa përfaqësim diplomatik ose konsullor në atëvend dhe refugjatëve ose

personave pa shtetësi u lejohen lehtësira të ngjashme për të komunikuar me përfaqësuesit diplomatikë të Shtetit që mer përsipër interesat e tyre ose me çdo autoritet kombëtar ose ndërkombëtar detyra e të cilit është të mbrojë këta persona.

[...]

54. (1) Në marrëdhëniet e tyre me të burgosurit, nëpunësit e institucionit nuk përdorin forcën, përveçse për vetëmbrojtje ose në rastet e tentativave për arratisje, ose të rezistencës aktive ose pasive ndaj një urdhëri të bazuar në ligj oserregullore. Nëpunësit që përdorin forcën nuk duhet të përdorin më shumë forcë nga sa është rreptësisht enevojshme dhe duhet të raportojnë menjëherë për incidentin tek drejtori i institucionit.

(2) Nëpunësit e burgjeve duhet të marrin trainim të veçantë fizik për t'u bërë të aftë të vënë nën kontroll të burgosurit agresivë.

(3) Përveçse në rrethana të veçanta, stafi që kryen detyra të cilat e vënë atë në kontakt të drejtpërdrejtë me të burgosurit nuk duhet të jëtë i armatosur. Për më tepër, në asnjë rrethanë stafit nuk duhet t'i jepen armë, pa u trainuar për përdorimin e tyre.

[...]

**Parimet e Etikës Mjekësore të vlefshëm për Rolin e Personelit Shëndetësor, veçanërisht të Mjekëve, në Mbrojtjen e Të Burgosurve dhe Të Ndaluarve nga Tortura dhe Trajtime të Tjerë të Egër, Çnjerëzorë ose Degradues**

Miraturar me rezolutën 37/194 të Asamblesë së Përgjithshme më 18 Dhjetor 1982

*Parimi 1*

Personeli shëndetësor, veçanërisht mjekët, të ngarkuar me kujdesin mjekësor të të burgosurve ose të ndaluarve, kanë për detyrë t'u sigurojnë atyre mbrojtjen e shëndetit të tyre fizik e mendor dhe trajtimin e sëmundjeve me të njëjtën cilësi dhe standard që u sigurohet atyre që nuk janë të burgosur ose të ndaluar.

*Parimi 2*

Është shkelje e rëndë e etikës mjekësore, si edhe shkelje sipas instrumenteve ndërkombëtarë përkatës, për personelin shëndetësor, sidomos mjekët, përfshirja aktive ose pasive në veprime të cilat përbëjnë pjesëmarrje, bashkëpunim, nxitje ose përpjekje për të kryer torturë ose trajtime apo ndëshkime të tjerë të egër, çnjerëzorë ose degradues.<sup>6</sup>

*Parimi 3*

Është shkelje e etikës mjekësore për personelin shëndetësor, sidomos mjekët, të përfshihen në çfarëdo marrëdhënie profesionale me të burgosurit ose të ndaluarit, qëllimi i të cilës nuk është vetëm vlerësimi, mbrojtja ose përmirësimi i shëndetit të tyre fizik e mendor.

*Parimi 4*

Është shkelje e etikës mjekësore për personelin shëndetësor, sidomos mjekët:

a) Të përdorin njohuritë dhe aftësitë e tyre për të ndihmuar në hetimin e të burgosurve ose të ndaluarve në një mënyrë që mund të dëmtojë shëndetin ose gjendjen fizike apo mendore të këtyre të burgosurve ose të ndaluarve dhe që nuk është në përputhje me instrumentet përkatës ndërkombëtarë <sup>7</sup>

b) Të vërtetojnë ose marrin pjesë në vërtetimin e përshtatshmërisë së të burgosurve ose të ndaluarve për çdo formë trajtimi ose ndëshkimi që mund të dëmtojë shëndetin e tyre fizik ose mendor dhe që nuk është në përputhje me instrumentet ndërkombëtarë përkatës, ose të marrin pjesë në çfarëdo mënyrë në çfarëdo trajtimi ose ndëshkimi të tillë i cili nuk është në përputhje me instrumentet ndërkombëtarë përkatës.

*Parimi 5*

Është shkelje e etikës mjekësore për personelin shëndetësor, sidomos mjekët, të marrin pjesë në çfarëdo procedurë për të detyruar një të burgosur ose të ndaluar, nëse kjo procedurë nuk përcaktohet në përputhje vetëm me kritere të pastra mjekësore që janë të nevojshme për mbrojtjen e shëndetit fizik e mendor të vetë të burgosurit ose të ndaluarit, të të burgosurve ose të ndaluarve të tjerë, ose të mbikqyrësve të tij, dhe që nuk paraqet asnjë rrezik për shëndetin e tij fizik e mendor.

*Parimi 6*

Nuk mund të ketë asnjë shmangie nga parimet e sipërpërmendura për asnjë arsye cilado qoftë, duke përfshirë edhe emergjencat publike.



### **Kodi i Sjelljes për Nëpunësit Ligjzbatues**

Miratuar me rezolutën 34/169 të Asamblesë së Përgjithshme më 17 Dhjetor 1979

#### *Neni 1*

Nëpunësit ligjzbatues përmbushin në çdo kohë detyrën që u ngarkon ligji, duke i shërbyer komunitetit dhe duke mbrojtur të gjithë personat nga veprimet e paligjshme, me shkallën e lartë të përgjegjësisë që kërkon ky profesion.

#### *Koment*

a) Termi “nëpunës ligjzbatues”, përmbledh të gjithë nëpunësit e ligjit, të emëruar ose të zgjedhur, të cilët ushtrojnë pushtetet e policisë, sidomos pushtetin e arrestimit apo ndalimit.

b) Në ato vende ku pushtetet e policisë ushtrohen nga autoritete ushtarake, me uniformë ose jo, ose nga forcat e sigurimit të Shtetit, përkufizimi i nënpunësve ligjzbatues konsiderohet se përfshin edhe nëpunës të këtyre shërbimeve.

c) Shërbimi ndaj komunitetit synon të përfshijë veçanërisht interpretimin e shërbimeve të asistencës për ato anëtarë të komunitetit që për shkak të emergjencave personale, ekonomike, sociale e të tjera kanë nevojë për ndihmë të menjëhershme.

d) Kjo dispozitë synon të mbulojë jo vetëm gjithë veprimet e dhunshme, grabitqare dhe të dëmshme, por të shtrihet edhe mbi tërësinë e ndalimeve sipas statuteve penale. Ajo përmbledh deri edhe sjelljen e personave të paaftë për të marrë përgjegjësi penale.

#### *Neni 2*

Gjatë kryerjes së detyrës së tyre, nëpunësit ligjzbatues respektojnë dhe mbrojnë dinjitetin njerëzor dhe nxisin e mbështesin të drejtat e njeriut për të gjithë personat.

#### *Koment:*

a) Të drejtat e njeriut në fjalë përcaktohen dhe mbrohen nga e drejta e brendshme dhe ajo ndërkombëtare. Ndërinstrumentet e vlefshëm ndërkombëtarë janë Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile e Politike, Deklarata për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Nënshtrimi ndaj Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të Tjerë, të Egër, Çnjerëzorë ose Degradues, Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e Të

Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventa Ndërkombëtare për Zhdukjen dhe Ndëshkimin e Krimit të Aparteidit, Konventa për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Genocidit, Rregullat StandardeMinimale për Trajtimin e të Burgosurve dhe Konventa eVienës për Marrëdhëniet Konsullore.

b) Komentet kombëtare rreth kësaj dispozite duhet të tregojnë dispozitat rajonale e kombëtare për identifikimin dhe mbrojtjen e këtyre të drejtave.

*Neni 3*

Nëpunësit ligjzbatues mund të përdorin forcën vetëm kur është rreptësisht e nevojshme dhe në masën që kërkon kryerja e detyrës.

*Koment:*

a) Dispozita thekson se përdorimi i forcës nga nëpunësit ligjzbatues duhet të jetë një përjashtim; ndërkohë që ajo nënkupton se nëpunësit ligjzbatues mund të autorizohen të përdorin forcën siç është e arësyeshme dhe e nevojshme sipas rrethanave për parandalimin e krimit ose për zbatimin apo ndihmën për një arrestim të ligjshëm tëshkelësve ose të dyshuarve për shkelje, nuk mund të përdortet asnjë forcë që kalon këtë kufi.

b) E drejta e brendshme zakonisht e kufizon përdorimin e forcës nga nëpunësit ligjzbatues në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Duhet kuptuar se të tillë parime kombëtare të proporcionalitetit duhen respektuar në interpretim të kësaj dispozite. Në asnjë rast kjo dispozitë nuk duhet interpretuar për të autorizuar përdorimin e forcës që është në disproporcion me objektivin e ligjshëm që duhet arritur.

c) Përdorimi i armëve të zjarrit konsiderohet një masë ekstreme. Duhet bërë të gjitha përpjekjet për të shmangur përdorimin e armëve të zjarrit, sidomos kundër fëmijëve. Në përgjithësi, armët e zjarrit nuk duhet të përdoren, përveçse kurnjë shkelës i dyshuar bën rezistencë të armatosur ose përndryshe rrezikon jetët e të tjerëve dhe kur masat më pak ekstreme nuk janë të mjaftueshme për të bllokuar ose kapur shkelësin e dyshuar. Në çdo rast kur qëllohet me armë zjarri, duhet të bëhet një raport i menjëhershëm për autoritetet kompetente.

*[...] Neni 5*

Asnjë nëpunës ligjzbatues nuk mund të shkaktojë, nxisë ose tolerojë torturën ose trajtime apo ndëshkime të tjerë të egër, çnjerëzorë ose degradues, dhe as të përdorë urdhërat e eprorëve apo rrethanat e jashtëzakonshme si gjendja e luftës ose kërcënimi i sigurisë kombëtare,

mos-stabiliteti i brendshëm politik apo çdo emergjencë tjetër publike, si justifikim për torturë ose trajtime apo ndëshkime të tjerë të egër, çnjerëzorë ose degradues.

*Koment:*

a) Ky ndalim rrjedh nga Deklarat për Mbrojtjen e Të Gjithë Personave nga Nënshtrimi ndaj Torturës ose Trajtimeve apo Ndëshkimeve të Tjerë, të Egër, Çnjerëzorë ose Degradues, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, sipas të cilës: “[Një veprim i tillë është] një shkelje e dinjitetit njerëzor dhe dënohet si një mohim i qëllimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe si shkelje e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të shpallura në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut [dhe instrumenteve të tjerë ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut]”.

b) Deklarata e përcakton torturën si më poshtë:

“...Tortura nënkupton çdo veprim përmes të cilit me dashje i shkaktohet një personi dhimbje ose vuajtje e rëndë fizike ose mendore nga, ose me nxitjen e një nëpunësi publik për qëllime të tilla si marrja prej tij ose një personi të tretë e informacioneve ose rrëfimeve, ndëshkimi i tij për një veprim që ai ka kryer ose dyshohet ta ketë kryer, ose kërcënimi i tij apo personave të tjerë. Ajo nuk përfshin dhimbje ose vuajtje që shkaktohet vetëm, ose është e qenësishme apo rastësore, nga sanksionet e ligjshme në atë masë që lejohet nga Rregullat Standarde Minimale për Trajtimin e të Burgosurve.”

c) Termi “trajtim ose ndëshkim i egër, çnjerëzor ose degradues” nuk është përcaktuar nga Asambleja e Përgjithshme por ai duhet të interpretohet në mënyrë të tillë që të sigurojë mbrojtjen më të gjerë të mundëshme ndaj abuzimeve, fizike ose mendore.

[...] *Neni 8*

Nëpunësit ligzbatues respektojnë ligjin dhe këtë Kod. Gjithashtu, ata parandalojnë dhe i kundërvihen, me maksimumin e aftësive të veta, çdo shkeljeje të tyre. Nëpunësit ligzbatues që kanë arësye të besojnë se ka ndodhur ose mund të ndodhë dhunimi i këtij Kodi, e raportojnë çështjen tek autoritetet e tyre eprore dhe, kur është e nevojshme, tek autoritete ose organe të tjerë përkatës që kanë fuqi shqyrtuese ose zgjidhëse.

*Koment:*

a) Ky kod zbatohet sa herë që ai është bërë pjesë e legjislacionit ose praktikës kombëtare. Nëse legjislacioni ose praktika përmbanë dispozita më të rrepta se ato të këtij Kodi, do të zbatohen ato dispozita

që janë më të rrepta.

b) Ky nen synon të ruajë barazpeshën midis nevojës për disiplinë të brendshme të agjencisë nga e cila varet në masë të madhe siguria publike, nga njëra anë, dhe nevojës për të trajtuar shkeljen e të drejtave elementare të njeriut, nga ana tjetër. Nëpunësit ligjzbatues i raportojnë shkeljet brenda zinxhirit të komandës dhe ndër marrin veprime të tjerë të ligjshëm jashtë këtij zinxhiri të komandës vetëm kur nuk ka më zgjidhje të tjera të efektshme. Është e kuptueshme se nëpunësit ligjzbatues nuk pësojnë ndëshkime administrative ose të tjera për shkak se raportojnë që kandodhur ose mund të ndodhë një dhunim i këtij Kodi.

c) Termi “organet përkatëse që kanë fuqi shqyrtuese ose zgjidhëse” i referohet çdo autoriteti ose organi egzistues sipas të drejtës së brendshme, si brenda agjencisë ligjzbatuese ose i pavarur prej saj, me fuqi statutores, të zakonshme ose tjetër për të shqyruar ankesat ose shkeljet që rrjedhin nga dhunimet që përfshihen në hapësirën e këtij Kodi.

d) Në disa vende, mjetet e komunikimit masiv mund të konsiderohen se kryejnë funksione të shqyrtimit të ankesave të ngjashëm me ato që përshkruhen në nënparagrafin (c) më sipër. Prandaj, nëpunësit ligjzbatues mund të justifikohen nëse, si masë të fundit dhe në përputhje me zakonet e vendeve të tyre dhe me dispozitat e nenit 4 të këtij Kodi, ata i sjellin shkeljet në vëmendjen e opinionit publik përmes medias.

e) Nëpunësit ligjzbatues që zbatojnë dispozitat e këtij Kodi meritojnë respektin, mbështetjen e bashkëpunimin eplotë të komunitetit dhe të agjencisë ligjzbatuese në të cilën ata shërbejnë, si edhe të profesionit të ligjzbatuesve.

**Parimet Bazë për Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit nga Nëpunësit Ligjzbatues Miratuar nga Kongresi i Tetë i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Shkelësve. Havana, Kubë, 27 Gusht deri 7 Shtator 1990**

[...]

1 Qeveritë dhe agjencitë ligjzbatuese miratojnë dhe zbatojnë rregullat e rregulloret për përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit kundër personave nga nëpunësit ligjzbatues. Qeveritë dhe agjencitë ligjzbatuese mbajnë gjithmonë nën vëmendje çështjet etike që lidhen me përdorimin e forcës dhe armeve të zjarrit.

[...]

7 Qeveritë sigurojnë që përdurimi abuziv dhe arbitrar i forcës dhe armëve të zjarrit nga nëpunësit ligjzbatues të ndëshkohet si shkelje penale sipas ligjit të tyre.

8 Rrethana të veçanta si mos-stabiliteti i brendshëm politik ose çdo emergjencë tjetër publike nuk mund të përdoren si justifikim për asnjë shmangie nga këto parime bazë.

[...]

15 Nëpunësit ligjzbatues, në marrëdhëniet e tyre me personat nën mbikqyrje ose ndalim, nuk përdorin forcën, përveçse kur është rreptësisht e nevojshme për ruajtjen e sigurisë dhe rregullit brendainstitucionit, ose kur kërcënohet siguria personale.

[...]

18 Qeveritë dhe agjencitë ligjzbatuese sigurojnë që të gjithë nëpunësit ligjzbatues të përzgjidhen me procedura të rregullta egzaminimi, të kenë cilësitë e duhura morale, psikologjike e fizike për ushtrimin e efektshëm të funksioneve të tyre dhe të marrin training të vazhdueshëm e të plotë profesional. Përshtatshmëria e tyre e vazhdueshme për kryerjen e këtyre funksioneve duhet t'i nënshtrohet shqyrtimeve periodike.

19 Qeveritë dhe agjencitë ligjzbatuese sigurojnë që të gjithë nëpunësit ligjzbatues të marrin training dhe të testohen në përputhje me standardet e duhura profesionale për përdorimin e forcës. Ato nëpunës ligjzbatues të cilëve u kërkohet të mbajnë armë zjarri duhet të autorizohen për ta bërë këtë vetëm pas përfundimit të trainingut të veçantë për përdorimin e tyre.

20 Në trainingun e nëpunësve ligjzbatues, qeveritë dhe agjencitë ligjzbatuese u kushtojnë vëmendje të veçantë çështjeve të etikës policore dhe të drejtave të njeriut, sidomos në procesin e hetimit, të alternativave të tjera përveç përdorimit të forcës dhe armëve të zjarrit, duke përfshirë zgjidhjen paqësore të konflikteve, të kuptuarit e sjelljes së turmës, dhe metodat e bindjes, bisedimit dhendërmjetësimit, si edhe mjeteve teknike, me synimin për të kufizuar përdorimin e forcës e armëve të zjarrit. Agjencitë ligjzbatuese duhet t'i rishikojnë programet e tyre trainuese dhe procedurat e veprimit nën dritën e incidenteve të veçanta.

[...]

23 Personat e prekur nga përdorimi i forcës dhe armëve të zjarrit ose përfaqësuesit e tyre ligjorë kanë akses në një proces të pavarur, duke përfshirë një proces gjyqësor. Në rastin e vdekjes së këtyre personave, kjo dispozitë zbatohet njëjelloj për personat nën varësi të tyre.

24 Qeveritë dhe agjencitë ligjzbatuesesigurojnë që nëpunësit eprorë të jenë përgjegjës nëse kanë dijeni, ose duhet të kenë dijeni, se nëpunësit ligjzbatues nënkomandën e tyre përdorin, ose kanë përdorur, në mënyrë të paligjshme forcën dhe armët e zjarrit, dhe ata nuk kanë marrë ose nuk marrin të gjitha masat në kompetencën e tyre për të parandaluar, shtypur ose raportuar këtë përdorim.

25 Qeveritë dhe agjencitë ligjzbatuese sigurojnë që të mos zbatohet asnjë ndëshkim penal ose disiplinor mbi nëpunësit ligjzbatues që, në pajtim me Kodin e Sjelljes për Nëpunësit Ligjzbatues dhe me këto parime bazë, refuzojnë të zbatojnë një urdhër për përdorimin e forcës dhe armeve të zjarrit, ose që eraportojnë këtë përdorim nga eprorët e tyre.

26 Bindja ndaj urdhërave të eprorëve nuk shërben si mbrojtje nëse nëpunësit ligjzbatues kanë pasur dijeni se një urdhër për përdorimin e forcës dhe armeve të zjarrit, që shkakton vdekjen ose dëmtimin e rëndë të një personi, ishte dukshëm paligjshëm dhe kishte mundësi të arësyeshme për të refuzuarzbatimin e tij. Në çdo rast, përgjegjësi kanë gjithashtu edhe eprorët që japin urdhëra të paligjshëm.

### **Udhëzime për Rolin e Prokurorëve**

Miraturar nga Kongresi i Tetë i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Shkelësve. Havana, Kubë, 27 Gusht deri 7 Shtator 1990

[...]

15 Prokurorët i kushtojnë vëmendjen e duhur ndjekjes penale të krimeve të kryera nga nëpunësit publikë, sidomos korrupsionit, abuzimit me pushtetin, shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe krimeve të tjerë të njohur nga e drejta ndërkombëtare dhe, kur autorizohet nga ligji ose është në përputhje me praktikën lokale, hetimit të këtyre shkeljeve.

16 Kur prokurorët kanë në dorë prova kundër të dyshuarve, të cilat ato kanë dijeni ose kanë arsye të besojnë se janë marrë përmes metodave të paligjshme, që përbëjnë një shkelje të rëndë të të drejtave njerëzore të të dyshuarit, sidomos kur është fjala për torturë, ose trajtime apo ndëshkime të tjerë, të egër, çnjerëzore ose degradues, apo abuzime të tjera të të drejtave të njeriut, ata refuzojnë përdorimin e këtyre provave kundër cilitdo përveç atyre që i kanë përdorur atometoda, ose informojnë Gjykatën sipas procedurës, dhe ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm që përgjegjësit për përdorimin e këtyre metodave të nxirren para drejtësisë.

[...]

### **Deklarata e Parimeve Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit me Pushtetin**

Miratuar me rezolutën 40/34 të Asamblesë së Përgjithshme më 29 Nëntor 1985

[...]

18 “Viktima” nënkupton persona që individualisht ose kolektivisht, kanë pësuar dëmtim, duke përfshirë dëmtimet fizike ose mendore, vuajtjet emocionale, humbjet ekonomike ose shkelje të konsiderueshme të lirive të tyre themelore, përmes veprimeve ose mosveprimeve që nuk përbëjnë akoma shkelje të të drejtës së brendshme penale por të normave ndërkombëtare të gjithpranuara që lidhen me të drejtat e njeriut.

19 Shtetet duhet të konsiderojnë futjen në të drejtën e brendshme të normave që përshkruajnë abuzimin me pushtetin dhe parashikojnë zgjidhje për viktimat e këtij abuzimi. Sidomos, këto zgjidhje duhet të përfshijnë rikthimin dhe/ose kompensimin, dhe asistencën e mbështetjen e nevojshmemateriale, mjekësore, psikologjike dhe sociale.

20 Shtetet duhet të marrin në konsideratë bisedimet shumëpalëshe për traktatet që lidhen me viktimat, siç përcaktohet në paragrafin 18.

21 Shtetet duhet të rishikojnë periodikisht legjislacionin dhe praktikat egzistuese për të siguruar që ato t’u përgjigjen rrethanave në ndryshim, duhet të miratojnë dhe zbatojnë, nëse është e nevojshme, një legjislacion që parashikon veprimet të cilët përbëjnë abuzime të rënda me pushtetin politik ose ekonomik, si edhe një legjislacion që nxit politika dhe mekanizma përparandalimin e veprimeve të tilla, dhe duhet të zhvillojnë e të vënë menjëherë në zbatim të drejta e zgjidhje të përshtatshme përviktimat e këtyre veprimeve.

### **Deklarata e Të Drejtave të Njeriut të Individëve që nuk janë Shtetas të Vendit ku Ata BanojnëMiratuar me rezolutën 40/44 të Asamblesë së Përgjithshme më 13 Dhjetor 1985**

[...] Neni 1

Për qëllimet e kësaj Deklarate termi “alien” përdoret, duke respektuar sa duhet cilësimet e bëra në nenet që vijojnë, për çdo individ i cili nuk është shtetas i Shtetit ku ai ose ajo është prezent.

[...] Neni 6

Asnjë alien nuk i nënshtrohet torturës ose trajtimeve apo ndëshkimeve të tjerë, të egër, çnjerëzorë ose degradues dhe, në veçanti,

asnjë alien nuk i nënshtrohet asnjë eksperimenti mjekësor ose shkencor, pa pëlqimin e tij/saj të lirë.

[...]

### **Deklarata për Mbrojtjen e Të Gjithë Personave ndaj Zhdukjes së Detyruar**

Rezoluta 47/133 e Asamblesë së Përgjithshme e 18 Dhjetorit 1992  
Asambleja e Përgjithshme,

Duke pasur parasysh se, në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe instrumentet të tjerë ndërkombëtarë, njohja e dinjitetit të qenësishëm dhe e të drejtave të barabarta e të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë,

Duke mbajtur parasysh detyrimin e Shteteve sipas Kartës, veçanërisht Nenit 55, për të nxitur respektimin dhe zbatimin universal të të drejtave e lirive themelore të njeriut,

Me shqetësimin e thellë se në shumë vende, shpesh në mënyrë të vazhdueshme, ndodhin zhdukje të detyruara, në kuptimin që njerëzit arrestohen, ndalohen ose rrëmbehen kundër vullnetit të tyre ose përndryshe privohen nga liria e tyre nga nëpunës të degëve ose niveleve të ndryshme të Qeverisë, ose nga grupe të organizuara apo individë privatë që veprojnë në emër, ose me mbështetjen e drejtpërdrejtë apo të tërthortë, me lejen apo dijeninë e Qeverisë, të pasuara nga refuzimi për të zbuluar fatin ose vendndodhjen e personave të përfshirë, ose nga refuzimi për të pranuar privimin e lirisë së tyre, gjë që i përjashton këta njerëz nga mbrojtja e ligjit,

Duke marrë në konsideratë se zhdukja e detyruar minon vlerat më të rëndësishme të çdo shoqërie të angazhuar për respektimin e shtetit të së drejtës, të drejtave e lirive themelore të njeriut, dhe se praktikimi sistematik i veprimeve të tilla ka natyrën e krimit kundër njerëzimit,

Duke sjellë në kujtesë Rezolutën 33/ 173 të 22 Dhjetorit 1978, në të cilën ajo shpreh shqetësimin për raportet nga pjesë të ndryshme të botës lidhur me zhdukjet e detyruara ose të pavullnetshme, si edhe për hidhërimet e vuajtjet e shkatkuara nga këto zhdukje,

dhe u bën thirrje Qeverive që të vënë para përgjegjësisë ligjore forcat ligjzbatuese e të sigurisë, për teprimet që mund të çojnë në zhdukje të detyruar ose të pavullnetshme të personave,



Duke sjellë në kujtesë gjithashtu mbrojtjen e dhënë viktimave të konflikteve të armatosura nga Konventat e Gjenevës të 12 Gushtit 1949 dhe Protokollet Shtesë të tyre, në 1977,

Duke konsideruar në veçanti nenet përkatëse të Deklaratës Universale të Të Drejtave të Njeriut dhe Paktit Ndërkombëtar për Të Drejtat Civile e Politike, të cilët mbrojnë të drejtën e jetës, të drejtën e lirisë dhe sigurisë së personit, të drejtën për të mos iu nënshtruar torturës dhe të drejtën e njohjes si person para ligjit,

Duke respektuar gjithashtu Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve të Tjerë, të Egër, Çnjerezorë ose Degradues, e cila parashikon që Shtetet Palë të ndërmarrin masa të efektshme për parandalimin e ndëshkimit të torturës,

Duke mbajtur parasysh Kodin e Sjelljes për Nëpunësit Ligjzbatues, Parimet Bazë për Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit nga Nëpunësit Ligjzbatues, Deklaratën e Parimeve Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimit e Abuzimit me Pushtetin, dhe Rregullat Standarde Minimale për Trajtimin e Të Burgosurve,

Duke afirmuar se, me qëllim që të parandalohen zhdukjet e detyruara, është e nevojshme të sigurohet zbatimi i rreptë i Paketës së Parimeve për Mbrojtjen e Të Gjithë Personave nën Çdo Formë Ndalimi ose Burgimi të përfshirë në aneksin e rezolutës së saj 443/173 të 9 Dhjetorit 1988, dhe i Parimeve të Parandalimit dhe Hetimit Efektiv të Ekzekutimeve të Jashtëligjshme dhe Arbitrare, të parashtruara në aneksin e rezolutës 1989/65 të Këshillit Ekonomik e Shoqëror më 24 Maj 1989 dhe të nënshkruara nga Asambleja e Përgjithshme në rezolutën e saj 44/162 të 15 Dhjetorit 1989,

Duke mbajtur parasysh se, ndërsa veprimet që përfshijnë zhdukjen e detyruar përbëjnë një dhunim të ndalimeve që gjenden në instrumentet ndërkombëtare të sipërpërmendur, është jo më pak e rëndësishme të krijohet një instrument që të karakterizojë të gjithë veprimet e zhdukjes së detyruar të personave si shkelje shumë të rënda dhe të parashtrorë standardet që synojnë të ndëshkojnë e parandalojnë kryerjen e tyre,

Shpall këtë Deklaratë për Mbrojtjen e Të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar, si një paketë parimesh për të gjithë Shtetet;

Nxit që të bëhen të gjitha përpjekjet me qëllim që Deklarata të njihet dhe respektohet përgjithësisht;

*Neni 1*

- Çdo veprim i zhdukjes së detyruar është një shkelje e dnjitetit njerëzor. Ajo dënohet si mohim i qëllimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe si dhunim flagrant e i rëndë i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të shpallura në Deklaratën Universale të Të Drejtave të Njeriut dhe të riafirmuara e të zhvilluara nëinstrumentet ndërkombëtarë në këtë fushë.

- Çdo veprim i zhdukjes së detyruar i përjashton personat që u nënshtrohen atyre nga mbrojtja e ligjit dhe u shkakton vuajtje të rënda atyre e familjeve të tyre. Ajo përbën një dhunim të të drejtës ndërkombëtare që garanton, ndër të tjera, të drejtën e njohjes si person para ligjit, të drejtën e lirisë dhe sigurisë së personit dhe të drejtën për të mos iu nënshtrohet torturës dhe trajtimeve apo ndëshkimeve të tjerë, të egër, çnjerëzore ose degradues. Ajo gjithashtu dhunon ose përbën një kërcënim serioz të të drejtës së jetës.

*Neni 2*

- Asnjë Shtet nuk praktikon, lejon ose toleron zhdukjet e detyruara.
- Shtetet veprojnë në nivel kombëtar ose lokal dhe në bashkëpunim me Kombet e Bashkuara për të kontribuar me të gjitha mjetet për parandalimin dhe çrrënjosjen e zhdukjes së detyruar.

*Neni 3*

- Çdo Shtet merr masa të efektshme ligjore, administrative, gjyqësore ose të tjera për parandalimin dhe ndalimin e veprimeve të zhdukjes së detyruar në çdo territor nën juridiksionin e tij.

*[...] Neni 6*

- Asnjë urdhër ose udhëzim i çdo autoriteti publik, civil, ushtarak ose tjetër nuk mund të përdoret për të justifikuar një zhdukje të detyruar. Çdo person që merr një urdhër ose udhëzim të tillë ka të drejtë dhe detyrë të mos e zbatojë atë.

- Çdo Shtet siguron që të ndalohen urdhërat ose udhëzimet që drejtojnë, autorizojnë ose

inkurajojnë çdo zhdukje të detyruar.

- Trainimi i nëpunësve ligjzbatues vë theksin mbi dispozitat në paragrafet 1 dhe 2 të këtij neni.

*[...] Neni 19*

- Viktimat e veprimeve të zhdukjes së detyruar dhe familjet e

tyrepërfitojnë korrigjim dhe kanë të drejtë për kompensimin e duhur, duke përfshirë mjetet për një rehabilitim sa më të plotë të mundshëm. Në rast vdekjeje të viktimës si rezultat i një veprimi të zhdukjes së detyruar, personat e varur prej tyre kanë gjithashtu të drejtë për kompensim.

[...]

### **Deklarata e Kombeve të Bashkuara mbi Eleminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor**

Shpallur me rezolutën 1904 (XVIII) të Asamblesë së Përgjithshme më 20 Nëntor 1963

[...] *Neni 7*

1. Çdokush është i barabartë para ligjit dhe i nenshtrohet drejtësisë së barabartë sipas ligjit. Çdokush, pa dallim rrace, ngjyre ose origjine etnike, ka të drejtën e sigurisë së personit dhe të mbrojtjes nga Shteti ndaj dhunës ose dëmtimeve trupore të shkaktuara nga nëpunësit e qeverisë ose nga çdo individ, grup apo institucion.

2. Çdokush ka të drejtën e një zgjidhjeje dhe mbrojtjeje të efektshme ndaj çdo diskriminimi që ai mund të vuajë për shkak të racës, ngjyrës ose origjinës etnike për sa i përket lirive dhe të drejtave themelore të tij përmes gjykatave të pavarura kombëtare e kompetente për të trajtuar çështje të tilla.

[...]

### **Deklarata e Të Drejtave dhe Përgjegjësisë të Individëve, Grupeve dhe Organeve të Shoqërisë për Nxitjen dhe Mbrojtjen e Të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut të Njohura Universalisht**

Miratuar më 9 Dhjetor 1988 si aneks i rezolutës 53/144 të Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme,

Duke riafirmuar rëndësinë e zbatimit të qëllimeve dhe parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara për nxitjen dhe mbrojtjen e të gjitha të drejtave e lirive themelore të njeriut për të gjithë personat në të gjithë vendet e botës,

Duke riafirmuar gjithashtu rëndësinë e Deklaratës Universale të Të Drejtave të Njeriut dhe Rezolutës 2200 A (XXI), aneksi, të Pakteve Ndërkombëtare mbi Të Drejtat e Njeriut si elementet bazë të përpjekjeve ndërkombëtare për të nxitur respektimin dhe zbatimin universal të të

drejtave e lirive themelore të njeriut dherëndësinë e instrumenteve të tjerë të të drejtave të njeriut të pranuar brenda sistemit të Kombeve të Bashkuara, si edhe ato në nivel rajonal,

Duke theksuar se të gjithë anëtarët e komunitetit ndërkombëtar përmbushin, bashkërisht ose veç e veç, detyrimin e tyre solemn për të nxitur dhe inkurajuar respektimin e të drejtave e lirive themelore të njeriut për të gjithë pa dallim të çfarëdo lloji, duke përfshirë dallimet e bazuara tek rraca, ngjyra, seksi, gjuha, feja, bindja politike ose tjetër, origjina kombëtare ose sociale, prona, statusi i lindjes ose tjetër, dhe duke riafirmuar rëndësinë e veçantë të realizimit të bashkëpunimit ndërkombëtar për përmbushjen e këtij detyrimi sipas Kartës,

Duke njohur rolin e rëndësishëm të komunitetit ndërkombëtar, dhe punën e çmuar të individëve, grupeve dhe shoqatave për të kontribuar në eliminimin e efektshëm të të gjithë shkeljeve të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për popujt dhe individët, duke përfshirë shkeljet masive, flagrante e sistematike si ato që shkaktohen nga aparteidi, gjithë format e diskriminimit racor, kolonializmit, sundimit ose pushtimit të huaj, agresionit ose kërcënimit të sovranitetit kombëtar, unitetit kombëtar ose integritetit territorial, dhe nga refuzimi për të njohur të drejtën e popujve për vetëvendosje dhe të drejtën e çdo populli për të ushtruar sovranitet të plotë mbi pasuritë dhe burimet e tij natyrore,

Duke pranuar lidhjen mes paqes e sigurisë ndërkombëtare dhe gëzimit të të drejtave e lirive themelore të njeriut, dhe të ndërgjegjshëm se mungesa e paqes e sigurisë ndërkombëtare nuk e justifikon mosrespektimin e tyre,

Duke ritheksuar se të gjitha të drejtat e liritë themelore të njeriut janë universale, të pandashme, të ndërvarura e të ndërlidhura dhe duhet të nxiten e të zbatohen në mënyrë të ndershme e të barabartë, pa paragjykime në zbatimin e secilës nga këto të drejta dhe liri themelore të njeriut,

Duke theksuar se detyra dhe përgjegjësia parësore për nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave e liritë themelore të njeriut i përkasin Shtetit,

Duke njohur të drejtën dhe përgjegjësinë e individëve, grupeve dhe shoqatave për nxitjen e respektimit dhe thellimin e njohurive për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në nivel kombëtar e ndërkombëtar,

#### *Deklaron: Neni 1*

Cilido ka të drejtë, individualisht ose i shoqëruar me të tjerë, të nxisë e të përpiqet për mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave e lirive themelore të njeriut në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

*Neni 2*

1. Çdo Shtet ka detyrën dhe përgjegjësinë parësore të mbrojtë, nxisë e zbatojë të gjitha të drejtat eliritë themelore të njeriut, ndër të tjera, duke ndërmarrë hapat e nevojshëm për krijimin e të gjithë kushteve të nevojshme në fushat sociale, ekonomike, politike e të tjera, si edhe garancive ligjore të nevojshme për të siguruar që të gjithë personat nën juridiksionin e tij, individualisht dhe në bashkëpunim me të tjerë, të jenë në gjendje t'i gëzojnë të gjitha ato të drejta dhe liri në praktikë.

2. Çdo Shtet miraton instrumente ligjorë, administrativë e të tjerë të nevojshëm për të siguruar që të drejtat e liritë themelore të njeriut të përcaktuara në këtë Deklaratë të garantohen në mënyrë të efektshme.

*Neni 3*

E drejta e brendshme në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare të Shtetit në fushën e të drejtave e lirive themelore të njeriut është kuadri ligjor brenda të cilit duhen zbatuar e ushtruar të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe brenda të cilit duhen zhvilluar të gjitha veprimtaritë e përmendura në këtë Deklaratë për nxitjen, mbrojtjen dhe realizimin e efektshëm të këtyre të drejtave e lirive.

*Neni 4*

Asgjë në këtë Deklaratë nuk duhet interpretuar si pengesë ose në kontradiktë me qëllimet dhe parimet e Kartës ë Kombeve të Bashkuara ose si kufizim apo shmangie nga dispozitat e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, Pakteve Ndërkombëtare për Të Drejtat e Njeriut dhe instrumenteve e angazhimeve të tjerë ndërkombëtarë të zbatueshme në këtë fushë.

*Neni 5*

Me synimin për nxitjen e mbrojtjen e të drejtave e lirive themelore të njeriut, cilido ka të drejtë, individualisht dhe i shoqëruar me të tjerë, në nivelkombëtar dhe ndërkombëtar:

- a) Të mblidhet ose grumbullohet paqësisht;
- b) Të formojë, të bashkohet me ose të marrë pjesë nëorganizata, shoqata ose grupe joqeveritare;
- c) Të komunikojë me organazita joqeveritare ose ndërqeveritare.

*Neni 6*

Cilido ka të drejtë, individualisht dhe i shoqëruar me të tjerë:

a) Të njohë, të kërkojë, të sigurojë, të marrë dhe të ruajë informacion për të gjitha të drejtat e liritë themelore të njeriut, duke përfshirë edhe aksesin në informacionin mbi mënyrën e zbatimit të këtyre të drejtave e lirive në sistemet e brendshme ligjore, gjyqësore ose administrative;

b) Siç parashikohet në instrumenetet e të drejtave të njeriut e në të tjerë instrumente të zbatueshëm, të publikojë, të shprehë ose përhapë lirshëm tek të tjerët pikëpamje, informacion dhe njohuri mbi të gjitha të drejtat e liritë themelore të njeriut;

c) Të studiojë, diskutojë, formojë dhe të ketë opinione mbi zbatimin, në ligj e në praktikë, të të gjitha të drejtave e lirive themelore të njeriut, dhe, përmes këtyre mjeteve si edhe mjeteve të tjerë të përshtatshëm, të tërheqë vëmendjen e publikut mbi këto çështje.

#### *Neni 7*

Cilido ka të drejtë, individualisht dhe i shoqëruar me të tjerë, të zhvillojë e diskutojë ide e parime të reja për të drejtat e njeriut dhe të mbështesë pranimin e tyre.

#### *Neni 8*

1 Cilido ka të drejtë, individualisht

dhe i shoqëruar me të tjerë, të ketë akses të efektshëm, mbi bazën e mosdiskriminimit, në pjesëmarrjen në qeverisjen e vendit të vet dhe në drejtimin e çështjeve publike.

2 Kjo përfshin, ndër të tjera, të drejtën, individuale dhe i shoqëruar me të tjerë, të paraqesë para organeve, agjencive dhe organizatave qeverisëse të angazhuara në çështjet publike, kritika e propozime për përmirësimin e funksionimit të tyre dhe të tërheqë vëmendjen ndaj çdo aspekti të punës së tyre që mund të dëmtojë ose pengojë nxitjen, mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave e lirive themelore të njeriut.

#### *Neni 9*

1 Në ushtrimin e të drejtave e lirive themelore të njeriut, duke përfshirë edhe nxitjen e mbrojtjen e të drejtave të njeriut të përmendura në këtë Deklaratë, cilido ka të drejtë, individualisht dhe i shoqëruar me të tjerë, të përfitojë nga një zgjidhje e efektshme e të mbrohet në rast shkeljeje të këtyre të drejtave.

2 Për këtë qëllim, cilido, të drejtat e të cilit pretendohet se janë shkelur, ka të drejtë, personalisht ose përmes një përfaqësuesi të autorizuar ligjërisht, të ankohet dhe të kërkojë shqyrtimin e menjëhershëm të kësaj ankese në një seancë dëgjimore publike para një autoriteti gjyqësor ose

tjetër të pavarur, asnjans e Kompetent të përcaktuar me ligj dhe, në përputhje me ligjin, të marrë nga ky autoritet një vendim i cili të japë korigjim, duke përfshirë çdo kompensim përkatës, atje ku ka pasur shkelje të lirive të atij personi, si edhe zbatimin e atij vendimi dhe shpërblimi, të gjitha këto pa asnjë vonesë të paarsyeshme.

3 Për të njejtin qëllim, cilido ka të drejtë, individualisht dhe ishokëruar me të tjerë, ndër të tjera:

a) Të ankohet për politikën e veprimet e nëpunësve të veçantë dhe organeve qeverisëse lidhur me shkeljet e të drejtave e lirive themelore të njeriut, përmes peticionit ose mjeteve të tjerë të përshtatshëm, pranë autoriteteve gjyqësore, administrative ose ligjore vendas ose çdo autoriteti tjetër kompetent të parashikuar nga sistemi ligjor i atij Shteti, të cilët duhet të japin vendimin e tyre për ankesën pa vonesë të paarsyeshme;

b) Të ndjekë seancat dëgjimore, procedimet e gjykimet publike, me qëllim që të krijojë një opinion mbi përputhshmërinë e tyre me të drejtën e brendshme dhe detyrimet e angazhimet përkatëse ndërkombëtare;

c) Të japë dhe garantojë asistencë ligjore, profesionale e të kualifikuar ose ndihmë a këshillim tjetër të përshtatshëm për mbrojtjen e të drejtave e lirive themelore të njeriut.

4 Për të njejtin qëllim, në përputhje me instrumentet e proceduratpërkatëse ndërkombëtare, individualisht dhe i shoqëruar me të tjerë, cilido ka të drejtën e aksesit e komunitit të lirë me organe ndërkombëtare me kompetencë të përgjithshme ose të veçantë për të marrë e shqyrtuar komunikata mbi çështje të të drejtave lirive themelore të njeriut.

5 Shteti bën një hetim të menjëhershëm e asnjans ose siguron që të zhvillohet një hetim i tillë sa herë që ka arsye të qenësishme për të besuar se ka ndodhur një dhunim i të drejtave e lirive themelore të njeriut në çdo territor nën juridiksionin e tij.

#### *Neni 10*

Askush nuk merr pjesë, me veprim ose mosveprim kur kërkohet, në dhunimin e të drejtave e lirive themelore të njeriut dhe askush nuk i nënshtrohet ndëshkimit ose veprimeve armiqësore të çdo lloji për shkak se refuzon ta bëjë këtë gjë.

#### *Neni 11*

Cilido, individualisht dhe i shoqëruar me të tjerë, ka të drejtën e

ushtrimit të lirë të zanatit ose profesionit të vet. Kushdo që, për shkak të profesionit të tij/saj, mund të prekë dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë themelore njerëzore të të tjerëve duhet t'i respektojë këto të drejta e liri dhe të pajtohet me standardet përkatëse kombëtare e ndërkombëtare të sjelljes e etikës profesionale të punës.

*Neni 12*

1 Cilido ka të drejtë, individualisht dhe shoqëruar me të tjerë, të marrë pjesë në veprimtari paqësorekundër shkëljes së të drejtave e lirive themelore të njeriut.

2 Shteti merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar mbrojtjen nga autoritetet kompetente të gjithsecilit, individualisht ose i shoqëruar me të tjerë, ndaj dhunës, kërcënimeve, shpagimeve, diskriminimit armiqësor de facto ose de jure, presionit ose çdo veprimi tjetër arbitrar si pasojë e ushtrimit tëtij/saj të ligjshëm të të drejtave të përmendura në këtë Deklaratë.

3 Në këtë kontekst, cilido ka të drejtë, individualisht ose i shoqëruar me të tjerë, të mbrohet efektivisht nga e drejta e brendshme nëse kundërshton ose reagon, me mjete paqësore, ndaj veprimeve e veprimtarive, duke përfshirë edhe mosveprimin, që i atribuohen Shteteve dhe që çojnë në shkelje të të drejtave e lirive themelore të njeriut, si edhe veprimeve të dhunës të shkaktuara nga grupe ose individë, të cilat prekin gëzimin e të drejtave e lirive themelore të njeriut.

*Neni 13*

Cilido ka të drejtë, individualisht dhe i shoqëruar me të tjerë, të nxisë, marrë dhe përdorë burime me synimin e qartë të nxitjes e mbrojtjes së të drejtave e lirive themelore të njeriut përmesmjeteve paqësore, në përputhje me nenin 3 të kësaj Deklarate.

*Neni 14*

1 Shteti ka përgjegjësinë për të marrë masat e duhura ligjore, gjyqësore, administrative e të tjera për nxitjen e kuptimit nga të gjithë personat nënjuridiksionin e tij të të drejtave të tyre civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore.

2 Këto masa përfshijnë, ndër të tjera:

a) Publikimin dhe disponibilitetin e gjerë të ligjeve e rregulloreve kombëtare dhe të instrumenteve përkatës ndërkombëtarë bazë të të drejtave të njeriut;

b) Akses të plotë e të barabartë në dokumentet ndërkombëtare



në fushën e të drejtave të njeriut, duke përfshirë raportet periodike të Shtetit për organet e ngritura nga traktatet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në të cilat ai është palë, si edhe dokumentacionin përmbledhës të diskutimeve dhe raporteve zyrtare të këtyre organeve.

3 Shteti siguron e mbështet, kur është e nevojshme, krijimin dhe zhvillimin e institucioneve të tjerë të pavarur kombëtarë për nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave e lirive themelore të njeriut në të gjithë territorin nën juridiksionin e tij, qofshin këta avokatë të popullit, komisione të të drejtave të njeriut ose çdo formë tjetër e institucioneve kombëtare.

*Neni 15*

Shteti ka përgjegjësinë të nxitë e lehtësojë mësimdhënien e të drejtave e lirive themelore të njeriut në të gjithë nivelet e arsimit dhe të sigurojë që të gjithë ata që janë përgjegjës për trainimin e avokatëve, nëpunësve ligjzbatues, personelit të forcave të armatosura dhe nëpunësive publikë, të përfshijnë në programet e tyre trainuese elementët e duhur të mësimdhënies së të drejtave të njeriut.

*Neni 16*

Individët, organizatat joqeveritare dhe institucionet përkatëse kanë një rol të rëndësishëm në kontributin për ta bërë publikun më të ndërgjegjshëm për çështje që lidhen me të gjitha liritë e të drejtat themelore të njeriut përmes veprimtarive të tilla si arsimi, trainimi dhe kërkimi shkencor në këto fusha për të forcuar më tej, ndër të tjera, mirëkuptimin, tolerancën, paqen dhe marrëdhëniet miqësore ndërmjet kombeve dhe ndërmjet gjithë grupeve racore e fetare, duke mbajtur parasysht mjediset e ndryshme të shoqërive e komuniteteve në të cilët ato kryejnë veprimtarinë e tyre.

*Neni 17*

Në ushtrimin e të drejtave e lirive të veta të përmendura në këtë Deklaratë, cilido, që vepron individualisht dhe në bashkëpunim me të tjerë, i nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve që janë në përputhje me detyrimet ndërkombëtare përkatëse dhe që përcaktohen me ligj vetëm për të siguruar njohjen e respektimin e të drejtave e lirive themelore të të tjerëve dhe të plotësisimit të kërkesave të drejta të moralit, rendit publik dhe mirëqenies së përgjithshme në një shoqëri demokratike.

*Neni 18*

1 Cilido ka detyrime ndaj dhe brenda komunitetit, vetëm brenda të cilit është i mundur zhvillimi i lirë e i plotë i personalitetit të tij/saj.

2 Individët, grupet, institucionet e organizatat joqeveritare kanë një rol e përgjegjësi të rëndësishme në mbrojtjen e demokracisë, nxitjen e të drejtave e lirive themelore të njeriut dhe kontributin për nxitjen epërparimin e shoqërive, institucioneve e proceseve demokratike.

3 Individët, grupet, institucionet e organizatat joqeveritare kanë gjithashtu një rol e përgjegjësi të rëndësishme në kontributin, siç duhet, për nxitjen e të drejtës së gjithsecilit për një rend social e ndërkombëtar në të cilin gjejnë realizim të plotë të drejtat e liritë themelore të përcaktuara në Deklaratën Universale të Të Drejtave të Njeriut dhe në instrumentet e tjerë ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut.

*Neni 19*

Asgjë në këtë Deklaratë nuk interpretohet se nënkupton të drejtën e çdo individi, grupi ose organi të shoqërisë ose çdo Shteti, për t'u përfshirë në çfarëdo veprimtarie ose përtë kryer çfarëdo veprimi që synon shkatërrimin e të drejtave e lirive të përmendura në këtë Deklaratë.

*Neni 20*

Asgjë në këtë Deklaratë nuk interpretohet se nënkupton lejimin e Shteteve për të mbështetur dhe nxitur veprimtari të individëve, grupeve të individëve, institucioneve ose organizatave joqeveritare, kundër dispozitave të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

## **2.Ndalimi i Torturës në Të Drejtën Humanitare**

*Neni 3 i Përbashkët i Konventës së Gjenevës*

Në rastin e një konflikti të armatosur jo me karakter ndërkombëtar që ndodh në territorin e njërës nga Palët e Larta Kontraktuese, secila Palë në konflikt detyrohet të zbatojë, minimalisht, dispozitat e mëposhtëme:

1 Personat që nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në luftime, duke përfshirë pjesëtarët e forcave të armatosura që kanë dorëzuar armët dhe ato të nxjerrë jashtë luftimit nga sëmundja, plagët, ndalimi, ose nga çdo shkak tjetër, në të gjitha rrethanat trajtohen në mënyrë njerëzore, pa asnjë dallim armiqësor të bazuar në racë, ngjyrë, fe ose besim, seks, lindje apo pasuri, ose çfarëdo kriteri tjetër të ngjashëm.

Për këtë qëllim veprimet që vijojnë janë dhe mbeten të ndaluara në çdo kohë dhe në çdo vend cilidoqoftë përsa i përket personave të sipërpërmendur:

a) Dhuna ndaj jetës dhe personit, në veçanti vrasjet e çdo lloji, gjymtimi, trajtimi i egër dhe tortura;

- b) Marrja e pengjeve;
- c) NËpërkëmbja e dinjitetit personal, sidomos trajtimi fyes e degradues;
- d) Marrja e vendimeve dhe zbatimi i ekzekutimeve pa vendim të shpallur më parë nga një gjykatë e krijuar sipasrregullave, e cila ofron të gjithagarancitë që njihen si të domosdoshme nga popujt e qytetëruar.

2 Të plagosurit e të sëmurët grumbullohen dhe mbahen nën kujdes.

**Protokolli i pare (I) Shtesë i Konventave të Gjenevës të 12 Gushtit 1949, dhe i lidhur me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura Ndërkombëtare**

Miraturar më 8 Qershor 1977

Hyri në fuqi më 7 Dhjetor 1979, në përputhje me Nenin 95

[...]

*Neni 1 Parime të përgjithshme dhe hapësira e zbatimit*

1. Palët e Larta Kontraktuese angazhohen të respektojnë e sigurojnë respektimin e këtij Protokolli në të gjitha rrethanat.

2. Për rastet që nuk mbulohen nga ky Protokoll ose nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare, civilët dhe luftëtarët mbeten nën mbrojtjen e autoritetin e të drejtësndërkombëtare që rrjedhin nga tradita e krijuar, nga parimet e humanizmit dhe nga ajo që diktohet nga ndërgjegja publike.

3. Ky Protokoll që plotëson Konventat e Gjenevës të 12 Gushtit 1949 për mbrojtjen e viktimave të luftës, zbatohet në situatat e përmendura në Nenin 2 të përbashkët për këto Konventa.

4. Situatat e përmendura në paragrafin e mëparshëm përfshijnë konflikte të armatosura në të cilët popujt luftojnë kundër sundimit kolonial dhe pushtimit të huaj dhe kundër regjimeve raciste në ushtrim të të drejtës së tyre për vetëvendosje, siç

përcaktohet në Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe në Deklaratën Universale për Parimet e Të Drejtës Ndërkombëtare lidhur me Marrëdhëniet dhe Bashkëpunimin Miqësor ndërmjet Shteteve në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara.

[...]

*Neni 11 – Mbrojtja e personave*

1. Shëndeti dhe integriteti fizik e mendor i personave që janë nën autoritetin e Palës armike ose që izoloohen, ndalohen ose përndryshe privohen nga liria si rezultat i një situatë të përmendur në Nenin 1, nuk rrezikohen nga asnjë veprim ose mosveprim i pajustificuar. Prejkëtej, është e ndaluar që personat e përkrahur në këtë Nen t'i nënshtrohen ndonjë procedurë mjekësore e cila nuk kushtëzohet nga gjendja shëndetësore e personit në fjalë dhe e cila nuk është në përputhje me standardet mjekësore përgjithësisht të pranuar që duhet të zbatohen në rrethana të ngjashme mjekësore për persona të cilët janë shtetas të Palës që kryen procedurën dhe të cilët në asnjë mënyrë nuk privohen nga liria.

2. Veçanërisht është e ndaluar të kryhen mbi këta persona, madje as edhe me pëlqimin e tyre:

- a) Gjymtime fizike;
- b) Eksperimente mjekësore ose shkencore;
- c) Heqje e indeve ose organeve për transplantim;

Përveçse kur këto veprime justifikohen në pajtim me kushtet e parashikuara në paragrafin 1.

[...]

3. Çdo veprim ose mosveprim i vullnetshëm, i cili rrezikon seriozisht shëndetin ose integritetin fizik e mendor të çdo personi që është nën autoritetin e një Pale tjetër të cilës ai nuk i përket dhe e cila ose shkel ndonjërin nga ndalimet në paragrafët 1 dhe 2 ose nuk zbaton kërkesat e paragrafit 3, është shkelje e rëndë e këtij Protokolli.

[...]

*Neni 16 – Mbrojtja e përgjithshme e detyrimeve mjekësore*

1. Në asnjë rrethanë, asnjë person nuk ndëshkohet për shkak se ka kryer veprimtari mjekësore në përputhje me etikën mjekësore, pavarësisht nga personi që përfiton prej tyre.

2. Personat e përfshirë në veprimtari mjekësore nuk detyrohen të kryejnë veprime ose punë në kundërshtim me rregullat e etikës mjekësore ose rregulla të tjera mjekësore të hartuara për të mirën e të plagosurve e të sëmurëve, ose në kundërshtim me dospozitat e Konevntës ose këtij

Protokolli, as nuk ndalohen për të kryer veprime ose punë që kërkohen nga këto rregulla e dispozita.

[...]

*Neni 75 – Garanci themelore*

[...]

3. Veprimet e mëposhtëme janë dhe mbeten të ndaluara në çfarëdo kohe dhe vendi, pavarësisht nëse kryhen nga civilë ose agentë ushtarakë:

a) Dhuna ndaj jetës, shëndetit, ose mirëqenies fizike apomendore të personave, veçanërisht: i. Vrasjet; ii. Torturat e të gjitha llojeve, fizike e mendore; iii. Ndëshkimet trupore; dhe iv. Gjymtimet

b) Nëpërkëmbjet e dinjitetit personal, sidomos trajtimet fyese dhe degraduese, prostitucioni i detyruar dhe çdo formë e sulmeve të pandershme;

[...]

*Neni 85 – Ndëshkimi i shkeljeve të këtij Protokoll*

1 Dispozitat e Konventave që lidhen me ndëshkimin e shkeljeve dhe me shkeljet e rënda, që shtohen nga ky Seksion, zbatohen për ndëshkimin e shkeljeve të rënda të këtij Protokoll.

2 Veprimet e përshkruara si shkelje të rënda nga Konventat janë shkelje të rënda të këtij Protokoll nëse kryhen kundër personave nën autoritetin e një Pale armike, të mbrojtur prej Neneve 44, 45, dhe 73 të këtij Protokoll, ose kundër tëplagosurve, të sëmurëve e të mbijetuarve të Palës armike të cilët mbrohen nga ky Protokoll, ose kundër atij personeli mjekësor ose fetar, njësisive mjekësore ose transportuesve mjekësorë të cilët janë nën kontrollin e Palës armike dhe mbrohen nga ky Protokoll.

3 Krahas shkeljeve të rënda të përcaktuara në Nenin 11, veprimet e mëposhtëme konsiderohen shkelje të rënda të këtij Protokoll, kur kryhen me dashje, në dhunim tëdispozitave të këtij Protokoll, dhe duke shkaktuar dëmtime të trupit ose shëndetit:

a) Bërja objekt sulmi e popullsisë civile ose individëve civilië;

b) Ndërmarrja pa asnjë dallim e një sulmi i cili prek popullsinë civile ose objektet civile edhe kur dihet se një sulm i tillë shkakton humbje të tepërta jetësh, dëmtime ndaj civilëve ose dëmtime ndaj objekteve civile, siç përcaktohet në Nenin 57, paragrafi 2 (a)(iii);

c) Ndërmarrja e një sulmi kundër veprave ose ndërtesave që

përmbajnë forca të rrezikshme edhe kur dihet se një sulm i tillë shkakton humbje të tepërta jetësh, dëmtime ndaj civilëve ose dëmtime ndaj objekteve civile, siç përcaktohet në Nenin 57, paragrafi 2 (a)(iii);

d) Bërja objekt sulmi e lokaliteteve të pambrojtura dhe zonave të çmilitarizuara;

e) Bërja objekt sulmi e një personi kur dihet se ai është jashtë luftimi;

f) Përdorimi i pabesë, në dhunim të Nenit 37, i shenjës dalluese të kryqit të kuq, gjysëmhënës së kuqe ose luanit dhe diellit të kuq apo shenjave të tjera mbrojtëse të njohura nga Konventat e këtij Protokolli.

4 Krahas shkeljeve të rënda të përcaktuara në paragrafin e mëparshëm dhe në Konventat, këto që pasojnë konsiderohen shkelje të rënda të këtij Protokolli kur kryhen me dashje dhe në dhunim të Konventave të këtij Protokolli:

a) Transferimi nga Fuqiapushtuese e pjesëve të popullsisë së vet civile në territorin që ajo pushton, ose shpërngulja ose transferimi i të gjitha pjesëve të popullsisë së territorit të pushtuar brenda ose jashtë këtij territori, në dhunim të Nenit 49 të Konventës së Katërt;

b) Vonesa e pajustificueshme në riatdhesimin e robërve të luftës ose civilëve;

c) Praktikat e aparteidit dhe të tjera praktika çnjerëzore e degraduese që shkaktojnë nëpërkëmbje të dinjitetit personal, mbi bazën e diskriminimit racor;

d) Bërja objekt sulmi e monumenteve historike, veprave të artit ose objekteve të kultit lehtësisht të dallueshme që përbëjnë trashëgiminë kulturore e shpirtërore të popujve, dhe të cilave u është dhënë mbrojtje e veçantë me marrëveshje të veçanta, për shembull, brenda kuadrit të një organizate kompetente ndërkombëtare, duke shkaktuar për pasojë shkatërrimin e rëndë të tyre, në ato raste kur nuk ka prova të dhunimit të Nenit 53, nënparagrafi (b) nga Pala armike, dhe kur këto monumente historike, vepra arti dhe objekte kulti nuk ndodhen në afërsi të objektivave ushtarake;

e) Privimi i një personi të mbrojtur nga Konventat ose të përmendur në paragrafin 2 të këtij Neni, nga të drejtat për gjykim të drejtë e të rregullt.

5 Pa paragjykuar zbatimin e Konventave dhe këtij Protokolli, shkeljet e rënda të këtyre instrumenteve konsiderohen krime lufte.

[...]

**Protokolli i dyte (II) Shtesë i Konventave të Gjenevës të 12 Gushtit 1949, dhe i lidhur me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve Jo-Të Armatosura Ndërkombëtare**

Miratuar më 8 Qershor 1977

Hyri në fuqi më 7 Dhjetor, në përputhje me Nenin 23

[...]

*Neni 1 – Fusha materiale e zbatimit*

1 Ky Protokoll i cili zhvillon dhe ishtohet Nenit 3 të përbashkët të Konventave të Gjenevës të 12 Gushtit 1949 pa ndryshuar kushtet egzistuese ose zbatimin e tij, zbatohet për të gjithë konfliktet e armatosura që nuk mbulohen nga Neni 1 i Protokollit Shtesë të Konventave të Gjenevës të 12 Gushtit 1949, dhe lidhur me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura (Protokolli 1) dhe që ndodhin në territorin e një Pale të Lartë Kontraktuese ndërmjet forcave të armatosura të saj dhe forcave të armatosura disidente ose grupeve të tjerë të organizuar e të armatosur të cilët, nën komanda të përgjegjshme, ushtrojnë një kontroll të tillë mbi pjesë të territorit të saj që u mundëson atyre ndërmarrjen e operacioneve të vazhdueshme e të organizuara ushtarake dhe zbatimin e këtij Protokollit.

2 Ky Protokoll nuk zbatohet për situatat e trazirave e tensioneve tëbrendshme, si rrebelimet, veprimet e izoluara ose sporadike të dhunës dhe veprime të tjera të një natyre të ngjashme, pasi ato nuk janëkonflikte të armatosura.

[...]

*Neni 4 – Garanci themelore*

1 Të gjithë personat që nuk marrin pjesë drejtpërdrejt ose që kanë pushuar së marri pjesë në luftime, pavarësisht nëse liria e tyre është kufizuar ose jo, kanë të drejtën e respektimit të personit, nderit dhe bindjeve e praktikave fetare të tyre. Në të gjitha rrethanat ata trajtohen në mënyrë njerëzore, pa asnjë dallim armiqësor. Ndalohet urdhëri që të mos ketë asnjë të mbijetuar.

2 Pa paragjykuar përgjithësimin e çka u tha më lart, veprimet e mëposhtëme kundër personave të përmendur në paragrafin 1 janë dhe mbeten të ndaluara në çfarëdo kohe ose vendi: dhuna ndaj jetës, shëndetit dhe mirëqenies fizike e mendore të personave, në veçanti vrasjet e trajtimet e egra si tortura, gjymtimi ose çdo formë endëshkimit trupor;

[...]

*Neni 5 – Personat liria e të cilëve është kufizuar*

[...]

2 Ata që janë përgjegjës për izolimin ose ndalimin e personave të përmendur në paragrafin 1, respektojnë, brenda kufinjve të mundësive të tyre, dispozitat e mëposhtëme që lidhen me këta persona:

[...]

e) Integriteti e shëndeti i tyre fizik e mendor nuk rrezikohet nga asnjë veprim ose mosveprim i pajustificueshëm. Prejkëtej, është e ndaluar që personat e përshkruar në këtë Nen t'inënshtrohen ndonjë procedurë mjekësore e cila nuk kushtëzohet nga gjendjashëndetësore e personit në fjalë dhe e cila nuk është nëpërputhje me standardet mjekësore përgjithësisht të pranuar që zbatohen përpersona të lirë në rrethanamjekësore të ngjashme.

[...]

*Neni 10 – Mbrojtja e përgjithshme e detyrimeve mjekësore*

1. Në asnjë rrethanë, asnjë person nuk ndëshkohet për shkak se ka kryer veprimtari mjekësore në përputhje me etikën mjekësore, pavarësisht nga personi që përfiton prej tyre.

2. Personat e përfshirë në veprimtari mjekësore nuk detyrohen të kryejnë veprime ose punë në kundërshtim me, as nuk detyrohen të mos kryejnë veprime që kërkohen nga rregullat e etikës mjekësore ose rregulla të tjera mjekësore të hartuara për të mirën e të plagosurve e të sëmurëve ose nga ky Protokoll.

[...]

3.

**Ndalimi i Torturës sipas Gjykatës Penale Ndërkombëtare dhe Tribunaleve Ad Hoc mëposhtëme kundër personave ose pronës të mbrojtur sipas dispozitave të Konventës përkatëse të Gjenevës:**

[...]

b) Torturë ose trajtim çnjerëzor, duke përfshirë eksperimentet biologjike;

[...]

Statuti i Romës i Gjykatës Penale Ndërkombëtare

Miratuar më 17 Korrik 1998 Hyri në fuqi me 1 korrik 2002 [...]



b. Shkaktimi i dëmtimeve të rënda trupore ose mendore ndaj anëtarëve të grupimit;

*Neni 7*

### **Krimet kundër njerëzimit**

1 Për qëllimet e këtij Statuti, “krime kundër njerëzimit” nënkupton cilindo nga veprimet e mëposhtëme kur ato kryhen si pjesë e një sulmi të gjerë e sistematik drejtuar kundër çdo popullsie civile, me dijeninë për sulmin:

Juridiksioni i Gjykatës kufizohet në krimet më të rënda që perbejne shqetësim për komunitetin ndërkombëtar në tërësi. Gjykata ka juridiksion në përputhje me këtë Statut mbi krimet e mëposhtëme:

- a. Krimin e genocidit;
- b. Krimet kundër njerëzimit;
- c. Krimet e luftës;

[...]

*Neni 6*

### **Genocidi**

Për qëllimet e këtij Statuti, “genocid” nënkupton veprimet e mëposhtëme të kryera me qëllimin për shkatërrimin si të tillë, tërësisht ose pjesërisht, të një grupimi kombëtar, etnik, rracor ose fetar:

[...]

2 Për qëllimin e paragrafit 1:

a. “Sulm i drejtuar kundër çdo popullsie civile” nënkupton një mënyrë sjelljeje që përfshin kryrjen e shumtë të veprimeve të përmendura në paragrafin 1 kundër çdo popullsie civile, në zbatim të ose në vijim të një politike Shtetërore ose organizative për të kryer të tilla sulme;

[...]

e) “Torturë” nënkupton shkaktimin e qëllimshëm të vuajtjeve osedhimbjeve fizike ose mendore ndaj njëpersoni nën mbikqyrjen ose nën kontrollin eakuzes; me përjashtim [...] të kësaj, tortura nukpërfshin dhimbje ose vuajtje që shkaktohen në mënyrë teqenësishme oserastësore, si rrjedhoje esanksioneve tëligjëshme;

[...]

*Neni 8*

### **Krimet e luftës**

1 Gjykata ka juridiksion mbi krimet e luftës, veçanërisht kur ato kryhen si pjesë e një plani ose politike ose si pjesë e kryrjes në shkallë të gjerë e këtyre krimeve.

2 Për qëllimin e këtij Statuti, “krime luftime” nënkupton:

a) Shkelje të rënda të Konventave të Gjnevëstë 12 Gushtit 1949, përkatësisht, çdonjërin nga veprimet emëposhtëme kundër personave ose pronës të mbrojtur sipasdispozitave të

Konventës përkatëse të Gjnevës:

[...]

(ii) Torturë ose trajtim [...]

çnjerezor, duke përfshirë eksperimentetbiologjike;

(iii) Shkaktimi i qëllimshëm i vuajtjeve të mëdha, osedëmtimeve të rënda trupore ose shëndetësore;

c) Në rastin e një konflikti të armatosur jo të një karakteri ndërkombëtar, shkeljet e rënda të nenit

3 të përbashkët për të katër Konventat e Gjnevës të 12 Gushtit 1949, përkatësisht, çdonjërin nga veprimet e mëposhtëme të kryera kundër personave që nuk marrin pjesë aktive në luftime, duke përfshirë pjesëtarët e forcave të armatosura që kanë dorëzuar armët dhe ata të konsideruar hors de combat nga sëmundja, plagët, ndalimi ose çdo shkak tjetër:

(i) Dhunën kundër jetës dhe personit, në veçanti vrasjet e çdo lloji, gjymtimin, trajtimin e egër dhe torturën;

(ii) Nëpërkëmbjen e dinjitetit personal, në veçanti trajtimin fyes e degradues;

d) Paragrafi 2 (c) zbatohet për konfliktet e armatosura jo të një karakteri ndërkombëtar dhe prandaj nuk zbatohet për situata trazirash e tensionesh të brendëshme, si rrebelimet, veprimet e izoluara e sporadike të dhunës ose veprime të tjera të një natyre të ngjashme.

[...]

*Neni 25*

### **Përgjegjësia penale individuale**

[...]

2. Një person që kryen një krim të klasifikueshem brenda juridiksionit të Gjykatës është individualisht përgjegjës dhe ligjrisht i ndëshkueshem në përputhje me këtë Statut.

3. Në përputhje me këtë Statut, një person është penalisht përgjegjës dhe ligjrisht i ndëshkueshem për një krim të klasifikueshem brenda juridiksionit të Gjykatës nëse ai person:

(a) Kryen këtë krim, individualisht ose bashkë me një tjetër ose përmes një personi tjetër, pavarësisht nëse ai person tjetër është penalisht përgjegjës;

(b) Urdhëron, nxit ose shkakton kryerjen e këtij krimi i cili në fakt ndodh ose mbetet në tentative;

(c) Për qëllimin e lehtësimit të kryerjes së këtij krimi, ndihmon, mbështet ose përndryshe asiston në kryerjen e tij ose në tentativën për kryerjen e tij, duke përfshirë sigurimin e mjeteve për kryerjen e tij;

(d) Në çfarëdo mënyre tjetër kontribuon për kryerjen ose tentativën për kryerjen e këtij krimi nga një grup personash që veprojnë me një qëllim të përbashkët. Ky kontribut është i qëllimshëm dhe:

i. Bëhet me qëllimin e mbështetjes së veprimtarisë kriminale ose qëllimit kriminal të grupit, kur kjo veprimtari ose ky qëllim përfshijnë kryerjen e një krimi brenda juridiksionit të Gjykatës; ose

ii. Bëhen me dijeninë për qëllimin e grupit për të kryer krimin;

(e) Për sa i përket krimit të genocidit, drejtpërdrejt dhe publikisht nxit të tjerët të kryejnë genocid;

[...]

*Neni 27*

### **Pavlefshmëria e imunitetit të zyrtareve të lartë**

1. Ky statut zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë personat pa asnjë dallim mbi bazën e cilësisë zyrtare. Në veçanti, cilësia zyrtare si Kryetar Shteti ose Qeverie, anëtar i një Qeverie ose parlamenti, përfaqësues i zgjedhur ose Nënpunës qeverie nuk e përjashton, në asnjë rast, personin nga përgjegjësia penale sipas këtij Statuti, dhe as nuk përbën ajo, vetëm dhe në vetvete, një arsye për zbutjen e dënimit.

2. Imunitetet ose rregullat e posaçme procedurale të cilat mund t'i akordohen cilësisë zyrtare të një personi, sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare, nuk e pengojnë Gjykatën të ushtrojë juridiksionin e vet mbi këtë person.

[...]

*Neni 55*

Të drejtat e personave gjatë hetimit<sup>1</sup>. Për sa i përket një hetimi sipas këtij Statuti, një person:

[...]

b. Nuk i nënshtrohet asnjë forme të detyrimit, ashpërsisë ose kërcënimit, torturës ose çdo forme tjetër të trajtimit e ndëshkimit të egër, çnjerëzor ose degradues;

[...]

### **Aktet ligjore rajonale lidhur me Torturën**

Tekstet e miratuara nga Organizata e Unitetit Afrikan

Karta Afrikane e Të Drejtave dhe Lirive të Popujve / Miratuar më 27 Qershor 1981 Hyri në fuqi më 21 Tetor 1986 [...]

Karta Afrikane e Të Drejtave dhe Mirëqenies së Fëmijës/ Miratuar në Adis Abeba, Etiopi, më 11 Korrik 1990/ Hyri në fuqi më 29 Nëntor 1999 [...]

### **Tekste të miratuara nga Organizata e Shteteve Amerikane**

Konventa Amerikane e Të Drejtave të Njeriut<sup>10</sup>

Konventa Ndër-Amerikane për Parandalimin, Ndëshkimin dhe Çrrënjosjen e Dhunës ndaj Grave/Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OSHA më 9 Qershor 1994/ Hyri në fuqi më 5 Mars 1995

Konventa Ndër-Amerikane për Zhdukjen e Detyruar të Personave/ Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OSHA më 9 Qershor 1004/ Hyri në fuqi më 28 Mars 1996 [...]

### **Tekste të miratuara nga Këshilli i Europës**

Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut/Nënshkruar më 4 Nëntor 1950, hyri në fuqi më 3 Shtator 1953. E amenduar me Protokollin Nr. 1112, miratuar më 11 Maj 1994, hyri në fuqi më 1 Nëntor 1998

[...]

*Neni 1*

#### **- Detyrimi për respektimin e të drejtave të njeriut**

Palët e Larta Kontraktuese i sigurojnë cdokujt që ndodhet në

juridiksionin e tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në titullin e I të kësaj Konvente.

*Neni 3*

### **Ndalimi i torturës**

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, as denimeve ose trajtimeve c'njerezore ose poshteruese.

[...]

*Neni 13*

### **- E drejta për ankim efektiv**

Çdokush, të cilit i janë shkelur te drejtat dhe liritë e njohura ne këtë Konventë, ka te drejte te beje ankim efektiv tek nje organ i vendit te tij, edhe kur shkelja eshte kryer nga persona qe veprojne ne permbushje te funksioneve te tyre zyrtare.

[...]

*Neni 15*

Derogimi në rastet e gjendjes se jashtezakonshme

1. Në rast lufte, ose rreziku tjetër publik që i kanoset jetës së kombit, çdo Palë e Lartë Kontraktuese mund të marrë masa që nuk u permbahen detyrimeve te parashikuara nga kjo Konvente, vecse në shkallen me te vogel që e kërkon situata dhe me kusht që këto masa të mos vijne në kundërshtim me detyrimet e tjera që rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare.

2. Dispozita e mesiperme nuk lejon asnjë shmangie nga neni 2, përveçse në rastet e vdekjeve që shkaktohen nga akte te ligjshme të luftës, dhe nga nenet 3, 4 (paragrafi

1) e 7.

[...]

## **TITULLI II - Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut**

*Neni 19*

### **Krijimi i Gjykatës**

Për të siguruar zbatimin e angazhimeve të ndërmarra nga Palët e Larta Kontraktuese nga kjo Konventë dhe nga protokollet e saj, krijohet Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, tani e tutje e quajtur "Gjykata". Ajo funksionon në menyrë te perhershme.

[...]

*Neni 27*

### **Komisionet, Dhomat dhe Dhoma e Madhe**

1. Për shqyrtimin e çështjeve që sillen para saj, Gjykata gjykon në Komitete prej tre gjyqtarësh, me Dhoma prej shatë gjyqtarësh dhe në një Dhomë të Madhe me shtatëmbëdhjetë gjyqtarësh. Komitetet krijohen nga Dhomat e Gjykatës për një periudhe kohe të përcaktuar.

2. Gjyqtari i zgjedhur në emer të një Shteti Pale në gjykim është anetar i caktuar kryesisht i Dhomes dhe i Dhomes së Madhe; në rast se ky gjyqtar mungon ose nuk mund të gjykojë, Shteti Pale cakton një person që merr pjesë në cilesinë e gjyqtarit.

3. Dhoma e Madhe përfshin edhe Kryetarin e Gjykatës, Nënkryetarët, Kryetarët e Dhomave dhe gjyqtarë të tjerë të zgjedhur në përputhje me rregulloren e Gjykatës. Kur një çështje paraqitet në Dhomën e Madhe sipas Nenit 43, asnjë gjyqtar i Dhomes e cila ka dhënë vendimin nuk mund të marrë pjesë në të, me përjashtim të Kryetarit të Dhomës dhe gjyqtarit që ka marrë pjesë në emer të Shtetit - Palë e interesuar.

*Neni 28*

**Deklarimi i papranueshmërisë nga Komitetet** Çdo Komitet, me votim unanimit, mund ta deklarojë të papranueshme ose ta ç'regjistrojë një kerkese individuale të paraqitura në baze të Nenit 34, kur ky vendim mund të merret pa shqyrtim të mëtejshëm. Vendimi është i formës së prapere.

*Neni 29*

### **Vendimet e Dhomave mbi pranueshmërinë dhe themelin**

1. Nëse nuk merret asnjë vendim sipas Nenit 28, njëra nga Dhomat vendos mbi pranueshmërinë dhe themelin e kërkesave individuale të paraqitura në baze të Nenit 34.

2. Dhoma vendos mbi pranueshmërinë dhe themelin e kërkesave ndër-Shtetërore, të paraqitura në baze të Nenit 33.

3. Vendimi mbi pranueshmërinë merret më vete, përveçse kur Gjykata, në raste përjashtimore, vendos ndryshe.

*Neni 30*

### **Terheqja në favor të Dhomes së Madhe**

Në qofte se një çështje në gjykim para një Dhome paraqet një problem

te rendesishem ne lidhje me interpretimin e Konventes ose te protokolleve te saj, ose kur zgjidhja e nje ceshtjeje mund te coje ne nje kundershiti me nje vendim te dhene me pare nga Gjykata, Dhoma, per sa kohe nuk ka dhene vendimin, mund te heqe dore nga juridiksioni i saj ne favor te Dhomes se Madhe, me kusht qe palet te mos kene kundershitime.

*Neni 31*

### **Kompetencat e Dhomës së Madhe**

Dhoma e Madhe:

a. Shprehet për kërkesat e dorëzuara sipas Nenit 33 ose Nenit 34 kur ceshtja i eshte kaluar nga Dhoma sipas Nenit 30 ose kur ceshtja I eshte kaluar sipas Nenit 43; dhe

b. Shqyrton kërkesat për opinione këshillimore që i dorëzohen asaj sipas Nenit 47

*Neni 32*

### **Juridiksioni i Gjykatës**

1. Juridiksioni i Gjykatës shtrihet mbi të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e Konventës dhe protokolleve të saj që i paraqiten sipas kushteve te parashikuara në Nenet 33, 34 dhe 47.

2. Në rastin e një mosmarrëveshjeje mbi faktin nëse Gjykata gezon juridiksion ose jo, vendos Gjykata.

*Neni 33*

### **Çështjet Ndër-Shtetërore**

Çdo Palë e Lartë Kontraktuese mund t'i drejtohet Gjykatës per çdo shkelje të dispoziatve të Konventës dhe protokolleve të saj, per te cilat mendonse eshte pergjegjese një tjetër Pale e Lartë Kontraktuese.

*Neni 34*

### **Kerkesat individuale**

Gjykates mund t'i paraqiten kerkesa nga çdo person fizik, organizatë jo-qeveritare ose grup individësh që pretendojnë se janë te demtuar nga ndonje shkelje prej një Pale të Lartë Kontraktuese te të drejtave njohura nga Konventa ose protokollet e saj. Palët e Larta Kontraktuese zotohen të mos pengojnë në asnjë mënyrë ushtrimin efektiv të kësaj të drejte.

*Neni 35*

### **Kushtet e pranueshmërisë**

1. Gjykata mund të vihet ne levizje vetëm pasi te jenë shteruar mjetet e brendshme ligjore, sipas kuptimit nga parimet përgjithësisht të pranuar

të së drejtës ndërkombëtare, dhe brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga data në të cilën është marrë vendimi përfundimtar i brendshëm.

2. Gjykata nuk merr ne shqyrtim kërkesa individuale që paraqiten sipas Nenit 34, kur:

a. janë anonime; ose

b. janë në thelb të njëjta me ndonjë kërkesë të shqyrtuar nga Gjykata ose që i është paraqitur për zgjidhje një organi tjetër ndërkombëtar hetimor ose vendimor dhe nuk përmban fakte të reja.

3. Gjykata deklaron të papranueshëm çdo kërkesë individuale të dorëzuar sipas Nenit 34, kur cmon se kërkesa nuk pajtohet me dispozitat e Konventës ose të protokolleve të saj, ajo është dukshëm e pabazuar ose është abuzive.

4. Gjykata rrezon çdo kërkesë që cmon të papranueshëm në zbatim të këtij Neni. Ajo mund ta bëjë këtë në çdo fazë të procedimit.

*Neni 36*

### **Ndërhyrja e të tretit**

1. Çdo Palë e Lartë Kontraktuese, në çeshtjet në shqyrtim nga një Dhome ose nga Dhoma e Madhe ku kerkues është një shtetas i saj, ka të drejtë të paraqesë vërejtje me shkrim dhe të marrë pjesë në seancat dëgjimore.

2. Kryeatri i Gjykatës mund të ftojë, në interes të mireadministrimit të drejtësisë, çdo Palë të Lartë Kontraktuese, që nuk është palë në gjykim ose çdo person të interesuar, që nuk është kerkuese, të dorëzojë vërejtjet me shkrim ose të marrë pjesë në seancat dëgjimore.

*Neni 37*

### **Çrregjistrimi**

1. Në çdo fazë të procedimit, Gjykata mund të vendosë të crregjistrojë një kërkesë kur rrethanat lejojnë të arrihet në përfundimin se:

a. Kerkuese nuk ka qëllim të vazhdojë aplikimin e tij; ose

b. Mosmarreveshja është zgjidhur; ose

c. Për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk përlligj vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës. Megjithatë, Gjykata vazhdon shqyrtimin e kërkesës kur këtë e kërkon respektimi i të drejtave të njeriut të garantuara nga Konventa dhe protokollet e saj.

2. Gjykata mund të vendosë irregjistrimin e një kërkesë, kur cmon se ky përlligj nga rrethanat.



Neni 38 – Shqyrtimi me pale kundërshtare i çështjes dhe procedura e pajtimit

1. Kur Gjykata deklaron të pranueshëm një kerkese, ajo:

a. Vazhdon shqyrtimin e çështjes, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të palëve dhe, nëse është nevoja, procedon me hetimin, për mbarëvajtjen e të cilit Shtetet e interesuara duhet të krijojnë të gjitha lëhtësitë e nevojshme;

b. Vihet në shërbim të të interesuarve për të arritur zgjidhjen e çështjes me pajtim, duke respektuar të drejtat e njeriut, siç njihen nga Konventa dhe protokollet e saj.

2. Procedura e përshkruar në paragrafin 1.b është konfidenciale.

*Neni 39*

### **Arritja e zgjidhjes me pajtim**

Në rast zgjidhjeje me pajtim, Gjykata çrregjistron çështjen me vendim, i cili kufizohet në një parashtrim të shkurtër të fakteve dhe zgjidhjes së dhënë.

*Neni 40*

### **Seancat dëgjimore publike dhe e drejta për t'u njohur me dokumentet**

1. Seancat dëgjimore janë publike, përveç rasteve kur Gjykata vendos ndryshe për shkak të rrethanave përjashtimore.

2. Dokumentat që depozitohen në Sekretari janë të hapura për publikun, përveç rasteve kur Kryetari i Gjykatës vendos ndryshe.

*Neni 41*

### **Shperblimi i drejtë**

Kur Gjykata deklaron shkelje të Konventës ose protokolleve të saj, dhe e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese mundëson vetëm ndreqjen e pjeshme të pasojave të shkaktuara nga shkelja, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shperblim të drejtë palese së demtuar.

*Neni 42*

### **Vendimet e Dhomave**

Vendimet e Dhomave marrin formë të prerë sipas dispozitave të Nenit 44, paragrafi 2.

*Neni 43*

### **Kalimi Dhomës së Madhe**

1. Brenda një periudhe prej tre muajsh nga data e vendimit të

Dhomës, cdo palë në çështje mund të kërkojë, në raste prjashtimore, që çështja të dërgohet në Dhomën e Madhe.

2. Kërkesa pranohet nga nje kolegji prej pesë gjyqtarësh të Dhomës së Madhe ne qofte se çështja ngre një problem te rendesishem për interpretimin ose zbatimin e Konventës ose protokolleve të saj, ose një çështje me rëndësi të karakterit te përgjithshem.

3. Kur kolegji e pranon kërkesën, Dhoma e Madhe e zgjidh çështjen me anë të një vendimi.

*Neni 44*

### **Vendimet e formes se prere**

1. Vendimi i Dhomës së Madhe është i formes se prere.

2. Vendimi i një Dhome merr formë të prere:

a. Kur palët deklarojnë se ato nuk do të kërkojnë që çështja t'i kalojë Dhomës se Madhe; ose

b. Kur nuk është kërkuar kalimi i çështjes në Dhomën e Madhe tre muaj pas dates se vendimit; ose

c. Kur kolegji i Dhomës së Madhe e ka rrezuar kërkesën për kalimin e ceshtjes, te bere ne zbatim te Nenit 43.

3. Vendimi i formës se prere botohet. Neni 45 – Arsyetimi i vendimet

1. Vendimet e formes se prere si dhe ato qe deklarojne pranueshmerine ose papranueshmerine ekerkesave, arsyetohen.

2. Në qofte se vendimi nuk shpreh tërësisht ose pjesërisht mendimin unanimit të gjyqtarëve, çdo gjyqtar ka të drejtë t'i bashkëngjis atij, vecas, mendimin e tij në pakicë.

*Neni 46*

### **Fuqia detyruese dhe zbatimi i vendimeve**

1. Palët e Larta Kontraktuese zotohen t'u binden vendimeve te formes së prere të Gjykatës në lidhje me mosmarrëveshjet në të cilat janë palë.

2. Vendimi i formës se prere i Gjykatës i dergohet Komitetit të Ministrave, i cili mbikqyr zbatimin e tij.

*Neni 47*

### **Opinionet këshillimore**

1. Gjykata, me kërkesë te Komitetit të Ministrave, mund të japë opinione këshillimore për çështje ligjore që lidhen me interpretimin e Konventës dhe të protokolleve të saj.

2. Gjykata ose Komiteti i Ministrave nuk mund të japin opinione këshillimore për çështje që lidhen me përmbajtjen ose qëllimin e të drejtave ose lirive të përcaktuara në Titullin I të Konventës dhe në protokollin dhe as për çështje të tjera që atyre mund t'u duhet të shqyrtojnë për shkak të procedurave të filluara në përputhje me Konventën.

3. Vendimi i Komitetit të Ministrave për t'i kërkuar opinione këshillimore Gjykatës merren me votën e shumicës së përfaqësuesve që kanë të drejtë të marrin pjesë në Komitet.

*Neni 48*

### **Kompetenca këshillimore e Gjykatës**

Gjykata vendos nëse kërkesa për opinion këshillimor që paraqitet nga Komiteti i Ministrave është në kompetencën e saj, sic përcaktohet në Nenin 47.

*Neni 49*

### **Arsyetimi i opinioneve këshillimore**

1. Opinione këshillimore të Gjykatës arsyetohen.
2. Nëse opinioni këshillimor nuk shpreh tërësisht ose pjesërisht, opinionin unanimit të gjyqtarëve, çdo gjyqtar ka të drejtë t'i bashkëngjijë atij, vecas, mendimin e tij në pakicë.
3. Opini këshillimor i Gjykatës i dërgohet Komitetit të Ministrave.

[...]

**Konventa Europiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues** E hapur për nënshkrim më 26 Nëntor 1987

Hyri në fuqi më 1 Shkurt 1989 në përputhje me nenin 19

Shtetet anëtarë të Këshillit të Europës, nënshkruan këtu;

Duke marrë në konsideratë dispozitat e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave e Lirive Themelore të Njeriut,

Duke sjellë ndërmend se, sipas Nenit 3 të të njejtës Konventë, "asnjë nuk i nënshtrohet torturës apo trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor ose degradues",

Duke vërejtur se institucionet e parashikuara në këtë Konventë veprojnë për persona që pretendojnë se janë viktime të dhunimeve të Nenit 3;

Të bindur se mbrojtja e personave të privuar nga liria e tyre kundër torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor ose degradues mund

të forcohet përmes masave jo-gjyqësore me karakter parandalues mbi bazën e vizitave,

Bien dakord për sa më poshtë:

## **Kapitulli I**

### *Neni 1*

Të krijohet një Komitet European për Parandalimin e Torturës e Trajtitimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues (paskëtaj i quajtur "Komiteti"). Përmes vizitave, Komiteti shqyrton trajtimin e personave të privuar nga liria e tyre me synimin për forcimin, nëse nevojitet, e mbrojtjes së këtyre personave nga tortura dhe trajtimi ose ndëshkimi çnjerëzor apo degradues.

### *Neni 2*

Çdo Palë lejon vizita, në përputhje me këtë Konventë, në çdo vend brendajuridiksonit të saj ku personat janë të privuar nga liria e tyre prej një autoriteti publik.

### *Neni 3*

Në zbatimin e Konventës, Komiteti dhe autoritetet kompetente kombëtare të Palës së përfshirë bashkëpunojnë me njeri tjetrin.

## **Kapitulli II**

### *Neni 4*

1. Komiteti përbëhet nga një numër anëtarësh të barabartë me atë të palëve.

2. Anëtarët e Komitetit përzgjidhen ndërmjet personave me karakter të lartë moral, të njohur për autoritetin e tyre në fushën e të drejtave të njeriut ose që kanë eksperiencë profesionale në fushat e mbuluara nga kjo Konventë.

3. Dy anëtarë të Komitetit muk mund të jenë shtetas të të njejtit Shtet.

4. Anëtarët shërbejnë në cilësinë e tyre individuale, janë të pavarur dhe asnjans, dhe të disponueshëm për t'i shërbyer Komitetit në mënyrë të efektshme.

### *Neni 5*

1. Anëtarët e Komitetit zgjidhen nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës me një votë shumice të një liste emrash të hartuar

nga Byroja e Asamblesë Konsultative të Këshillit të Europës; çdo delegacion kombëtar i Palëve në Asamblenë Konsultative i propozon këto kandidatë, nga të cilët të paktën dy janë shtetas të tij.

2. E njejta procedurë ndiqet për plotësimin e vendeve bosh.

3. Anëtarët e Komitetit zgjidhen për një periudhë katërvjeçare. Ata mund të rizgjidhen vetëm një herë. Sidoqoftë, ndërmjet anëtarëve të zgjedhur në zgjedhjet e para, mandati i tre anëtarëve skadon në përfundim të dy viteve. Anëtarët, mandati i të cilëve skadon në fund të periudhës fillestare prej dy vitesh, zgjidhen me short nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve të para.

#### *Neni 6*

1. Komiteti mblidhet në praninë e kamerave. Kuorumi është i barabartë me shumicën e anëtarëve të tij. Vendimet e Komitetit merren me një shumicë të anëtarëve të pranishëm, duke iu nënshtruar dispozitave të Nenit 10, paragrafi 2.

2. Komiteti harton rregullat e veta proceduriale.

3. Sekretariati i Komitetit parashikohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

### **Kapitulli III**

#### *Neni 7*

1. Komiteti organizon vizita në vendet e përmendura në Nenin 2. Krahas vizitave periodike, Komiteti mund të organizojë vizita të tjera që ai i gjykon të nevojshme sipas rrethanave.

2. Si rregull i përgjithshëm, vizitet kryhen nga të paktën dy anëtarë të Komitetit. Komiteti, nëse e konsideron të nevojshme, mund të ndihmohet nga ekspertë dhe përkthyes.

#### *Neni 8*

1. Komiteti njofton Qeverinë e Shtetit të përfshirë mbi qëllimin e tij për të kryer një vizitë. Pas këtij njoftimi, ai mund të vizitojë në çdo kohë çdo vend të përmendur në Nenin 2.

2. Një Palë i mundëson Komitetit lehëtsirat e mëposhtëme për të kryer detyrën e tij:

a. Akses në territorin e tij dhe të drejtën për të udhëtuar pa kufizim;

b. Informacion të plotë mbi vendet ku mbahen personat e privuar nga liria e tyre;

c. Akses të pakufizuar në çdo vend ku mbahen persona të privuar nga liria e tyre, duke përfshirë të drejtën për të lëvizur brenda këtyre vendeve pa kufizim;

d. Informacione të tjera që Pala disponon e që mund të jenë të nevojshme që Komiteti të kryejë detyrën e tij. Kur kërkon këtë informacion Komiteti mban parasysh rregullat në fuqi të të drejtës së brendshme dhe etikës profesionale.

3. Komiteti mund të intervistojë në mënyrë private personat e privuar nga liria.

4. Komiteti mund të komunikojë lirshëm me çdo person që ai beson se mund të japë informacion të vlefshëm.

5. Nëse është e nevojshme, Komiteti mund t'ua komunikojë menjëherë vërejtjet e tij autoriteteve kompetente të Palës së përfshirë.

#### *Neni 9*

1. Në rrethana të veçanta, autoritetet kompetente të Palës së përfshirë mund t'i paraqesin Komitetit kundërshtimin për një vizitë në një kohë ose vend të caktuar të propozuar nga Komiteti. Ky kundërshtim mund të bëhet vetëm për arsye të mbrojtjes kombëtare, sigurisë publike, trazirave të rënda në vendin ku mbahen personat e privuar nga liria, gjendjes mjekësore të një personi ose kur është në proces një hetuesi urgjente lidhur me një krim të rëndë.

2. Pas këtyre kundërshtimeve, Komiteti dhe Pala hyjnë menjëherë në konsultime me qëllim që të sqarohet situata dhe të arrihen marrëveshje e të merren masa për t'i mundësuar Komitetit ushtrimin e funksioneve të tij me shpejtësi. Këto masa mund të përfshijnë transferimin në një vend tjetër të çdo personi që Komiteti propozoi për vizitë. Deri në kryerjen e vizitës, Pala i jep informacion Komitetit rreth personit në fjalë.

#### *Neni 10*

1. Pas çdo vizite, Komiteti përpilon një raport mbi faktet e zbuluara gjatë vizitës, duke marrë parasysh çdo vërejtje që mund të jetë bërë nga Pala e përfshirë. Ai i transmeton kësaj të fundit raportin e tij ku përfshihen edhe rekomandimet që ai i konsideron të nevojshme. Komiteti mund të konsultohet me Palën me synimin për të sugjeruar, nëse është e nevojshme, përmirësime në mbrojtjen e personave të privuar nga liria e tyre.

2. Nëse pala nuk bashkëpunon ose refuzon të përmirësojë situatën nën dritën e rekomandimeve të Komitetit, Komiteti mund të vendosë

me një shumicë prej dy të tretat e anëtarëve të tij, të bëjë publike një deklaratë mbi çështjen, pasi Palës t'i jetë dhënë mundësia të bëjë të njohura pikëpamjet e veta.

*Neni 11*

1. Informacioni i grumbulluar nga Komiteti nëlidhje me vizitën e tij, raporti i tij dhe konsultimet e tij me Palën e përfshirë janëkonfidencialë.

2. Komiteti publikon raportin e tij, sëbashku me komentet e Palës së përfshirë, sa herë që kjo kërkohet nga ajo Palë.

3. Sidoqoftë, asnjë e dhënë personale nuk publikohet pa shprehejen e pëlqimit nga personi i përfshirë.

*Neni 12*

Duke iu nënshtruar rregullave të konfidencialitetit në Nenin 11, çdo vit Komiteti i paraqet Komitetit të Ministrave një raport mbi veprimtarinë e tij i cili i përcillet AsamblesëKonsultative dhe bëhet publik.

*Neni 13*

Anëtarëve të Komitetit, ekspertëve dhe personave të tjerë që ndihmojnë Komitetin u kërkohet, që gjatë dhe pas shërbimit në detyrë, të ruajnë konfidencialitetin e fakteve ose informacioneve për të cilët ata janë bërë të ndërgjegjshëm gjatë kryerjes së funksioneve të tyre.

*Neni 14*

1. Emrat e personave që ndihmojnë Komitetin përcaktohen në njoftimin sipas Nenit 8, paragrafi 1.

2. Ekspertët veprojnë sipas udhëzimeve dhe nën autoritetin e Komitetit. Ata kanë njohuri dhe eksperiencë të veçantë në fushat e mbuluara nga kjo Konventë dhe kanë të njejtat përgjegjësi të pavarësisë, asnjësisë dhe disponueshmërisë si edhe anëtarët e Komitetit.

3. Një palë mund të deklarojë, në raste të veçanta, që një ekspert ose person tjetër i cili ndihmonKomitetin mund të mos lejohet të marrë pjesë në vizitën në një vend brenda juridiksionit të tij.

## **Kapitulli IV**

*Neni 15*

Çdo Palë informon Komitetin për emrin dhe adresën e autoritetit kompetent që merr njoftimet për Qeverinë e tij, dhe për çdo koordinator që ajo mund të caktojë.

*Neni 16*

Komiteti, anëtarët dhe ekspertët e tij të përmendur në Nenin 7, paragrafi 2, gëzojnë privilegjet e imunitetet e përcaktuara në Aneksin e kësaj Konvente.

*Neni 17*

Kjo Konventë nuk paragjykon dispozitat e të drejtës së brendshme ose ndonjë marrëveshjeje ndërkombëtare të cilat parashikojnë mbrojtje më të madhe për personat e privuar nga liria e tyre. Asgjë në këtë Konventë nuk konsiderohet si kufizim ose shmangie nga kompetencat e organeve të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut ose nga detyrimet e marra nga Palët sipas asaj Konvente. Komiteti nuk viziton vende të cilat vizitohen efektivisht nga përfaqësuesit ose delegatët e Fuqive Mbrojtëse ose Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq në mënyrë periodike sipas Konventave të Gjenevës të 12 Gushtit 1949 dhe Protokolleve Shtesë të saj të 8 Qershorit 1977.

**Kapitulli V***Neni 18*

Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga Shtetet anëtarë të Këshillit të Europës. Ajo i nënshtrohet ratifikimit, aderimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, aderimit ose miratimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

*Neni 19*

1. Kjo Konventë hyn në fuqi ditën e parë të muajit që pason përfundimin e një periudhe tremujore pas datës në të cilën shtatë Shtete anëtarë të Këshillit të Europës kanë shprehur pëlqimin e tyre për t'u lidhur nga kjo Konventë në përputhje me dispozitat e Nenit 18.

2. Për çdo Shtet anëtar që më pas shpreh pëlqimin e tij për t'u lidhur nga kjo Konventë, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë pas përfundimit të një periudhe tremujore pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, aderimit ose miratimit.

*Neni 20*

1. Çdo Shtet, në momentin e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, aderimit ose miratimit, mund të specifikojë territorin ose territoret në të cilat zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo Shtet, në çdo datë të mëvonshme, përmes një deklarate



drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të zgjerohet zbatimin e Kësaj Konvente në çdo territor tjetër që specifikohet në deklaratë. Për këtë territor Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason përfundimin e një periudhe tremujore pas datës së marrjes së kësaj deklaratë nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafeve pararendës, për çdo territor të specifikuar në këtë deklaratë, mund të tërhiqet, përmes një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja behët e efektshme në ditën e parë të muajit që pason një periudhë trmujore pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

*Neni 21*

Asnjë rezervë nuk mund të shprehet për dispozitat e kësaj Konvente.

*Neni 22*

1. Çdo palë mund të denoncojë, në çdo kohë, këtë Konventë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Ky denoncim bëhet i efektshëm në ditën e parë të muajit që pason përfundimin e një periudhe prej dymbëdhjetë muajsh pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

*Neni 23*

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton Shtetet anëtarë të Këshillit të Europës për:

- a. Çdo firmosje;
- b. Depozitimim e çdo instrumenti të ratifikimit, aderimit ose miratimit;
- c. Çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me Nenet 19 dhe 20;
- d. Çdo veprim, njoftim ose komunikatë që lidhet me këtë Konventë, përveç veprimeve të ndërmarra në zbatim të Neneve 8 dhe 10. Si dëshmitarë të kësaj, nënshkruarit, duke pasur autoritetin e duhur për këtë, nënshkruajnë këtë Konventë.

## **ANEKSI**

*Privilegjet dhe imunitetet (Neni 16)*

1. Për qëllimet e këtij aneksi, referimet për anëtarët e Komitetit përfshijnë referimet për ekspertët e përmendur në Nenin 7, paragrafi 2.
2. Anëtarët e Komitetit, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre dhe

gjatë udhëtimeve të kryera për ushtrimin e funksioneve të tyre, gëzojnë privilegjet e imunitetet e mëposhtëme:

a. Imunitet ndaj arrestimit ose ndalimit personal dhe ndaj konfiskimit të bagazheve të tyre dhe, për fjalët e thëna ose të shkruara dhe gjithë veprimet e kryera prej tyre në cilësinë e tyre zyrtare, imunitet ndaj çfarëdo lloj procesiligor;

b. Përjashtim nga çdo kufizim mbi lirinë e tyre të lëvizjes kur dalin ngavendi i tyre i banimit ose kthehen atje, dhe kur hyjnë ose dalin nga vendi në të cilin ata ushtrojnë funksionet e tyre, dhe nga regjistrimi si alienë në vendin që ata vizitojnë ose përmes të cilit ata kalojnë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

3. Gjatë udhëtimeve të kryera në ushtrim të funksioneve të tyre, anëtarëve të Komitetit, për çështje të kontrollit doganor dhe valutor, u jepen:

a. Nga Qeveria tyre, të njejtat lehtësira si ato që u jepen nëpunësve të lartë që udhëtojnë jashtë shtetit me detyrë zyrtare të përkohëshme.

b. Nga Qeveritë e Palëve të tjera, të njejtat lehtësira si ato që u jepen përfaqësuesve të Qeverive të huaja me detyrë zyrtare të përkohëshme.

4. Dokumentet e shkresat e Komitetit, për aq sa lidhen me punën e Komitetit, janë të pacënueshme. Korrespondenca zyrtare dhe komunikime të tjera zyrtare të Komitetit nuk mund të mbahen ose t'i nënshtrohen çensurës.

5. Me qëllim që për anëtarët e Komitetit të sigurohet liri e plotë shprehjeje dhe pavarësi e plotë në kryerjen e detyrave të tyre, imuniteti për fjalët e thëna ose të shkruara dhe gjithë veprimet e kryera prej tyre gjatë kryejes së detyrave të tyre vazhdon të jepet, pavarësisht nëse personat në fjalë nuk janë më të angazhuar në kryerjen e këtyre detyrave.

6. Privilegjet e imunitetet u jepen anëtarëve të Komitetit, jo për përfitime personale të vetë individëve por me qëllim që të sigurojnë ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre. Vetem Komiteti ka kompetencën të heqë imunitetin e anëtarëve të vet; ai ka jo vetëm të drejtën por është i detyruar të heqë imunitetin e një anëtari të tij në çdo rast kur, sipas bindjes së tij, imuniteti do të pengonte rrjedhën e drejtësisë, dhe kur ai mund të hiqet pa paragjykuar qëllimin për të cilin imuniteti është dhënë.

## **Konventa Europiane mbi Kompensimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme**

Hapur për nënshkrim më 24 Nëntor 1983/Hyri në fuqi më 1 Shkurt 1988 në përputhje me nenin 15

Shtetet anëtarë të Këshillit të Europës, nënshkrues këtu, Duke marrë parasysh se qëllimii Këshillit të Europës është të arrijë një unitet më të madh ndërmjet anëtarëve të tij;Duke marrë parasysh se për arsye të barazisë dhe solidaritetit social është e nevojshme të trajtohet situata e viktimave të krimeve ndërkombëtare të dhunës të cilët kanë vuajtur dëmtime trupore ose dëmtime të shëndetit e të personave nën varësinë personave të vdekur si rezultat i këtyre krimeve;

Duke marrë parasysh se është e nevojshme të futen ose zhvillohen skema për kompensimin e këtyre viktimave nga Shteti në territorin e të cilit janë kryer këto krime, veçanërisht kur shkelësi nuk është identifikuar ose kur nuk ka burime;

Duke marrë në konsideratë Rezolutën (77) 27, të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës mbi kompensimin e viktimave të krimin,

Bien dakord për sa më poshtë:

### **Pjesa I - Parimet bazë**

#### *Neni 1*

Palët angazhohen të ndërmarrin hapat e nevojshme për të vënë në zbatim parimet e përcaktuara në Pjesën I të kësaj Konvente.

#### *Neni 2*

1. Kur kompensimi nuk është tërësisht i mundur nga burime të tjera, Shteti kontribuon për të kompensuar:

- a. Ata që kanë pësuar dëmtime të rënda trupore ose dëmtime të shëndetit të cilat i detyrohen drejtpërdrejt një krimi të qëllimshëm dhune;
- b. Përsonat në varësi të personave që kanë vdekur si rezultat i këtij krimi;

2. Kompensimi jepet në rastet e sipërpermendura edhe nëse shkelësi nuk mund të ndiqet ose ndëshkohet penalisht.

#### *Neni 3*

Kompensimi u paguhet nga Shteti në territorin e të cilit është kryer krimi:

- a. Shtetasve të Shteteve palë në këtë Konventë;
- b. Shtetasve të të gjithë Shteteve anëtarë të Këshillit të Europës që janë banues të përhershëm të Shtetit në territorin e të cilit është kryer krimi.

*Neni 4*

Kompensimi mbulon, sipas rastit nën shqyrtim, të paktën zërat e mëposhtëm: humbje të fitimeve, shpenzimet mjekësore e spitalore dhe shpenzimet funerale, dhe për sa i përket personave nën varësi, humbje të mjeteve të jetesës.

[...]

Rezoluta 690 (1979) mbi Deklaratën për Policinë

Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Këshillit të Europës më 8 Maj 1979

Asambleja, [...]

4. Duke pasur bindjen se sistemi European për mbrojtjen e të drejtave të njeriut do të përmirësohej nëse do të kishte rregulla përgjithësisht të pranuar lidhur me etikën profesionale të policisë, të cilat të mbajnë parasysh parimet e të drejtave e lirive themelore të njeriut;

[...]

8. Pranon Deklaratën e mëposhtëme për Policinë, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rezolute;

[...]

#### **A. Etika**

[...]

3. Ekzekutimet pa gjyq, tortura dhe forma të tjera të trajtimit e ndëshkimit çnjerëzor ose degradues mbeten të ndaluara në të gjitha rrethanat. Një nëpunës policie ka detyrimin të mos i bindet ose të injorohë çdo urdhër ose udhëzim që përmban këto masa.

[...]

7. Asnjë veprim penal ose disiplinor nuk mund të ndërmerret kundër një nëpunësi të policisë i cili ka refuzuar zbatimin e një urdhëri të paligjshëm.

[...]

9. Një nëpunës policie është personalisht përgjegjës për veprimet e

tij dhe për aktet e veprimit ose mosveprimit që ai ka urdhëruar dhe që janë të paligjshme.

10. Do të ketë një zinxhir të qartë komande. Gjithmonë duhet të jetë e mundur të përcaktohet se cili epror mund të jetë në fund të fundit përgjegjës për aktet e veprimit ose mosveprimit të një nëpunësi të policisë.

11. Legjislacioni duhet të mundësojë një sistem garancish dhe zgjidhesh ligjore kundër çdo dëmtimi që vjen si rezultat i veprimtarisë së policisë.

[...]

## **B. STATUSI**

[...]

3. Një nëpunës policie duhet të marrë trainim të plotë të përgjithshëm, trainim profesional, dhe trainim në detyrë, si edhe instruksionin e duhur mbi problemet sociale, liritë demokratike, të drejtat e njeriut dhe në veçanti mbi Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut.

[...]

Rekomandimi Nr. R (87) 3 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtarë të Rregullave Europiane të Burgjeve Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 12 Shkurt 1987

[...]

### **Hyrje**

Qëllimet e këtyre rregullave janë:

a. Të vendosin një sërë standardesh minimale për të gjitha aspektet e administrimit të burgjeve që janë thelbësore për kushtet njerëzore dhe trajtimin pozitiv në sistemet moderne e përparimtare;

b. Të shërbejnë si nxitje për administratat e burgjeve në zhvillimin e politikave dhe stilit e praktikave menaxhuese të bazuara në parime të mira bashkëkohore të qëllimit e barazisë;

c. Të inkurajojnë tek stafet e burgjeve qëndrimet profesionale që reflektojnë cilësitë e rëndësishme morale e sociale të punës së tyre dhe të krijojnë kushtet në të cilat ata të përsosin performancën e vet për të mirën e shoqërisë në përgjithësi, të të burgosurve nën kujdesin e tyre dhe për kënaqësinë e vet profesionale;

d. Të parashtrojnë kritere reale bazë përkundrejt të cilave administrata e burgjeve dhe ata që janë përgjegjës për inspektimin

e kushteve dhe menaxhimit të burgjeve të mund të bëjnë gjykime të vlefshme për performancën dhe të matin progresin drejt standardeve më të larta. Theksohet se rregullat nuk përbëjnë një sistem model dhe se, në praktikë, shumë shërbime të burgjeve Europiane po funksionojnë tashmë shumë më mirë se standardet e përcaktuara në rregulla dhe se të tjerë po përpiqen, dhe do të vazhdojnë të përpiqen të veprojnë kështu. Kudo ku ka vështirësi ose probleme praktike që duhen kapërcyer në zbatimin e rregullave, Këshilli i Europës ka institucionet dhe ekspertizën e disponueshme për të ndihmuar me këshilla, dhe frutet e eksperiencës së administratave të ndryshme të burgjeve brenda hapësirës së tij.

Në këto rregulla, vihet theksi sërish në perceptimin e dinjitetit njerëzor, në përkushtimin e administratave të burgjeve për trajtimin njerëzor e pozitiv, në rëndësinë e roleve të stafëve dhe metodave të efektshme të menaxhimit modern. Ato janë hartuar për të ofruar referencë të gatshme, inkurajim dhe udhëheqje për ata që punojnë në të gjitha nivelet e administratës së burgjeve. Memorandumi shpjegues që shoqëron rregullat, synon të sigurojë kuptimin, pranimin dhe fleksibilitetin e nevojshëm për arritjen e nivelit më të lartë realist të zbatimit përtej standardeve bazë.

*[...] Parimi 1*

Privimi i lirisë kryhet në kushtemateriale e morale të cilat sigurojnë respektimin e dinjitetit njerëzor dhe janë në përputhje me këto rregulla.

*[...] Parimi 5*

Mbrojtja e të drejtave individuale të të burgosurve në veçanti e ligjshmërisë së ekzekutimit të masave ndaluese sigurohet me anën e një kontrolli të kryer, sipas rregullave kombëtare, nga një autoritet gjyqësor ose një organ tjetër i krijuar siç duhet, i autorizuar të vizitojnë të burgosurit dhe që nuk i përket administratës së burgjeve.

*[...] Parimi 27*

Të burgosurit nuk mund t'i nënshtrohen asnjë eksperimenti që mund të shkaktojë dëmtim fiziologjik ose moral.

*[...] Parimi 37*

Ndëshkimet kolektive, ndëshkimi trupor, ndëshkimi përmes mbylljes në një qeli të errët, dhe të gjitha ndëshkimet e egra, çnjerëzore ose degraduese ndalohen tërësisht si ndëshkime për shkelje disiplinore.

*Parimi 38*

1. Ndëshkimi përmes izolimit disiplinor dhe çdo ndëshkim tjetër

që mund të ketë një pasojë të dëmshme mbi shëndetin fizik ose mendor të të burgosurit zbatohen vetëm nëse nëpunësi mjekësor vërteton me shkrim pas egzaminimit se i burgosuri është në gjendje ta përballojë atë.

2. Në asnjë rast një ndëshkim i tillë nuk mund të jetë në kundërshtim me, ose të largohet nga, parimet e parashtruara në Rregullin 37.

3. Nëpunësi mjekësor viziton çdo ditë të burgosurit që i nënshtrohen këtyre ndëshkimeve dhe këshillon drejtorin e administratës nëse konsiderohet i nevojshëm përfundimi ose ndryshimi i ndëshkimit për shkak të shëndetit fizik ose mendor.

*Instrumentet e detyrimit Parimi 39*

Instrumentet e detyrimit, si prangat, zinxhirët, hekurat dhe xhaketat shtërnguese, nuk përdoren kurrë si ndëshkim. Për më tepër, zinxhirët ose hekurat nuk përdoren si detyrues. Ato mund të përdoren si instrumente detyrimi vetëm në rrethanat e mëposhtme:

a. Si masë parandaluese e arratisjes gjatë shpërnguljes, me kusht që ato të hiqen kur i burgosuri paraqitet para një autoriteti gjyqësor ose administrativ;

b. Për arësye mjekësore me udhëzim të nëpunësit mjekësor;

c. Me urdhër të drejtorit, nëse dështojnë metodat e tjera të kontrollit, me qëllim që të parandalohet mundësia që një i burgosur të dëmtojë veten, të tjerët ose pronën; në këto raste drejtori këshillohet menjëherë me nëpunësin mjekësor dhe raporton tek autoriteti më i lartë administrativ.

*Parimi 40*

Mënyrat e përdorimit të instrumenteve të detyrimit përcaktohen nga administrata qendrore e burgjeve. Këto instrumente nuk duhet të përdoren për kohë më të gjatë nga sa është rrëptësisht e nevojshme. Informacioni për të burgosurit dhe ankesat prej tyre

*Parimi 41*

1. Në momentin e pranimit çdo i burgosur pajiset me informacion me shkrim mbi rregulloret që drejtojnë trajtimin e të burgosurve të kategorisë së tij, kërkesatdisiplinore të institucionit, metodat e autorizuara për të kërkuar informacion dhe për të bërë ankesa, dhe çështje të tjera të nevojshme për të bërë të mundur që ai të kuptojë të drejtat dhe detyrimet e tij dhe të përshtatet me jetën në institucion.

2. Nëse një i burgosur nuk e kupton informacionin e shkruar që i jepet atij, ky informacion shpjegohet me gojë.

*Parimi 42*

1. Çdo ditë jave çdo i burgosur ka mundësi të bëjë kërkesa ose ankesa tek drejtori i institucionit ose nëpunësi i autorizuar që vepron në këtë cilësi.

2. Është e mundur që kërkesat ose ankesat t'i bëhen inspektorit të burgjeve gjatë inspektimit të tij. I burgosuri ka mundësi të flasë me inspektorin ose çdo nëpunës tjetër inspektimi pa praninë e drejtorit ose pjesëtarëve të tjerë të stafit.

3. Çdo i burgosur lejohet të bëjë kërkesë ose ankesë, pa u çensuruar për përmbajtjen por në formën e duhur, pranë administratës qendrore të burgjeve, autoritetit gjyqësor ose autoriteteve të tjerë përkatës, përmes kanaleve të miratuara. Sidoqoftë apelimet kundër vendimeve formale mund të kufizohen tek procedurat e autorizuar.

4. Çdo kërkesë ose ankesë, që i drejtohet ose i referohet një autoriteti të burgut, trajtohet menjëherë dhe merr përgjigje nga ky autoritet pa asnjë vonesë të paarësyeshme.

*Kontakti me botën e jashtme*

1. Të burgosurit lejohen, nën mbikqyrjen e nevojshme, të komunikojnë me familjen e tyre dhe, sipas nevojave të trajtimit, sigurisë dhe rregullit, me persona ose përfaqësues të organizatave nga jashtë dhe të presin vizita nga keto persona sa më shpesh që të jetë e mundur.

2. Për të inkurajuar kontaktet me botën e jashtme do të ketë një sistem të lejeve të burgut në pajtim me objektivat e trajtimit në Pjesën IV të ketyre rregullave.

*Parimi 44*

1. Të burgosurit që janë shtetas të huaj informohen pa vonesë për të drejtën e tyre për të kërkuar kontakt dhe për t'iu lejuar lehtësira komunikimi me përfaqësuesit diplomatikë ose konsullorë të shtetit të cilit ata i përkasin. Administrata e burgjeve duhet të bashkëpunojë plotësisht me këto përfaqësues në interes të shtetasve të huaj në burg që mund të kenë nevoja të veçanta.

2. Të burgosurve që janë shtetas të Shteteve pa përfaqësim diplomatik ose konsullor në atë vend dhe refugjatëve ose personave pa shtetësi u lejohen lehtësira të ngjashme për të komunikuar me përfaqësuesit diplomatikë të Shtetit që merr përsipër interesat e tyre ose me çdo autoritet kombëtar ose ndërkombëtar detyra e të cilit është të mbrojë këta persona.



[...]

*Parimi 52*

Stafi i burgjeve inkurajohet vazhdimisht përmes trainimeve, procedurave konsultative dhe stilit pozitiv të menaxhimit që të aspirojnë për standarde njerëzore, efektshmëri më të lartë dhe një metodë të përkushtuar ndaj detyrave të veta.

*Parimi 55*

1. Kur rekrutohen ose pas njëperiudhe të përshtatshme të eksperiencës praktike, personelit i bëhen kurse trainimi për detyrat e tyre të përgjithshme e të veçantadhe mund t'u kërkohet të kalojnë testime teorike e praktike, përveçse kur kjo bëhet e panevojshme nga kualifikimet e tyre profesionale.

2. Gjatë karrierës së tyre, të gjithë anëtarët e personelit ruajnë dhe përmirësojnë njohuritë e kapacitetin e tyre profesional duke ndjekur kurse të trainimit në detyrë që organizohen nga administrata në intervale të rregullta.

3. Duhet marrë masa për një eksperiencë e trainim më të gjerë për personelin, kapaciteti personal i të cilëve mund të përmirësohet me këtë.

4. Trainimi i të gjithë personelit duhet të përfshijë instruksionin mbi kërkesat dhe zbatimin e Rregullave Europiane të Burgjeve dhe Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

[...] *Parimi 63*

1. Stafi i institucioneve nuk përdor forcën kundër të burgosurve, përveç rasteve të vetëmbrojtjes dhe tentativave për arratisje, ose rezistencës fizike pasive ose aktivendaj një urdhëri të bazuar në ligj ose rregullore. Stafi që përdor forcën nuk duhet të përdorë më shumë nga sa është rreptësisht e nevojshme dhe duhet t'ia raportojë incidentin menjëherë drejtorit të institucionit.

[...]

**Rekomandimi Nr. R (98) 7 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtarë lidhur me Aspektet Etike dhe Organizative të Kujdesit Shëndetësor në Burg**

Miraturar nga Komiteti i Ministrave më 8 PriLL 1998

Komiteti i Ministrave, sipas kushteve të Nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Europës,

Duke marrë parasysh se praktika mjekësore në komunitet e në kontekstin e burgut duhet të udhëhiqet nga të njëjtat parime etike;

Indërgjegjshëm se respektimi i të drejtave themelore të të burgosurve kërkon garantim të trajtimit parandalues dhe kujdesit shëndetësor për të burgosurit të barabartë me ato që ofrohen për komunitetin në përgjithësi;

Duke pranuar se specialisti mjekësor në burg ndeshet shpesh me probleme të vështira që rrjedhin prej pretendimeve konfliktuale nga administrat e burgjeve dhe të burgosurit, pasojat e të cilëve kërkojnë që specialisti të zbatojë parime shumë të rrepta etike;

Duke marrë parasysh se është në interes të mjekut të burgut, personelit tjetër të kujdesit shëndetësor, të të burgosurve dhe të administratës së burgut që të veprojnë me një vizion të qartë për të drejtën e kujdesit shëndetësor në burg dhe rolin e veçantë të mjekut të burgut e personelit tjetër të kujdesit shëndetësor;

Duke marrë parasysh se situatat e veçanta problematike në burg si mbipopullimi, sëmundjet infektive, varësia nga droga, çrregullimet mendore, dhuna, izolimi në qeli ose kontrollet trupore, kërkojnë parime të shëndosha etike në sjelljen e praktikës mjekësore;

Duke mbajtur parasysh Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, Kartën Sociale Europiane dhe Konventën për të Drejtat e Njeriut dhe Biomedicinën;

Duke mbajtur parasysh Konventën Europiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit apo Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues, dhe rekomandimet për shërbimin e kujdesit shëndetësor në burgje të përmbledhura në raportin e 3të të përgjithshëm mbi veprimtarinë e Komitetit European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit apo Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues;

Duke iu referuar Rekomandimit Nr. R (87) 3 për Rregullat Europiane të Burgjeve të cilat ndihmojnë për të garantuar standardet minimale të humanizmit dhe dinjitetit në burgje;

Duke sjellë ndër mend Rekomandimin Nr. R (90) 3 për kërkimet mjekësore mbi qeniet njerëzore dhe Rekomandimin Nr. R (93) 6 lidhur me burgjet dhe aspektet kriminologjike të kontrollit të sëmundjeve të transmetueshme duke përfshirë Aids dhe probleme të tjera në burg, si edhe direktivat e OBSH të 1993 mbi infeksionin HIV dhe Aids në burg;

Të vëmendshëm ndaj rekomandimeve 1235 (1994) mbi psikiatrinë

dhe të drejtat e njeriut dhe 1257 (1995) mbi kushtet e paraburgimit në shtetet anëtarë të Këshillit të Europës;

Duke iu referuar Parimeve të Etikës Mjekësore për Mbrojtjen e Personave të Ndaluar dhe të Burgosurve ndaj Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të Tjera, të Egra, Çnjerëzore ose Degraduese, të pranuar nga Asambleja ePërgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 1992;

Duke iu referuar deklaratave të veçanta të Shoqatës Mjekësore Botërore (SHMB) për etikën mjekësore, në veçanti Deklaratës së Tokios (1975), Deklaratës së Maltës mbi grevat e urisë (1991) dhe Deklaratës mbi kontrollet trupore të të burgosurve (1993);

Duke mbajtur nën vëmendje reformat më të fundit në strukturën, organizimin, dhe rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor në burg në shumë shtete anëtarë, sidomos në lidhje me reformat e sistemeve të tyre të kujdesit shëndetësor;

Duke marrë në konsideratë strukturat e ndryshme administrative të shteteve anëtarë të cilat kërkojnë zbatimin e rekomandimeve në nivele federale dhe shtetërore;

Rekomandon që qeveritë e shteteve anëtarë:

- Të marrin në konsideratë, kur shqyrtojnë legjislacionin e tyre dhe në praktikën e tyre në fushën garantimit të kujdesit shëndetësor në burg, parimet e rekomandimet e parashtruara në shtojcën e këtij rekomandimi;

- Të sigurojnë përhapjen më të gjerë të mundëshme të rekomandimit dhe memorandumit shpjegues të tij, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të gjithë individëve dhe organeve përgjegjës për organizimin dhe garantimin e trajtimit parandalues dhe kujdesit shëndetësor në burg.

### **Shtojcë e Rekomandimit Nr. R (98) 7**

I. Karakteristikat kryesore të të drejtës për shëndetin në burg

A. *Aksesi tek një mjek*

1. Kur hyjnë në burg dhe më vonë kur janë në mbikqyrje, të burgosurit duhet të jenë në gjendje në çdo kohë të kenë akses tek një mjek ose një infermiere e kualifikuar, pavarësisht nga regjimi i tyre i ndalimit dhe pa vonesë të paarsyeshme, nëse këtë e kërkon gjendja e shëndetit të tyre. Të gjithë të ndaluarit duhet të përfitojnë prej egzaminimeve të përkatëse mjekësore në momentin e hyrjes. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar përcaktimit të çrregullimeve mjekësore, të përshtatjes psikologjike në

burg, të simptomave të tërheqjes që rezultojnë nga përdorimi i drogës, ilaçeve ose alkoolit, dhe të kushteve ngjitëse dhe kronike.

[...]

*C. Pëlqimi dhe konfidencialiteti ipacientit*

13. Konfidencialiteti mjekësor duhet garantuar e respektuar me tënajtën rreptësi si për popullsinë në tërësi.

14. Përveçse kur të burgosurit vuajnë nga ndonjë sëmundje që i bën të paaftë të kuptojnë natyrën e gjendjes së tyre, ata gjithmonë kanë të drejtë t'i japin mjekut pëlqimin e tyre para kryerjes së çdo egzaminimi të personit të tyre ose të produkteve të tyre trupore, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj. Arësyet e çdo egzaminimi duhet të shpjegohen qartë dhe të kuptohen nga të burgosurit. Treguesit e çdo mjekimi duhet t'u shpjegohen të burgosurve, sëbashku me efektet e mundshme anësore që ata mund të provojnë.

[...]

*D. Pavarësia profesionale*

19. Mjekët që punojnë në burg duhet t'u ofrojnë të burgosurve të njejtat standarde të kujdesit shëndetësor që u ofrohen pacientëve në komunitet. Nevojat shëndetësore të të burgosurit duhet të jenë gjithmonë shqetësismi kryesor i mjekut.

20. Vendimet klinike dhe çdo vlerësim tjetër që ka të bëjë me shëndetin e të ndaluarve duhet të udhëhiqen vetëm nga kritere mjekësore. Personeli i kujdesit shëndetësor duhet të veprojë në pavarësi të plotë brenda kufinjve të kualifikimit dhe kompetencës së vet.

[...]

II. Roli i veçantë i mjekut të burgut dhe stafit tjetër të kujdesit shëndetësor në kontekstin e ambientit të burgut

[...]

C. Forma të veçanta tëpathologjisë dhe kujdesit parandalues shëndetësor në burg

30. Çdo shenjë dhune e vërejtur gjatë kontrollit mjekësor të të burgosurve gjatë pranimit të tyre në një ndërtesë burgu duhet të dokumentohet plotësisht nga mjeku, sëbashku me deklaratimet përkatëse të të burgosurit dhe konkluzionet e mjekut. Ky informacion i vihet në dispozicion edhe administratës së burgut me pëlqimin e të burgosurit.

31. Çdo informacion mbi raste të dhunës ndaj të burgosurve, që

ndodh gjatë ndalimit, i përcillet autoriteteve përkatëse. Si rregull, një veprim i tillë ndërmerret vetëm me pëlqimin e të burgosurve në fjalë.

32. Në raste të caktuara të veçanta, dhe në çdo rast në përputhje të plotë me rregullat e etikës profesionale, pëlqimi i informuar i të burgosurit nuk duhet konsideruar si thelbësor, sidomos, nëse mjeku konsideron se ai ose ajo ka një përgjegjësi të madhe për pacientin dhe pjesën tjetër të komunitetit të burgut për të raportuar një incident të rëndë që paraqet një rrezik konkret. Shërbimi i kujdesit shëndetësor duhet të grumbullojë, nëse është e nevojshme, të dhëna periodike statistikore mbi dëmtimet e vërejtura, me synimin për t'ua komunikuar ato drejtuesve të burgut dhe ministrive të përfshira, në përputhje me legjislacionin e brendshëm për mbrojtjen e të dhënave.

[...]

III. Organizimi i kujdesit shëndetësor në burg duke iu referuar menaxhimit të disa problemeve të përbashkëta

[...]

F. Dhuna në burg: procedurat dhendëshkimet disiplinore, izolimi disiplinor, detyrimi fizik, regjimi i sigurisë së lartë

64. Të burgosurit që i tremben veprimeve të dhunës duke përfshirë dhunimet e mundshme seksuale nga të burgosurit e tjerë për çfarëdo arsyeje përkatëse, ose që së fundi janë sulmuar ose dëmtuar seksualisht nga pjesëtarë të tjerë të komunitetit të burgut, duhet të jenë në gjendje të kenë mbrojtjen e plotë të stafit mbikqyrës.

65. Roli i mjekut nuk duhet të përfshijë autorizimin ose mbështetjen e përdorimit të forcës nga stafi i burgut, të cilët duhet ta marrin vetë këtë përgjegjësi për të mbajtur disiplinën e rregullin.

66. Në rastin e një ndëshkimi me izolim disiplinor, çdo ndëshkim tjetër disiplinor ose masë tjetër sigurie që mund të ketë një pasojë negative mbi shëndetin fizik ose mendor të të burgosurit, stafi i kujdesit shëndetësor duhet të japë ndihmë ose trajtim mjekësor me kërkesën e të burgosurit ose të stafit të burgut.

### **Rekomandimi Nr. R (99) 3 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtarë mbi Harmonizimin e Rregullave lidhur me Autopsinë Mjeko-Ligjore**

Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 2 Shkurt 1999

Komiteti i Ministrave, sipas kushteve të Nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Europës,

Duke mbajtur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është të arrijë një unitet më të madh ndërmjet anëtarëve të tij;

Duke respektuar parimet e parashtruara në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave e Lirive Themelore të Njeriut dhe, sidomos, ndalimin e torturës ose trajtimit apo ndëshkimit çnjerëzor ose degradues, dhe të drejtën e jetës;

I ndërgjegjshëm se është praktikë normale që autopsitë e kryera në të gjithë Shtetet anëtarë të Këshillit të Europës të përcaktojnë shkakun e mënyrën e vdekjes për arësye mjeko-ligjore ose të tjera ose të përcaktojnë identitetin e të vdekurit;

Duke marrë parasysh rëndësinë e kompensimit për viktimat e familjet e tyre në procedime civile e penale;

Duke nënvizuar nevojën që hetimi, përshkrimi, dokumentimi fotografik dhe kampionimi gjatë autopsisë mjeko-ligjore duhet të zbatohet para së gjithash parime mjekësore e shkencore dhe njëkohësisht të marrin në konsideratë kërkesat e procedurat ligjore;

Të ndërgjegjshëm se lëvizshmëria në rritje e popullsisë në Europë dhe botë, si edhe ndërkombëtarizimi në rritje i procedimeve gjyqësore kërkojnë zbatimin e udhëzimeve uniforme mbi mënyrën e kryerjes së autopsive dhe mbi mënyrën si hartohen raportet e autopsive;

Duke marrë parasysh Marrëveshjen e Këshillit të Europës mbi Transferimin e Kufomave (Traktati Europian Nr. Serie 80) dhe duke marrë në konsideratë vështirësitë që hasen shpesh nga vendi marrës kur një kufomë riatdhesohet nga një shtet anëtar tek një tjetër;

Të ndërgjegjshëm përrëndësinë e procedurave të sakta të autopsisë, sidomos me synimin për të hedhur dritë mbi ekzekutimet e paligjshme, dhe krimet e shkaktuara nga regjimet autoritare;

Duke nënvizuar nevojën për të mbrojtur pavarësinë dhe asnjansinë e ekspertëve mjeko-ligjorë, si edhe për të vënë në dispozicion lehtësirat e nevojshme ligjore dhe teknike që ata të mund të kryejnë detyrat e tyre në mënyrën e duhur dhe për të nxitur trainimin e tyre;

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e simeve kombëtare të kontrollit të cilësisë për sigurimin e performancës së autopsive mjeko-ligjore;

Duke nënvizuar nevojën për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar me synimin për harmonizimin e vazhdueshëm të procedurave të autopsisë mjeko-ligjore në nivel Europian;

Duke marrë parasysh Rekomandimin 1159 (1991) mbi harmonizimin e rregullave të autopsisë, të miratuar në Sesionin e saj të 43të Zakonshëm nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës;

Duke marrë parasysh Protokollin e Autopsisë Model të Kombeve të Bashkuara, të nënshkruar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 1991;

Duke marrë në konsideratë “guidën për identifikimin e viktimave të katastrofave” të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol) në 1997,

1. U rekomandon qeverive të shtetve anëtarë:

i. Të zbatojnë si standarde të brendshme të vetat parimet dhe rregullat që përfshihen në këtë rekomandim;

ii. Të ndërmarrin ose forcojnë, sipas rastit, të gjitha masat e nevojshme me synimin për zbatimin e vazhdueshëm të parimeve dhe rregullave që përfshihen në këtë rekomandim;

iii. Të ngrenë një program të sigurimit të cilësisë për të garantuar zbatimin e duhur të parimeve e rregullave që përfshihen në këtë rekomandim.

2. Fton qeveritë e shteteve anëtarë

të informojnë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës me kërkesën e tij/saj mbi masat e marra për zbatimin e parimeve e rregullave që përfshihen në këtë rekomandim.

Parimet dhe rregullat që lidhen me procedurat e autopsisë mjekoligjore

Hapësira e rekomandimit

1. Në rastet kur vdekja mund të vijë nga shkaqe jo natyrore, autoriteti kompetent, i shoqëruar nga një ose më shumë ekspertë mjekoligjorë, duhet të hetojë vendin, kur është e nevojshme, të egzaminojë trupin dhe të vendosë nëse duhet kryer autopsia.

2. Autopsitë duhet të kryhen në të gjitha vdekjet jo natyrore të qarta ose të dyshuara, edhe kur ka vonesë midis vdekjes dhe ngjarjeve që e shkaktuan atë, në veçanti:

[...]

c. Dhunim të të drejtave të njeriut, si dyshimi për torturë ose çdo formë tjetër të keqtrajtimit;

[...]

**Tekste të miratuara nga OSBE/KSBE**

**Dokumenti Përfundimtar i Mbledhjes së Tretë/Vienë, Austri, 15 Janar 1989**

[...]

23. Shtetet pjesëmarrës:

23.1 – sigurojnë që askush të mos i nënshtrohet arrestimit, ndalimit ose mërgimit;

23.2 – sigurojnë që të gjithë individët nën ndalim ose burgim të trajtohen me humanizëm dhe respekt për dinjitetin e qenësishëm të qenies njerëzore;

23.3 – zbatojnë Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të Burgosurve si edhe Kodin e Sjelljes të Kombeve të Bahkuara për Nëpunësit Ligjzbatues;

23.4 – ndalojnë torturën dhe trajtimet apo ndëshkimet e tjera, të egra, çnjerëzore ose degraduese dhe të marrin masa të efektshme ligjore, administrative, gjyqësore dhe masa të tjera për parandalimin dhe ndëshkimin e praktikave të tilla;

23.5 – shqyrtojnë pjesëmarrjen në Konventën kundër Torturës e Trajtimeve apo Ndëshkimeve të Tjera, të Egra, Çnjerëzore ose Degraduese, nëse nuk e kanë bërë këtë;

23.6 – mbrojnë individët nga çdo praktikë psikiatrike ose praktika të tjera mjekësore që shkelin të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe marrin masa të efektshme për parandalimin dhe ndëshkimin e praktikave të tilla.

[...]

**Dokumenti i Mbledhjes së Kopenhagenit të Konferencës mbi Dimensionet Njerëzore të OSBEKopenhagen, 29 Qershor 1990 [...]**

16. Shtetet pjesëmarrës

16.1 – riafirmojnë angazhimin e tyre për ndalimin e torturës dhe trajtimeve apo ndëshkimeve të tjera, të egra, çnjerëzore ose degraduese, marrjen e masave të efektive ligjore, administrative, gjyqësore ose masave të tjera për parandalimin dhe ndëshkimin e këtyre praktikave, për mbrojtjen e individëve nga çdo praktikë psikiatrike ose praktikë tjetër mjekësore që dhunon të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe për marrjen e masave të efektshme për parandalimin e ndëshkimin e praktikave të tilla;



16.2 - synojnë, me urgjencë, të shqyrtojnë pjesëmarrjen në Konventën kundër Torturës e Trajtimeve apo Ndëshkimeve të Tjera, të Egra, Çnjerëzore ose Degraduese, nëse nuk e kanë bërë këtë, dhe njohjen e kompetencës së Komitetit kundër Torturës sipas nenit 21 dhe 22 të Konventës dhe tërheqjen e rezervave lidhur me kompetencën e Komitetit sipas nenit 20;

16.3 - theksojnë se asnjë rrethanë e veçantë ciladoqoftë, gjendje lufte ose kërcënim për luftë, mos-stabilitet ibrendshëm politik ose çdo emergjencë tjetër publike, nuk mund të përdoret si justifikim për torturë;

16.4 - sigurojnë që edukimi dhe informimi mbi ndalimin e torturës të përfshihen plotësisht në trainimin e personelit ligjzbatues, civil ose ushtarak, personelit mjekësor, nëpunësve publikë dhe personave të tjerë që mund të përfshihen në mbikqyrjen, hetimin ose trajtimin e çdo individi që i nënshtrohet çdo forme të arresitmit, ndalimit ose burgimit;

16.5 - mbajnë nën shqyrtim sistematik rregullat, udhëzimet, metodat e praktikat e hetimit si edhe masat për mbikqyrjen dhe trajtimin e personave që i nënshtrohen çdo forme të arresitmit, ndalimit ose burgimit në çdo territor nën juridiksionin e tyre, me synimin për parandalimin e rasteve të torturës;

16.6 - japin përparësi për shqyrtim dhe veprim të përshtatshëm, në përputhje me masat e procedurat e pranuar për zbatimin e efektshëm të angazhimeve që lidhen me dimensionin njerëzor të KSBE, çdo rasti të torturës dhe trajtimeve apo ndëshkimeve të tjera çnjerëzore ose degraduese që u bëhet i ditur atyre përmes kanaleve zyrtare ose që vjen nga çdo burim tjetër i besueshëm informacioni.

16.7 - veprojnë me bindjen se ruajtja dhe garantimi i jetës dhe sigurisë së çdo individi që i nënshtrohet çdo forme të torturës dhe trajtimeve apo ndëshkimeve të tjera çnjerëzore ose degraduese, është kriteri i vetëm në përcaktimin e urgjencës dhe përparësive që duhen dhënë kur ndërmerret një veprim i posaçëm për zgjidhje; dhe, prandaj, shqyrtimi i çdo rasti të torturës dhe trajtimeve apo ndëshkimeve të tjera çnjerëzore ose degraduese brenda kuadrit të çdo organi ose mekanizmi tjetër ndërkombëtar nuk mund të përdoret si një arsye për të mos shqyrtuar ose për të mos ndërmarrë veprimet e duhura në përputhje me masat e procedurat e pranuar për zbatimin e efektshëm të angazhimeve që lidhen me dimensionin njerëzor të KSBE.

## Dokumenti i Mbledhjes së Moskës të Konferencës mbi Dimensionin Njerëzor të OSBE

Moskë, 3 tetor 1991

[...]

23. Shtetet pjesëmarrës i trajtojnë të gjithë personat e privuar nga liria e tyre me humanizëm dhe respekt për dinjitetin e qenësishëm të qenies njerëzore dhe respektojnë standardet e njohura ndërkombëtarisht që lidhen me dhënien e drejtësisë dhe të drejtat njerëzore të të ndaluarve.

23.1 Shtetet pjesëmarrës sigurojnë që:

i. Askush nuk privohet nga liria e tij përveçse për ato arsye e në përputhje me ato procedura që

përcaktohen me ligj;

ii. Cilido që arrestohet informohet menjëherë në një gjuhë që ai kupton, mbi arsyet për arrestimin e tij, dhe informohet për akuzat kundër tij;

iii. Çdo person që është privuar nga liria e tij ka të drejtën të informohet menjëherë për të drejtat e tij sipas të drejtës së brendshme;

iv. Çdo person i arrestuar ose ndaluar ka të drejtën të nxirret menjëherë para një gjyqtari ose nëpunësi tjetër të autorizuar me ligj për të përcaktuar ligjshmërinë e arrestimit ose ndalimit të tij, dhe lirohet pa vonesë nëse ai është i paligjshëm;

v. Cilido që akuzohet për një shkelje penale ka të drejtën të mbrohet vetë osepërmes ndihmës ligjore që ai zgjedh vetë ose, nëse nuk ka mjetet e nevojshme për të paguar ndihmën ligjore, ajo t'i jepet falas kur kjo kërkohet nga interesat e drejtësisë;

vi. Çdo person i arrestuar ose ndaluar ka të drejtë, pa vonesa të paarsyeshme, të njoftojë, ose t'i kërkojë autoritetit kompetent të njoftojë personat e duhur për arrestimin, ndalimin ose burgimin dhe vendndodhjen e tij; çdo kufizim në ushtrimin e kësaj të drejte parashikohet me ligj dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare;

vii. Masa të efektshme ndërmerren, nëse kjo nuk është bërë akoma, për bërë të mundur që organet ligjzbatuese të mos përfitojnë në mënyrë të parregullt nga situata e personave të ndaluar ose të burgosur me qëllim që t'i detyrojnë ata të rrefejnë, ose përndryshe të inkriminojnë veten, ose t'i detyrojnë ata të dëshmojnë kundër çdo personi tjetër;

viii. Kohëzgjatja seancave të hetuesisë dhe intervalet ndërmjet tyre dokumentohen dhe vertetohen sipas të drejtës së brendshme;

ix. Një person i ndaluar ose avokati i tij ka të drejtë të bëjë kërkesë ose ankesë lidhur me trajtimin e tij, në veçanti kur është ushtruar torturë ose trajtim apo ndëshkim tjetër i egër, çnjerëzor ose degradues, pranë autoriteteve përgjegjës për administrimin e vendit të ndalimit dhe pranë autoriteteve më të larta, dhe kur është e nevojshme, pranë autoriteteve që kanë fuqi shqyrtuese ose zgjidhëse;

x. Kjo kërkesë ose ankesë trajtohet menjëherë dhe merr përgjigje pa vonesë ta paarsyeshme; nëse kërkesa ose ankesa refuzohet, ose në rastin e një vonese të parregullt, ankuesi ka të drejtë ta përcjellë atë tek një autoritet gjyqësor ose tjetër; personi i ndaluar apo i burgosur dhe asnjë ankues nuk paragjykohet për shkak se ka bërë një kërkesë ose ankesë;

xi. Cilido që ka qenë viktimë e një arrestimi ose ndalimi të paligjshëm ka të drejtën e zbatueshme me ligj të kërkojë kompensim.

#### 23.2 – Shtetet pjesëmarrës:

i. Do të përpiqen për të marrë masa, sipas nevojës, përpërmirësimin e kushteve të individëve nën ndalim ose burgim;

ii. Do t'i kushtojnë vëmendje të veçantë çështjes së alternativave të burgimit.

### **Karta për Sigurinë Europiane Stamboll, 19 Nëntor 1999**

#### **II THEMELET TONA TË PËRBASHKËTA**

7. Ne riafirmojmë aderimin tonë të plotë në Kartën e Kombeve të Bashkuara, dhe në Aktin Final Të Helsinshit, Kartën e Parisit dhe dokumente të tjerë të OSBE për të cilët në kemi rënë dakord. Këto dokumente përfaqësojnë angazhimet tona të përbashkëta dhe janë themeli i punës sonë. Ato na kanë ndihmuar për t'i dhënë fund konformimit të vjetër në Europë dhe për të nxitur një epokë të re të demokracisë, paqes dhe solidaritetit gjatë gjithë epokës së OSBE. Ato përcaktojnë standarde të qarta për trajtimin që Shtetet pjesëmarrës i bëjnë njeri-tjetrit dhe gjithë individëve brenda territorit të tyre. Të gjitha angazhimet e OSBE, pa përjashtim, zbatohen në mënyrë të barabartë për çdo Shtet pjesëmarrës. Zbatimi i tyre në mirëbesim është thelbësor për marrëdhëniet ndërmjet Shteteve, ndërmjet qeverive dhe popujve të tyre, si edhe ndërmjet organizatave, anëtarë të cilave ata janë. Shtetet pjesëmarrës janë përgjegjës para qytetarëve të vet dhe ndaj njeri tjetrit për zbatimin e angazhimeve të tyre të OSBE. Ne i konsiderojmë këtoangazhime si arritjet tona të

përbashkëta dhe prandaj i konsiderojmë ato çështje të një interesi imediat dhe të ligjshëm të të gjithë Shteteve pjesëmarrës.

[...]

#### DIMENSIONI NJERËZOR

19. Ne riafirmojmë se respekti për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës është thelbi i konceptit gjithpërfshirës të sigurisë së OSBE. Në angazhohemi të përballojmë kërcënime të tilla ndaj sigurisë, si shkeljet e të drejtave e lirive themelore të njeriut, duke përfshirë lirinë e mendimit, të ndërgjegjes, fesë ose besimit, dhe shprehjet e intolerancës, nacionalizmit agresiv, racizmit, ksenofobisë dhe anti-Semitizmit.

[...]

21. Në jemi të angazhuar të çrrenosim torturën dhe trajtimin apo ndëshkimin e egër, çnjerëzor ose degradues nga e gjithë hapësira e OSBE. Për këtë qëllim, ne do të nxitim legjislacionin që parashikon garanci dhe zgjidhje proceduriale e të prekshme për të luftuar këto praktika. Ne do të ndihmojmë viktimat e do të bashkëpunojmë si duhet me organizatat përkatëse ndërkombëtare dhe organizatat joqeveritare.

### Tekste të miratuara nga Bashkimi Europian

#### Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian

Nicë, Francë, 7 Dhjetor 2000

publikisht dhe brenda një kohe të arësyeshme nga një gjykatë e pavarur e paanshme, e krijuar me ligj. Cdo person ka mundësinë të këshillohet, mbrohet dhe përfaqësohet. Ndihmë ligjore u jepet atyre që nuk kanë mjetet e mjaftueshme për aq sa kjo ndihmë është e nevojshme për të siguruar akses të efektshëm në drejtësi.

## KAPITULLI VII

### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### KAPITULLI I

#### DINJITETI

##### *Neni 1*

##### *Dinjiteti njerëzor*

Dinjiteti njerëzor është i pacënueshëm. Ai duhet respektuar dhe mbrojtur.

[...]

*Neni 4*

Ndalimi i torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor ose degradues

Askush nuk i nënshtrohet torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor ose degradues.

[...]

## **KAPITULLI VI**

### **DREJTËSIA**

*Neni 47*

#### **E drejta për ankim efektiv dhe proces të rregullt**

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara nga e drejta e Bashkimit, ka të drejtën e një ankimi efektiv para një gjykate në përputhje me kushtet e parashtruara në këtë Nen. Cdo person ka të drejtë që ceshtja e tij të degjohet drejtesisht,

*Neni 51*

#### **Hapësira**

1. Dispozitat e kësaj Karte u drejtohen institucioneve dhe organeve të Bashkimit me konsideratën e duhur për parimin e subsidiarititetit dhe Shteteve Anëtarë vetëm kur ato zbatojnë të drejtën e Bashkimit. Prandaj ato respektojnë të drejtat, zbatojnë parimet dhe nxitin zbatimin e tyre në përputhje me kompetencat e tyre përkatëse.

2. Kjo Kartë nuk krijon ndonjë kompetencë ose detyrë të re për Komunitetin ose Bashkimin, e as nuk ndryshon kompetencat edetyrat e përcaktuara nga Traktatet.

*Neni 52*

#### **Hapësira e të drejtave të garantuara**

1. Çdo kufizim në ushtrimin e të drejtave e lirive të njohura nga kjo Kartë duhet të parashikohet me ligj dhe të respektojë thelbin e atyre të drejtave e lirive. Duke iu nënshtroar parimit të proporcionalitetit, kufizime mund të bëhen vetëm nëse ato janë të nevojshme dhe plotësojnë objektiva me interes të përgjithshëm të njohura nga Bashkimi ose nevojën për të mbrojtur të drejtat e liritë e të tjerëve.

2. Të drejtat e njohura nga kjo Kartë të cilat bazohen në Traktatet e Komunitetit ose Traktatet e Bashkimit European ushtrohen sipas kushteve dhe brenda kufinjve të përcaktuara nga këto Traktate.

3. Përderisa kjo Kartë përmban të drejta që i korrespondojnë të drejtave të garantuara nga Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave e Lirive Themelore të Njeriut, kuptimi e hapësira e këtyre të drejtave është e njëjtë me ato të parashtruara nga Konventa në fjalë. Kjo dispozitë nuk ndalon të drejtën e Bashkimit për të ofruar një mbrojtje më të gjerë.

*Neni 53*

### **Niveli i mbrojtjes**

Asnjë dispozitë e kësaj Karte nuk mund të interpretohet si kufizim ose dëmtim i të drejtave e lirive themelore të njeriut të njohura, në fushat përkatëse të zbatimit, nga e drejta e Bashkimit dhe e drejta ndërkombëtare dhe nga marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Bashkimi, Komuniteti ose Shtetet Anëtarë janë palë, duke përfshirë Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave e Lirive Themelore të Njeriut, dhe nga kushtetutat e Shteteve Anëtarë.

*Neni 54*

### **Ndalimi i abuzimit me të drejtat**

Asgjë në këtë Kartë nuk interpretohet se nënkupton ndonjë të drejtë për t'u përfshirë në ndonjë veprimtari ose për të kryer ndonjë veprim që synon shkatërrimin e ndonjerës nga të drejtat e liritë e njohura në këtë Kartë ose kufizimin e tyre në një masë më tëmadhe nga sa parashikohet këtu.

## **Udhëzime për politikën e BE ndaj vendeve të treta mbi torturën dhe trajtimet ose ndëshkimet e tjera të egra, çnjerëzore ose degraduese**

Miratur nga Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme, Luksemburg, 9 Pri!! 2001

*Qëllimi*

Qëllimi i këtyre udhëzimeve është që t'i japin BE-se një mjet veprimi që mund të përdoret në kontaktet me vendet e treta në të gjitha nivelet si edhe në forumetshumëpalëshe të të drejtave të njeriut për të mbështetur e forcuar përpjekjet e vazhdueshme për parandalimin dhe çrrënjosjen e torturës dhe keqtrajtimin në të gjitha pjesët e botës. Termi "torturë" përdoret në këto udhëzime në përputhje me përkufizimin e bërë në Nenin 1 të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të Tjera të Egra, Çnjerëzore ose Degraduese. Për qëllimet e këtyre udhëzimeve, keqtrajtimi nënkupton të gjitha format e trajtimit ose ndëshkimit të egër, çnjerëzor ose degradues, duke përfshirë ndëshkimin

trupor, i cili e privon individin nga integriteti i tij fizik e mendor. Ndërsa trajtimi i shqetësimeve të veçanta mbi torturën dhe keqtrajtimin është qëllimi kryesor, udhëzimet gjithashtu kontribuojnë edhe për forcimin e politikës së BE-se për të drejtat e njeriut në përgjithësi.

### *Hyrje*

Bashkimi European mbeshtetet mbi parimet e lirisë, demokracisë, respektit për të drejtat e liritë themelore të njeriut, dhe shtetin e të drejtës. Këto parime janë të përbashkëta për Shtetet Anëtarë. Respekti për të drejtat e njeriut është ndër objektivat kryesorë të politikës së jashtme e të sigurisë së përbashkët të BE-se.

Tortura dhe keqtrajtimi janë ndër shkeljet më të rënda të të drejtave të njeriut e të dinjitetit njerëzor. Sipas Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut askush nuk i nënshtrohet torturës ose trajtimit apo ndëshkimit të egër, çnjerëzor ose degradues. E drejta ndërkombëtare nuk lejon asnjë përjashtim. Të gjitha vendet janë të detyruara të pajtohen me ndalimin e pakushtëzuar të të gjitha formave të torturës dhe keqtrajtimit. Megjithë përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar, tortura e keqtrajtimi vazhdojnë në të gjitha anët e botës. Mosndëshkimi i shkaktarëve të torturës dhe keqtrajtimit vazhdon të mbizotërojë në shumë vende.

Puna për parandalimin dhe çrrënjosjen e të gjitha formave të torturës dhe keqtrajtimit brenda BE-se dhe në botë është një pikëpamje politike e mbështetur fuqishëm nga shtetet anëtarë të BE-se. Nxitja dhe mbrojtja e kësaj të drejte është përparësi e politikës së BE-se për të drejtat e njeriut.

Në punën e tij për parandalimin dhe çrrënjosjen e torturës dhe keqtrajtimit BE-ja udhëhiqet nga normat dhe standardet rajonale e ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, dhënien e drejtësisë dhe menaxhimin e konflikteve të armatosura, duke përfshirë ndër të tjera, ato që përfshihen në instrumentet e mëposhtme:

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

- Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile e Politike (ICCPR) dhe dy Protokollat Opsionale të tij

Një listë shtesë e normave e standardeve përkatëse që BE mund të përdorë në kontaktet e saj me vende të treta jepet në Aneksin e udhëzimeve.

### *Nisma të tjera Bashkimi European:*

- Do të vazhdojë ta ngrejë çështjen e torturës dhe keqtrajtimit në

forumet ndërkombëtare, si Kombet e Bashkuara, Këshilli i Europës dhe OSBE. Bashkimi Europian do të vazhdojë të mbështesë aktivisht rezolutat përkatëse të organeve të Kombeve të Bashkuara duke përfshirë Asamblenë e Përgjithshme dhe Komisionin e të Drejtave të Njeriut;

- Do të mbështesë mekanizmat përkatës ndërkombëtarë e rajonalë (p.sh. Komitetin kundër Torturës, Komitetin Europian për Parandalimin e Torturës, Raportuesit Specialë përkatës) dhe do të theksojë nevojën që shtetet të bashkëpunojnë me keto mekanizma;

- Do të mbështesë Fondin Vullnetar të Kombeve të Bashkuara për Viktimat e Torturës dhe do të inkurajojë vendet e tjera që të veprojnë kështu;

- Do të ofrojë bashkëpunim të përbashkët ose dypalësh për parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit;

- Do të mbështesë arsimin publik dhe fushatat ndërgjegjësuese kundër torturës e keqtrajtimit;

- Do të mbështesë punën e OJF-ve përkatëse kombëtare e ndërkombëtare për të luftuar torturën dhe keqtrajtimin dhe do të vazhdojë dialogun me to;

- Do të vazhdojë të financojë projektet që ndërmerren për përmirësimin e trainimit të personelit dhe kushteve në vendet e ndalimit dhe do të vazhdojë mbështetjen e tij thelbësore për qendrat e rehabilitimit të viktimave të torturës në të gjithë botën.

### *Aneks*

Krahas listës së instrumenteve të përfshirë në pjesën hyrëse të udhëzimeve, Bashkimi Europian mund të përdorë, kur duhet, normat dhe parimet e mëposhtme në kontaktet e tij me vendet e treta në lidhje me torturën e keqtrajtimit.

- Deklaratën e Kombeve të Bashkuara mbi Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Nënshtrimi ndaj Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve të Tjera, të Egra, Çnjerëzore ose Degraduese- Deklaratën e Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e Dhunës ndaj Grave

- Deklaratën e Kombeve të Bashkuara mbi Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukjet e Detyruara

- Deklaratën e Kombeve të Bashkuara lidhur me Statusin e Refugjatëve

- Parimet e Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin dhe Hetimin



Efektiv të Ekzekutimeve të Paligjshme, Arbitrare dhe pa procesgjyqesor

- Rregullat Standarde Minimale për Trajtimin e të Burgosurve-Parimet Bazë të Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të Burgosurve

- Paketën e Parimeve të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Gjithë Personave

nën çdo Formë Ndalimi ose Burgimi

- Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e Femijeve të Privuar nga Liria e tyre

- Deklaratën e Kombeve të Bashkuara mbi Parimet Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit me Pushtetin

- Parimet Bazë të Kombeve të Bashkuara mbi Pavarësinë e Gjyqësorit

- Patimet Bazë të Kombeve të Bashkuara mbi Rolin e Avokatëve

- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara mbi Rolin e Prokurorëve

- Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara mbi Masat Jo-Mbikqyrëse

- Kodin e Kombeve të Bashkuara për Sjelljen e Nëpunësve Ligjzbatues

- Parimet Bazë të Kombeve të Bashkuara mbi Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit nga Nëpunësit Ligjzbatues

- Parimet e Kombeve të Bashkuara mbi Etikën Mjekësore të nevojshme për Personelin Mjekësor, sidomos Mjekët, në Mbrojtjen e të Burgosurve dhe të Ndaluarvendaj Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve të Tjera të Egra, Çnjerëzore ose Degraduese

- Parimet e Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Dokumentimin Efektiv të Ekzekutimeve të Paligjshme, Arbitrare dhe pa procesgjyqesor

- Parimet mbi Hetimin dhe Dokumentimin Efektiv të Torturës e Trajtimeve apo Ndëshkimeve të Tjera të Egra, Çnjerëzore ose Degraduese (Protokolli i Stambollit) të aneksuara në rezolutën 2000/ 43 të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut

- Garancitë që sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të atyre që përballen me dënimin me vdekje (rezoluta 1984/50 e ECOSOC)

- Deklaratën dhe Programin e Veprimit të Vienës

- Komentet e Përgjithshme nga Komiteti i të Drejtave të Njeriut i Kombeve të Bashkuara, sidomos Komentin Nr. 20 mbi Nenin 7 dhe Nr. 21 mbi Nenin 10 të Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile e Politike

- Rekomandimin e Përgjithshëm Nr. 19 të Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave

- Kartën Afrikane të të Drejtave të Njeriut e të Popujve
- Kartën Afrikane të të Drejtave dhe Mirëqenies së Fëmijës - Konventën Amerikane të të Drejtave të Njeriut
- Konventën Ndër-Amerikane për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Torturës
- Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës:
- Nr. R (87) 3 Rregullat Europiane të Burgjeve
- Nr. R (98) 7 Lidhur me aspektet etike e organizative të kujdesitshëndetësor në burg
- Nr. R (99) 3 Mbi Harmonizimin e Rregullave të Autopsisë Mjeko-Ligjore
- Nr. R (99) 2 Mbi Mbiipopullimin e Burgjeve dhe Inflacionin e popullsisë së burgjeve.



## 1. MBI KONVENTEN KUNDER TORTURES (CAT) DHE LEGJISLACIONIN SHQIPTAR

### A. Hyrje

Republika e Shqipërisë aderoi në Konventën kundër Torturës dhe Dënimeve, a Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore, ose Degraduese me ligjin nr. 7727, datë 30.06.1993, shpallur me dekretin nr. 592, datë 06.07.1993 të Presidentit të Republikës. Konventa hyri në fuqi në Republikën e Shqipërisë më 11 maj 1994.

### B. Kuadri i përgjithshëm ligjor

Të drejtat dhe liritë e njeriut parashikohen në Pjesën II të Kushtetutës (nenet 15-63). Ndërsa dispozita kryesore në lidhje me mbrojtjen ndaj torturës dhe dënimeve, a trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore, ose degraduese është neni 25 i saj i cili parashikon se “askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues”. Më tej, neni 26 parashikon se “Askujt nuk mund t’i kërkohet të kryejë një punë të detyruar, përveçse në rastet e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, të kryerjes së shërbimit ushtarak, të një shërbimi që rrjedh nga një gjendje lufte, nga një gjendje e jashtëzakonshme ose nga një fatkeqësi natyrore, që kërcënon jetën ose shëndetin e njerëzve”.

Sipas nenit 4 të Kushtetutës “B drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit”. Në të njëjtën mënyrë neni 15/1 parashikon se “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të

patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”.

Sipas nenit 18 “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.

Sipas nenit 28 të Kushtetutës, “Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personi, të cilit i është hequr liria, duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin, si dhe t’i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij. Personi, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, paragrafi 2, nënparagrafi c, duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimimin e tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim. I paraburgosuri ka të drejtë të ankohet kundër vendimit të gjyqtarit. Ai ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të procedohet i lirë përkundrejt një garancie pasurore sipas ligjit. Në të gjitha rastet e tjera, personi, të cilit i hiqet liria në rrugë jashtëgjyqësore, mund t’i drejtohet në çdo kohë gjyqtarit, i cili vendos brenda 48 orëve për ligjshmërinë e kësaj mase. Çdo person, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij.

Sipas nenit 42/2 të Kushtetutës “Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”. Në vijim neni 43 dhe 44 garantojnë se “Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe”. Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore”.

“Kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t’u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj” (neni 48 i Kushtetutës).

Organizimi i sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë

parashikohet në pjesën e Ix të Kushtetutës, nenet 135-147. Sipas nenit 135 "Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj. Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata për fusha të veçanta, por në asnjë rast gjykata të jashtëzakonshme". Më tej organizimi i pushtetit gjyqësor rregullohet me ligjin nr. 8436, datë 28.12.1998 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar me ligjin nr. 8546, datë 05.11.1999 dhe me ligjin nr. 8656, datë 31. 07. 2000.

Një nga ligjet kryesore të miratuara nga Kuvendi në vitin 2002 është ligji "Mbi Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë". Ky ligj parashikon strukturën më të nevojshme ligjore, kompetencat, përbërjen, organizimin dhe procedurat e punës të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) për ushtrimin e dy kompetencave kryesore:

Emërimi, transferimi dhe karriera e gjyqtarëve dhe, Procedurat disiplinore dhe masat kundër gjyqtarëve.

Ky ligj po ashtu parashikon marrëdhëniet, rolin dhe përgjegjësitë e Zv/Kryetarit të KLD dhe Ministrit të Drejtësisë mbi çështjet e përmendura më sipër.

Në fushën penale me qëllim përfaqshjen me dispozitat e Kushtetutës (miratuar në Nëntor 1998), mbështetur në problemet e evidentuara gjatë periudhës 5-vjeçare të zbatimit, përvojës së fituar si dhe pranimin nga Shqipëria të një numri të konsiderueshëm të instrumentave ndërkombëtarë të bashkëpunimit në fushën penale pas një procesi intensiv dhe gjithpërfshirës legjislativ gjatë 2001 janë miratuar nga Kuvendi amendamente të rëndësishme dhe voluminoze në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe në Kodin Penal Ushtarak.

Qëllimi kryesor i këtyre amendamenteve është përmirësimi i procedurave të hetimit dhe të gjykimit të çështjeve penale që ndiqen në gjykatë, minimizimin e zvarritjeve, rritjen e efektivitet të veprimeve që kryejnë dhe palët në proces dhe gjykatat dhe vendosjen e disa normave ligjore bazë për ngritjen dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë është një nga ligjet më të rëndësishme të sistemit ligjor shqiptar. Ky Kod u miratua më datë 27.01.1995 në kuadër të reformës së përgjithshme në sistemin ligjor shqiptar. Kodi ka pësuar ndryshime të rëndësishme me ligjin nr.8175, datë 23.12.1996, ligjin nr. 8204, datë 10.4.1997 dhe ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001.

Sipas nenit 1/a të Kodit Penal, "Kodi Penal bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në parimet e përgjithshme të së drejtës penale ndërkombëtare, si dhe në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar. Legjislacioni penal përbëhet nga ky Kod dhe ligje të tjera që parashikojnë vepra penale".

Sipas nenit 9 të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim", "qëllimi i dënimit për të dënuarit është realizimi i një trajtimi që synon riedukimin për integrimin e tyre në jetën shoqërore".

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është organi qendror që organizon, drejton dhe kontrollon institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe organizmat e veprimtarive ndihmëse. Drejtoria e Përgjithshme realizon detyrën e saj në bazë të ligjit "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim", rregullores së përgjithshme të burgjeve, urdhrave dhe udhëzimeve të ministrit të Drejtësisë, si dhe të gjitha akteve të tjera ligjore dhe nënligjore që përmbajnë rregulla për to. Drejtori i institucionit organizon dhe kontrollon si më sipër veprimtarinë në institucionin përkatës dhe përgjigjet për ekzekutimin e vendimeve penale në të.

Trajtimi i të dënuarve duhet të bëhet sipas kriterit të individualizimit në përputhje me gjendjen dhe karakteristikat individuale të secilit të dënuar. Individualizimi bëhet duke verifikuar nevojat individuale dhe duke marrë parasysh kushtet dhe mjedisin në të cilin i dënuari ka jetuar, shkaqet edukative dhe shoqërore që e kanë larguar atë nga jeta normale. Vëzhgimi bëhet në fillim të trajtimit dhe rezultatet e tij verifikohen vazhdimisht gjatë ekzekutimit, duke bërë përshtatjet e duhura.

Vëzhgimi, programimi dhe realizimi i trajtimit bëhet nga administrata e burgut me anë të personelit të vet, në bashkëpunim me organet dhe institucionet shtetërore përkatëse. Kontributi i organizatave joqeveritare dhe individëve të veçantë, inkurajohet dhe mbështetet nga administrata e burgjeve në realizimin e programit të trajtimit.

Sipas nenit 48 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve dhe përcaktimeve të

parashikuara në rregulloret e institucioneve të veçanta, "Stafit të burgjeve i ndalohet të kryejë ndaj të dënuarve veprime të pabazuara në ligj, ndërskime apo trajtime çnjerëzore apo denigruese, si dhe çdo lloj torture".

### C. Angazhime të tjera që rrjedhin nga Konventat e ratifikuara

Në kuadrin e angazhimeve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, Republika e Shqipërisë ka nënshkruar dhe ratifikuar pjesën më të madhe të Konventave dhe protokolleve ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Evropës në fushën penale.

Gjithashtu janë nënshkruar një numër marrëveshjesh bilaterale në fushën penale.

Konventa mbi parandalimin dhe dënimin e krimit të genocidit ratifikuar më 12 maj 1955;

Konventa ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial, hyrë në fuqi për Republikën e Shqipërisë më 11 maj 1994;

Konventa mbi mos-aplikimin e kufizimeve statutores ndaj krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit hyrë në fuqi më 19 maj 1971;

Konventa kundër torturës dhe trajtimit mizor, çnjerëzor dhe degradues dhe ndëshkimit, hyrë në fuqi më 11 maj 1994;

Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale, Romë 18 korrik 1998, ratifikuar më 23 dhjetor 2002;

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, ratifikuar më 12 dhjetor 2000;

Protokoll për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht grave dhe fëmijëve, që shton Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar ratifikuar më 12 dhjetor 2000;

Protokoll kundër trafikimit të emigrantëve nga toka, deti dhe ajri, që shton Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, ratifikuar më 12 dhjetor 2000.

Statuti i Këshillit të Europës u ratifikua dhe hyri në fuqi në Republikën e Shqipërisë më 13.7.1995. Konventa "Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut", u nënshkrua më 13.07.1995, dhe u ratifikua dhe hyri në fuqi më 02.10.1996. Shqipëria gjithashtu ka ratifikuar edhe protokollin shtesë nr. 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8, të kësaj Konvente të cilat janë nënshkruar, ratifikuar dhe hyrë në fuqi gjithashtu më 02.10.1996.

Protokolli 11 i Konventës Evropiane "Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore" është nënshkruar më 13.07.1995, ratifikuar më 02.10.1996 dhe hyrë në fuqi më 01.11.1998.



Përsa i përket protokollit të 6 shtesë të Konventës Evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, mbi heqjen e denimit me vdekje, u nënshkrua më 04.04.2000, u ratifikua më 21.09.2000 dhe hyri në fuqi më 01.10.2000. Nga viti 1992, vit në të cilin u zbatua ekzekutimi i fundit me vdekje (varje në litar), dënimi me vdekje parashikohej në Kodin Penal, por zbatimi i këtij dënimi u pezullua, dhe pas ratifikimit të protokollit të 6 shtesë të Konventës Evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, ky dënim u zëvendësua me dënimin me burgim të përjetshëm. Janë në proces ratifikimi edhe Protokollat 12 dhe 13 shtesë të Konventës Evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”.

Krahas Konventës Evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, Shqipëria ka nënshkruar një pjesë të madhe të Konventave të Këshillit të Evropës në fushën penale si më poshtë:

- Konventa Evropiane “Për ekstradimin”, nënshkruar dhe ratifikuar më 19.5.1998 dhe hyrë në fuqi më 17.8.1998;
- Protokollit shtesë i Konventës Evropiane “Për ekstradimin”, nënshkruar dhe ratifikuar më 19.05.1998, dhe hyrë në fuqi më 17.08.1998;
- Protokollit i dytë shtesë i Konventës Evropiane “Për ekstradimin”, nënshkruar dhe ratifikuar më 19.05.1998 dhe hyrë në fuqi më 17.08.1998;
- Konventa Evropiane “Për ndihmën e ndërsjelltë në çështjet penale”, nënshkruar më 19.5.1998, ratifikuar më 04.04.2000 dhe hyrë në fuqi më 03.07.2000;
- Konventa Evropiane “Për parandalimin e torturës dhe dënimeve dhe trajtimeve çnjerëzore, apo degraduese”, nënshkruar më 02.10.1996, ratifikuar më 02.10.1996 dhe hyrë në fuqi më 01.01.1997;
- Protokollit nr. 1 i Konventës Evropiane “Për parandalimin e torturës dhe dënimeve, apo trajtimeve çnjerëzore apo degraduese”, nënshkruar, ratifikuar dhe hyrë në fuqi më 02.10.1996;
- Protokollit nr. 2 i Konventës Evropiane “Për parandalimin e torturës dhe dënimeve apo trajtimeve çnjerëzore apo degraduese”, nënshkruar, ratifikuar dhe hyrë në fuqi më 02.10.1996;
- Konventa “Për transferimin e personave të dënuar”, nënshkruar më 19.05.1998, ratifikuar më 04.04.2000 dhe hyrë në fuqi më 01.08.2000;
- Konventa Evropiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen, dhe konfiskimin e produkteve të krimit, nënshkruar më 04.04.2000, ratifikuar më 20.07.2000 dhe hyri në fuqi më 01.02.2002;

- Konventa Evropiane “Për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjykimeve penale”, nënshkruar më 08.06.2000;

- Marrëveshja Evropiane “Për transmetimin e kërkesave për ndihmë juridike”, nënshkruar më 08.06.2000, ratifikuar më 04.04.2000 dhe hyrë në fuqi më 03.07.2000;

- Protokoll i shtesë i Konventës Evropiane “Për ndihmën e ndërsjelltë në çështjet penale”, nënshkruar më 19.05.1998, ratifikuar më 10.06.1999 dhe hyrë në fuqi më 03.07.2000;

- Konventa Evropiane “Për ndalimin e terrorizmit”, nënshkruar më 04.04.2000, ratifikuar më 21.09.2000 dhe hyrë në fuqi më 22.12.2000;

- Konventa Evropiane “Për transferimin e procedimeve në çështjet penale”, nënshkruar më 19.05.1998, ratifikuar më 04.04.2000 dhe hyrë në fuqi më 05.07.2000;

- Konventa Evropiane “Për mbikqyrjen e personave të dënuar ose liruar më kusht”, nënshkruar më 08.06.2000, ratifikuar më 17.05.2001 dhe hyrë në fuqi më 18.08.2001;

- Marrëveshja Evropiane në lidhje me personat pjesëmarrës në proceset e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, nënshkruar më 21.09.2000;

- Protokoll i dytë shtesë i Konventës Evropiane “Për ndihmën e ndërsjelltë në çështjet penale”, nënshkruar më 12.11.2001, ratifikuar nga Kuvendi, depozituar instrumenti i ratifikimit;

- Protokoll i shtesë i Marrëveshjes Evropiane “Për transmetimin e kërkesave për ndihmë juridike”, nënshkruar më 12.11.2001, ratifikuar nga Kuvendi, depozituar instrumenti i ratifikimi.

Në vijim të ratifikimit të Konventës Evropiane “Për parandalimin e torturës dhe dënimeve dhe trajtimeve çnjerëzore, apo degraduese”, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor apo Degradues (CPT), ka organizuar 4 vizita në Shqipëri ndërmjet 1997 dhe 2001. Teksti i Raporteve dhe përgjigjet përkatëse të Qeverisë shqiptare janë autorizuar nga ana e Shqipërisë për t’u publikuar.

Gjithashtu, Kodi i Prodedurës Penale të Republikës së Shqipërisë nr.7905, datë 21.03.1995, përmban dispozita të ndryshme në lidhje me marrëdhëniet e gjykatave dhe Ministrisë së Drejtësisë në fushën e asistencës ligjore ndërkombëtare.

Sipas nenit 10 të Kodit të Prodedurës Penale “Marrëdhëniet me autoritetet e huaja në fushën penale rregullohen nga marrëveshjet

ndërkombëtare, të pranuar nga shteti shqiptar, nga parimet dhe normat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare, si dhe dispozitat e këtij kodi”.

#### **D. Përfshirja në legjislacionin e brendshëm**

Në Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë miratuar në nëntor të vitit 1998 (neni 122) thuhet se çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik, pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.

Kjo dispozitë e Kushtetutës është e një rëndësie të veçantë në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, sepse edhe në rastet kur në legjislacionin e brendshëm ka mangësi mund të zbatohet direkt Konventa e OKB-së kundër Torturës dhe Trajtitimit, ose Ndërshkimit Mizor, Çnjerëzor, dhe Degradues, nëse për zbatim nuk është e domosdoshme aprovimi i ligjeve të veçanta.

Sipas nenit 180 të Kushtetutës, “Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë para hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute konsiderohen të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute. Këshilli i Ministrave i paraqet Gjykatës Kushtetuese marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat përmbajnë dispozita që vijnë në kundërshtim me Kushtetutën”.

#### **E. Mjetet ligjore të mbrojtjes**

Sipas nenit 17 të Kushtetutës, “Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të çenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

Sipas nenit 7 të Kushtetutës sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.

Pushteti gjyqësor në Republikën e Shqipërisë ushtrohet nga Gjykata e Lartë, Gjykatat e Apelit dhe Gjykatat e Shkallës së Parë. Gjykatat

ushtrojne tre tipe juridiksioni: juridiksioni civil, juridiksioni penal dhe juridiksioni administrativ.

Sipas nenit 407 të Kodit të Procedurës Penale, “Ligji cakton rastet në të cilat vendimet dhe urdhrat e gjykatës mund të ankimohen, si dhe mjetin e ankimit. Ankimi i urdhrave të gjykatës, kur nuk parashikohet ndryshe nga ligji, mund të bëhet vetëm me ankimin kundër vendimit. Mjetet e ankimit janë: apeli, rekursi në Gjykatën e Lartë dhe kërkesa për rishikim. E drejta e ankimit i takon vetëm atij që ligji ia njeh shprehimisht. Kur ligji nuk bën dallim ndërmjet palëve, kjo e drejtë i takon secilës prej tyre. Kur ankimi bëhet në gjykatën jokompetente, ajo ia dërgon aktet gjykatës kompetente”.

Ligji nr. 8503 i vitit 1999, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentat Zyrtare” parashikon se të drejtën për këtë informim e kanë personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj.

Në nenin 2 të këtij ligji përcaktohet se me person, në kuptim të këtij ligji, kuptohet çdo person fizik ose juridik, vendas ose i huaj. Gjithashtu, ligji parashikon edhe të drejtën e ankimit në rrugë administrative dhe gjyqësore, në rast të shkeljes të së drejtës së informimit për dokumentat zyrtare.

## **F. Informacion në lidhje me nenet e pjesës i të konventës**

### *Neni 2*

Dispozitat kryesore në lidhje me torturën parashikohen në nenin 25 të Kushtetutës, sipas të cilit “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues”.

Po kështu në bazë të nenit 17, “Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut”.

“Çështjet që lidhen me tërësinë territoriale të Republikës së Shqipërisë, me kufizimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, me buxhetin, taksat e detyrimet financiare të shtetit, me vendosjen dhe heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme, me deklarimin e luftës dhe të paqes dhe me amnistinë nuk mund të shtrohen në asnjë referendum” (neni 151/2).

“Parimet e veprimtarisë së organeve publike dhe shkalla e kufizimit të të drejtave dhe lirive të njeriut gjatë gjithë periudhës së ekzistencës së gjendjeve që kërkojnë marrjen e masave të jashtëzakonshme, përcaktohen me ligj” (neni 170/2).

Kodi Penal parashikon rastet të cilat përfaqësojnë raste torture dhe përcakton në lidhje me to dënimet dhe sanksionet përkatëse ndaj personave përgjegjës. Kështu, nenet 86 dhe 87 të Kodit Penal parashikojnë se: “Tortura, si dhe çdo akt tjetër çnjerëzor apo poshtërues dënohen me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Tortura, si dhe çdo akt tjetër çnjerëzor, kur ka sjellë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim të përhershëm të shëndetit të personit apo vdekjen, dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet”.

Neni 50 i Kodit Penal gjithashtu parashikon se: “Rëndojnë dënimin rrethanat kur kryerja e veprës penale është bërë me egërsi dhe mizori”. Sipas nenit 75 të të njëjtit kod, “Veprat e kryera nga persona të ndryshëm në kohë lufte, si vrasja, keqtrajtimi ose dëbimi për punë skllavëruese, si dhe për çdo lloj shfrytëzimi tjetër çnjerëzor në dëm të popullsisë civile ose në territor të pushtuar, vrasja ose keqtrajtimi i robërve të luftës, vrasja e pengjeve, shkatërrimi i pasurisë private ose publike, shkatërrimi i qyteteve, komunave ose fshatrave, jo të diktuar nga nevoja ushtarake, dënohet me heqje të lirisë jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm”.

“Shkaktimi i vetëvrasjes ose i tentativës së vetëvrasjes të një personi, si rrjedhojë e trajtimit të keq sistematik ose nga sjellje të tjera sistematike që prekin rëndë dinjitetin, të kryera nga personi që e ka në vartësi materiale apo çfarëdolloj vartësie tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet (neni 99).

Me qëllim përmirësimit të Kodit Penal, me ligjin nr. 8175, datë 23.12.1996, ky Kod iu nënshtrua disa ndryshimeve, ku ndërmjet të tjerave bëhen edhe shtesa në nenet 104 dhe 109 si më poshtë:

“Marrëdhënia seksuale me dhunë që ka sjellë si pasojë vdekjen, ose vetëvrasjen e personit të dëmtuar dënohet me burgim të përjetshëm. Marrëdhënia seksuale me dhunë që paraprihet, shoqërohet ose pasohet me torturë ndaj personit të dëmtuar dënohet me njëzet vjet burgim” (neni 104).

Pas nenit 109 shtohet neni 109/a me këtë përmbajtje: “Rrëmbimi dhe mbajtja peng e personit dënohet me njëzet e pesë vjet burgim, kur viktimi ka pësuar dëmtime të rënda e permanente të shëndetit të shkaktuara me dashje ose si rezultat i kushteve në të cilat mbahet apo si rezultat i privimeve nga nevojat jetësore, ose kur kryhet ndaj disa

personave. Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit dënohet me burgim të përjetshëm, kur paraprihet ose shoqërohet me torturë të viktimës, kur viktima është person i mitur ose kur është kryer nga një organizatë kriminale. Kur personi i mitur ose personat lirohen vullnetarisht përpara mbarimit të shtatë ditëve nga rrëmbimi a marrja peng dhe ndaj tyre nuk është ushtruar torturë ose nuk i janë shkaktuar dëmtime të rënda e permanente të shëndetit, atëherë dënimi është dhjetë vjet burgim.”

Me ligjin nr. 8733, datë 24.01.2001 këtij neni iu bënë disa ndryshime thelbësore. Kështu u parashikua se: “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit ose e të miturit nën moshën 14 vjeç, i paraprirë ose i shoqëruar me tortura fizike ose psikike, kur është kryer kundër disa personave ose më shumë se një herë, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet dhe, kur është shkaktuar vdekja, me burgim të përjetshëm. Kur personi i rrëmbyer ose i mbajtur peng lirohet vullnetarisht para mbarimit të shtatë ditëve nga rrëmbimi ose mbajtja peng, pa e arritur qëllimin e krimit dhe, kur ndaj personit nuk është ushtruar torturë ose dëmtime të tjera të shëndetit, dënohet me burgim nga tre gjer në pesë vjet”.

Sipas nenit 27 të ligjit nr. 7939 datë 25.05.1995 “Për Migracionin”, “Nuk dëbohen, kthehen ose dërgohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë personat që kanë një frikë të mirëbazuara se do t’i nënshtrohen torturave a trajtimit çnjerëzor ose poshtërues për çdo arsye tjetër, në kufijtë e territoreve ku i kërcënon ky rrezik. Nuk dëbohen, kthehen ose dërgohen në një shtet tjetër gjithashtu ata persona, për të cilët ka arsye të forta për të menduar se atje rrezikohen të dënohen me vdekje”. Duke vijuar, neni 35 i të njëjtit ligj parashikon se, “Në të gjithë rastet, kur është marrë një vendim për të debuar një person nga Republika e Shqipërisë, pikat e mëposhtme zbatohen pavarësisht nëse personi është apo jo i pranishëm ligjërisht në territorin e Republikës së Shqipërisë:

Personat, të cilët kanë një kërkesë të argumentuar se dëbimi i tyre nga Republika e Shqipërisë përbën një ndërhyrje në të drejtën e tyre për të respektuar jetën private a familjare, siç garantohet nga parimet e përgjithshme të akteve ndërkombëtare të pranuar nga Shqipëria. Ata kanë të drejtë në të gjitha rastet që për vendimin e dëbimit t’i drejtohen gjykatës, duke iu dhënë e drejta për një përfaqësim ligjor.

Personat, të cilët kanë një arsye të argumentuar se dëbimi i tyre nga Republika e Shqipërisë i ekspozon ndaj rrezikut të dënimit me vdekje, torturues ose trajtimi çnjerëzor e poshtërues, në të gjithë rastet kanë të drejtë që kundër vendimit të dëbimit t’i drejtohen gjykatës duke iu njohur e drejta për një përfaqësim ligjor në këto procedura gjyqësore”.

Në bazë të ligjit nr. 7514, datë 30.09.1991 "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", ndryshuar me ligjin nr.7660 datë 14.01.1993 dhe ligjin datë 29.06.1993, "Nuk përfitojnë nga ky ligj ata që janë dënuar për krime ordinere si vrasje, tortura, grabitje, krime seksuale etj" (neni 1).

Shqipëria gjithashtu ka nënshkruar dhe ratifikuar Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Civile dhe Kulturore, Konventën mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën mbi parandalimin dhe dënimin e krimit të genocidit, Konventën Evropiane "Për parandalimin e torturës dhe dënimeve dhe trajtimeve çnjerëzore apo degraduese" dhe konventa të tjera ndërkombëtare të cilat ndalojnë torturën dhe trajtimin degradues dhe çnjerëzor.

Në bazë të kodit të Procedurave Administrative neni 9, "Organet e Administratës Publike e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë aderon, ligjet e Republikës së Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave që u janë dhënë atyre dhe konform qëllimit për të cilat janë dhënë këto kompetenca. Aktet administrative të nxjerra në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi janë të vlefshme, në qoftë se rezultati i kërkuar në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Palët e dëmtuara nga aktet e lartpërmendura kanë të drejtë të kompensohen për humbjet eventuale në bazë të dispozitave ligjore, që rregullojnë përgjegjësinë e administratës publike".

Ligji nr. 8003, datë 28.09.1995, "Kodi Penal Ushtarak", nenet 92, 93 dhe 94 parashikojnë dënime të rënda penale në rastin e sjelljes brutale me robërit e luftës, kryerjen e pakujdesshme të detyrave kundrejt atyre që janë të sëmure apo të plagosur nga ana e personave që janë ngarkuar me mjekimin e tyre, lënien e të plagosurve në fushën e luftës nga ana e personave që janë të detyruar t'i tërheqin dhe vrasjen e plagosjet e personave të kapur rob. Më tej dënime parashikohen për cilido që plagos rëndë ose vret një armik që dorëzon armët ose nuk kundërshton me mënyra të tjera. Keqtrajtimi i kufomës së armikut konsiderohet gjithashtu kundërvajtje penale.

Në të njëjtën mënyrë, ligji nr.8291, datë 25.02.1998, "Kodi i Etikës së Policisë", neni 6/2 "Gjatë shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të personave të implikuar në krime, punonjësit e policisë zbatojnë me rreptësi normat ligjore, si dhe u ndalohet çdo akt torture a veprim tjetër që cënon personalitetin dhe dinjitetin e tyre".

Neni 8 i ligjit parashikon se, "Punonjësit e policisë përgjigjen penalisht, administrativisht, civilisht dhe sipas rregullores së disiplinës për veprimet dhe mosveprimet e kryera me iniciativë ose në kundërshtim me urdhrin, si dhe për zbatimin e urdhrave të dhënë jo në formën e kërkuar nga ligji a rregullorja, ose nga një person a organ jokompetent. Punonjësi i policisë mban përgjegjësi për zbatimin e urdhrave haptazi të kundërligjshme. Kur urdhri i dhënë formalisht në përputhje me rregullat është i kundërligjshëm, punonjësi i policisë mban përgjegjësi në rast se para kryerjes së veprimit kishte mundësi të vinte në dijeni organet e prokurorisë ose menjëherë mbas zbatimit nuk i ka njoftuar ato për veprimin e kryer.

Neni 12 parashikon se, "Kur një punonjësi të policisë i kërkohet të përmbushë një urdhër a një detyrë që është në kundërshtim të hapur me ligjin, ai është i detyruar ta refuzojë zbatimin e tij dhe të informojë eprorin më të lartë".

Neni 10, "Punonjësit e policisë nuk përdorin asnjëherë forcën në kundërshtim me dispozitat ligjore. Ata marrin dhe japin udhëzime të qarta e të përpikta për mënyrën dhe rrethanat kur përdoren forca dhe armët".

Në përputhje me sa më sipër, nenet 6 dhe 7 të ligjit nr. 8321, datë 02.04.1998, "Për Policinë e Burgjeve", parashikojnë se: "Punonjësit e Policisë së Burgjeve janë të detyruar të zbatojnë urdhrat e dhënë nga eprorët sipas shkallës funksionale dhe në raporte të barabarta sipas hierarkisë së gradës. Urdhrat duhet të jepen në përputhje me detyrën funksionale e në realizim të saj, si dhe të mos jenë në kundërshtim me ligjin dhe me dinjitetin e personit të cilit i drejtohen. Në mungesë të eprorit të drejtpërdrejtë, në raste urgjente dhe kur nuk ka mundësi të komunikohet me eprorë më të lartë, funksionari me gradë më të lartë ka të drejtën e urdhrat ndaj funksionarëve të barabartë ose më të ulët në gradë.

Urdhri me shkrim që konsiderohet i paligjshëm duhet të zbatohet kurdoherë, me përjashtim të rastit kur është haptazi i kundërligjshëm. Për urdhrat verbalë, që konsiderohen të paligjshëm, është e detyrueshme dhënia me shkrim kur kërkohet nga zbatuesi dhe, kur kjo është e pamundur, jepet pas zbatimit të tij. Në të gjitha rastet, marrësi i urdhrat duhet të njoftojë sa më parë organet e prokurorisë për konstatimin e paligjshmërisë. Për urdhrin e dhënë mban përgjegjësi në çdo rast urdhërdhënësi, si dhe zbatuesi i urdhrat, kur nuk ka paraqitur kundërshtimet si më sipër. Për zbatimin e urdhrat haptazi të kundërligjshëm, mban përgjegjësi në çdo rast edhe zbatuesi.



Pranimi, verifikimi dhe zgjidhja e ankesave dhe kërkesave ndaj policisë së rendit ka qenë një nga prioritetet e Institucionit të Avokatit të Popullit për shkak se organet e policisë kanë detyra specifike, moskryerja me korrektesë e të cilave shpesh çon në dhunime dhe shkelje të rënda të të drejtave dhe lirive themelore të individëve, siç janë jeta, liria personale, liria dhe fshehtësia e korrespondencës, paprekshmëria e banesës, e drejta e azilit politik etj.

Disa nga shkaqet që kanë çuar në shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e punonjësve të Policisë, janë:

- Mosnjohja e duhur e legjislacionit, sidomos Kushtetutës dhe ligjit “Për Policinë e Shtetit”, të cilat garantojnë respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

- Mosnjohja sa duhet e konventave ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

- Niveli akoma i ulët kulturor e profesional i punonjësve të policisë, sidomos i atyre të rolit bazë (policëve).

- Mentaliteti i gabuar “i të fortit” që ekziston i trashëguar në radhët e policisë në përgjithësi, dhe në disa kuadro të veçantë drejtues të saj “se policia është shteti, se policia bën ligjin” etj.

- Mungesa e përgjithësimeve të duhura të qendrimeve ndaj rasteve të shkeljeve të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut me qëllim parandalimin e tyre në të ardhmen.

- Ekzistenca e një fryme liberalizmi dhe mungesa e kërkesës së llogarisë nga kuadrot drejtuese dhe indiferenca e tyre përballë shkeljeve të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të kryera nga vartësit e tyre, që vjen si pasojë e mosformimit të plotë të tyre si dhe e frikës për mosdaljen e namit të keq.

- Gjendja relativisht e rëndë e rendit që po kalojmë dhe veçanërisht vrasja e plagosja e shumë punonjësve të policisë, sidomos vitet e fundit, ndikon në humbjen e vetëkontrollit dhe qetësisë së tyre në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut gjatë ushtrimit të detyrave funksionale.

### *Neni 3*

Sipas nenit 16 të Kushtetutës, “Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejné njëlloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e

Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara”.

Sipas nenit 39 pika 3 të Kushtetutës, “Ndalohej dëbimi kolektiv i të huajve. Dëbimi i individëve të huaj lejohet në kushtet e përcaktuara me ligj”. Po kështu në përputhje me nenin 40, “Të huajt kanë të drejtën e strehimit në Republikën e Shqipërisë sipas ligjit”.

Hyrja, qëndrimi dhe trajtimi i të huajve në Republikën e Shqipërisë rregullohen nga ligji nr.7939, datë 25.05.1995 “Për Migracionin”, ligji nr. 8492 datë 27.05.1999 “Për të huajt” dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr.439, datë 04.08.2000 “Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”.

Sipas nenit 3 të ligjit “Për Migracionin”, ky ligj njeh dhe respekton parimet e përgjithshme të akteve ndërkombëtare. Neni 4 i ligjit parashikon se, “Nëpunësit e administratës shtetërore shqipëtare, që angazhohen në zbatimin e këtij ligji, ose të akteve të tjera nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, zbatojnë detyrat e tyre në pajtim me parimet e përgjithshme të akteve ndërkombëtare dhe detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë, pa marrë në konsideratë gjininë, kombësinë, racën ngjyrën ose besimin e personave, të cilët kërkojnë të hyjnë, të dalin a të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë.

Neni 24 i këtij ligji parashikon se, “Personat, që për shkak të persekutimit për arsye race, feje, kombësie, pjesëmarrje në një grup shoqëror a politik, janë jashtë vendit të kombësisë së tyre dhe nuk kanë mundësi të mbrohen në këtë vend, ose ata që nuk kanë kombësi janë jashtë vendit të banimit të tyre formal të zakonshëm dhe nuk kanë mundësi të kthehen në të, njihen si refugjatë në bazë të procedurave të caktuara në aktet e nxjerra në zbatim të këtij ligji”.

Personi pushon së qeni refugjat në kuptim të këtij ligji, në qoftë se:

a)Ka kryer një krim kundër paqes, një krim lufte ose një krim kundër njerëzimit, sipas përcaktimeve të akteve ndërkombëtare;

b)ka kryer një krim të rëndë jopolitik jashtë Shqipërisë, para se ai të pranohet në Shqipëri si refugjat;

c)merr shtetësinë shqiptare ose shtetësinë e ndonjë vendi tjetër dhe gëzon mbrojtjen e atij shteti, shtetësinë e të cilit ka marrë;

ç) rivendoset vullnetarisht në vendin nga i cili ishte larguar, ose jashtë të cilit ai kishte mbetur si rezultat i frikës së persekutimit;

d) nuk mund të vazhdojë të refuzojë mbrojtjen e vendit të shtetësisë së tij, pasi rrethanat në të cilat ai është njohur si refugjat kanë pushuar si të tilla, ose në rast se ka humbur shtetësinë e tij, ai vazhdon të refuzojë të kthehet në vendin e mëparshëm të banimit të tij.

Sipas neneve 26, 27 dhe 28 të këtij ligji, “Nuk dëbohen, kthehen ose dërgohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ata persona që kanë frikë të mirëbazuar se jeta ose liria e tyre kërcënohen për shkak të racës, gjinisë, besimit, kombësisë, përkatësisë në një grup shoqëror të veçantë apo opinione politike të tyre, në kufijtë e territoreve ku i kërcënon ky rrezik.

Nuk dëbohen, kthehen ose dërgohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë personat që kanë një frikë të mirëbazuar se do t’i nënshtrohen torturave, a trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës për çdo arsye tjetër, në kufijtë e territoreve ku i kërcënon ky rrezik. Nuk dëbohen, kthehen ose dërgohen në një shtet tjetër gjithashtu ata persona, për të cilët ka arsye të forta për të menduar se atje rrezikohen të dënohen me vdekje.

Çdo person që ndodhet në kufirin e Republikës së Shqipërisë ose brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nëse ka hyrë në Shqipëri në mënyrë të ligjshme ose jo, dhe që dëshiron të qëndrojë në Shqipëri si refugjat sipas dispozitave të këtij ligji, duhet t’i drejtohet organit përkatës të përcaktuar në aktet e nxjerra në zbatim të këtij ligji. Asnjë kërkues azili nuk dërgohet në një vend tjetër për t’iu shqyrtuar kërkesa, derisa t’i jetë dhënë mundësia për të paraqitur arsyet se përse kjo kërkesë duhet të shqyrtohet në Republikën e Shqipërisë e jo në një vend tjetër dhe pasi këto arsye të jenë shqyrtuar tërësisht. Askush që ka paraqitur një kërkesë për azil, e cila është refuzuar, nuk dëbohet nga Shqipëria pa iu dhënë mundësia e rishqyrtimit sipas procedurave përkatëse”.

Po kështu sipas neneve 33, 34 dhe 35 të ligjit “Për Migracionin”, personat, subjekte të neneve të këtij ligji, që banojnë ligjërisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk dëbohen prej këtej, përveç zbatimit të një vendimi të marrë në pajtim me ligjin.

Ata kanë të drejtë:

- a) të paraqesin arsyet kundër dëbimit të tyre,
- b) të kërkojnë rishikimin e rasteve të tyre,
- c) të përfaqësohen për këto qëllime pranë një autoriteti kompetent të përcaktuar në aktet e nxjerra në zbatim të këtij ligji.

Këta persona mund të dëbohen para ushtrimit të të drejtave të tyre sipas pikave a, b dhe c të këtij neni, vetëm kur ky dëbim është i domosdoshëm në interes të rendit publik ose bazohet në arsyet e sigurimit kombëtar. Personat, subjekte të neneve të këtij ligji që banojnë jo ligjërisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, dëbohen sipas procedurave të përcaktuara në aktet e nxjerra në zbatim të këtij ligji, të cilat publikohen.

Në të gjithë rastet, kur është marrë një vendim për të dëbuar një person nga Republika e Shqipërisë, pikat e mëposhtme zbatohen pavarësisht nëse personi është apo jo i pranishëm ligjërisht në territorin e Republikës së Shqipërisë:

- Personat, të cilët kanë një kërkesë të argumentuar se dëbimi i tyre nga

Republika e Shqipërisë përbën një ndërhyrje në të drejtën e tyre për të respektuar jetën private a familjare, siç garantohet nga parimet e përgjithshme të akteve ndërkombëtare të pranura nga Shqipëria. Ata kanë të drejtë në të gjitha rastet që për vendimin e dëbimit t'i drejtohen gjykatës, duke iu dhënë e drejta për një përfaqësim ligjor.

- Personat, të cilët kanë një arsye të argumentuar se dëbimi i tyre nga Republika

e Shqipërisë i ekspozon ndaj rrezikut të dënimit me vdekje, torturues ose trajtimi çnjerëzor e poshtëruës, në të gjithë rastet kanë të drejtë që kundër vendimit të dëbimit t'i drejtohen gjykatës duke iu njohur e drejta për një përfaqësim ligjor në këto procedura gjyqësore.

Vetëm kur ka të dhëna se me veprimet e personave që bëjnë përpjekje për të hyrë në mënyrë të paautorizuar në territorin e Republikës së Shqipërisë, ekzistojnë elemente të ndonjë vepre penale, duhet të kërkohet procedimi penal i tyre si dhe marrja e masave të ndalimit dhe arrestimit në përputhje me legjislacionin penal shqiptar.

Dispozitat ligjore dhe nënligjore të paraqitura më sipër përbënë kuadrin ligjor për përballimin me sukses të krizës kosovare të vitit 1999, kur rreth 500 000 rrefugjatë kosovarë u strehuan përkohësisht në Shqipëri.

Para vitit 2001, organet e specializuara të shtetit shqiptar në bashkëpunim me homologët e tyre bënë të mundur identifikimin dhe dëbimin nga territori shqiptar të 10 shtetasve të huaj të dyshuar si ekstremistë. Pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2001, në përputhje me Rezolutën 1373 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Ministria e Rendit Publik e R.SH. me Urdhërin nr. 1560, datë 6 tetor 2001, dëboi nga territori shqiptar 5

shtetas të huaj të dyshuar për terrorizëm dhe urdhëroi shumë shtetas të tjerë të huaj të largoheshin nga territori shqiptar.

#### *Neni 4*

Kapitulli IV i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë parashikon mënyrën e caktimit të dënimit.

a) Sipas nenit 47 të Kodit, gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuara në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

b) Sipas nenit 50, rëndojnë dënimin ndërmjet të tjerave, rrethanat që vijojnë:

- Kryerja e veprës penale me egërsi dhe mizori;
- Kryerja e veprimeve që rëndojnë apo shtojnë pasojat e veprës penale;
- Kur vepra është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen;

Kreu I i pjesës së posaçme të Kodit Penal parashikon:

a) Neni 73, Zbatimi i një plani të paramenduar që synon shkatërrimin tërësisht apo pjesërisht të një grupi nacional, etnik, racial apo fetar i drejtuar kundër anëtarëve të grupit dhe i shoqëruar me veprat që vijojnë, si: vrasje me dashje të anëtarëve të grupit, dëmtime të rënda fizike dhe psikike, vendosja në kushte jetese të rënda që shkaktojnë shkatërrimin fizik, zbatimi i masave që synojnë pengimin e lindjeve, si dhe transferimi i detyrueshëm i fëmijëve të një grupi në një grup tjetër, dënohet me burgim jo më pak se dhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

b) Neni 74, Vrasjet, shfarosjet, kthimi në skllëvër, internimet dhe dëbimet, si dhe çdo lloj torture apo dhune tjetër çnjerëzore të kryera për motive politike, ideologjike, raciale, etnike e fetare dënohen jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

c) Neni 75, Veprat e kryera nga persona të ndryshëm në kohë lufte, si vrasja, keqtrajtimi ose dëbimi për punë skllavëruese, si dhe për çdo lloj shfrytëzimi tjetër çnjerëzor në dëm të popullsisë civile ose në territor të pushtuar, vrasja ose keqtrajtimi i robërve të luftës, vrasja e pengjeve, shkatërrimi i pasurisë private ose publike, shkatërrimi i qyteteve, komunave ose fshatrave, jo të diktuar nga nevoja ushtarake, dënohet

me heqje të lirisë jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Kreu II i Pjesës së posaçme “Vepra Penale kundër personit” parashikon:

Neni 86, Tortura, si dhe çdo akt tjetër çnjerëzor apo poshtërues dënohen me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Neni 87, Tortura, si dhe çdo akt tjetër çnjerëzor, kur ka sjellë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim të përhershëm të shëndetit të personit apo vdekjen, dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 88, Plagosja e kryer me dashje që ka sjellë si pasojë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim tjetër të përhershëm të shëndetit, ndërprerjen e shtatzanisë, ose ka qenë e rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit të saj, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet. Po kjo vepër, kur është kryer kundër disa personave ose kur ka sjellë si pasojë vdekjen, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 90, Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, përbën kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë deri në 9 ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj.

Neni 99, Shkaktimi i vetëvrasjes ose i tentativës së vetëvrasjes të një personi, si rrjedhojë e trajtimit të keq sistematik ose nga sjellje të tjera sistematike që prekin rëndë dinjitetin, të kryera nga personi që e ka në vartësi materiale apo çfarëdolloj vartësie tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 100, Kryerja e marrëdhënieve seksuale me të miturën, që nuk ka arritur moshën katërmbëdhjetë vjeç ose që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Kur marrëdhënia seksuale kryhet me dhunë ose kur i janë shkaktuar të dëmtuarës pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të miturës, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet.

Neni 101, Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë me të miturën në moshë katërmbëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç dhe që ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Kur të miturës i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të miturës, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 102, Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë me të rritura dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet. Kur të dëmtuarës i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen apo vetëvrasjen e të dëmtuarës, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 103, Kryerja e marrëdhënieve seksuale duke përfitur nga pazotësia fizike ose mendore e të dëmtuarës që ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç dhe pjekurinë seksuale ose, nga vendosja e saj në gjendje të pandërgjegjshme, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Kur të dëmtuarës i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarës, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 104, Kryerja e marrëdhënieve seksuale duke kërcënuar të dëmtuarën për përdorim aty për aty të armës, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 105, Kryerja e marrëdhënieve seksuale duke shpërdoruar raportet e vartësisë ose të detyrës, dënohet me burgim gjer në tre vjet.

Neni 109, Rrëmbimi i personit i bërë me qëllim për të fituar pasuri ose për të siguruar çdo lloj përfitimi tjetër, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzetë vjet. Rrëmbimi i fëmijës nën moshën katërmëdhjetë vjeç, fshehja ose zëvendësimi me një tjetër, dënohet jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm a me vdekje.

Neni 110, Heqja e paligjshme e lirisë së personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit. Kur kjo vepër ka vënë në rrezik jetën ose është shoqëruar me vuajtje të rënda fizike, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 111, Zotërimi dhe vënia nën kontroll e avionëve, anijeve dhe mjeteve të tjera të transportit ku ndodhen njerëz, duke përdorur dhunë ose me kërcënim me armë a mjete të tjera, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 112, Hyrja ose qëndrimi në banesën e tjetrit pa pëlqim të tij përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj. Kur vepra është kryer me dhunë ose me kërcënim për përdorim të armës përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Neni 124, Braktisja e fëmijës nën moshën 14 vjeç nga prindi ose personi që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me gjobë ose me

burgim gjer në tre vjet. Kur nga vepra është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit ose vdekja e fëmijës, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Neni 129, Shtytja ose tërheqja e të miturve nën moshën katërbëdhjetë vjeç për të kryer krim, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 130, Shtrengimi ose pengimi për të filluar ose vazhduar bashkëjetesën ose shtrengimi për të zgjidhur martesën, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

Neni 141, Vjedhja e pasurisë, kur është shoqëruar me dhunime që kanë sjellë vdekjen e personit, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 230, Kryerja e veprimeve të dhunshme ndaj jetës, shëndetit të njerëzve, lirisë vetjake nëpërmjet rrëmbimit të tyre apo të mjeteve të udhëtimit masiv, që kanë për qëllim turbullimin e rëndë të rendit publik dhe ngjalljen e frikës e të pasigurisë në masë, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 238, Kanosja serioze për vrasje apo për plagosje të rëndë, që i bëhet punonjësit që kryhen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, për shkak të veprimtarisë së tij shtetërore ose të shërbimit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 250, Kryerja e veprimeve ose dhënia e urdhërave arbitrare, nga ana e punonjësit që kryen një funksion shtetëror ose një shërbim publik gjatë ushtrimit të detyrës së tij, të cilat prekin lirinë e shtetasve, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet.

Neni 251, Mosmarrja e masave ose moskërkimi pranë personit kompetent, që të ndërpritet gjendja e paligjshmërisë si rezultat i një veprimi arbitrar, që ka prekur lirinë e shtetasit, nga ana e personit të ngarkuar me një funksion shtetëror ose në shërbim publik, që vjen në dijeni të asaj gjendjeje për shkak të funksionit apo shërbimit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 252, Mbajtja në burg, pa vendim të organit kompetent ose tej afatit të caktuar në vendim apo në ligj, prej personit të ngarkuar me detyrën e administratorit të burgut, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.



Neni 261, Kryerja e veprimeve për të penguar shtetasit për të ushtruar lirinë e shprehjes së mendimit, të grumbullimit apo të manifestimit, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj. Kur veprimet shoqërohen me përdorimin e dhunës fizike, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 264, Detyrimi i punonjësit që kundër vullnetit të marrë apo të mos marrë pjesë në grevë ose krijimi i pengesave dhe vështirësive për të vazhduar punën kur punonjësi dëshiron të punojë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

Neni 286, Nxitja e të tjerëve për përdorimin e drogës narkotike ose të substancave psikotrope apo injektimi i tyre pa pëlqimin e të dëmtuarit, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Kur nxitja apo injektimi i detyruar bëhet ndaj fëmijëve apo në institucione penale, shkollore, sportive apo të çdo veprimtarie tjetër shoqërore dënohet me burgim nga dhjetë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Kapitulli IV, “Vepra Penale kundër drejtësisë” parashikon:

Neni 303, Fshehja ose asgjësimi i kufomës së një personi, viktimë e vrasjes, apo të veprave të tjera të dhunshme, e bërë me qëllim për të ndihmuar autorin e krimit që t’i shpëtojë kërkimit, kapjes dhe arrestimit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 313, Fillimi i paligjshëm i ndjekjes penale nga prokurori kundër një personi që dihet se është i pafajshëm dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Kreu X, “Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik” parashikon:

Neni 332, Shpërdorimi i autoritetit ushtarak nga oficeri ose kuadri ushtarak për të influencuar në votim tek ushtarakët e tjerë që ka në varësi, me dhënie urdhërash, këshilla apo me çfarëdo lloj propagande, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Lidhur me veprat penale dhe të dënuarit të cilet kanë konsumuar veprat penale të akteve të torturës, torturës me pasoja të rënda dhe veprave penale të kryera me dashje kundër shëndetit, për vitin 2001:

- Në bazë të nenit 86 të Kodit Penal nuk ka të dënuar dhe vepra të konsumuara; ? Në bazë të nenit 87 (tortura me pasoja të rënda) janë evidentuar 23 çështje me 15 të dënuar;

- Po kështu, gjatë vitit 2001 janë evidentuar 82 krime dhe 213

kundravajtje, çështje penale të gjykuara në bazë të veprave penale të kryera me dashje kundër shëndetit.

Numri i plagosjeve të rënda sipas nenit 88 të Kodit Penal.

- Në vitin 1997 u regjistruan 344 raste të plagosjes së rëndë, prej të cilave 53% të tyre u zbuluan nga policia dhe u sollën para gjykatës.

- Në 1998 u regjistruan 188 raste të plagosjes së rëndë, prej të cilave u zbuluan dhe u sollën para drejtësisë 76% e tyre.

- Ndërsa në 1999 pati 193 raste të plagosjes së rëndë, prej të cilave u zbuluan dhe u sollën para drejtësisë 80% e tyre.

Burimi: Ministria e Drejtësisë.

### *Neni 5*

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë përcakton kufijtë e shtrirjes së juridiksionit dhe rastet e zbatimit të këtij Kodi. Fusha e zbatimit të ligjit penal shqiptar parashikohet në nenet 5, 6, 7, 8 dhe 9 të këtij Kodi.

Neni 5, Territori i Republikës së Shqipërisë, në kuptim të ligjit penal, quhet hapësira tokësore, gjerësia e ujërave territoriale dhe të brendshme detare, hapësira ajrore që shtrihet mbi hapësirën tokësore dhe të ujërave territoriale dhe të brendshme detare, si dhe çdo vend tjetër ku shtrihet sovraniteti i shtetit shqiptar, si selitë e përfaqësive diplomatike dhe konsullore shqiptare, anijet që mbajnë flamurin e Republikës së Shqipërisë, anijet e marinës luftarake, të aviacionit ushtarak ose civil kudo që ndodhen.

Neni 6, Për vepra penale të kryera nga shtetas shqiptarë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë zbatohet ligji penal i Republikës së Shqipërisë. Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin shqiptar që kryen krim në territorin e një shteti tjetër, kur krimi është njëkohësisht i dënueshëm dhe derisa nuk është dhënë për të një vendim përfundimtar nga një gjykatë e huaj. Në kuptim të këtij neni shtetas shqiptarë do të konsiderohen edhe ata persona që përveç shtetësisë shqiptare gëzojnë edhe shtetësi tjetër.

Neni 7, Shtetasi i huaj, që kryen vepër penale në territorin e Republikës së Shqipërisë, përgjigjet në bazë të ligjit penal të Republikës së Shqipërisë. Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin e huaj që jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë kryen në dëm të interesave të shtetit ose të shtetasit shqiptar një nga krimet e mëposhtme:

- a) krime kundër njerëzimit;
- b) krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues;
- c) akte terroriste;
- d) Organizimi i prostitucionit, trafikimi i jashtëligjshëm i njerëzve, fëmijëve dhe grave prodhimi dhe trafikimi i jashtëligjshëm i armëve, drogës, substancave të tjera narkotike e psikotrope, i substancave bërthamore, i materialeve pornografike, si dhe trafikimi i jashtëligjshëm i veprave të artit dhe i objekteve me vlerë historike, kulturore dhe arkeologjike;
- e) rrëmbimi i avionëve dhe i anijeve;
- f) falsifikimi i vulës së shtetit shqiptar, parave dhe letrave me vlerë shqiptare;
- g) krime që cenojnë jetën dhe shëndetin e shtetasit shqiptar, për të cilat ligji parashikon dënim mbi pesë vjet burgim ose çdo lloj dënimi më të rëndë.

Neni 8, Për personin pa shtetësi që kryen veprë penale në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe krim jashtë këtij territori, vlejnë rregullat e nenit 7 të këtij Kodi.

Neni 9, Çështja e përgjegjësisë për shtetasit e huaj që kryejnë veprë penale në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që gëzojnë imunitet në bazë të së drejtës ndërkombëtare, zgjidhet me rrugë diplomatike.

Në kuadër të angazhimeve të saj në drejtim të rritjes së sigurisë në nivel ndërkombëtar, Republika e Shqipërisë ka ratifikuar dhe është palë në Konventat e mëposhtme ndërkombëtare:

1. Konventa për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurimit të Aviacionit Civil, Montreal 1971, hyrë në fuqi në Republikën e Shqipërisë më 20.11.1997;

2. Konventa mbi Veprat Penale dhe aktet e tjera të kryera në Bordin e Avionit, Tokio 1963, hyrë në fuqi në Republikën e Shqipërisë më 01.03.1998;

3. Konventa për Ndalimin e Rrëmbimit të Paligjshëm të Avionëve, Hagë 16.12.1970, hyrë në fuqi në Republikën e Shqipërisë më 20.11.1997;

4. Konventa kundër Marrjes së Pengjeve, hyrë në fuqi në Republikën e Shqipërisë më 22.02.2002;

5. Protokollin për Ndalimin e Akteve të Paligjshme të Dhunës në Aeroportet që Shërbejnë për Aviacionin Civil Ndërkombëtar, dorëzuar instrumenti i aderimit.

6. Konventa për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurimit të Lundrimit detar dhe Protokolli për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurimit të Platformave Fikse të vendosura në Shelfin Kontinental, hyrë në fuqi në Republikën e Shqipërisë më 17.09.2002;

7. Konventa mbi Ndalimin e Bombardimeve Terroriste, hyrë në fuqi më 22.02.2002.

#### *Neni 6*

Në fushën e ndihmës dhe procedimit penal, Republika e Shqipërisë ka ratifikuar dhe është palë në konventat e mëposhtme të Këshillit të Evropës, të cilat në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës përbëjnë pjesë të sistemit të brendshëm juridik:

1- Konventa Evropiane “Për ndihmën e ndërsjelltë në çështjet penale”, nënshkruar më 19.5.1998, ratifikuar më 04.04.2000 dhe hyrë në fuqi më 03.07.2000;

2- Konventa “Për transferimin e personave të dënuar”, nënshkruar më 19.05.1998, ratifikuar më 04.04.2000 dhe hyrë në fuqi më 01.08.2000;

3- Konventa Evropiane “Për vlefshmerinë ndërkombëtare të gjyqimeve penale”, nënshkruar më 08.06.2000;

4- Marrëveshja Evropiane “Për transmetimin e kërkesave për ndihmë juridike”, nënshkruar më 08.06.2000, ratifikuar më 04.04.2000 dhe hyrë në fuqi më 03.07.2000;

5- Protokolli shtesë i Konventës Evropiane “Për ndihmën e ndërsjelltë në çështjet penale”, nënshkruar më 19.05.1998, ratifikuar më 10.06.1999 dhe hyrë në fuqi më 03.07.2000;

6- Konventa Evropiane “Për transferimin e procedimeve në çështjet penale”, nënshkruar më 19.05.1998, ratifikuar më 04.04.2000 dhe hyrë në fuqi më 05.07.2000;

7- Konventa Evropiane “Për mbikqyrjen e personave të dënuar ose liruar me kusht”, nënshkruar më 08.06.2000, ratifikuar më 17.05.2001 dhe hyrë në fuqi më 18.08.2001;

8- Protokolli i dytë shtesë i Konventës Evropiane “Për ndihmën e ndërsjelltë në çështjet penale”, nënshkruar më 12.11.2001, ratifikuar nga Kuvendi, depozituar instrumenti i ratifikimit;

9- Protokolli shtesë i Marrëveshjes Evropiane “Për transmetimin e kërkesave për ndihmë juridike”, nënshkruar më 12.11.2001, ratifikuar nga Kuvendi, depozituar instrumenti i ratifikimit.

Rastet e heqjes së lirisë së personave parashikohen me Kushtetutë. Sipas nenit 27 të saj:

1. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.

2. Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhtme:

a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente;

b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj;

c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;

ç) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent;

d) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë;

dh) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose të ekstradimit.

3. Askujt nuk mund t'i hiqet liria vetëm për shkak se nuk është në gjendje të përmbushë një detyrim kontraktor.

Në Kodin e Familjes (neni 75), parashikohet e drejta e Këshillit të Kujdestarisë t'i kërkojë gjykatës që të vendosë heqjen e fëmijës nga prindërit në rastet kur prindërit nuk kujdesen për rritjen dhe edukimin e fëmijës së mitur ose kur këtë e do interesi i tij, dhe t'ia besojë për rritje dhe edukim një institucioni shtetëror ose një personi tjetër, kur ky e pranon.

Sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës neni 5, "Liria e personit mund të kufizohet me masa sigurimi vetëm në rastet dhe mënyrat e përcaktuara me ligj. Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit poshtërues. Të dënuarve me burgim u sigurohet trajtimi njerëzor dhe rehabilitimi moral.përcaktuar me ligj". "I pandehuri, edhe kur është me masë sigurimi izoluese ose kur i është hequr liria për çdo lloj shkakut tjetër, merret në pyetje i lirë, përveç rasteve kur duhen marrë masa për të parandaluar rrezikun e ikjes ose të dhunës. Nuk mund të përdoren, as me pëlqimin e të pandehurit, metoda ose teknika për të ndikuar mbi lirinë e vullnetit ose për të ndryshuar aftësinë e kujtesës e të vlerësimit të fakteve. Para se të ketë filluar pyetja,

të pandehurit i shpjegohet se ka të drejtë të mos përgjigjet dhe se edhe po të mos përgjigjet, procedimi do të vazhdojë”.

Neni 42, “Organi procedues merr të dhëna për kushtet e jetesës personale, familjare dhe shoqërore të të pandehurit të mitur me qëllim që të sqarojë përgjegjshmërinë dhe shkallën e përgjegjësisë, të vlerësojë rëndësinë shoqërore të faktit si dhe të caktojë masa të përshtatshme penale. Organi procedues mbledh informacione nga personat që kanë patur marrëdhënie me të miturin dhe dëgjon mendimin e ekspertëve”.

Në të njëjtën mënyrë, “Në çdo rast kur gjendja mendore e të pandehurit tregon se ai duhet të kurohet, gjykata, vendos, edhe kryesisht shtrimin e të pandehurit në një institucion psikiatrik. Kur është vendosur ose duhet vendosur masa mjekësore e detyrueshme për të pandehurin, gjykata urdhëron që i pandehuri të ruhet në një institucion psikiatrik. Gjatë hetimeve paraprake, prokurori i kërkon gjykatës të vendosë për shtrimin e të pandehurit në një institucion psikiatrik dhe kur vonesa paraqet rrezik, urdhëron shtrimin e përkohshëm deri në marrjen e vendimit nga gjykata”.

Sipas nenit 88, “Masat e sigurimit të vendosura nga gjykata, e cila në të njëjtën kohë ose më vonë shpallet jokompetente për çdo lloj shkak, i humbasin efektet, në qoftë se brenda dhjetë ditëve nga marrja e akteve, gjykata kompetente nuk vendos për masën e sigurimit”.

Sipas nenit 228, “Askush nuk mund t’u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova. Asnjë masë nuk mund të zbatohet kur ka shkaqe padënueshmërie ose të shuarjes së veprës penale”.

Masat e sigurimit personal vendosen:

a- kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës;

b- kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet;

c- kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

Sipas nenit 229, “Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për

veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal. Kur i pandehuri është i mitur gjykata mban parasysh kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete”.

Në rastin e ekstradimit sipas nenit 495, “Në rastet e ngutshme, policia gjyqësore mund të bëjë arrestimin e personit, kundër të cilit është paraqitur kërkesa për arrestimin e përkohshëm. Ajo bën edhe sekuestrimin e provave materiale të veprës penale dhe të sendeve që i përkasin asaj. Autoriteti që ka bërë arrestimin njofton menjëherë prokurorin dhe ministrin e Drejtësisë. Brenda njëzet e katër orëve prokurori e vë të arrestuarin në dispozicion të gjykatës në territorin e së cilës është bërë arrestimi, duke i dërguar edhe dokumentacionin përkatës. Gjykata, brenda njëzet e katër orëve nga arrestimi e miraton atë, kur janë kushtet ose vendos lirim të të arrestuarit. Për vendimin që merr ajo njofton ministrin e Drejtësisë. Masa e arrestit revokohet në qoftë se Ministria e Drejtësisë nuk kërkon, brenda dhjetë ditëve nga miratimi, mbajtjen e saj. Kopja e vendimit të dhënë nga gjykata për masat shtrënguese dhe sekuestrimet, në bazë të këtyre neneve, u njoftohet prokurorit, personit të interesuar dhe mbrojtësit të tij, të cilët mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit”.

Republika e Shqipërisë ka nënshkruar dhe ratifikuar Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore e cila ka hyrë në fuqi më datë 14 tetor 1991. Sipas nenit 36 të Konventës:

(a) nëpunësit konsullorë janë të lirë të komunikojnë dhe takohen me shtetasit e vendit dërgues. Shtetasit e shtetit dërgues do të kenë njëjtën liri e komunikimi dhe kontakti me nëpunësit konsullorë të shtetit dërgues;

(b) nëse ai paraqet kërkesë, autoritetet kompetente të vendit pritës do të informojnë pa vonesë postin konsullor të shtetit dërgues, nëse brenda rajonit të tij konsullor një shtetas i atij vendi është arrestuar, dënuar, ndodhet nën hetime, apo është paraburgosur në ndonjë mënyrë tjetër. Çdo njoftim drejtuar postit konsullor nga ana e personit të arrestuar, dënuar, nën hetime, apo të paraburgosur do t’i paraqitet pa vonesë autoriteteve në fjalë. Autoritetet në fjalë do të informojnë pa vonesë personin e interesuar në lidhje me të drejtat e tij të parashikuara sipas këtij nënparagrafi;

(c) nëpunësit konsullorë kanë të drejtën të vizitojnë një shtetas të vendit dërgues, i cili ndodhet në burg ose në paraburgim, të bisedojnë dhe korrespondojë me të, si dhe të negociojnë për përfaqësimin e tij ligjor. Ata gjithashtu kanë të drejtë të vizitojnë çdo shtetas të shtetit dërgues i

cili ndodhet në burg apo paraburgim në rrethin e tyre konsullor në pritje të gjyqimit. Megjithatë, nëpunësit konsullorë nuk do të ndërmarrin asnjë veprim në emër të një shtetasi i cili ndodhet i burgosur apo i paraburgosur, nëse ai shprehimisht e kundërshton një veprim të tillë.

#### *Neni 7*

Sipas nenit 39 të Kushtetutës, “Asnjë shtetas shqiptar nuk mund të dëbohet nga territori i shtetit. Ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, dhe vetëm me vendim gjyqësor. Ndalohet dëbimi kolektiv i të huajve. Dëbimi i individëve të huaj lejohet në kushtet e përcaktuara me ligj”.

Sipas Kodit të Procedurës Penale neni 492, “Kur merr nga një shtet i huaj një kërkesë ekstradimi, Ministria e Drejtësisë, në qoftë se nuk e refuzon atë, ia dërgon bashkë me dokumentet prokurorit pranë gjykatës kompetente. Prokurori pasi merr kërkesën urdhëron paraqitjen e të interesuarit për të bërë identifikimin e tij dhe për të marrë pëlqimin eventual për ekstradimin. Të interesuarit i bëhet e ditur se ka të drejtë të ndihmohet nga një mbrojtës. Prokurori u kërkon autoriteteve të huaja, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, dokumentacionin dhe informacionin që çmon të nevojshëm. Brenda tre muajve nga data kur ka ardhur kërkesa për ekstradim, prokurori i paraqet gjykatës kërkesën për shqyrtim. Kërkesa e prokurorit depozitohet në sekretarinë e gjykatës bashkë me aktet dhe sendet e sekuestruara. Sekretaria kujdeset për njoftimin e personit për të cilin është kërkuar ekstradimi, mbrojtësit të tij dhe përfaqësuesit eventual të shtetit kërkues, të cilët, brenda dhjetë ditëve, kanë të drejtë të shikojnë dhe të nxjerrin kopje të akteve, si dhe të këqyrin sendet e sekuestruara dhe të paraqesin memorie”.

Në përputhje me nenin 422, të Kodit të Procedurës Penale, “Prokurori, i pandehuri dhe palët private mund të apelojnë vendimet e gjykatës së shkallës së parë”. Po kështu sipas nenit 498/5, “Kundër vendimit të gjykatës, lidhur me kërkesën e ekstradimit, mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit nga personi i interesuar, nga mbrojtësi i tij, nga prokurori dhe nga përfaqësuesi i shtetit kërkues, sipas rregullave të përgjithshme të ankimit”.

#### *Neni 8*

Në Republikën e Shqipërisë, ekstradimi për në vendet e tjera të



personave të cilët dyshohen për kryerjen e veprave penale, rregullohet nga aktet e mëposhtme:

1. Neni 39/2 i Kushtetutës sipas të cilit, "Ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, dhe vetëm me vendim gjyqësor".

2. Konventa Evropiane "Për ekstradimin", nënshkruar dhe ratifikuar më 19.05.1998 dhe hyrë në fuqi më 17.08.1998, protokollet e saj shtesë 1 dhe 2 të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe marrëveshjet dypalëshe të nënshkruara me shtete të veçanta.

3. Neni 11 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë dhe Titulli X i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë të cilët përcaktojnë marrëdhëniet juridiksionale me shtetet e huaja.

Republika e Shqipërisë, duke filluar nga viti 1992 ka nënshkruar marrëveshje të ndihmës juridike reciproke në fushën civile dhe penale me Republikën e Greqisë - 17.05.1993, Federatën Ruse - 27.03.1995, IRJ të Maqedonisë - 15.01.1998 dhe Republikën e Turqisë - 20.02.1998.

Ndihma juridike në fushën penale me shtetet me të cilat nuk ka marrëveshje në këtë fushë, rregullohet mbi bazën e parimeve të Konventës Evropiane "Për ekstradimin", nënshkruar dhe ratifikuar më 19.05.1998 dhe hyrë në fuqi më 17.08.1998, si dhe nga Titulli X (nenet 408-504) i Kodit të Procedurës Penale, e cila mbulon bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e ndihmës juridike.

Organet kryesore të ekstradimit të cilat përfshihen në procesin e pranimit dhe paraqitjes së kërkesave për ndihmë juridike për dhe nga shtetet e huaja janë

Ministria e Drejtësisë - Drejtoria e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe Marrëdhënieve Juridiksionale;

Ministria e Rendit Publik - Zyra Qendrore Kombëtare, Interpol Tirana; ? Prokuroria e Përgjithshme - Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë;

Ministria e Punëve të Jashtme - Drejtoria Konsullore.

Procedura e ekstradimit nga Shqipëria parashikohet nga dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, të cilat janë në përputhje të plotë me nenin 12 të Konventës Evropiane të Ekstradimit. Sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, ekstradimi lejohet vetëm mbi bazën e një kërkesë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë. Kjo kërkesë mund t'i drejtohet

Ministrisë së Drejtësisë drejtëpërdrejt, ose në rrugë diplomatike, npr. Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Kërkesa për ekstradim duhet të përmbajë:

a - kopjen e vendimit të dënimit me burgim ose e aktit të procedimit;  
b - një relacion mbi veprën penale që i ngarkohet personit për të cilin kërkohet ekstradimi, duke treguar kohën dhe vendin e kryerjes së veprës dhe cilësimin ligjor të saj;

c - teksti i dispozitave ligjore që do të zbatohen, duke treguar nëse për veprën për të cilën kërkohet ekstradimi është parashikuar nga ligji i shtetit të huaj dënimi me vdekje;

ç - të dhënat individuale dhe çdo informacion tjetër të mundshëm që shërben për të përcaktuar identitetin dhe shtetësinë e personit, për të cilin kërkohet ekstradimi.

Shteti shqiptar nuk ka paraqitur asnjë rezervë lidhur me gjuhën që do të përdoret në procedurën e ekstradimit, pra kërkesat mund të jenë në gjuhën shqipe, anglisht, ose frengjisht.

Nëse për një rast të dhënë ka disa kërkesa ekstradimi, Ministria e Drejtësisë cakton radhën e shqyrtimit. Për këtë qëllim ajo mban parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe veçanërisht datën e marrjes së kërkesës, rëndësinë dhe vendin e kryerjes së veprës penale ose shtetësinë dhe vendbanimin e personit të kërkuar, si dhe mundësinë e një riekstradimi nga shteti kërkuar. Në qoftë se për një shkelje të vetme ekstradimi kërkohet në të njëjtën kohë nga shumë shtete, ai i jepet shtetit ndaj të cilit është drejtuar vepra penale, ose atij shteti mbi territorin e të cilit është kryer vepra.

Me kërkesën e shtetit të huaj, Ministria e Drejtësisë vendos nëse do ta refuzojë apo jo ekstradimin. Në rast se ajo nuk e refuzon ekstradimin, dokumentacioni i dërgohet Prokurorisë së Përgjithshme e cila merr masa për t'ia nisur prokurorit pranë gjykatës kompetente. Prokurori duhet që brenda 3-muajsh nda data e mbërritjes së kërkesës për ekstradim t'ia paraqesi atë para gjykatës kompetente.

Gjykata mund të vendosë përkohësisht një masë shtrënguese para se të vijë kërkesa e ekstradimit. Kjo masë mund të vendoset kur:

a - shteti i huaj ka deklaruar se kundër personit është marrë një masë për kufizimin e lirisë personale ose një vendim dënimi me burgim dhe se ka ndër mend të paraqesë kërkesë për ekstradim;

b - shteti i huaj ka paraqitur të dhëna të hollësishme për veprën

penale dhe elemente të mjaftueshme për identifikimin e personit;

c - kur ka rrezik ikjeje.

Masat shtrënguese revokohen në qoftë se brenda tetëmbëdhjetë ditëve dhe gjithsesi në maksimum dyzet ditë nga njoftimi i mësipërm nuk vjen në Ministrinë e Drejtësisë kërkesa e ekstradimit dhe dokumentet që i bashkëlidhen asaj.

Masat shtrënguese revokohen, nëse brenda 3-muajsh nga fillimi i ekzekutimit të tyre, nuk ka përfunduar procedimi para gjykatës.

Kompetenca për të vendosur masën u takon, sipas radhës, gjykatës së rrethit gjyqësor në territorin e së cilës personi ka vendbanimin, vendqëndrimin apo banesën, ose gjykatës së rrethit ku ai gjendet. Në qoftë se kompetenca nuk mund të përcaktohet në mënyrat e treguara më sipër kompetente është Gjykata e Shkallës së Parë - Tiranë.

Gjykata mund të vendosë edhe sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që i përkasin veprës penale. Nga ana tjetër Ministria e Drejtësisë njofton shtetin e huaj për zbatimin e përkohshëm të masës shtrënguese dhe të sekuestrimit eventuale.

Pasi merr kërkesën e prokurorit gjykata cakton seancën dhe njofton, të paktën dhjetë ditë përpara, prokurorin, personin me të cilin është kërkuar ekstradimi, mbrojtësin e tij dhe përfaqësuesin eventuale të shtetit kërkuar. Gjykata merr të dhëna dhe bën verifikimet që i çmon të nevojshme, si dhe dëgjon personat e thirrur në gjykim.

Gjykata jep vendim në favor të ekstradimit kur ka të dhëna të rëndësishme fajësie ose kur ekziston një vendim dënimi i formës së prerë. Në këtë rast, kur ka kërkesë nga Ministria e Drejtësisë, të paraqitur nëpërmjet prokurorit, gjykata vendos paraburgimin e personit që duhet të ekstradohet dhe që ndodhet në gjendje të lirë, si dhe sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që i përkasin veprës penale.

Gjykata jep vendim kundër ekstradimit kur janë rastet e parashikuara për mospranimin e kërkesës së ekstradimit. Në këtë rast, ekstradimi nuk mund të bëhet. Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankimi para gjykatës kompetente, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të RSH.

Nuk mund të jepet ekstradimi:

a - për një veprë me karakter politik ose kur rezulton që ai kërkohet për qëllime politike;

b - kur ka arsye të mendohet se personi që kërkohet do t'u

nënshtrahet persekutimeve ose diskriminimeve për shkak të racës, fesë, seksit, shtetësisë, gjuhës, bindjeve politike, gjendjes personale a shoqërore ose dënimeve a trajtimeve të egra, çnjerëzore a poshtëruese ose veprimeve që përbëjnë shkelje të një të drejte themelore të njeriut;

c - kur personi që kërkohet ka kryer një vepër penale në Shqipëri;

ç - kur ka filluar procedimi ose është gjykuar në Shqipëri edhe pse vepra është kryer jashtë shtetit;

d - kur vepra penale nuk parashikohet si e tillë nga legjislacioni shqiptar;

e - kur për veprën penale është dhënë amnisti nga shteti shqiptar;

f - kur personi i kërkuar është shtetas shqiptar dhe nuk ka marrëveshje që të parashikojë ndryshe;

g - kur është parashikuar ndjekja penale ose dënimi sipas ligjit të shtetit që e kërkon.

Megjithëse Kodi i Procedurës Penale nuk parashikon si arsye refuzimi shkeljet ushtarake dhe fiskale të parashikuara nga neni 4 dhe 5 i Konventës Evropiane të Ekstradimit, meqënëse në Shqipëri është palë në këtë Konventë, detyrohet t'i zbatojë këto dispozita.

Vendimi kundër ekstradimit ndalon dhënien e një vendimi të mëpasshëm në favor të ekstradimit si rezultat i një kërkesë të re të paraqitur për të njëjtat fakte nga i njëjti shtet, përveçse kur kërkesa mbështetet në elemente që nuk kanë qenë vlerësuar nga gjykata. Kundër vendimit të gjykatës, lidhur me kërkesën e ekstradimit, mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit nga personi i interesuar, nga mbrojtësi i tij, nga prokurori dhe nga përfaqësuesi i shtetit kërkues, sipas rregullave të përgjithshme të ankimit.

Ministria e Drejtësisë disponon për ekstradimin brenda tridhjetë ditëve nga data që vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë. Me mbarimin e këtij afati, edhe kur nuk është disponuar nga ministri, personi për të cilin është kërkuar ekstradimi, në qoftë se është i burgosur, lirohet. Personi lirohet edhe në rast refuzimi të kërkesës së ekstradimit. Ministria e Drejtësisë i komunikon shtetit kërkues vendimin dhe, kur ky është pozitiv, vendin e dorëzimit dhe datën nga fillimi i së cilës do të jetë e mundur të veprohet. Afati i dorëzimit është pesëmbëdhjetë ditë nga data e caktuar dhe me kërkesë të arsyetuar të shtetit kërkues mund të zgjatet edhe pesëmbëdhjetë ditë të tjera. Kur ka shkaqe që nuk varen nga palët, mund të caktohet një datë tjetër dorëzimi, por gjithmonë duke

u zbatuar afatet e caktuara më lart. Vendimi i ekstradimit e humbet fuqinë dhe i ekstraduari lirohet kur shteti kërkues nuk vepron, në afatin e caktuar, për marrjen në dorëzim të të ekstraduarit.

Ekzekutimi i ekstradimit pezullohet kur i ekstraduari duhet të gjykohet në territorin e shtetit shqiptar ose duhet të vuajë një dënim për vepra penale të kryera para ose pas asaj për të cilën është dhënë ekstradimi. Por, Ministria e Drejtësisë pasi dëgjon autoritetin procedues kompetent të shtetit shqiptar ose atë të ekzekutimit të dënimit, mund të urdhërojë dorëzimin e përkohshëm në shtetin kërkues të personit që duhet ekstraduar, duke përcaktuar afatet dhe mënyrën e veprimit. Ministria mund të bjerë dakord që dënimi i mbetur të vuhet në shtetin kërkues (neni 500 i K.P.P.).

Për veprat penale të torturës, parashikuar nga neni 86 i Kodit Penal, janë bërë 5 shpallje për kërkim ndërkombëtar nga ana e Zyrës Qendrore Kombëtare – Interpol Tirana. Nga ana e homologëve në shtetet e tjera, Zyra Qendrore Kombëtare – Interpol Tirana ka patur gjithmonë mbështetjen e duhur dhe në këtë drejtim nuk ka patur zvarritje për çështje të veçanta.

#### *Neni 9*

Shqipëria është palë në Konventën Evropiane “Për ndihmën e ndërsjelltë në çështjet penale”, dhe protokollet e saj shtese, nënshkruar më 19.05.1998, ratifikuar me 04.04.2000 dhe hyrë në fuqi për Republikën e Shqipërisë me 03.07.2000.

Në bazë të ratifikimit të kësaj Konvente, Republika e Shqipërisë merr përsipër dhënien e ndihmës së duhur reciproke në çështjet penale në përputhje me dispozitat e konventës.

Gjithashtu, Shqipëria është palë në Konventën Evropiane “Për transferimin e procedimeve në çështjet penale”, nënshkruar më 19.05.1998, ratifikuar me 04.04.2000 dhe hyrë në fuqi më 05.07.2000. Në lidhje me Protokollin shtese të Marrëveshjes Evropiane „Për transmetimin e kërkesave për ndihmë juridike”, nënshkruar më 12.11.2001 dhe ratifikuar nga Kuvendi, është depozituar instrumenti i ratifikimit.

Procedura e komunikimit ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera në fushën e ndihmës së ndërsjelltë juridike në çështjet penale, rregullohet nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacioni Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë. Në

këtë mënyrë sipas nenit 505 të këtij kodi, „Ministria e Drejtësisë vendos që t’i jepet rrugë letërporosisë së një autoriteti të huaj për komunikimet, njoftimet dhe për marrjen e provave, përveçse kur çmon se veprimet e kërkuara rrezikojnë sovranitetin, sigurimin, ose interesa të rëndësishme të shtetit. Ministria nuk i jep rrugë letërporosisë kur del e qartë se veprimet e kërkuara janë të ndaluara shprehimisht nga ligji ose kur vijnë në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik shqiptar. Ministria nuk i jep rrugë letërporosisë edhe kur ka arsye të bazuara për të menduar se konsideratat lidhur me racën, fenë, seksin, kombësinë, gjuhën, bindjet politike apo gjendjen shoqërore mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e procesit, si dhe kur nuk del që i pandehuri të ketë shprehur lirisht pëlqimin e tij për letërporosinë. Në rastet kur letërporosia ka si objekt thirrjen e një dëshmitari, të një eksperti a të një të pandehuri para autoritetit gjyqësor të huaj, Ministria e Drejtësisë nuk i jep rrugë letërporosisë kur shteti kërkues nuk jep garancinë e duhur për paprekshmërinë e personit të thirrur. Ministria ka të drejtë të mos i japë rrugë letërporosisë kur shteti kërkues nuk jep garancinë e duhur të reciprocitetit“.

#### *Neni 10*

Aktualisht, aktiviteti dhe praktika e sistemit të burgjeve bazohet në një paketë aktesh ligjore, e cila konsiderohet me vlerë thelbësore në drejtim të ndërtimit të një shteti demokratik. Kjo paketë ligjore përbëhet nga:

Ligji nr. 8321, datë 02.04.1998, “Për Policinë e Burgjeve”,

Ligji nr.8328 datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” dhe

Ligji nr. 8331, datë 21.04.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

Në zbatim të këtyre akteve ligjore u hartua dhe miratua Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, projekti i së cilës u miratua edhe nga ekspertë të Këshillit të Evropës dhe u aprovua nga Qeveria shqiptare me Vendimin nr. 63, datë 9 mars 2000. Projekti i rregullores u studiua edhe nga specialistë të ngarkuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, vërejtjet e të cilëve u vlerësuan dhe u pasqyruan në një masë të konsiderueshme në versionin final të rregullores. Gjithashtu, ky kuadër ligjor u plotësua me miratimin e Rregullores së Policisë së Burgjeve, në qershor 2000.

Në bazë të nenit 18 të ligjit 8328 datë 16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim" dhe Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, institucionet e vuajtjes së dënimit (burgjet), kanë përgatitur rregulloret përkatëse. Përveç kësaj, Ministria e Drejtësisë dhe Administrata e Burgjeve kanë zbatuar me rigorozitet rekomandimet e ndryshme të bëra nga Këshilli i Evropës, të cilat në shumë raste janë konvertuar në Urdhra Ministri ose Drejtori të Përgjithshëm, sipas problematikës dhe janë dërguar në institucionet përkatëse për zbatim.

Stafi i burgjeve (civil apo ushtarak), administron veprimtarinë në burgje në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore. Rastet e përdorimit të forcës janë të përcaktuara shprehimisht në ligj dhe përdorimi i saj konsiderohet si mjeti i fundit për zgjidhjen e një konflikti apo situatë të caktuar. Sipas nenit 48 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, "Stafit të burgjeve i ndalohet të kryejë ndaj të dënuarve veprime të pabazuara në ligj, ndërshkime apo trajtime çnjerëzore apo denigruese, si dhe çdo lloj torture". Kjo dispozitë është e përfshirë edhe në të gjitha rregulloret e veçanta të institucioneve të dënimit.

Ligji nr. 8321, datë 02.04.1998, "Për Policinë e Burgjeve", neni 8 parashikon se: "Armatimi nuk mund të mbahet në mjediset e brendshme të burgut të destinuar për qëndrim dhe përdorim nga të dënuarit, por vetëm në mjedise jashtë tyre dhe në shërbimet e shoqërimit jashtë institucionit. Llojet, normat, rastet dhe mënyra e vënies në përdorim të armatimit vetjak, bëhet vetëm në rastet e parashikuara me ligjin "Për Policinë e Rendit". Mjetet e tjera të forcës vihen në përdorim vetëm me urdhër të drejtorit të Policisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve ose në raste të jashtëzakonshme me urdhër të shefit të Policisë së Institucionit".

Në sistemin arsimor të R. Shqipërisë masat për arsimimin, informimin dhe trajnimin e personelit në lidhje me ndalimin e torturës kanë disa synime:

- njohjen e konventës për ndalimin e të gjitha formave të torturës dhe të legjislacionit përkatës administrativ e penal për këtë problem;
- parandalimin e përdorimit të çdo forme të torturës nëpërmjet zbatimit të kërkesave të konventës dhe të legjislacionit përkatës;
- evidentimin dhe kontrollin e shfaqjeve dhe dukurive të ndryshme, që përmbajnë elemente të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të formave të ndryshme të torturës;
- përdorimin e formave dhe mënyrave të përshtatshme për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e kategorive të ndryshme sociale në lidhje me ndalimin e torturës, etj.

Shtrirja e masave për arsimimin, informimin dhe trajnimin e personelit në lidhje me ndalimin e torturës.

Konkretisht, njohja në mënyrë tërësore e Konventës dhe e legjislacionit administrativ e penal në lidhje me ndalimin e torturës realizohet në shkollat e larta, në ato fakultete, degë ose profile, që përgatisin personel, në veprimtarinë e të cilit ekzistojnë rrethanat për shfaqjen e formave të ndryshme të torturës.

Format dhe mënyrat e informimit dhe të trajnimit për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin në lidhje me ndalimin e torturës.

Janë përdorur forma dhe mënyra të larmishme të informimit dhe trajnimit për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e personelit dhe të kategorive të ndryshme sociale në lidhje me ndalimin e torturës:

- leksione dhe biseda për sqarimin dhe zbërthimin në mënyra sistematike të Konventës dhe të legjislacionit administrativ e penal në lidhje me ndalimin e torturës;

- kënde dhe aktivitete të posaçme në shkolla për të drejtat e njeriut, posaçërisht të fëmijës, duke evituar sidomos të drejtën e fëmijëve që të mos detyrohen për të bërë punë të dëmshme dhe të rënda, të e fëmijës që të mos përcmohet për shkak të pamjes, ngjyrës, seksit, gjuhës, etj.

- shqyrtimi dhe diskutimi rreth rasteve konkrete të dhunës në mjedise publike apo familjare, të vrojtuar drejtpërdrejt ose të evidentuara me anketime e intervistime, nga media e shkruar dhe elektronike, etj.;

- komente e diskutime rreth pjesëve historike, letrare, artistike (filma, piktura, etj.) me tematika në lidhje me format e ndryshme të torturës;

- ndërmarrja e iniciativave dhe aksioneve konkrete për t' i nxjerrë fëmijët nga situata të vuajtjeve torturuese. Të tilla janë masat e programe për kthimin në shkollë të fëmijëve, që janë nxjerrë dhunshëm në rrugë apo në semafore, dhe sidomos të fëmijëve të ngujuar për shkaqe gjakmarrjeje. Veprimtarë të organeve të pushtetit, të shoqatave joqeveritare, të komuniteteve fetare dhe mësues e nxënës të disa zonave në veri të vendit tonë kanë ndërmarrje një lëvizje me rëndësi të ndjeshme sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere për pajtimin e gjaqeve dhe nxjerrjen e fëmijëve nga ngujimi dhe kthimin e tyre në shkolla. Edhe fëmijë të tillë kanë ndikuar në uljen e shifrës së atyre, që kanë braktisur shkollën, konkretisht, nga 6.4% në vitin 1992, në 3.1% në vitin 1997 dhe 2% në vitin 2002.

- dënime penale për raste flagrante të sjelljeve dhe qendrimeve, që kanë si pasojë shfaqje me lloje të ndryshme të elementeve të torturës.



Kështu gjatë vitit 2002 u dënua me burgim një drejtues shkolle në rrethin e Fierit, në sjelljen e të cilit u denoncuan dhe u vërtetuan veprime ngacmuese seksuale ndaj fëmijëve.

Pra mund të thuhet se ka një informim të mirë, si dhe një sensibilizim dhe ndërgjegjësim të dukshëm të opinionit shoqëror dhe posaçërisht të kategorive përkatëse sociale në lidhje me ndalimin e çdo forme të torturës.

#### *Neni 11*

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 28 parashikon se, “Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personi, të cilit i është hequr liria, duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin, si dhe t’i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij. Personi, të cilit i është hequr liria, duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirim të tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim. I paraburgosuri ka të drejtë të ankohet kundër vendimit të gjyqtarit. Ai ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të procedohet i lirë përkundërt një garancie pasurore sipas ligjit. Në të gjitha rastet e tjera, personi, të cilit i hiqet liria në rrugë jashtëgjyqësore, mund t’i drejtohet në çdo kohë gjyqtarit, i cili vendos brenda 48 orëve për ligjshmërinë e kësaj mase. Çdo person, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij.

Neni 148 i Kushtetutës parashikon se: “Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj. Prokurorët janë të organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor si një organ i centralizuar. Në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve”. Në vijim, neni 149/4 parashikon se “Prokurori i Përgjithshëm informon herë pas here Kuvendin për gjendjen e kriminalitetit”.

Ligji nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 4 parashikon se: “Prokurorët në ushtrimin e detyrës u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve. Prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre duke respektuar

parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave, interesave dhe lirive të ligjshme të njeriut. Urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë jepen me shkrim dhe janë të detyrueshme për prokurorin më të ulët. Prokurorët marrin masa për ushtrimin e ndjekjes penale, zbatimin e udhëzimeve që jepen në përputhje me ligjin, të vendimeve penale dhe të urdhrave të gjykatës, si dhe ndihmojnë në miradministrimin e drejtësisë”.

Sipas nenit 56 të të njëjtit ligj, “Ministri i Drejtësisë kontrollon në mënyrë të planifikuar ose në bazë të informacioneve të dhëna nga organe, institucione ose persona të interesuar, ligjshmërinë e veprimtarisë së prokurorëve. Objekti i kontrollit të Ministrisë së Drejtësisë në organin e prokurorisë është:

a) ndjekja e ecurisë së çështjeve që përmbahen në rekomandimet vjetore të dhëna nga Këshilli i Ministrave për luftën kundër kriminalitetit;

b) respektimi i afateve të hetimit;

c) respektimi i afateve të paraburgimit;

ç) respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të subjekteve të procedimit penal dhe, në veçanti, të të ndaluarve dhe të arrestuarve;

d) rregullshmëria dhe vijueshmëria e kryerjes të veprimeve hetimore; dh) respektimi i detyrimit ligjor të prokurorit për fillimin e ndjekjes penale;

e) ecuria e politikës penale dhe, në veçanti, e politikës së dënimeve që ndiqet nga prokurorët:

ë) rregullshmëria e mbajtjes dhe administrimit të statistikave dhe regjistrimit të veprave penale;

f) respektimi i parimeve të drejtësisë, barazisë dhe ligjshmërisë së veprimtarisë së prokurorit në marrëdhëniet e tij me subjektet e tjera të procedimit penal.

Kontrolli në çdo rast duhet të jetë i paralajmëruar dhe për çështje për të cilat kanë përfunduar hetimet paraprake. Për rezultatin e kontrollit vihet në dijeni Presidenti i Republikës, Prokurori i Përgjithshëm dhe prokurori, veprimtaria e të cilit ka qenë objekt kontrolli”.

Në bazë të nenit 2 të Kodit të Procedurës Penale, Dispozitat procedurale caktojnë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjyqimit të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit.

Duke vijuar nenet 5 dhe 38 të Kodit parashikojnë se, Liria e personit mund të kufizohet me masa sigurimi vetëm në rastet dhe mënyrat e përcaktuara me ligj. Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit poshtërues. Të dënuarve me burgim u sigurohet trajtimi njerëzor dhe rehabilitimi moral.përcaktuar me ligj. Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit poshtërues. Të dënuarve me burgim u sigurohet trajtimi njerëzor dhe rehabilitimi moral.

I pandehuri, edhe kur është me masë sigurimi izoluese ose kur i është hequr liria për çdo lloj shkakut tjetër, merret në pyetje i lirë, përveç rasteve kur duhen marrë masa për të parandaluar rrezikun e ikjes ose të dhunës. Nuk mund të përdoren, as me pëlqimin e të pandehurit, metoda ose teknika për të ndikuar mbi lirinë e vullnetit ose për të ndryshuar aftësinë e kujtesës e të vlerësimit të fakteve. Para se të ketë filluar pyetja, të pandehurit i shpjegohet se ka të drejtë të mos përgjigjet dhe se edhe po të mos përgjigjet, procedimi do të vazhdojë.

Organi procedues i shpjegon të pandehurit, në formë të qartë dhe të përpiktë, faktin që i atribuohet, e njeh me provat që ekzistojnë kundër tij dhe, kur hetimet nuk dëmtohen, i tregon burimet e tyre. Organi procedues e fton atë të shpjegojë gjithçka që çmon të dobishme për mbrojtjen e tij dhe i bën drejtpërsëdrejti pyetje. Kur i pandehuri nuk pranon të përgjigjet kjo shënohet në procesverbal. Në procesverbal shënohen, kur është e nevojshme, edhe tiparet fizike dhe shenjat e veçanta eventuale të të pandehurit (neni 39).

Sipas procedurës prokurori verifikon identitetin personal të të pandehurit, moshën e tij, personalitetin e të pandehurit të mitur dhe përgjegjshmërinë e të pandehurit. Në rastet kur del se gjendja mendore e të pandehurit është e tillë që pengon pjesëmarrjen e vetëdijshme në procedim, organi që procedon merr vendim për pezullimin e procedimit, por gjithnjë kur nuk duhet të merret vendim pafajësie ose pushimi.

Me vendimin e pezullimit organi që procedon i cakton të pandehurit një kujdestar të posaçëm, të cilit i jepen të drejtat e përfaqësuesit ligjor. Kundër vendimit të pezullimit mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Kasacionit nga prokurori, i pandehuri ose mbrojtësi i tij. Pezullimi nuk pengon organin procedues që të marrë prova që mund të çojnë në pafajësinë e të pandehurit dhe kur vonesa paraqet rrezik, çdo provë tjetër të kërkuar nga palët. Në veprimet që duhet të kryhen rreth personit të të pandehurit, si dhe në ato ku i pandehuri ka të drejtë të jetë i pranishëm merr pjesë kujdestari i posaçëm i tij.

Në çdo rast kur gjendja mendore e të pandehurit tregon se ai duhet të kurohet, gjykata, vendos, edhe kryesisht shtrimin e të pandehurit në një institucion psikiatrik. Kur është vendosur ose duhet vendosur masa mjekësore e detyrueshme për të pandehurin, gjykata urdhëron që i pandehuri të ruhet në një institucion psikiatrik. Gjatë hetimeve paraprake, prokurori i kërkon gjykatës të vendosë për shtrimin e të pandehurit në një institucion psikiatrik dhe kur vonesa paraqet rrezik, urdhëron shtrimin e përkohshëm deri në marrjen e vendimit nga gjykata (neni 46).

Në vijim sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, Oficerët dhe agentët e policisë gjyqësore që kanë kryer një arrestim ose ndalim ose kanë marrë në dorëzim të arrestuarin, njoftojnë menjëherë prokurorinë e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi. Ato i bëjnë të ditur të arrestuarit ose të ndaluarit se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë, si dhe të drejtën që ka për të zgjedhur mbrojtës dhe njoftojnë menjëherë mbrojtësin e zgjedhur ose atë të caktuar kryesisht nga prokurori. Oficerët dhe agentët e policisë gjyqësore e vënë të arrestuarin ose të ndaluarin në dispozicion të prokurorit, në dhomat e paraburgimit, sa më shpejt, nëpërmjet dërgimit të procesverbalit përkatës. Kur i arrestuari ose i ndaluar është i sëmurë ose i mitur, prokurori mund të urdhërojë që ai të mbahet në ruajtje në banesën e tij ose në një vend tjetër të ruajtur. Policia gjyqësore, me pëlqimin e të arrestuarit ose të ndaluarit, duhet të lajmërojë pa vonesë familjarët. Kur i arrestuari ose i ndaluar është i mitur lajmërohet detyrimisht prindi ose kujdestari (neni 255).

Prokurori merr në pyetje të arrestuarit ose të ndaluarin në prani të mbrojtësit të zgjedhur ose të caktuar kryesisht. Ai i njofton të arrestuarin ose të ndaluarin faktin për të cilin procedohet dhe arsyet e marrjes në pyetje, duke i treguar të dhënat në ngarkim të tij dhe, kur nuk i shkaktohet dëm hetimeve, edhe burimet" (neni 256).

Në bazë të nenit 46 të ligjit nr.8328 datë 16.04.1998 "Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim", "Në institucionet, izolimi vendoset:

- kur parashikohet për arsye shëndetësore;
- në ekzekutim të masës së vendosjes në regjim të mbikëqyrjes së veçantë;
- në rastet e parashikuara në nenin 13 të këtij ligji;
- në të gjitha rastet e personave të arrestuar dhe të ndaluar.

Neni 57 parashikon se, "Nuk lejohet përdorimi i forcës fizike ndaj të dënuarve, nëse nuk është e domosdoshme për të ndaluar aktet e dhunshme, tentativat e largimit nga institucioni, si dhe për mposhtjen e kundërshtimit edhe kur ai është pasiv, në zbatimin e urdhrave të dhëna. Personeli, i cili për çdo lloj arsye ka përdorur forcën fizike ndaj të dënuarve, duhet menjëherë të verë në dijeni me shkrim drejtorin e institucionit, i cili nga ana e tij bën kontrollin dhe siguron ndihmën shëndetësore të të dënuarve dhe vetëm pas kësaj verifikon çështjen. Mjetet e shtrëngimit fizik nuk mund të përdoren si ndëshkim, por vetëm në rastet që parashikohen shprehimisht në rregullore dhe për të shmangur përpjekjet për largimin nga institucioni, dhunën ndaj personave, dëmtimin e sendeve, si dhe për të garantuar shëndetin e vetë të dënuarit. Përdorimi i mjeteve të shtrëngimit fizik duhet të jetë i kufizuar në kohë dhe për kalimin për një periudhë mbi 72 orë duhet të merret miratimi i prokurorit. Gjatë shtrëngimit fizik, i dënuari duhet të jetë nën kontrollin e vazhdueshëm të shërbimit shëndetësor"

Në rregulloren e burgjeve përcaktohen llojet, natyra e forcës dhe e mjeteve të shtrëngimit dhe rregullat e përdorimit të tyre me funksion parandalues dhe në përputhje me individualitetin e të dënuarit. Ndalohet përdorimi i mjeteve të forcës dhe atyre shtrënguese, që formojnë armë ose i lëndëve narkotike në kuptim të Kodit Penal, si dhe ato që kanë natyrë torturuese dhe hipnoze. Policët e shërbimit brenda institutit nuk duhet të mbajnë armë, me përjashtim të rasteve të parashikuar në ligjin "Për Policinë e Burgjeve".

Prokurorët në shkallë vendi, në ushtrimin e funksionit të ndjekjes penale në fazën e hetimeve paraprake mbikqyrin ligjshmërinë e veprimtarisë së oficerëve/agjentëve të policisë gjyqësore duke synuar respektimin e këtyre parimeve dhe normave procedurale penale, që parashikojnë kushtet dhe kriteret për arrestimin në flagrancë, ose ndalimin dhe që ndalojnë sjellje apo veprime të paligjshme gjatë procedimit të tyre.

Zbatimi i ligjit dhe rregullave në institucionet e vuajtjes së dënimit, realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të të dënuarve mbikëqyrret nga prokurori i caktuar posaçërisht në prokurorinë e territorit në të cilin ndodhet institucioni. Në burgjet e sigurisë së lartë mbikëqyrja bëhet nga prokurorë të autorizuar nga Prokurori i Përgjithshëm. Në të gjitha kategoritë e institucioneve për zbatimin e ligjit dhe rregullave përkatëse, të drejtën e kontrollit e ka edhe Këshilli i Mbikëqyrjes, krijuar në bazë të ligjit "Për vënien në ekzekutim të vendimeve penale". Mbi bazë kërkesë,

ankese ose kryesisht, ai ka të drejtë të bëjë të gjitha verifikimet e nevojshme dhe, mbi bazën e tyre, të kërkojë marrjen e masave nga drejtoria e institucionit, t'i rekomandojë prokurorit ushtrimin e kompetencave ose t'i paraqesë kërkesa drejtpërdrejt gjykatës kompetente.

Prokurori duhet të mbikqyrë drejtpërdrejt, periodikisht ose pa paralajmërim institucionet e ekzekutimit të dënimeve me burgim, duke u shoqëruar, kur është rasti, nga specialistë të fushave përkatëse. Për konstatimet dhe për parregullsitë apo pengesat në drejtim të kompetencës së tij të mbikëqyrjes, prokurori, paraqet kërkesë të drejtori i institucionit për rivendosjen e menjëhershme të ligjit apo rregullit të shkelur, për realizimin e së drejtës së të dënuarit, si dhe nisjen e procedimit disiplinor, administrativ apo të zhdëmtimit ndaj shkaktarëve, përveç kur është vendi për procedim penal.

Kur kërkesa e prokurorit nuk merret në konsideratë dhe në të gjitha rastet kur rivendosja e ligjit, rregullit apo e së drejtës të shkelur është kompetencë e gjykatës sipas kësaj ligje ose organeve të tjera kompetente, çështja u paraqitet atyre për shqyrtim.

Neni 70 i ligjit nr.8328 datë 16.04.1998 "Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim" (ndryshuar) parashikon mënyrën e realizimit të mbikëqyrjes së vuajtjes së dënimit nga ana e prokurorit e cila zhvillohet nëpërmjet:

1. marrjes dhe evidentimit të njoftimit për ekzekutimin e vendimit me burgim nga administrata e institucionit;

2. pranimit të ankesave dhe kërkesave nga të dënuarit, me shkrim ose drejtpërdrejt;

3. marrjes së informacionit, ankesave dhe kërkesave të të dënuarve, kërkesave të Këshillit të Mbikëqyrjes ose nga persona që kanë statusin e vizitorit, sipas nenit 41 të ligjit nr.8328 datë 16.04.1998 "Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim", ose të organeve shtetërore apo organizatave jo qeveritare, të cilat kanë kontrolluar apo vizituar institucionin sipas kompetencës që u njeh ligji ose me autorizim, si dhe nga avokati i të dënuarit;

4. kërkimit të informacioneve nga administrata e institucionit;

5. verifikimit mbi dokumente, në objekte, pajisje dhe mjedise brenda dhe jashtë institucionit, që kanë lidhje me të dënuarit. Kur është vendi, bëhen verifikime edhe në vetë personin e dënuar ose punonjëseve të institucionit. Për realizimin e mbikëqyrjes prokurori mund të marrë

edhe specialistë të fushave përkatëse. Në çdo rast dhe pavarësisht nëse konstatohen shkelje e parregullsi, gjatë verifikimit, prokurori mban procesverbal, i cili nënshkruhet nga drejtori i institucionit ose i ngarkuari prej tij, me të drejtën e pasqyrim të observacioneve.

Nëpërmjet mbikqyrjes së veprimtarisë së agentëve/oficerëve të policisë gjyqësore ndaj të shoqëruarve dhe të paraburgosurve, si dhe praktikës së disa procedimeve penale për veprime arbitrare të disa punonjësve të Policisë së Shtetit janë evidentuar raste të keqtrajtimit të të shoqëruarve, të arrestuarve në flagrancë, ose të ndaluarve, si gjatë marrjes në pyetje në Drejtoritë, ose Komisaritet e Policisë në disa rrethe, ashtu edhe nëpërmjet mbajtjes së të shoqëruarve tej afatit ligjor në këto ambiente.

Mbi bazën e kallëzimeve, ankimeve dhe nëpërmjet iniciativës vetjake, prokurorët kanë filluar procedimin penal për rastet e konstatuara të dhunës dhe/ose keqtrajttimeve në dëm të shëndetit, të të paraburgosurve, duke hetuar në kohë këto çështje për të vënë fajtorët para përgjegjësisë penale.

Neni 71 i ligjit nr.8328 datë 16.04.1998 "Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim" parashikon se, Gjykata në territorin e së cilës ndodhet institucioni, shqyrton me një gjyqtar të gjitha rastet që përcaktohen shprehimisht në këtë ligj, si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me të drejtat e të dënuarit, të cilat nuk janë zgjidhur nga institucioni mbi ankimin e të dënuarit ose kërkesës së prokurorit, me përjashtim të çështjeve për të cilat në Kodin e Procedurës Penale është përcaktuar kompetenca.

Sipas nenit 58 të ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998, "Për ekzekutimin e Vendimeve Penale", "Në vendet e vuajtjes së dënimeve, mund të kërkojnë informacione dhe sqarime edhe organe të tjera shtetërore dhe organizatat joqeveritare lidhur me rregullsinë e ekzekutimit të vendimit dhe respektimin e të drejtave të të dënuarit, duke rekomanduar marrjen e masave përkatëse dhe kur e shohin me vend, të kërkojnë ndërhyrjen e prokurorit. Nga rregulli i mesipërm bëjnë përjashtim institucionet e vuajtjes së dënimit me burgim, për të cilat zbatohen kriteret e përcaktuara me ligj të veçantë".

Nëpërmjet praktikave të dërguara, kontrolleve të ushtruara, letër porosive dhe rregullores së paraburgimit është trajnuar në vijueshmëri nga Drejtoria Qendrore e Policisë së Rendit i gjithë efektivit, dhe në veçanti personeli që merret me trajtimin e të paraburgosurve. Këto

trajnime janë kryer me qëllim respektimin e ligjit, Konventës të Kombeve të Bashkuara (CAT) dhe Konventave Evropiane.

Në aktet normative përkatëse për veprimtarinë e brendshme të paraburgimit janë parashikuar masa disiplinore ndaj personave të cilët shkelin rregjimin e brendshëm të paraburgimit. Gjithashtu bëhen përpjekje të mëdha nga ana e efektivave të policisë për parandalimin e torturës dhe çdo veprimi tjetër çnjerëzor, veçanërisht gjatë shoqërimit të personave dhe në këtë kuadër janë ndërshtuar rëndë rastet e evidentuara të tejkalimit të forcës në kundërshtim me aktet normative.

Po kështu, Drejtoria e Policisë Kriminale dhe asaj të Rendit janë në fazat e hartimit të një manuali për përdorim nga ana e efektivave të policisë, i cili duke u bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore do të shërbejë për njohjen e detyrimeve dhe të të drejtave të personave që shoqërohen nga ana e policisë. Gjithashtu, manuali do të përfshijë njohjen e efektivave të policisë me kohën e lejueshme të mbajtjes së personave në ambientet e komisariateve, kohën e hetimit dhe të paraburgimit deri në momentin e lirim, apo arrestimit.

### *Neni 12*

Neni 1 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë parashikon se: "Legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës e të ligjeve të shtetit".

Sipas nenit 280 të Kodit të Procedurës Penale "Prokurori dhe policia marrin dijeni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët, pra prokurori mund ta fillojë procedimin penal duke u mbështetur mbi këtë bazë".

Detyrimin e kallëzimit me shkrim e kanë edhe nëpunësit publikë, personeli mjekësor dhe policia gjyqësore. Në vijim, çdo person që ka marrë dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm. Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore me gojë ose me shkrim, personalisht, ose nëpërmjet përfaqësuesit.

Pasi kryen veprimet e nevojshme hetimore, policia gjyqësore i dërgon aktet prokurorit bashkë me një relacion shpjegues për faktin dhe provat, si dhe me sugjerimet e veta për mënyrën e përfundimit të



hetimeve. Prokurori, pasi shqyrton aktet dhe sigurohet që i pandehuri ose mbrojtësi është njohur me to vendos, sipas rastit, pushimin e çështjes ose dërgimin e saj në gjykatë.

Nenet 277, 278 dhe 279 i Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me hetimet paraprake parashikojnë se, "Prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale. Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore. Gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, të dëmtuarit dhe palëve private, vendos gjykata. Veprimet hetimore janë sekrete derisa i pandehuri të mos ketë marrë dijeni për to. Në rast nevoje për vazhdimin e hetimeve prokurori mund të urdhërojë ruajtjen e sekretit për akte të veçanta deri në përfundim të hetimeve. Prokurori mund të lejojë, me vendim të arsyetuar, publikimin e akteve të veçanta ose të pjesëve të tyre. Aktet e publikuara depozitohen në sekretarinë e prokurorit.

Në bazë të nenit 9/b të ligjit nr.8737, datë 12.02.2001 "Për Prokurorinë në Republikën e Shqipërisë", pranë Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm funksionojnë drejtoritë e hetimit dhe të kontrollit të ndjekjes penale, të cilat bashkërendojnë, kontrollojnë dhe ndihmojnë prokuroritë pranë gjykatave në ushtrimin e funksioneve të tyre.

### *Neni 13*

Sipas nenit 28/1,2,3 të Kushtetutës, "Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personi, të cilit i është hequr liria, duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin, si dhe t'i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij. Personi, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, paragrafi 2, nënparagrafi c, duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimin e tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim. I paraburgosuri ka të drejtë të ankohet kundër vendimit të gjyqtarit. Ai ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të procedohet i lirë përkundrejt një garancie pasurore sipas ligjit".

Neni 43, "Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe".

Neni 48, "Kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t' u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj".

Në vijim, në bazë të nenit 131/f, Gjykata Kushtetuese është kompetente për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Sipas nenit 311 të Kodit Penal, Kanosja që i bëhet të dëmtuarit nga vepra penale me qëllim që të mos kallzojë, të mos ankohet apo të tërheqë kallzimin apo ankimin e bërë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Parimi i hetimit paraprak dhe gjykimin të pavarur garantohet nga neni 15/3 i Kodit të Procedurës Penale sipas të cilit, "Nuk mund të ushtrojë në të njëjtin procedim detyrën e gjyqtarit ai që ka qenë prokuror ose që ka kryer veprime të policisë gjyqësore ose që ka qenë mbrojtës, përfaqësues i një pale ose dëshmitar, ekspert ose që ka paraqitur një kallëzim, ankim, kërkesë për procedim ose që ka dhënë apo ka marrë pjesë në dhënien e vendimit për autorizimin e procedimit".

Neni 111, "I pandehuri i izoluar me masë sigurimi ka të drejtë të paraqesë ankesa, kërkesa dhe deklarata nëpërmjet drejtorit të institucionit, i cili lëshon dokument për marrjen në dorëzim të tyre. Ato regjistrohen në një libër të veçantë, i komunikohen menjëherë organit kompetent dhe kanë efekt njëloj sikur të ishin pranuar drejtpërdrejt nga ai organ. I pandehuri që është në gjendje arresti në shtëpi ose që mbahet në ruajtje në një vend kurimi, ka të drejtë të paraqesë ankesa, kërkesa dhe deklarata tek oficeri i policisë gjyqësore, i cili vërteton marrjen në dorëzim të tyre dhe kujdeset për dërgimin menjëherë tek autoriteti kompetent. Po këto rregulla zbatohen edhe për kallëzimet, ankesat, kërkesat dhe deklaratat që paraqiten nga palët private ose nga i dëmtuari".

Neni 284, "Për veprat penale të parashikuara nga nenet 85, 89, 102 paragrafi i parë, 105, 106, 130, 239, 240, 241, 243, 264, 275 dhe 318 të Kodit Penal, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e të dëmtuarit, i cili mund ta tërheqë atë në çdo fazë të procedimit. Ankimi bëhet nga i dëmtuari te prokurori ose në policinë gjyqësore me anën e një deklaratë, në të cilën personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të posaçëm, shfaqet vullneti që të procedohet në lidhje me një fakt të parashikuar nga ligji si veprë penale. Kur ankimi bëhet me gojë procesverbali që mbahet

për këtë qëllim nënshkruhet nga ankuesi ose përfaqësuesi i tij. Ai që merr ankimin sigurohet për identitetin e ankuesit dhe i dërgon aktet prokurorit. Për rastet e parashikuara nga neni 59, ankimi bëhet në gjykatë nga i dëmtuari akuzues”.

Neni 285, “Heqja dorë nga e drejta e ankimit bëhet personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit me deklaratë të nënshkruar ose me gojë para prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore, i cili mban procesverbal të nënshkruar detyrimisht nga deklaruesi. Heqja dorë me afat ose me kusht nuk është e vlefshme. Në të njëjtën deklaratë mund të bëhet heqja dorë edhe nga padia civile”.

Neni 286, “Tërheqja e ankimit bëhet personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit me deklaratë të paraqitur në organin që procedon. Tërheqja e ankimit mund të bëhet në çdo fazë të procedimit, gjersa vendimi i gjykatës nuk ka marrë formën e prerë. Shpenzimet e procedimit janë në ngarkim të atij që tërheq ankimin, përveçse kur në aktin e tërheqjes është parashikuar, me marrëveshje, që ato të jenë tërësisht ose pjesërisht në ngarkim të atij kundër të cilit është bërë ankimi”.

Neni 339, Seanca gjyqësore është publike, përndryshe quhet e pavlefshme. Nuk pranohen në seancë të miturit nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe ata që janë në gjendje dehje, intoksikimi ose çrregullimi mendor. Ndalohet prania në seancë e personave të armatosur, me përjashtim të pjesëtarëve të forcave të ruajtjes së rendit.

Neni 340 Gjykata vendos që shqyrtimi gjyqësor ose disa veprime të tij të zhvillohen me dyer të mbyllura kur publiciteti mund të dëmtojë moralin shoqëror ose mund të sjellë përhapjen e të dhënave që duhet të mbahen sekret në interes të shtetit; në qoftë se një gjë e tillë kërkohet nga organi kompetent; kur nga ana e publikut ka shfaqje që prishin zhvillimin e rregullt të seancës; kur është e nevojshme të mbrohet siguria e dëshmitarëve ose e të pandehurve; kur gjykohet e nevojshme në pyetjen e të miturve.

Vendimi i gjykatës për zhvillimin e seancës me dyer të mbyllura revokohet kur pushojnë shkaqet që e sollën atë.

#### *Neni 14*

Në bazë të nenit 44 të Kushtetutës, “Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore”.

Sipas kreut V të Kodit të Procedurës Penale, "Kompensimi për Burgim të Padrejtë" neni 268-269 "Ai që është deklaruar i pafajshëm me vendim të formës së prerë ka të drejtën e kompensimit për paraburgimin e vuajtur, me përjashtim të rasteve kur është provuar që vendimi i gabuar ose moszbulimi në kohën e duhur i faktit të panjohur është shkaktuar tërësisht ose pjesërisht prej tij. E njëjta e drejtë i takon edhe të dënuarit që ka qenë i paraburgosur, kur me vendim të formës së prerë vërtetohet se akti me të cilin është caktuar masa është nxjerrë pa qenë kushtet e parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale (nenet 228 dhe 229). Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 zbatohen edhe në favor të personit për të cilin është vendosur pushimi i çështjes nga gjykata ose prokurori. Kur me vendim të gjykatës është vërtetuar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, për shkak të shfuqizimit të dispozitës përkatëse, e drejta e kompensimit nuk njihet për atë pjesë të paraburgimit të vuajtur para shfuqizimit. Kërkesa për kompensim duhet të bëhet, ndryshe nuk pranohet, brenda tre vjetëve nga data në të cilën vendimi i pafajësisë ose i pushimit të çështjes ka marrë formë të prerë. Masa e kompensimit dhe mënyra e llogaritjes, si dhe rastet e kompensimit për arrestin në shtëpi caktohen me ligj të veçantë".

Neni 397 i këtij Kodi parashikon se, "Me vendimin që pranon kërkesën e kthimit të sendit ose të shpërblimit të dëmit, gjykata detyron solidarisht të pandehurin dhe të paditurin civil për pagimin e shpenzimeve procedurale në dobi të paditësit civil, përveçse kur çmon se duhet të vendosë kompesimin tërësor ose të pjesshëm të tyre. Kur rrëzohet kërkesa ose kur i pandehuri deklarohej i pafajshëm, përveç rastit që është i papërgjegjshëm, gjykata detyron paditësin civil me pagimin e shpenzimeve procedurale të bëra nga i pandehuri dhe nga i padituri civil për efekt të padisë civile, por gjithnjë kur nuk ekzistojnë shkaqe për kompesimin tërësor a të pjesshëm. Kur vërtetohet pakujdesia e rëndë, gjykata mund ta detyrojë edhe me shpërblimin e dëmeve të shkaktuara të pandehurit ose të paditurit civil".

Në vijim Kodi i Procedurës Penale, neni 459 parashikon se, "Ai që ka marrë pafajësinë gjatë rishikimit, kur nuk ka dhënë shkak me dashje ose pakujdesi të rëndë për gabimin gjyqësor, ka të drejtë për një kompensim në përpjesëtim me kohëzgjatjen e dënimit dhe me pasojat personale dhe familjare që rrjedhin nga dënimi. Kompensimi bëhet me pagimin e një shume parash ose me dhënien e një të ardhure jetësore. Kërkesa për kompensim bëhet, me pasojë mospranimi, brenda dy vjetëve nga dita që vendimi i rishikimit ka marrë formë të prerë dhe

paraqitet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin. Kërkesa i komunikohet prokurorit dhe të gjithë të interesuarve. Kundër vendimit për kompensim mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit.

Kur i dënuari vdes, qoftë edhe para procedimit të rishikimit, e drejta për kompensim u përket trashëgimtarëve të tij. Këtë të drejtë nuk e përfitojnë trashëgimtarët e padenjë" (neni 460).

Në bazë të ligjit nr.7514 "Për Pafajësinë, Amnistinë dhe Rehabilitimin e ish të Dënuarve Politikë" datë 30.09.1991, ndryshuar me ligjin nr.7660, datë 14.01.1993 dhe ligjin datë 29.06.1993, personave të cilët në bazë të këtij ligji përfitojnë pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin, "U behet kompensimi per demet e shkaktuara dhe u jepet nje shperblim i caktuar per plotesimin e kushteve te jeteses, sipas rregullave qe do te vendosen me dispozita te vecanta ne perputhje me kriteret nderkombetare. U njihet e drejta e kthimit ose e kompesimit te pasurive te konfiskuara. Kompensimi per demet e shkaktuara u jepet edhe familjeve ose trashegimtareve te ligjshem te ish te burgosurve politike qe nuk jetojne me si edhe te atyre qe jane te pushkatuar pa gjyq ose qe kane vdekur pa u denuar nga gjykata. perfitojne pension, sipas dispozitave per pensionet familjare, familjaret e te pushkatuarve dhe te denuarve pa gjyq, te te vdekurve ne burg ose te atyre qe kane vdekur ne burg pa u denuar me gjyq (neni 5/d, dh, e).

Sipas nenit 6 dhe 7 të të njëjtit ligj "Te drejtat e njohura ne nenin 5 te ketij ligji, i perfitojne edhe personat e debuar apo te internuar per motive politike dhe ata qe janë akuzuar për krime politike dhe janë mbyllur në institucione psikiatrike për mjekim të detyrueshëm. Te gjitha te drejtat e njohura ne kete ligj per te denuarit politik u njihen dhe familjeve te personave qe kane vdekur gjate procesit te hetimit ose qe jane ekzekutuar pa gjyq" Nga ky ligj nuk përfitojnë ata që kanë bërë pjesë në nomenklaturën e lartë të shtetit komunist dhe në organet e tij të diktaturës, të cilët janë të implikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me faje të tilla penale si urdhërat për arrestime, burgime, internime e shpërngulje të familjeve si pasojë e luftës së klasave dhe që kanë marrë pjesë aktive në përdorimin e mjeteve të dhunës kundër të dënuarve në hetuesi, burgje, kampe etj., kur këto vepra provohen me rrugë gjyqësore".

Sipas ligjit të mësipërm, ish-të burgosurve politikë, për kohën e qëndrimit në burg, ose në kampet e punës, i jepet dëmshpërblimi sipas rregullave që do të vendosen në dispozita të veçanta në përputhje me kriteret ndërkombëtare, si dhe diferenca e pensionit që nga koha e lindjes të së drejtës për përfitimin e tij. Të drejtën e pensionit e përfitojnë fëmijët e ish-të burgosurve politikë që vazhdojnë studimet pavarësisht

nga mosha. Dëmshtëpërblimi për kohën e qëndrimit në burg ose në kampet e punës si dhe diferenca e pensionit u jepet dhe familjeve të ish-të burgosurve politikë që nuk jetojnë më. U njihet e drejta e kthimit të pasurive të konfiskuara ose e kompensimit të këtyre pasurive deri në masën që përfitojnë të gjithë të shpronësuarit e tjerë me ligje e vendime të veçanta.

Me ligjin nr. 8246, datë 01.10.1997, "Për Institutin e Integritit të të Përndjekurve" u formua Instituti i të Përndjekurve, në varësi të Këshillit të Ministrave. Sipas nenit 1 të ligjit, Instituti krijohet si një organizëm shtetëror më vete, i cili ka për qëllim të marrë të gjitha masat dhe të ndjekë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me integritimin në jetën e shoqërisë shqiptare të ish të përndjekurve politikë nga regjimi komunist.

Gjithashtu ky Institut përgjigjet edhe për kërkesat e vazhdueshme të shtresës së të përndjekurve politikë dhe në të njëjtën kohë ai punon për gjetjen e konsensusit me shoqatat e ndryshme të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, me qëllim përmirësimin e kushteve dhe të trajtimit të tyre.

Sipas dispozitave të Kodit Civil, neni 608 "Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar. Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj. Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cënimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.

Personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur ka pësuar një dëmtim të shëndetit ose është cënuar në nderin e personalitetit të tij; është fyer kujtimi i një të vdekuri dhe kërkohet nga bashkëshorti me të cilin ka bashkëjetuar deri në ditën e vdekjes ose nga të afërmit e tij deri në shkallën e dytë, përveç kur fyerja është kryer kur i vdekuri ka qenë gjallë dhe i është njohur e drejta e shpërblimit të dëmit për fyerjen e bërë. B drejta e parashikuar në paragrafin e mësipërm është e patrashëgueshme.

Personi që i ka shkaktuar tjetrit një dëm në shëndetin e tij, detyrohet ta shpërblejë dëmin, duke patur parasysh humbjen ose pakësimin e aftësisë për punë të të dëmtuarit, shpenzimet që janë bërë për mjekimin e tij, si dhe shpenzime të tjera që kanë lidhje me dëmin e shkaktuar.

Masa e shpërblimit të dëmit mund të ndryshojë në të ardhmen, në varësi të përmirësimit apo rëndimit të shëndetit ose të shtimit apo pakësimit të aftësisë për punë të të dëmtuarit, në krahasim me kohën

e caktimit të shpërblimit dhe të ndryshimeve që mund të ketë pësuar paga e të dëmtuarit.

Kur është shkaktuar vdekja e një personi, dëmi që duhet të shpërblejë përbëhet nga shpenzimet për ushqim e jetesë të fëmijëve të tij të mitur, të bashkëshortes dhe prindërve të paaftë për punë që kanë qenë në ngarkim të të vdekurit, plotësisht ose pjesërisht, si dhe të personave që banonin në familjen e të vdekurit dhe që gëzonin prej tij të drejtën e ushqimit; shpenzimet e duhura për varrimin e të vdekurit, në masën që ato i përgjigjen rrethanave personale e familjare të të vdekurit. Personi që ka shkaktuar dëmin mund të kundrejtojë të njëjtat mjete mbrojtëse që do t'i kundrejtonte të vdekurit. Gjykata, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes, mund të vendosë që shpërblimi të jepet në natyrë, ose në para, njëherësh ose me këste.

Kur personi që ka kryer veprimin apo mosveprimin e paligjshëm krahas dëmit të shkaktuar, ka patur edhe një përfitim të dukshëm, gjykata me kërkesën e palës së dëmtuar duke patur parasysh natyrën e dëmit, shkallën e fajësisë e rrethana të tjera të çështjes mund të llogarisë në shpërblimin e dëmit, tërësisht apo pjesërisht përfitimin.

Kur shkaktohet vdekja ose dëmtimi i shëndetit të një personi që fiton nga sigurimet shoqërore, dëmi shpërblehet në mënyrën e caktuar me ligj. Për një person që nuk ka qenë në marrëdhënie pune ose nuk ka qenë i siguruar, masa e shpërblimit të dëmit të rrjedhur nga vdekja ose dëmtimi i shëndetit, caktohet nga gjykata në bazë të pagës që merr një punonjës i asaj kategorie me të cilën mund të barazohet edhe puna që kryente ose mund të kryente i dëmtuari.

I mituri i dëmtuar, kur mbush moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe nuk ka pagë nga puna e tij, ka të drejtë që në vend të shpërblimit që merr për jetesë, të kërkojë të shpërblehet për humbjen e aftësisë së tij për punë me pagën mesatare të një punonjësi, sipas kriterëve të nenit 646 të këtij Kodi. Me mbushjen e moshës tetëmbëdhjetë vjeç ka të drejtë që në vend të shpërblimit që merr, të kërkojë të shpërblehet me pagën mesatare të një punëtori të asaj kategorie që do të kishte fituar ose duhej të kishte fituar po të mos ishte shkaktuar dëmtimi i shëndetit.

#### *Neni 15*

Neni 32 i Kushtetutës parashikon se:

Askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose familjes së vet dhe as të pohojë fajësinë e tij.

Askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

Në bazë të nenit 312 të Kodit Penal “Propozimi ose dhënia e shpërblimeve, dhuratave apo përfitimeve të tjera, ose kanosja apo vepra të tjera dhune që i bëhen personit për të siguruar dëshmi, ekspertim apo përkthim të rremë, ose për të refuzuar kryerjen e detyrave të tyre përpara organeve të ndjekjes penale dhe gjykatës, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Në vijim, neni 314 i Kodit parashikon se, “Përdorimi i dhunës nga personi i ngarkuar me zhvillimin e hetimeve për ta detyruar shtetasin të bëjë deklaratë, të dëshmojë ose të pohojë fajësinë e tij a të një tjetri, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet”.

Neni 3/2 i Kodit të Procedurës Penale, parashikon se: “Gjykata jep vendim në bazë të provave që shqyrtohen e verifikohen në seance gjyqësore”.

Sipas nenit 151/3-4 të Kodit, “Kur kërkohet një provë që nuk rregullohet me ligj, gjykata mund ta marrë në qoftë se ajo vlen për të vërtetuar faktet dhe nuk cenon lirinë e vullnetit të personit. Gjykata vendos për marrjen e provës pasi dëgjon palët mbi mënyrën e marrjes së saj. Provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren. Papërdorshmëria ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit”.

Neni 316/b, “Gjatë hetimeve paraprake, prokurori dhe i pandehuri mund të kërkojnë nga gjykata që të procedohet me sigurimin e provës në rastin e marrjes së dëshmisë, kur ka arsye të bazuara për të menduar se personi mund të jetë objekt dhune, kanosje ose premtimi për t’i dhënë para ose përfitime të tjera me qëllim që të mos bëjë dëshmi ose të bëjë dëshmi të gënjeshtërt”.

Neni 357, “Gjykata, pasi dëgjon palët, jep vendim për marrjen e provave. Gjatë shqyrtimit gjyqësor palët mund të bëjnë pretendime lidhur me marrjen e provave. Gjykata mund të revokojë me vendim marrjen e provave që dalin të panevojshme ose të pranojë marrjen e provave që kanë qenë refuzuar.

Neni 450/ç, në lidhje me rishikimin e vendimit parashikon se mund të kërkohet rishikimi i një vendimit të formës së prerë kur vërtetohet se vendimi është dhënë si pasojë e falsifikimit të akteve të gjykimit ose të një fakti tjetër të parashikuar nga ligji si vepër penale.

Në vijim të punës intensive që po zhvillohet, si arsye kryesore



për këtë afat kohor është konstatimi i vështirësive dhe kompleksitetit të marrëdhënieve juridike që synohet të rregullohen, si në planin e brendshëm edhe në atë ndërkombëtar. Po kështu, projektligji për mbrojtjen e dëshmitarëve përmban disa norma dhe angazhime të shtetit kundrejt jetës, shëndetit dhe trajtimit të posaçëm të dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve të drejtësisë etj, që kanë efekte të veçanta në aspektin material dhe procedural penal, efekte sociale e financiare (strehim, mjete jetese, ndryshim identiteti, punësim, shkollim etj.), efekte në burime njerëzore, në përgatitjen, trajtimin dhe specializimin e strukturave shtetërore etj.

### *Neni 16*

Ligji nr. 8092, datë 21.03.1996, "Për Shëndetin Mendor" rregullon procedurën mbi kushtet e dhënies së kujdesit psikiatrik dhe në të njëjtën kohë detyrimet e shtetit dhe pushtetit lokal për organizimin e kujdesit për personat me çrregullime mendore.

Neni 3 i ligjit parashikon se politika parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor mbështetet në:

- Zbatimin e parimeve të mbrojtjes së shëndetit mendor në institucionet arsimore, shëndetësore, qendrat e punës dhe repartet ushtarake.

- Ngritjen e institucioneve parandaluese dhe këshilluese.

- Mbështetjen e organizmave dhe iniciativave në fushën e kujdesit të shëndetit mendor.

- Përfshirjen e elementeve të kujdesit shëndetësor mendor në programet e formimit për personat që punojnë në sektorët e arsimit, përkujdesjes shoqërore, shëndetësisë, administratës, organizimit të veprimtarive shlodhëse.

- Realizimin e kërkimeve në fushën e përmirësimit të shëndetit mendor dhe parandalimin e çrregullimeve mendore.

- Rikuperimin e shëndetit mendor të të sëmurët.

Personat me zhvillim mendor të vonuar dhe ata me çrregullime mendore trajtohen falas në institucionet publike të kurimit, rehabilitimit, arsimit dhe edukimit. Kur këta persona janë nën moshën 18 vjeç dhe trajtohen në institucione private, shteti mbulon pjesën e shpenzimeve të barabartë me koston e trajtimit në institucionet publike.

Në vazhdim, neni 8 i ligjit parashikon se, "Në të gjitha institucionet psikiatrike dhe rehabilituese, Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes

Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë cakton punonjës socialë, të cilët mbikëqyrin trajtimin e pacientëve nga pikëpamja sociale dhe e mbrojtjes së të drejtave të tyre.

Heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar i personave me çrregullime mendore ose me prapambetje mendore mund të propozohet nga komisioni psikiatriko-ligjor, i përbërë nga jo më pak se 3 veta. Vendimi përkatës merret nga gjykata në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. Në vendim gjykata cakton edhe kujdestarin ligjor të tij”.

Titullari i institucionit psikiatrik e rehabilitues duhet të njoftojë gjykatën e rrethit, nëse vërtetohet që kujdestari ligjor i personit me çrregullime mendore ose me prapambetje mendore, që ndodhet nën kontrollin e institucionit të tij, nuk i përmbush detyrimet e tij. Në këtë rast gjykata mund të revokojë kujdestarin e caktuar më parë, duke caktuar një kujdestar të ri.

Personi i sëmurë, kujdestari i tij ligjor dhe familjarët e tij gëzojnë të drejtën për t’u informuar për gjendjen shëndetësore të tij si dhe metodat e ekzaminimit e të kurimit që do të zbatohen. Informacioni jepet nga mjeku kurues ose punonjësi social, në bazë të gjendjes shëndetësore të pacientit dhe të parimeve të etikës mjekësore.

Për realizimin e detyrimeve të këtij ligji, kufizimi fizik i personave me çrregullime mendore mund të përdoret vetëm kur personi paraqet rrezikshmëri për shëndetin dhe/ose jetën e tij dhe të të tjerëve; kryen veprime kundër sigurisë publike; me veprimet e tij dëmton ose shkatërron objektet përreth; si dhe në të gjitha ato raste që parashikohen në rregulloren e shërbimit psikiatrik.

Vendimi për të zbatuar kufizimin fizik merret nga mjeku, i cili përcakton mënyrën e kufizimit dhe mbikëqyr personalisht zbatimin e saj. Në institucionet psikiatrike e rehabilituese, kur është i pamundur sigurimi i vendimit të menjëhershëm të mjekut, vendimi për zbatimin e kufizimit fizik jepet nga infermieri, i cili njofton menjëherë mjekun. Mjeku mund të shfuqizojë vendimin e infermierit, kur e gjen të padrejtë. Veprimet e mjekut, si dhe vendimet e marra nga ai pasqyrohen në dokumentacionin përkatës.

Përpara zbatimit të kufizimit fizik, personi që do të kufizohet duhet të informohet. Gjatë zbatimit të kufizimit fizik duhet të zgjidhet mënyra më pak shqetësuese dhe të tregohet kujdes për mirëqenien e personit.

Vendimi i kufizimit fizik duhet të përligjet brenda 24 orëve nga

marrja e tij përpara një komisioni të përhershëm të ngritur për këtë qëllim pranë institucionit psikiatrik e rehabilitues. Përbërja e komisionit, të drejtat dhe detyrat, si dhe mënyra e funksionimit të tij, përcaktohen me rregullore të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mjedisit. Ministria e Shëndetësisë akoma nuk e ka miratuar një rregullore të tillë.

Një person me çrregullime mendore mund të shtrohet në një institucion psikiatrik, pa marrë miratimin e tij, apo të kujdestarit ligjor, vetëm nëse për shkak të çrregullimit mendor të tij ai paraqet rrezik të drejtpërdrejtë për jetën ose shëndetin e tij dhe të të tjerëve. Vendimi për shtrimin e një personi merret nga mjeku specialist vetëm pasi të ketë kryer personalisht ekzaminimin e tij. Personi i sëmurë, familjarët e tij ose kujdestari ligjor gëzojnë të drejtën të informohen për shkaqet e marrjes së këtij vendimi. Procedurat e shtrimit pasqyrohen në kartelat klinike.

Mjeku që vendos shtrimin pa miratimin e personit, kujdestarit ligjor të tij, duhet të njoftojë brenda 24 orëve shefin e klinikës, i cili lejon ose jo mbajtjen e mëtejshme të personit në institucionin psikiatrik. Shefi i klinikës, brenda 48 orëve nga dhënia e lejes për shtrim të detyruar, duhet ta paraqesë rastin përpara gjykatësit të vetëm në gjykatën e rrethit ku ndodhet insitucioni.

Gjyqtari i vetëm, i cili shqyrton çështjen jo më vonë se 3 ditë nga paraqitja e saj, thërret për shpjegime personin e shtruar në institucionin pa miratimin e tij, kujdestarin ligjor të tij, mjekun që ka kryer shtrimin, shefin e klinikës që e ka lejuar, si dhe familjarët ose personat e interesuar për të shtruarin. Vendimi i gjyqtarit të vetëm për ta mbajtur ose për ta nxjerrë të sëmurin nga institucioni psikiatrik zbatohet menjëherë.

Për çdo person të shtruar me ose pa miratimin e tij në një institucion psikiatrik, familja e tij ose përfaqësuesi ligjor kanë të drejtën të kërkojnë daljen nga spitali në çdo kohë. Kjo kërkesë mund të bëhet në çdo formë dhe regjistrohet në kartelën klinike personale. Nëse refuzohet dalja nga spitali, ata kanë të drejtën të ankohen në gjykatën e rrethit ku ndodhet institucioni psikiatrik, brenda 7 ditësh nga dita e marrjes dijeni, dhe çështja shqyrtohet nga gjyqari i vetëm, vendimi i të cilit është i formës së prerë.

Institucionet psikiatrike janë të detyruara të shqyrtojnë të gjitha kërkesat, ankesat dhe propozimet e bëra nga shoqata a grupime të tjera vullnetare të pacientëve, familjarëve ose personave të interesuar për mbrojtjen e interesave të të sëmurëve mendorë.